



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
QERSHOR 2026

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i dytë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2026

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 2, datë 25.06.2026
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i bordit

Gjeneral brigade **Ferdinant Dimo**

Anëtarët e Bordit

Gjeneral brigade **Fatmir Neziraj**

Kolonel (R) Msc. **Dilaver Hoxha**

Prof. as. dr. **Etleva Smaçi**

Prof. as. dr. **Teki Kurti**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Nënkolonel (R) Dr. **Enrik Ago**

Nënkolonel Dr. **Fitim Karasani**

Përgatiti për botim: Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit, IKSHU

Art design: Engjellushe Llulla

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2026 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në “Revista Ushtarake” janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: Qershor 2026

PËRMBAJTJA E REVISTËS USHTARAKE

RUBRIKA E PARË

Siguria dhe mbrojtja në mjedisin bashkëkohor: analiza dhe vlerësime

Sfidat shumëdimensionale të sigurisë dhe ndikimi i tyre në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare	9
---	----------

Kolonel (R) Msc. Agim Shahu

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

Një vështrim mbi konceptin strategjik të NATO-s dhe përshtatja e tij me një mjedis sigurie në ndryshim	25
---	-----------

Dr. Edlira Titini

Pedagoge për Marrëdhëniet Ndërkombëtare,

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

Demografia dhe fuqia kombëtare: implikime strategjike për sigurinë dhe zhvillimin	39
--	-----------

Nënkolonel (R) Msc. Alqi Nikolla

Oficer shtabi/specialist/kërkues për studime dhe analizë strategjike,

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Ndikimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak në mjedisin e sigurisë globale	57
---	-----------

Nënkolonel Ervin Hodo

Oficer shtabi, Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

RUBRIKA E DYTË

Zhvillimi i teknologjisë dhe inovacionit në fushën e mbrojtjes

Inteligjenca artificiale dhe “agjentët” autonomë të saj në sistemet e mbrojtjes	73
--	-----------

Kolonel (R) Msc. Adi Ndoni

Oficer shtabi, kërkues I, specialist për FT,

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Hendeku i aftësive në sigurinë kibernetike: Një vlerësim empirik i mospërputhjeve të tregut të punës në Shqipëri dhe implikimet për hartimin e politikave arsimore	87
---	-----------

Dr. Gentian Hoxhalli

*Përgjegjës i Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit,
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA*

Roli i kriptografisë në sigurinë kibernetike	101
---	------------

Dr. Ulsi Meta

RUBRIKA E TRETË

Arsimimi ushtarak, lidhshipi dhe zhvillimi profesional

Mësimdhënia e ‘Anglishtes për Qëllime Ushtarake’ dhe analiza e ligjërimit operacional: disa karakteristika leksikore dhe pragmatike	119
--	------------

Dr. Alma Vladi,

Dr. Manjola Likaj

*Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Gjuhëve të Huaja,
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA*

Inteligjenca artificiale në arsimin ushtarak: perceptimet dhe përdorimi nga studentët dhe stafit pedagogjik	131
--	------------

Nënkolonel Mazllum Alla

*Kërkues për studime dhe analizë strategjike,
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA*

RUBRIKA E KATËRT

Punime historike

Konflikti në Lindjen e Mesme – një përshkrim i përmbledhur nga origjina deri në fillim të shekullit XXI	151
--	------------

Nënkolonel Latif Shurdhi

Pedagog në Kolegjin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë

Një vështrim historik mbi shërbimet inteligjente gjatë Luftës së Ftohtë	165
--	------------

Major Msc. Kujtim Zeka

Pedagog në Fakultetin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë, AFA

Kolonel Msc. Myslym Rrasa

Shef shtabi në Bazën Ajrore, Kuçovë

RUBRIKA E PARË

**SIGURIA DHE MBROJTJA
NË MJEDISIN BASHKËKOHOR:
ANALIZA DHE VLERËSIME**

Sfidat shumëdimensionale të sigurisë dhe ndikimi i tyre në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare

Kolonel (R) Agim SHAHU
Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar

Ky punim trajton sfidat shumëdimensionale të sigurisë si një realitet të ri strategjik që prodhon implikime të drejtpërdrejta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për gjithë sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Teza themelore e studimit është se rreziqet bashkëkohore nuk shfaqen më si kërcënime të izoluara, por si procese të ndërthurura me natyrë ushtarake, hibride, kibernetike, ekonomike, informative dhe civile. Këto procese ndikojnë njëkohësisht në gatishmërinë operacionale, në qëndrueshmërinë institucionale dhe në aftësinë e shtetit për të garantuar vazhdimësinë e funksioneve themelore.

Studimi mbështetet në analizë cilësore, interpretim strategjik dhe qasje shkak-pasojë, duke e vendosur theksin jo vetëm tek identifikimi i sfidave, por te mekanizmat përmes të cilëve ato prodhojnë efekt mbi mbrojtjen e sigurinë kombëtare. Përfundimi kryesor i punimit është se implikimi themelor i këtij mjedisi sigurie është nevoja për ta konceptuar mbrojtjen kombëtare si sistem të integruar kapacitetesh, funksionesh dhe mekanizmash reagimi. Në këtë kuadër, FARSH mbetet instrumenti qendror i mbrojtjes ushtarake, por jo i shkëputur nga qëndrueshmëria kombëtare, mbrojtja civile dhe bashkërendimi ndërinstitutional.

Fjalë kyçe: siguri shumëdimensionale, FARSH, mbrojtje dhe siguri kombëtare, parandalim dhe mbrojtje, rezistencë/qëndrueshmëri, kërcënime hibride, siguri kibernetike, mbrojtje civile.

Hyrje

Mjedisi ndërkombëtar i sigurisë në dekadën e fundit ka pësuar një transformim të dukshëm, jo vetëm për shkak të rikthimit të konfliktit të armatosur në hapësira të rëndësishme strategjike, por edhe për shkak të rritjes së paqartësisë, të paqëndrueshmërisë dhe të ndërvarësisë së krizave. Në dallim nga periudhat kur kërcënimet perceptoheshin kryesisht në prizmin ushtarak, sot ato paraqiten në forma të ndërthurura dhe prekin njëkohësisht sektorë të ndryshëm të jetës shtetërore. Në këtë kuptim, siguria nuk përkufizohet më vetëm si ruajtje e integritetit territorial, por edhe si mbrojtje e funksioneve jetike, e infrastrukturës kritike, e rendit institucional, e ekonomisë, e informacionit dhe e qëndrueshmërisë së përgjithshme të shoqërisë.

Kjo ndryshon edhe mënyrën se si duhet parë roli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. FARSH mbetet institucioni kryesor i mbrojtjes dhe sigurisë ushtarake të vendit, por në kushtet e sfidave shumëdimensionale ajo vepron si pjesë e një sistemi më të gjerë shtetëror, ku ndërthuren detyrat e parandalimit, mbrojtjes, mbështetjes së institucioneve, reagimit në situata emergjente dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Kjo qasje nuk e zbeh funksionin themelor të forcës ushtarake; përkundrazi, e vendos atë në një kuadër më realist dhe më funksional, ku mbrojtja kombëtare kuptohet si e lidhur ngushtë me qëndrueshmërinë kombëtare.

Tema e këtij punimi është bashkëkohore, sepse reflekton një situatë reale sigurie në zhvillim e sipër, ku trysnitë strategjike nuk shfaqen vetëm në formën e kërcënimeve të drejtpërdrejta, por edhe nëpërmjet ndërhyrjeve në informacion, ekonomi, teknologji, energji, infrastrukturë dhe psikologji publike. Pikërisht për këtë arsye, studimi synon të analizojë jo vetëm natyrën e sfidave, por edhe implikimet e tyre praktike për mbrojtjen kombëtare, pasojat që mund të prodhojnë dhe drejtimet kryesore ku duhet të orientohet veprimi shtetëror për të ardhmen.

Objekti i studimit, pyetjet kërkimore, teza, metodologjia dhe kuadri konceptual

Objekti i këtij studimi, është analiza e implikimeve që sfidat shumëdimensionale të sigurisë prodhojnë mbi FARSH dhe mbi sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Qëllimi i tij nuk është të japë një listë rreziqesh, por të shpjegojë mënyrën se si këto sfida ndikojnë mbi funksionet kryesore të mbrojtjes: gatishmërinë operacionale, zhvillimin e kapaciteteve, mbrojtjen e infrastrukturës kritike, mbështetjen civile dhe aftësinë për reagim të koordinuar.

Pyetjet kërkimore, që drejtojnë analizën janë këto: cilat janë tiparet themelore të sfidave shumëdimensionale në mjedisin aktual strategjik; në çfarë

mënyre ato ndikojnë mbi funksionet e FARSH dhe mbi sistemin kombëtar të mbrojtjes; cilat pasoja prodhojnë mbi qëndrueshmërinë institucionale, mbi mbështetjen civile dhe mbi përgatitjen për të nesërmen; dhe cilat kërkesa për transformim burojnë nga kjo situatë për politikën e mbrojtjes dhe për zhvillimin afatmesëm të kapaciteteve.

Teza qendrore e punimit, është se sfidat shumëdimensionale të sigurisë nuk sjellin vetëm rritje të rrezikut, por prodhojnë implikime strukturore për mënyrën se si duhet të konceptohet, të organizohet dhe të mbështetet mbrojtja kombëtare. Këto implikime prekin njëkohësisht komponentin ushtarak, institucional, civil, logjistik, informativ dhe kibernetik të shtetit; për rrjedhojë, përgjigjja ndaj tyre kërkon kalim nga qasje kryesisht reaguese në një model të integruar që mbështetet në parandalim, gatishmëri, rezistencë dhe bashkërendim ndërinstitucional.

Metodologjia, e përdorur është cilësore, analitike dhe interpretuese. Studimi mbështetet në analizën e dokumenteve strategjike dhe të politikave publike në fushën e sigurisë e mbrojtjes, në interpretimin e zhvillimeve bashkëkohore të mjedisit strategjik dhe në vlerësimin shkak-pasojë të lidhjes midis llojit të sfidës, mekanizmit të ndikimit dhe implikimit që ajo prodhon për FARSH dhe për sistemin e mbrojtjes e sigurisë kombëtare. *Në kuadrin konceptual*, sfidat shumëdimensionale kuptohen si rreziqe të ndërlidhura me natyrë ushtarake, hibride, kibernetike, ekonomike, informative dhe civile; ndërsa rezistenca apo qëndrueshmëria kombëtare kuptohet si aftësia e shtetit për të përballuar situata, për të ruajtur funksionet kritike dhe për t'u rikuperuar shpejt dhe në mënyrë të organizuar.

Sfidat shumëdimensionale si realitet i ri i mjedisit strategjik

Sfidat shumëdimensionale të sigurisë janë të tilla sepse përfshijnë njëkohësisht disa fusha veprimi dhe prodhojnë pasoja që nuk kufizohen në një sektor të vetëm. Në planin strategjik, ato lidhen me rritjen e konkurrencës ndërkombëtare, me paqëndrueshmërinë rajonale, me riformatimin e interesave të sigurisë dhe me rikthimin e krizave të zgjatura që shtrihen nga niveli lokal në atë ndërkombëtar¹. Në planin ushtarak, këto sfida reflektojnë zhvillime që tregojnë se përdorimi i forcës mbetet realitet dhe se shtetet duhet të ruajnë kapacitete të besueshme mbrojtëse. Në planin jo-kinetik, ato manifestohen në formën e sulmeve kibernetike, fushatave të dezinformimit, trysnive ekonomike, goditjeve ndaj infrastrukturës kritike dhe rritjes së ndjeshmërisë së sistemeve publike dhe private.

¹ Vizioni i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për periudhën 2026-2028

Karakteristika themelore e mjedisit aktual është ndërthurja. Një krizë me origjinë gjeopolitike mund të prodhojë pasoja gjeoeconomike; një sulm kibernetik mund të shoqërohet me ndërhyrje informative; një situatë tensioni rajonal mund të ndikojë psikologjikisht mbi shoqërinë dhe të ngarkojë institucionet përgjegjëse për rendin, sigurinë dhe mbrojtjen civile. Kjo do të thotë se siguria nuk është më një çështje lineare, ku shkaku dhe pasoja janë të lehta për t'u dalluar. Përkundrazi, rreziku modern karakterizohet nga përhapja, nga paqartësia e autorësisë, nga sinkronizimi i mjeteve dhe nga aftësia për të prodhuar konsum të vazhdueshëm institucional pa hyrë domosdoshmërisht në një konflikt të hapur.

Në këtë mjedis, kërcënimet hibride marrin rëndësi të veçantë.² Ato janë hibride jo vetëm sepse përdorin mjete të ndryshme, por sepse synojnë të cenojnë procesin e vendimmarrjes, besimin të institucionet, funksionimin e shërbimeve dhe kohezionin e brendshëm të shoqërisë. Ato shpesh zhvillohen nën prapën e reagimit klasik, duke e vendosur shtetin përballë nevojës për të dalluar kohë pas kohe se kur një shqetësim i pjesshëm po shndërrohet në problem strategjik. Këtu qëndron edhe vështirësia e madhe e sistemit bashkëkohor të sigurisë: jo çdo rrezik është menjëherë i dukshëm, por shumë prej tyre prodhojnë efekt akumulues.

Një dimension po aq i rëndësishëm është ai kibernetik.³ Digjitalizimi i shtetit, i shërbimeve publike, i sistemeve të komunikimit dhe i sektorëve ekonomikë krijon mundësi të mëdha funksionale, por njëkohësisht shton varësinë nga rrjetet dhe sistemet teknologjike. Kjo e bën më të ndjeshme gjithë strukturën kombëtare ndaj ndërprerjeve, bllokimeve, infiltrimeve dhe manipulimeve të të dhënave. Në këtë kuptim, siguria kibernetike është shndërruar në një komponent të drejtpërdrejtë të sigurisë kombëtare dhe nuk mund të trajtohet më si fushë thjesht teknike apo administrative.

Po kështu, dimensionin informativ është shfaqur si një fushë strategjike më vete.⁴ Dezinformimi, përhapja e qëllimshme e narrativave manipuluese, krijimi i klimës së pasigurisë, relativizimi i fakteve dhe instrumentalizimi i platformave të komunikimit mund të dobësojnë aftësinë e shoqërisë për të kuptuar rrezikun dhe për të mbështetur një reagim të bashkërenduar. Për shtete të vogla, ku kohezioni shoqëror dhe besimi institucional kanë peshë të madhe, ky dimension nuk është dytësor. Ai ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë kombëtare.

² NATO 2022 Strategic Concept (Brussels: NATO, 2022).

³ NATO, "Cyber Defence" (Brussels: NATO, 2025).

⁴ Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike, Countering Illegal Foreign Interference and Disinformation as Hybrid Threats in the Republic of Albania 2025–2030 (Tiranë, 2026).

Mjedisi bashkëkohor i sigurisë përfshin gjithashtu trysni ekonomike dhe klimatike. Paqëndrueshmëria e zinxhirëve të furnizimit, luhatja e kostove të energjisë, ndikimet mbi tregjet dhe rritja e cenueshmërisë së sektorëve jetikë prekin aftësinë e shtetit për të ruajtur normalitetin funksional. Ndryshimet klimatike, përmbytjet, zjarret, thatësira, temperaturat ekstreme dhe dëmtimi i infrastrukturës shkaktojnë ngarkesa të mëdha mbi administratën, ekonominë dhe mbrojtjen civile. Këto zhvillime nuk duhen parë jashtë sigurisë kombëtare; ato janë pjesë e saj.

Prandaj, kur flitet për sfida shumëdimensionale të sigurisë, nuk bëhet fjalë për një zgjerim artificial të nocionit të sigurisë, por për pranimin realist të faktit se shteti sot mund të vihet nën presion në disa fronte njëherësh. Sa më i ndërlidhur të jetë sistemi kombëtar, aq më e madhe është nevoja për kuptim të integruar të rrezikut. Kjo përbën pikënisjen e domosdoshme për çdo analizë serioze mbi FARSH dhe mbrojtjen kombëtare. Mbi këtë bazë, hapi pasues është të shihet se si ky realitet strategjik përkthehet në implikime konkrete për funksionet e mbrojtjes.

Mekanizmat e ndikimit dhe implikimet për FARSH dhe funksionet e mbrojtjes e sigurisë kombëtare

Ndikimi i sfidave shumëdimensionale në FARSH duhet parë së pari në planin e konceptimit të misionit.⁵ Forcat e Armatosura mbeten institucioni themelor i mbrojtjes ushtarake, por mënyra si përkufizohet sot mjedisi i sigurisë kërkon që planifikimi i forcës, gatishmëria operationale dhe zhvillimi i kapaciteteve të mos orientohen vetëm nga skenarët klasikë. Ato duhet të reflektojnë mundësinë e krizave të shpejta, të ndërlidhura dhe me pasoja të shpërndara në hapësira të ndryshme të sigurisë. Kjo shton kërkesën për fleksibilitet, për ndërveprueshmëri, për logjistikë më të fortë dhe për aftësi reagimi në kushte pasigurie të lartë.

Në planin organizativ, sfidat shumëdimensionale nënkuptojnë se FARSH duhet të jetë në gjendje të operojë jo vetëm në funksion të mbrojtjes së drejtpërdrejtë, por edhe në mbështetje të mekanizmave kombëtarë të sigurisë dhe emergjencës.⁶ Kjo përfshin mbështetjen e strukturave të mbrojtjes civile, kontributin në reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, sigurimin e vazhdimësisë së disa funksioneve kritike dhe koordinimin me institucione të tjera për të përballuar pasoja të përhapura. Kjo nuk e ndryshon natyrën ushtarake të FARSH, por e bën më të gjerë kuadrin e saj të veprimit në kohë krize.

⁵ Republika e Shqipërisë, *Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë*, (Tiranë, 2024).

⁶ Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, *Direktiva e Mbrojtjes 2024* (Tiranë, 2024).

Ndikimi është i qartë edhe në planin e edukimit, stërvitjes dhe formimit profesional. Personeli ushtarak duhet të jetë i përgatitur jo vetëm për detyra tradicionale, por edhe për mjedise ku informacioni është i kontestuar, komunikimi është i ngarkuar, teknologjia bëhet objekt goditjeje dhe kriza zhvillohet në kushte të ndërthurjes së komponentëve ushtarakë me ata civilë. Kjo kërkon kulturë më të lartë strategjike, njohuri më të gjera mbi qëndresën kombëtare, ndërgjegjësim mbi sigurinë kibernetike dhe aftësi më të mira bashkërendimi me aktorë të tjerë shtetërorë.

Sfidat shumëdimensionale ndikojnë gjithashtu në ecurinë e planit të modernizimit.⁷ Çdo investim në mbrojtje duhet të vlerësohet jo vetëm për efektin e tij në një skenar të vetëm, por për vlerën që krijon në disa skenarë të mundshëm. Kjo nënkupton se kapacitetet e komunikimit, të komandimit, të logjistikës, të vëzhgimit, të mbrojtjes së sistemeve dhe të lëvizshmërisë marrin rëndësi të shtuar. Po ashtu, aftësia për të ruajtur qëndrueshmërinë e funksioneve ushtarake në kushte ndërprerjeje të rrjeteve, dëmtimi të infrastrukturës apo presioni shumë-sektorial është bërë po aq e rëndësishme sa edhe vetë kapaciteti i veprimit operacional.

Në marrëdhënie me sistemin kombëtar të sigurisë, FARSH nuk mund të shihet e shkëputur nga pjesa tjetër e institucioneve. Efektiviteti i saj varet nga funksionimi i logjistikës kombëtare, nga mbrojtja e infrastrukturës kritike, nga siguria e komunikimeve, nga burimet njerëzore, nga mbështetja ligjore dhe nga bashkërendimi ndërinstitucional. Kur këto elemente janë të dobëta, edhe potenciali ushtarak has vështirësi në realizimin e plotë të misionit. Prandaj, ndikimi i sfidave shumëdimensionale mbi FARSH është në të njëjtën kohë i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë: ai vepron mbi vetë forcën, por edhe mbi sistemin që e mbështet atë.

Një aspekt i rëndësishëm për Shqipërinë është fakti se mbrojtja kombëtare zhvillohet brenda një arkitekture kolektive sigurie. Kjo rrit garancitë dhe krijon përfitime të mëdha në planin e partneritetit, standardizimit, stërvitjes dhe koordinimit. Megjithatë, kjo nuk e ul rëndësinë e kapaciteteve kombëtare. Përkundrazi, sa më e thellë të jetë ndërveprueshmëria me partnerët, aq më e nevojshme bëhet që sistemi kombëtar të jetë vetë i qëndrueshëm, funksional dhe i përgatitur. Kontributi në sigurinë kolektive dhe aftësia për të përfituar prej saj lidhen ngushtë me seriozitetin e përgatitjes së brendshme.

Pikërisht për këtë arsye, ndikimi i sfidave shumëdimensionale në FARSH duhet kuptuar si shtysë për transformim të vazhdueshëm profesional dhe jo thjesht si listë kërcënimesh. Sa më i ndërlikuar të jetë mjedisi i sigurisë, aq më shumë kërkohet që institucioni ushtarak të zhvillojë kulturë parashikuese,

⁷ Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033 (Tiranë, 2024).

gatishmëri fleksibile, disiplinë planifikimi dhe kapacitet më të lartë bashkërendimi me të gjithë komponentët e mbrojtjes kombëtare. Pikërisht nga ky nivel ndikimi lind nevoja për të vlerësuar pasojat që këto sfida prodhojnë mbi qëndrueshmërinë e sistemit dhe mbi mbështetjen civile.

Pasojat mbi sistemin e parandalimit, qëndrueshmërisë dhe mbrojtjen civile

Analiza e sfidave shumëdimensionale merr vlerë reale vetëm kur shoqërohet me vlerësimin e pasojave të mundshme. E nesërmja, në kuptimin e sigurisë kombëtare, nuk duhet parë si parashikim abstrakt, por si hapësirë e mundshme rreziku për të cilën shteti duhet të përgatitet paraprakisht. Nëse trendet e paqëndrueshmërisë strategjike vazhdojnë, pasojat mund të shfaqen në disa plane njëherësh: në funksionimin e institucioneve, në mbrojtjen e infrastrukturës kritike, në ekonominë kombëtare, në psikologjinë publike, në rendin civil dhe në kërkesat shtese që mund të ngrihen ndaj FARSH.

Në planin institucional, pasoja e parë e një mjedisi të rënduar shumëdimensional është rritja e konsumit të kapacitetit shtetëror.⁸ Kur krizat shfaqen në forma të ndërthurura, institucionet përballen me nevojën për të menaxhuar njëkohësisht informacionin, komunikimin publik, mbrojtjen e shërbimeve, koordinimin e reagimit dhe ruajtjen e vazhdimësisë. Në mungesë të planeve të qarta, të strukturave funksionale dhe të procedurave të ushtruara paraprakisht, kjo mund të çojë në fragmentim, vonesë vendimmarrjeje dhe ulje të efektivitetit të reagimit. Për rrjedhojë, qëndrueshmëria institucionale është një formë e drejtpërdrejtë e sigurisë.

Në planin e infrastrukturës kritike, pasojat mund të jenë edhe më të ndjeshme.⁹ Sistemet energjetike, rrjetet e komunikimit, transporti, shërbimet digjitale, furnizimet thelbësore dhe objektet me rëndësi të veçantë për funksionimin e shtetit janë pika ku rreziku shumëdimensional mund të prodhojë efekt disproporcional. Edhe një ndërprerje e kufizuar, nëse prek sektorin e duhur dhe shoqërohet me dezinformim apo me trysni të tjera, mund të krijojë klimë pasigurie dhe barrë shtesë mbi administratën, ekonominë dhe mbrojtjen civile. Prandaj, dobësia në infrastrukturë përkthehet drejtpërdrejt në dobësi strategjike.

Në planin ekonomik, pasojat lidhen me rritjen e kostove, me cenimin e parashikueshmërisë dhe me kufizimin e mundësive për investim afatgjatë. Siguria dhe ekonomia nuk janë fusha të ndara. Një shtet që përballlet me pasiguri të lartë në furnizime, energji, komunikime apo tregje duhet të shpenzojë më shumë për të ruajtur normalitetin dhe më pak mund të orientojë

⁸ NATO, "Resilience, Civil Preparedness and Article 3" (Brussels: NATO, 2024).

⁹ NATO, Strengthened Resilience Commitment (Brussels: NATO, 2021).

drejt transformimit afatgjatë. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe mbi mbrojtjen kombëtare, sepse financimi i modernizimit, i rezervave, i stërvitjes dhe i infrastrukturës mbështetëse kërkon qëndrueshmëri ekonomike.

Në planin shoqëror, pasojat mund të shfaqen në formën e rritjes së ndjeshmërisë psikologjike, të qarkullimit të pasigurisë dhe të uljes së besimit tek institucionet, nëse informacioni nuk menaxhohet si duhet. Shpesh, krizat moderne nuk synojnë vetëm të dëmtojnë një objekt apo një sistem, por të krijojnë perceptimin se shteti nuk është në kontroll të situatës. Kjo i jep dimension strategjik komunikimit publik, qartësisë institucionale dhe ruajtjes së unitetit shoqëror. Në këtë kuptim, kohezioni kombëtar është një faktor sigurie dhe jo vetëm një vlerë politike ose shoqërore.

Në planin civil, e nesërmja mund të kërkojë një rol më të madh të mbrojtjes civile dhe një shkallë më të lartë të përgatitjes së popullsisë.¹⁰ Fatkeqësitë natyrore, zjarret, përmytjet, ndërprerjet e zgjatura të shërbimeve apo incidente të përhapura me ndikim në infrastrukturë kërkojnë struktura funksionale, rezerva materiale, plane evakuimi, komunikim të qartë dhe aftësi rikuperimi. Sa më e madhe të jetë ndërvarësia e shoqërisë nga rrjetet dhe shërbimet, aq më i madh bëhet rreziku që një krizë të kalojë shpejt nga niveli teknik në nivel shoqëror.

Për FARSH, pasojat e së nesërme mund të përkthehen në zgjerim të spektrit të misionit, në rritje të ngarkesës operacionale dhe në nevojë për lëvizshmëri më të madhe strategjike e taktike. Kjo do të kërkojë jo vetëm kapacitete materiale, por edhe doktrinë më fleksibile, kulturë më të lartë stërvitjeje, procedura më të integruara dhe përgatitje për skenarë ku mjedisi operativ është i paqartë, i ndërprerë dhe i goditur në disa dimensione njëherësh. FARSH duhet të jetë e gatshme për të vepruar si forcë ushtarake, por edhe si komponent kyç i arkitekturës kombëtare të qëndrueshmërisë.

Prandaj, pasojat e mundshme të sfidave shumëdimensionale nuk duhen parë si skenarë alarmues, por si hipoteza pune për planifikim serioz. Vetëm nëse shteti e mendon të nesërmen si objekt të përgatitjes së sotme, ai mund të zvogëlojë pasigurinë dhe të rrisë mundësinë e reagimit të suksesshëm. Ky është kuptimi më praktik i sigurisë së përgjegjshme. Mbi këtë logjikë mbështetet edhe kërkesa për transformim, e cila përbën hapin tjetër të analizës.

Kërkesat për transformim: parandalimi, qëndrueshmëria dhe reagimi i integruar

Përballë sfidave shumëdimensionale, qasja më e përshtatshme është ajo që ndërton lidhje të qartë midis parandalimit, mbrojtjes dhe reagimit.¹¹ Këto tre

¹⁰ Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2023–2028 (Tiranë, 2024).

¹¹ Po aty.

nivele nuk duhet të shihen si faza të ndara, por si pjesë të një cikli të vetëm të sigurisë kombëtare. Parandalimi ul mundësinë e krizës ose të përshkallëzimit të saj; mbrojtja redukton cenueshmërinë; reagimi kufizon dëmin, rikthen funksionet dhe mbron rendin institucional. Kur këto tre elemente funksionojnë së bashku, shteti fiton qëndrueshmëri. Kur ato shkëputen nga njëri-tjetri, rritet probabiliteti i improvizimit dhe i konsumit institucional.

Parandalimi duhet të nisë me kuptimin e saktë të rrezikut.¹² Kjo kërkon vlerësim strategjik të vazhdueshëm, monitorim të zhvillimeve të mjedisit të sigurisë, analizë të cenueshmërisë kombëtare, vëmendje ndaj sinjaleve të hershme dhe kulturë planifikimi që nuk mjaftohet me reagimin pas ngjarjes. Parandalimi është më shumë se ruajtje e vigjilencës; ai përfshin ndërtimin paraprak të kapaciteteve, qartësimin e përgjegjësive institucionale, përgatitjen e skenarëve dhe ushtrimin e procedurave përpara se kriza të ndodhë. Në këtë plan, FARSH ka rol të rëndësishëm si pjesë e mekanizmit kombëtar të vlerësimit dhe përgatitjes.

Mbrojtja, si niveli i dytë, lidhet me forcimin e kapaciteteve dhe me rritjen e rezistencës. Kjo nënkupton mbrojtje të infrastrukturës kritike, siguri më të lartë të sistemeve digjitale, ruajtje të aftësisë së komandimit dhe komunikimit, garantim të mbështetjes logjistike, zhvillim të rezervave strategjike dhe sigurim të kapaciteteve civile që mund të përballojnë tronditje të zgjatura. Mbrojtja kërkon gjithashtu qartësi ligjore, procedura funksionale, zinxhir të qartë përgjegjësie dhe standarde bashkëpunimi midis institucioneve. Pa këto, çdo kapacitet teknik apo material mbetet i kufizuar në efekt.

Reagimi është provë praktike e gjithë sistemit. Në momentin e krizës, nuk vlen vetëm sasia e mjeteve, por shpejtësia e aktivizimit, qartësia e komandimit, aftësia për të komunikuar me publikun, ruajtja e vazhdimësisë së funksioneve dhe rikthimi i normalitetit. Reagimi ndërinstitutional duhet të jetë i ushtruar dhe jo improvizuar. Ai duhet të bazohet në skenarë të provuar, në ndarje të qartë detyrash dhe në mundësi reale bashkëveprimi mes institucioneve qendrore, strukturave vendore, mekanizmave të mbrojtjes civile dhe FARSH. Sa më e lartë të jetë ndërveprueshmëria në kohë paqeje, aq më i lartë bëhet efekti në kohë krize.

Në këtë kuadër, mbrojtja civile zë një vend të veçantë.¹³ Ajo është ura që lidh mbrojtjen kombëtare me sigurinë e përditshme të qytetarëve. Një shtet që nuk është i përgatitur për të menaxhuar emergjencat civile, vështirë se mund të pretendojë gatishmëri të plotë ndaj sfidave strategjike më komplekse. Kjo do të thotë se planifikimi për evakuim, mbështetje logjistike, ruajtje të shërbimeve

¹² Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike 2024–2028 (Tiranë, 2024).

¹³ NATO, “Resilience, Civil Preparedness and Article 3” (Brussels: NATO, 2024).

themelore, sistemet e njoftimit, menaxhimi i rezervave dhe rikuperimi pas krizës duhet të jenë pjesë e një tabloje të vetme të sigurisë kombëtare.

Një element tjetër i domosdoshëm është rezerva strategjike. Në mjedisin aktual, ku tronditjet globale mund të prekin furnizimet jetike, energjinë, materialet kritike dhe mbështetjen teknike, shteti duhet të mendojë për kapacitete rezervë që sigurojnë vazhdimësi në kushte reduktimi apo ndërprerjeje¹⁴. Rezervat strategjike nuk duhen konceptuar vetëm si depo materiale; ato përfshijnë edhe alternativa organizative, kapacitete zëvendësuese, rrugë alternative furnizimi dhe plane rikuperimi. Për mbrojtjen kombëtare, kjo është çështje themelore, sepse pa mbështetje të qëndrueshme edhe kapaciteti ushtarak bëhet i paqëndrueshëm.

Bashkëpunimi ndërinstitucional duhet të mbështetet në dy parime: qartësi përgjegjësie dhe kulturë e përbashkët veprimi. Institucionet nuk mjafton të jenë të shumta; ato duhet të jenë të lidhura në funksionalitet. Kjo kërkon ushtrime të përbashkëta, standarde komunikimi, mekanizma koordinimi, shkëmbim informacioni dhe vullnet për të vepruar brenda një logjike të vetme sigurie kombëtare. FARSH, për shkak të kapaciteteve, disiplinës organizative dhe rolit të saj në sistemin e mbrojtjes, është një nga shtyllat kryesore të këtij bashkërendimi.

Në fund, parandalimi, mbrojtja dhe reagimi i përbashkët nuk janë thjesht kategori konceptuale, por një mënyrë e re organizimi të sigurisë. Ato përkthejnë idenë se siguria e qëndrueshme nuk ndërtohet vetëm mbi aftësinë për të reaguar me forcë, por mbi aftësinë për të kuptuar rrezikun, për të kufizuar cenueshmërinë dhe për të garantuar funksionalitet shtetëror edhe në kushte presioni të lartë. Ky është drejtimi më i arsyeshëm për politikën e mbrojtjes dhe për zhvillimin afatmesëm të sistemit kombëtar të sigurisë. Pikërisht për këtë arsye, diskutimi zhvendoset te orientimi afatmesëm i kapaciteteve dhe te funksionaliteti i sistemit të mbrojtjes.

Zhvillimi afatmesëm i kapaciteteve dhe orientimi funksional i sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare

Në kushtet e sfidave shumëdimensionale, politika e mbrojtjes duhet të ruajë qartësinë e misionit themelor të FARSH, por njëkohësisht të përvetësojë një kuadër më të gjerë vlerësimi të rrezikut.¹⁵ Kjo do të thotë se prioritetet e zhvillimit të kapaciteteve nuk duhen ndërtuar vetëm sipas logjikës së fuqisë klasike, por edhe sipas nevojës për qëndrueshmëri, lëvizshmëri, mbështetje, komunikim të sigurt, bashkërendim me institucionet civile dhe ruajtje të

¹⁴ Vizioni i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për periudhën 2026-2028.

¹⁵ Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033 (Tiranë, 2024).

funksioneve në kushte ndërprerjeje. Me fjalë të tjera, politika e mbrojtjes duhet të shohë përtej pajisjeve dhe strukturave, duke vlerësuar gjithashtu cilësinë e ekosistemit që i mban ato funksionale.

Në planin afatmesëm, kjo nënkupton se kapacitetet më të rëndësishme janë ato që krijojnë efekt në disa skenarë njëkohësisht.¹⁶ Kapaciteti për komandim dhe kontroll, siguria e komunikimeve, fleksibiliteti logjistik, mbështetja e lëvizjes, mbrojtja e sistemeve digjitale, stërvitja ndërinstitutionale dhe aftësia për të operuar në kushte të kontestimit të informacionit duhet të marrin peshë gjithnjë e më të madhe. Këto nuk janë vetëm zgjidhje teknike, por investime strategjike që rrisin vlerën e përgjithshme të sistemit të mbrojtjes.

Po ashtu, zhvillimi i kapaciteteve për burime njerëzore mbetet përcaktues. Në një mjedis shumëdimensional, personeli duhet të kuptojë jo vetëm procedurën, por edhe kontekstin. Kjo kërkon arsimim profesional, kulturë strategjike, aftësi analitike dhe vetëdije më të madhe mbi mënyrën si ndërthuren sfidat ushtarake me ato civile, kibernetike, informative e logjistike. Një forcë që përshtatet shpejt dhe mendon në mënyrë të integruar krijon efekt më të madh sesa një forcë që mbështetet vetëm në rutinë.

Politika e mbrojtjes duhet të mbështetet gjithashtu në vazhdimësi dhe jo vetëm në reagime të pjesshme. Rreziqet bashkëkohore zhvillohen me ritëm të shpejtë, por përballimi i tyre kërkon procese të qëndrueshme zhvillimi. Kjo nënkupton lidhje më të fortë midis dokumenteve strategjike, planeve të zbatimit, vlerësimit periodik të cënueshmërisë dhe korrigjimit të politikave mbrojtëse aty ku realiteti kërkon përshtatje. Sa më e madhe të jetë distanca midis planifikimit dhe zbatimit, aq më e vogël bëhet aftësia reale e sistemit për të përballuar të papriturën.

Në këtë kuptim, zhvillimi afatmesëm i kapaciteteve duhet të orientohet nga parimi i funksionalitetit: çfarë i nevojitet sistemit kombëtar të mbrojtjes për të mbetur funksional, i koordinuar dhe efektiv edhe në kushte të vështira.¹⁷ Ky parim krijon urë midis forcimit të FARSH, mbrojtjes së infrastrukturës kritike, mbështetjes logjistike, sigurisë kibernetike, mbrojtjes civile dhe rezistencës kombëtare. Për një vend me përmasa të kufizuara si vendi jonë, kjo qasje është më e dobishme se fragmentimi i përpjekjeve në shumë prioritate të shpëputura. Mbi këtë bazë mund të formulohen më qartë edhe përfundimet kryesore të studimit.

Përfundime

Analiza e paraqitur në këtë punim tregon se sfidat shumëdimensionale të sigurisë nuk përbëjnë thjesht një zgjerim sasior të rreziqeve, por një ndryshim

¹⁶ Vizioni i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për 2026-2028.

¹⁷ NATO, "Deterrence and Defence" (Brussels: NATO, 2025).

cilësor të vetë mjedisit në të cilin funksionon mbrojtja dhe siguria kombëtare. Ndërthurja e presioneve ushtarake, hibride, kibernetike, informative, ekonomike dhe civile prodhon implikime që shtrihen përtej dimensionit operacional dhe prekin vetë qëndrueshmërinë e sistemit shtetëror.

Për FARSH, ky realitet do të thotë se roli i saj duhet të kuptohet në mënyrë funksionale dhe të integruar. Ajo mbetet instrumenti qendror i mbrojtjes ushtarake, por efektiviteti i saj varet gjithnjë e më shumë nga aftësia e gjithë sistemit të sigurisë për të mbështetur gatishmërinë, për të ruajtur vazhdimësinë e funksioneve kritike dhe për të garantuar koordinim të shpejtë me institucionet e tjera kombëtare.

Punimi argumenton se e nesërmja e sigurisë do të karakterizohet nga kriza më të ndërthurura, më të shpejta dhe më pak të parashikueshme. Për pasojë, implikimi kryesor për politikën e mbrojtjes nuk është vetëm rritja e kapaciteteve, por rritja e funksionalitetit të sistemit, e rezistencës së tij dhe e aftësisë për të vepruar në mënyrë të koordinuar nën kushte trysnie.

Në përfundim, mund të thuhet se përgjigjja më e përshtatshme ndaj sfidave shumëdimensionale është ndërtimi i një modeli të integruar sigurie e mbrojtjeje, i cili bashkon parandalimin, gatishmërinë, mbrojtjen, reagimin dhe mbështetjen civile. Ky model nuk e zëvendëson funksionin klasik të forcës ushtarake, por e vendos atë brenda një arkitekture më të gjerë të qëndrueshmërisë kombëtare.

Në aspektin e politikës së mbrojtjes, ky përfundim nënkupton se rezistenca nuk duhet parë si nocion dytësor, por si kusht funksional për efektivitetin e mbrojtjes kombëtare. Sa herë që shteti humbet aftësinë për të ruajtur funksionet thelbësore, dobësohet jo vetëm administrimi i krizës, por edhe vetë kapaciteti për mbrojtje.

Rëndësia shkencore e këtij punimi qëndron në faktin se ai i trajton sfidat shumëdimensionale jo si listë kërcënimesh, por si mekanizma me implikime të drejtpërdrejta mbi organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të mbrojtjes kombëtare. Kjo qasje i jep analizës një karakter më të orientuar drejt studimit, vlerësimit strategjik dhe përdorimit praktik institucional.

Rekomandime

Rekomandimet që pasojnë burojnë nga analiza e mjedisit bashkëkohor të sigurisë dhe synojnë të orientojnë veprimin institucional, gjithëpërfshirës, drejt forcimit të qëndrueshmërisë, të gatishmërisë dhe të aftësisë së reagimit. Ato nuk paraqesin masa të shkëputura, por drejtime të ndërlidhura të cilat kanë kuptim vetëm nëse zbatohen si pjesë e një qasjeje të integruar.

Së pari, duhet të thellohet qasja e integruar ndaj sigurisë, duke e trajtuar mbrojtjen kombëtare si sistem ku ndërthuren komponentët ushtarakë, civilë,

kibernetikë, logjistikë dhe informativë.

Së dyti, duhet të shtohen skenarët në procesin e planifikimi për lloje shumëfishta apo shumëdimensionale krize, në mënyrë që institucionet të mos varen nga reagimi i improvizuar, por nga procedura të ushtruara dhe me përgjegjësi të qarta.

Së treti, duhet të rritet vëmendja ndaj mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe ndaj garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve jetike në kushte krize ose ndërprerjeje.

Së katërti, duhet të zhvillohen më tej rezervat strategjike, kapacitetet logjistike dhe alternativat funksionale që sigurojnë qëndrueshmëri kombëtare në raste krizash të zgjatura.

Së pesti, duhet të forcohet kultura e sigurisë kibernetike dhe e bashkëpunimit e koordinimit institucional, si pjesë e mbrojtjes dhe sigurisë së përgjithshme të shtetit.

Së gjashti, duhet të zgjerohet bashkëpunimi ndërinstitucional nëpërmjet stërvitjeve të përbashkëta, standardeve të koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit në kohë.

Së shtati, duhet të investohet në kapacitetet speciale njerëzore të FARSH dhe të institucioneve të tjera të sigurisë, me qëllim rritjen e aftësisë analitike, të kulturës strategjike dhe të përshtatjes profesionale ndaj mjedisit të ri të sigurisë.

Së fundi, duhet të ruhet vazhdimësia e orientimit të politikës së mbrojtjes drejt forcimit të qëndrueshmërisë kombëtare, sepse siguria e së nesërme varet po atë nga përgatitja e sotme sa edhe nga kapaciteti për reagim në momentin e krizës.

Vlera shkencore, kufizimet e studimit dhe mbyllja

Ky studim synon të ofrojë një kornizë të strukturuar interpretimi për sfidat shumëdimensionale të sigurisë dhe për implikimet e tyre mbi FARSH dhe mbi sistemin e mbrojtjes kombëtare. Vlera e tij shkencore qëndron në përpjekjen për ta zhvendosur analizën nga përshkrimi i thjeshtë i rreziqeve të shpjegimi i mekanizmave përmes të cilëve ato ndikojnë mbi funksionet e mbrojtjes dhe mbi qëndrueshmërinë e shtetit.

Një vlerë tjetër e punimit është se ai e lidh dimensionin ushtarak me atë institucional, civil dhe mbështetës, duke argumentuar se mbrojtja kombëtare duhet të shihet si sistem i integruar dhe jo si një fushë e kufizuar vetëm të përdorimit të forcës. Kjo e bën studimin të dobishëm si në planin teorik, ashtu edhe në planin e reflektimit strategjik dhe të orientimit institucional.

Në aspektin metodologjik, kufizimi kryesor i studimit lidhet me natyrën

dinamike të vetë objektit të analizës. Sfidat shumëdimensionale ndryshojnë shpejt, shfaqen shpesh në forma të ndërthurura dhe jo gjithmonë mund të reduktohen në tregues të qartë operacionalë. Për këtë arsye, studimi mbetet brenda një kornize cilësore dhe interpretuese, pa synuar matje statistikore apo vlerësime të detajuara operative.

Një kufizim i dytë lidhet me qasjen për të folur në terma të përgjithshëm dhe institucionalë. Kjo zgjedhje është e vetëdijshme, në mënyrë që analiza të ruajë karakterin profesional, të shmangë gjuhën politike dhe të mbetet e përshtatshme për një revistë shkencore ushtarake. Pikërisht për këtë arsye, vlera e saj qëndron jo te komentimi i rasteve të veçanta, por te formulimi i një logjike analitike të përdorshme për mendimin strategjik dhe për planifikimin ndërinstitutional të çështjeve të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Duke përfunduar, mund të them shkurtimisht se në kushtet e mjedisit bashkëkohor të sigurisë, dinamike dhe gjithnjë e pasigurte, mbrojtja kombëtare nuk mund të kuptohet më vetëm si kapacitet ushtarak në kuptimin tradicional të fjalës. Ajo përballlet me sfida shumëdimensionale që shtrihen njëkohësisht në planin ushtarak, politik, ekonomik, teknologjik, informativ dhe shoqëror.

Kërcënimet hibride, sulmet kibernetike, dezinformimi, krizat energjetike, migracioni i pakontrolluar dhe pasojat e fatkeqësive natyrore krijojnë një realitet sigurie më të ndërlikuar, ku cenimi i stabilitetit kombëtar nuk vjen domosdoshmërisht përmes agresionit të drejtpërdrejtë ushtarak, por edhe përmes dobësimit gradual të institucioneve, të besimit publik dhe të kapaciteteve reaguese të shtetit.

Një nga sfidat më të mëdha për elementët e mbrojtjes kombëtare lidhet me nevojën për bashkërendim të qëndrueshëm ndërinstitutional. Efektiviteti i mbrojtjes nuk përcaktohet vetëm nga gatishmëria e Forcave të Armatosura, por edhe nga niveli i koordinimit mes institucioneve të sigurisë, strukturave civile, pushtetit vendor dhe sektorëve kritikë të infrastrukturës kombëtare.

Në këtë kuptim, mbrojtja dhe siguria kombëtare duhet të funksionojë si një sistem i integruar, ku shkëmbimi i informacionit, planifikimi i përbashkët, menaxhimi i krizave dhe ndarja e përgjegjësive bëhen elemente kyçe të qëndrueshmërisë kombëtare. Sa më i lartë të jetë niveli i këtij integrimi, aq më e fortë bëhet aftësia e shtetit për të parandaluar, përballuar dhe kapërcyer situata të krizës.

Një dimension tjetër me rëndësi strategjike është përshtatja e mbrojtjes kombëtare me ritmin e zhvillimeve teknologjike dhe me natyrën në ndryshim të konflikteve moderne. Modernizimi i kapaciteteve mbrojtëse, rritja e investimeve në mbrojtjen kibernetike, zhvillimi i burimeve njerëzore të specializuara, investime për mbështetje të aleatëve përgjatë Korridorit 8, baza ajrore, porte, si dhe forcimi i kulturës së mbrojtjes dhe sigurisë në shoqëri

përbëjnë kushte të domosdoshme për një mbrojtje funksionale dhe afatgjatë.

Në këtë drejtim, qëndrueshmëria kombëtare nuk lidhet vetëm me posedimin e armatimeve, mjeteve dhe pajisjeve, por edhe me aftësinë për të ndërtuar dhe zhvilluar institucione funksionale e të përshtatura, profesioniste dhe të afta për të vepruar në mënyrë pro aktive ndaj rreziqeve të reja shumëdimensionale.

Bibliografia

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, 2023–2028. Tiranë, 2024.
2. Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2024.
3. Plan i Afatgjatë i Zhvillimit të FARSH, 2024-2033. Tiranë, 2024.
4. Vizioni i Shefit të SHPFARSH për periudhën 2026-2028.
5. Countering Illegal Foreign Interference and Disinformation as Hybrid Threats in the Republic of Albania 2025–2030. Tiranë, 2026.
6. Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2025–2030. Tiranë, 2025.
7. A Strengthened EU Code of Practice on Disinformation. Brussels, 2022.
8. Countering Foreign Interference and Cyberattacks. Brussels, 2025.
9. European Commission. Countering Information Manipulation. Brussels, 2026.
10. Cybersecurity of Network and Information Systems (NIS2). Brussels, 2022.
11. European Union. Making Critical Entities More Resilient. Brussels, 2022.
12. Ministria e Mbrojtjes. Direktiva e Mbrojtjes 2024. Tiranë, 2024.
13. Ministria e Mbrojtjes. Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike 2024–2028. Tiranë, 2024.
14. NATO. Countering Hybrid Threats. Brussels: NATO, 2026.
15. NATO. Cyber Defence. Brussels: NATO, 2025.
16. NATO. Deterrence and Defence. Brussels: NATO, 2025.
17. NATO. NATO 2022 Strategic Concept. Brussels: NATO, 2022.
18. NATO. NATO's Approach to Counter Information Threats. Brussels: NATO, 2024.
19. NATO. Readiness Action Plan. Brussels: NATO, 2025.
20. NATO. Resilience, Civil Preparedness and Article 3. Brussels: NATO, 2024.
21. NATO. Strengthened Resilience Commitment. Brussels: NATO, 2021.
22. The NIST Cybersecurity Framework (CSF) 2.0. Gaithersburg, MD: NIST, 2024.
23. The Council of the European Union. Hybrid Threats. Brussels, 2026.

Një vështrim mbi konceptin strategjik të NATO-s dhe përshtatja e tij me një mjedis sigurie në ndryshim

Dr. Edlira TITINI

*Pedagoge për Marrëdhëniet Ndërkombëtare,
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA*

Trajtesë e shkurtuar

Ky punim synon të analizojë përmbajtjen e Konceptit Strategjik të NATO-s 2022 si një prej vendimmarrjeve më të rëndësishme të Samitit të Madridit, të zhvilluar më 29 qershor 2022 me kërret e shteteve dhe të qeverive të tridhjetë¹ vendeve anëtare të NATO-s.

Pas një vështrimi retrospektiv mbi evolucionin e dokumenteve strategjike që prej krijimit të Aleancës, artikulli përqendrohet në analizën e Konceptit Strategjik aktual, duke evidentuar kërcënimet dhe sfidat komplekse të mjedisit të sigurisë me të cilat përballet aleanca, tri detyrat themelore dhe qasjen e Aleancës për dekadën e ardhshme. Paralelisht evidentohen risitë e këtij Koncepti në raport me atë paraardhës të vitit 2010.

Në rrethanat e një mjedisi sigurie që ndryshon me shpejtësi, vëmendje e veçantë u kushtohet edhe samiteve të Vilniusit, Uashingtonit dhe Hagës, si hapa të domosdoshëm për operacionalizimin e objektivave strategjike dhe përshtatjen e Aleancës me kontekstin e ri të sigurisë globale.

Fjalë kyçe: Koncepti strategjik, mjedisi i sigurisë, NATO, Kina, Rusia.

¹ Finlanda dhe Suedia u anëtarësuan në NATO përkatësisht në 4 prill 2023 dhe 7 mars 2024, duke e çuar në 32 numrin e shteteve anëtare të Aleancës

Hyrje

NATO, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, e cila përfshin një hapësirë që shtrihet nga brigjet e Paqësorit në Amerikën e Veriut deri në Detin e Zi me rreth një miliard banorë është organizata më jetëgjatë në fushën e mbrojtjes. Suksemi i saj qëndron në aftësinë që ka treguar për t'iu përshtatur ndryshimeve në skenarin e sigurisë globale.² Në fakt, synimet e NATO-s mbeten po ato që janë vendosur nga Traktati i Uashingtonit i 4 prillit 1949, pra, mbrojtja e qytetarëve të vendeve anëtare dhe territoreve të tyre si dhe mbrojtja e sistemit të vlerave, lirisë dhe demokracisë. Ato që kanë ndryshuar dhe evoluar me kalimin e kohës janë strategjia e organizatës dhe mjetet e përdorura prej saj për të përmbushur qëllimet e traktatit, sipas përcaktimeve të koncepteve të ndryshme strategjike ku përshkruhen detyrat e NATO-s.³ Deri më tani janë hartuar tetë Koncepte Strategjike, përkatësisht në vitet 1949, 1952, 1957, 1968, 1991, 1999, 2010 dhe 2022. Sipas ish-sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, për nga rëndësia e dokumenteve të Aleancës, Koncepti Strategjik qëndron i vendosur menjëherë pas Traktatit të Atlantikut të Veriut.⁴

Koncepti Strategjik i NATO-s në fillesat e tij ka qenë një dokument i klasifikuar me natyrë ushtarake, për të cilin jepej vetëm një komunikatë zyrtare. Më konkretisht, gjatë Luftës së Ftohtë, strategjia e NATO-s u fokusua kryesisht te mbrojtja dhe parandalimi i agresionit, megjithëse me vëmendje në rritje ndaj dialogut dhe shtensionimit për dy dekadat e fundit të kësaj periudhe. Në periudhën nga krijimi i organizatës deri në rënien e Murit të Berlinit u hartuan katër Koncepte Strategjike, të shoqëruara me dokumente që përcaktonin masat që duhet të merreshin nga ushtria për zbatimin e Konceptit Strategjik, të titulluar “Udhëzime strategjike”, “Modeli më efektiv i forcës ushtarake të NATO-s për vitet e ardhshme” dhe “Masat për zbatimin e Konceptit strategjik”.⁵

Duke nisur nga teksti i miratuar gjatë samitit të Romës në nëntor 1991, koncepti strategjik ka marrë një karakter gjithnjë e më publik, si gjatë procesit të përgatitjes, ashtu edhe në shpërndarjen e tij.

Konceptet e periudhës pas Luftës së Ftohtë nuk janë më plane strategjike ushtarake, por analiza të situatës ndërkombëtare, rreziqeve, sfidave dhe rolit të NATO-s. Ato shoqërohen nga direktiva të Komitetit ushtarak që mbeten sekret.⁶

² NATO 2030: United for a New Era, 25 November 2020, f.7

³ Italian Atlantic Committee, The future of NATO and the role of Italy. Elements of reflections, 2023, f.7

⁴ https://www.nato.int/cps/en/natohq/opinions_188063.htm?selectedLocale=en

⁵ https://www.nato.int/cps/fr/natohq/topics_56626.htm?selectedLocale=en

⁶ <https://www.monde-diplomatique.fr/mav/183/BULARD/64710>

Nga viti 1991, NATO adoptoi një qasje më të gjerë, ku përveç parandalimit të agresionit dhe mbrojtjes, rëndësi iu kushtua bashkëpunimit dhe sigurisë. Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, NATO rriti vëmendjen ndaj luftës kundër terrorizmit, përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, luftës hibride dhe teknologjive në zhvillim që po revolucionarizonin botën.⁷ Aleanca gjithashtu angazhoi trupa edhe përtej zonës euroatlantike si në rastin e Afganistanit. Në këtë periudhë të pas Luftës së Ftohtë, u botuan tri koncepte strategjike jo të klasifikuara, të integruara me dokumente të klasifikuara ushtarake të cilat ishin: Direktiva e Komitetit ushtarak për zbatimin në planin ushtarak të Konceptit Strategjik të Aleancës MC 400, Udhëzuesi i Komitetit ushtarak për zbatimin në planin ushtarak të Strategjisë së Aleancës MC 400/2 dhe Udhëzuesi i Komitetit ushtarak MC 400/3.⁸

Evolucioni i doktrinës së NATO-s pasqyron kalimin nga një kërcënim unik (BRSS) drejt rreziqeve asimetrike dhe operacioneve jashtë zonës euroatlantike, siç ishte rasti i Afganistanit. Megjithatë, hendeku midis objektivave ambicioze dhe burimeve reale kulmoi me dështimin në Afganistan. Sot, rishfaqja e Rusisë si një kërcënim konvencional ka rikthyer nevojën për qartësi, duke e rifokusuar Aleancën te misioni i saj origjinal: mbrojtja kolektive dhe parandalimi i agresionit.⁹

Hartimi i Konceptit Strategjik aktual

NATO publikoi konceptin strategjik aktual në samitin e Madridit, në qershor 2022. Ai përcakton orientimin politik dhe ushtarak të NATO-s deri në vitin 2030. Koncepti në fjalë pasqyron përkeqësimin e mjedisit strategjik të NATO-s, i shenjuar nga dëshira në rritje e Rusisë dhe Kinës për të sfiduar rendin ndërkombëtar të dominuar nga Perëndimi.¹⁰

Intensifikimi i kërcënimit rus, aneksimi i paligjshëm i Krimesë, investimi i aktorëve autoritarë në kapacitete të sofistikuara konvencionale, bërthamore dhe raketore, ndërhyrja e tyre në proceset demokratike përmes taktikave hibride, promovimi nga ana e tyre i fushatave dezinformuese, instrumentalizimi i migrimit, aktivitetet keqdashëse në hapësirën kibernetike dhe në hapësirë, kërcënimimi i vazhdueshëm terrorist, ndryshimet klimatike dhe zhvillimet e shpejta teknologjike e shtynë Aleancën të angazhohej për hartimin e një koncepti të ri strategjik.

⁷ https://www.nato.int/cps/fr/natohq/topics_56626.htm?selectedLocale=en

⁸ https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_56626.htm

⁹ LSE IDEAS. (2023, September). NATO's 2022 Strategic Concept: One Year On (Strategic Update). London School of Economics and Political Science, f.12; <https://www.lse.ac.uk/ideas/Assets/Documents/updates/2023-SU-NATO-OneYearOn.pdf>

¹⁰ Larsen Henrik, Concept stratégique de l'OTAN: des ambitions modérées, Politique de sécurité: analyses du CSS, Center for Security Studies (CSS), ETH Zürich, No 309, Septembre 2022, f.1

Përkeqësimi i situatës kulmoi me sulmin rus ndaj Ukrainës të nisur më 24 shkurt 2022. Në konceptet e mëparshme të pas Luftës së Ftohtë vihej në dukje fakti se zona euroatlantike ishte në paqe, ndërsa në konceptin e 2022 kjo nuk mund të pohohej më.

Lufta në Ukrainë nxiti Suedinë dhe Finlandën t'i bashkoheshin aleancës duke hequr dorë nga politika tradicionale e asnjësisë, tanimë e konsideruar si e papërshtatshme për të shmangur një sulm të mundshëm rus ndaj tyre. Bashkimi i Finlandës dhe Suedisë me NATO-n ka rritur kapacitetet e aleancës sa i përket forcave dhe mjeteve ushtarake e megjithatë burimet e aleancës nuk janë të pakufizuara dhe përparësia që i jepet kërcënimit rus duke u përqendruar në skenarët e mundshëm të një konflikti konvencional në krahun lindor të aleancës sjell kuptueshëm si pasojë më pak vëmendje në krahun jugor të saj.

Koncepti strategjik aktual është rezultat i një procesi të gjatë reflektimi e konsultimi të pezulluar gjatë mandatit të presidentit Donald Trump, i cili përtej skepticizmit ndaj aleancës që e konsideronte të “vjetëruar”¹¹ vazhdimisht kritikonte vendet anëtare për dështimin e tyre në përmbushjen e objektivit të shpenzimeve të mbrojtjes në masën 2% të PBB duke përmendur edhe idenë e tërheqjes së forcave amerikane nga Europa dhe Azia¹² apo nevojën e SHBA-së për të rishikuar përfshirjen e saj në NATO¹³. Nga ana tjetër, pas takimit të Brukselit në maj 2017 mes krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të NATO-s, kancelarja Merkel do të komentonte se “Ne europianët” nuk mund të mbështetemi më te SHBA dhe “duhet ta marrim fatin tonë në duart tona”.¹⁴ Ndërsa në tetor 2019, presidenti Macron në një intervistë për “The Economist” paralajmëronte vendet europiane se ato nuk mund të mbështeteshin te SHBA për mbrojtjen e vendeve aleate dhe se NATO ishte në gjendjen e vdekjes cerebrale. Europa sipas tij ishte në buzë të greminës dhe duhet të mendonte strategjikisht për veten si një fuqi gjeopolitike, përndryshe vendet europiane nuk do të kishin më nën kontroll fatin e tyre.¹⁵ Në të tilla rrethana dhe në vazhden e qëndrimeve të tilla ekzistonte frika se nuk do të arrihej dot në një dokument konsensual mes vendeve anëtare.

¹¹ James Sperling and Mark Webber, Trump's foreign policy and NATO: Exit and voice, Review of International Studies, July 2019, f.523; Shiko edhe mesazhet në Twitter të Donald Trump në dt. 27.03.2016 dhe 6.06.2016

¹² Joyce P. Kaufman, The US perspective on NATO under Trump: lessons of the past and prospects for the future, International Affairs 93: 2 (2017), f.263

¹³ <https://www.cbsnews.com/news/trump-nato-past-comments/>, konsultuar në dt 3.01.2025

¹⁴ <https://edition.cnn.com/2017/05/28/politics/angela-merkel-donald-trump-g7/index.html>, <https://www.reuters.com/article/world/after-summits-with-trump-merkel-says-europe-must-take-fate-into-own-hands-idUSKBN18O0JN/>, të konsultuara në 1.04.2025

¹⁵ <https://www.economist.com/europe/2019/11/07/emmanuel-macron-warns-europe-nato-is-becoming-brain-dead>

Në takimin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në Londër në dhjetor 2019, liderët e Aleancës i kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg që të ndërmerre një proces reflektimi për të vlerësuar mënyrat për forcimin e dimensionit politik të Aleancës së NATO-s. Në vitin 2020, Stoltenberg rifilloi procesin duke porositur hartimin e një raporti nga një grup ekspertësh të pavarur dhe dhënien e rekomandimeve në tri fusha: 1) përforcimi i unitetit, solidaritetit dhe kohezionit aleat, duke përfshirë çimentimin e qendrës së lidhjes transatlantike; 2) rritja e konsultimeve dhe koordinimit politik ndërmjet aleatëve në NATO dhe 3) forcimi i rolit politik të NATO-s dhe instrumenteve përkatëse për të adresuar kërcënimet dhe sfidat aktuale dhe të ardhme ndaj sigurisë së Aleancës që burojnë nga të gjitha drejtimet strategjike.¹⁶ Koncepti i 2010 ishte i papërshtatshëm për t'iu përgjigjur mjedisit të ri përmirësimi i përmbajtjes së strategjisë së dyfishtë të parandalimit të agresionit dhe dialogut për të siguruar efektivitetin e saj të vazhdueshëm. Sipas të njëjtit raport, NATO-ja duhet të vazhdonte t'u përgjigjej kërcënimeve ruse në mënyrë koherente, të vendosur dhe politikisht e bashkuar si dhe t'u kushtonte shumë më tepër kohë, burime politike dhe veprim sfidave të sigurisë që paraqiste Kina duke lënë të hapur mundësinë e dialogut politik me të. Gjithashtu, NATO-ja sipas raportit duhet të rriste ritmin dhe shkallën e përqendrimit të saj politik në fushën e teknologjive të reja revolucionarizuese, nëse dëshironte t'u kundërvihej kërcënimeve dhe të përfitonte nga të mirat që sjellin këto teknologji.

Megjithatë, aleatët vijonin të ishin të ndarë lidhur me mundësinë ose jo të partneritetit me Rusinë por edhe sa i përket qëndrimit ndaj Kinës, nëse ajo do të konsiderohej një rival ekonomik apo një sfidë gjeopolitike dhe nëse ishte NATO vendi i duhur për të adresuar qasjen ndaj Kinës. Arritjen në një qëndrim të përbashkët e bëri më të lehtë agresioni rus ndaj Ukrainës.¹⁷

Detyrat që shtrohen para Aleancës

Koncepti i vitit 2022 përshkruan mjedisin strategjik të Aleancës e më pas përcakton detyrat themelore dhe qasjet e NATO-s në dekadën vijuese.¹⁸ Ai përcakton prioritetet të qarta midis kërcënimeve, të cilat kërkojnë një përgjigje të drejtpërdrejtë ushtarake, dhe sfidave, të cilat kërkojnë një gjendje gatishmërie më të gjerë.¹⁹

¹⁶ NATO 2030: United for a New Era, Analysis and Recommendations of the Reflection Group Appointed by the NATO Secretary General, 25 November 2020, f.3

¹⁷ Deni John R., Rynning Sten, The NATO Strategic Concept on Its Seventy-Fifth Anniversary, MILITARY REVIEW July-August 2024, f.11-12

¹⁸ https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_210907.htm

¹⁹ NATO 2022 Strategic concept https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2022/6/pdf/290622-strategic-concept.pdf

Ndryshe nga koncepti i mëparshëm i vitit 2010,²⁰ i cili e konsideronte bashkëpunimin NATO-Rusi me rëndësi strategjike dhe evidentonte vullnetin e NATO-s për të parë një partneritet të vërtetë strategjik me Rusinë, në konceptin aktual, Rusia përcaktohet si “kërcënimi më i rëndësishëm dhe i drejtpërdrejtë për sigurinë e aleancës”. Ndërkohë që terrorizmi, i lidhur me brishtësinë dhe konfliktet e pranishme në periferinë jugore të Aleancës, identifikohet si kërcënimi më i drejtpërdrejtë asimetrik për sigurinë e qytetarëve të NATO-s dhe për paqen ndërkombëtare.

Koncepti strategjik aktual përmban tri detyrat themelore për Aleancën, të parashikuara edhe në konceptin e mëparshëm. Ato janë mbrojtja dhe parandalimi i agresionit, parandalimi dhe menaxhimi i krizave si dhe siguria bashkëpunuese.

Mbrojtja kolektive dhe parandalimi i agresionit shihen me përparësi në raport me dy detyrat e tjera dhe kjo tregon për forcën dhe vendosmërinë e NATO-s “për të mbrojtur çdo centimetër katror të territorit aleat”, me një qëndrim që kombinon aftësitë e mbrojtjes bërthamore, konvencionale dhe raketore, të integruara me kapacitetet hapësinore dhe kibernetike. Pas agresionit rus ndaj Ukrainës, objektivi i qëndrimit konvencional të NATO-s është të ndalojë çdo plan të Moskës për të bërë të njëjtën gjë në territorin e Aleancës. Për arritjen e kësaj, Aleanca angazhohet të garantojë që qëndrimi i saj për parandalimin e agresionit dhe mbrojtjen të mbetet i besueshëm, fleksibël, i përshtatur dhe i qëndrueshëm.

Konflikti i armatosur Rusi-Ukrainë si dhe pandemia e Covid-19 evidentuan edhe një sërë dobësish dhe varësish strategjike duke e ndërgjegjësuar Aleancën për nevojën e identifikimit dhe zvogëlimit të tyre edhe për sa i përket infrastrukturës kritike të Aleancës, zinxhirëve të furnizimit dhe sistemeve shëndetësore. Vendet anëtare angazhohen gjithashtu të rrisin sigurinë e tyre energjetike duke u fokusuar te besueshmëria e furnizuesve dhe diversifikimi i burimeve, ndryshe nga Koncepti i mëparshëm, ku vëmendja ishte orientuar kryesisht te rreziku i ndërprerjes së rrugëve të furnizimit.

Për të forcuar parandalimin dhe aftësinë e Aleancës për t’u mbrojtur, koncepti parashikon ndër të tjera sigurimin e një pranije të qenësishme dhe të vazhdueshme në tokë, det dhe ajër si dhe rregullimin e ekuilibrit midis forcave në terren dhe përforcimit të tyre.²¹

Për sa i përket parandalimit të sulmit bërthamor, koncepti është kryesisht një vazhdim i strategjive të kaluara duke riafirmuar vendin qendror të armëve

²⁰ Active Engagement, Modern Defence, Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of the North Atlantic Treaty Organization, November 2010, f.29

²¹ NATO 2022 Strategic concept, f. 6

bërthamore në parandalimin e sulmeve dhe mbrojtjen e NATO-s. Çështjet e kontrollit të armëve, çarmatimit dhe mospërhapjes janë inkuadruar në detyrën e parë themelore ndërsa në konceptin e mëparshëm përfshiheshin në kuadër të detyrës së sigurisë bashkëpunuese.

Detyra e dytë themelore e NATO-s mbetet parandalimi dhe menaxhimi i krizave. Edhe pse forcon mbrojtjen e saj kolektive në lindje, në kontekstin e pushtimit rus të Ukrainës, Aleanca mbetet e përkushtuar ndaj “qasjes së saj 360 gradë” sipas së cilës ajo duhet të jetë në gjendje të kundërshtojë të gjitha kërcënimet, në të gjitha fushat e nga të gjithë drejtimet që ato burojnë. Detyra e dytë trajtohet në një mënyrë më të përgjithshme duke mos u ndalur në masat e detajuara për përmbushjen e saj.

Ndërsa koncepti i vitit 2010 përmendte vetëm menaxhimin e krizave si një detyrë themelore, koncepti i 2022 vendos më shumë theksin te parandalimi, në aspekte të tilla si ndërtimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmëria e vendeve të cenueshme nga destabilizimi dhe terrorizmi, gjë që mund të sjellë si rezultat një kufizim më të madh të nevojës për ndërhyrje nga ana e NATO-s. Masat e parashikuara kanë të bëjnë me përmirësimin e gatishmërisë dhe aftësive ushtarake dhe civile të Aleancës, pa anashkaluar forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit me organizma ndërkombëtare si OKB-ja, BE-ja, OSBE-ja dhe Bashkimin Afrikan.

Koncepti ripohon sigurinë bashkëpunuese si detyrën e tretë themelore që duhet të përmbushë NATO-ja. Ai përcakton gjithashtu dy direktiva kryesore. E para ka të bëjë me zgjerimin dhe pohon politikën e dymëve të hapura dhe refuzimin e Aleancës ndaj çdo ndërhyrjeje nga palët e treta në vendimarrjen e saj. Megjithatë nuk ndërmerret ndonjë hap konkret në lidhje me anëtarësimin e mundshëm të Ukrainës, Moldavisë apo Gjeorgjisë. E dyta konfirmon BE-në si një “partner unik dhe thelbësor”. Kjo e fundit angazhohet për të forcuar partneritetin strategjik me BE-në në drejtim të konsultimit politik dhe rritjes së bashkëpunimit për një sërë çështjesh. Ajo “njeh vlerën e një mbrojtjeje më të fortë dhe më të aftë evropiane që kontribuon pozitivisht për sigurinë transatlantike dhe globale dhe është plotësuese dhe ndërvepruese me NATO-n”.²²

Siguria bashkëpunuese është pjesë e një tradite të gjatë të krijuar në vitet 1966-1967 nga Raporti Harmel, i cili kërkon që Aleanca të mbetet e përkushtuar ndaj dialogut politik me vendet e tjera nga një pozicion i fuqisë ushtarake. Nëse nga njëra anë koncepti parashikon forcimin e mbrojtjes kundër Rusisë, nga ana tjetër ai ruan ambicien e mosmbylljes së kanaleve të komunikimit me

²² Marrone Alessandro, NATO's New Strategic Concept: Novelities and Priorities, IAI Commentaries 22 /30 July 2022; <https://www.iai.it/it/pubblicazioni/natos-new-strategic-concept-novelities-and-priorities>

Moskën për të zbutur rreziqet dhe për të shmangur një përshkallëzim të padëshiruar të situatës. Ndryshe nga koncepti i vitit 2010, Koncepti aktual nuk i referohet Aktit të Themelimit për Marrëdhëniet e Ndërsjella, Bashkëpunimin dhe Sigurinë midis NATO-s dhe Federatës Ruse, i nënshkruar në 1997 për të shmangur ringritjen e tensioneve pas Luftës së Ftohtë, por përfundimisht i shkelur nga Rusia. Po kështu, ndërsa Koncepti aktual parashikon qëndrueshmëri të përbashkët përballë taktikave shtrënguese të Kinës, ai gjithashtu pohon se Aleanca është e gatshme të ndërveprojë në mënyrë konstruktive me Pekinin. Megjithatë, reagimi armiqësor i Kinës ndaj publikimit të këtij koncepti strategjik nxjerr në pah vështirësinë e jetësimit të një angazhimi të tillë në praktikë.

Këto tri detyra themelore përbëjnë komponentë të qartë të strategjisë së përshtatjes së NATO-s, të cilët janë të rëndësishëm në vetvete, por nuk japin një përgjigje adekuate për çështjen e ndarjes reale të barrës midis aleatëve. Koncepti ndërkaq pohon përkushtimin e NATO-s për të siguruar që shpenzimet kombëtare për mbrojtjen dhe financimi i përbashkët i NATO-s të jenë në përputhje me sfidat e një rendi të sigurisë më të kontestuar, që lë të nënkuptohet se objektivi i shpenzimeve për mbrojtjen sa 2% e PBB mund të konsiderohet i tejkaluar duke qenë se sfidat që paraqiten janë më të mëdha e mjedisi i sigurisë ndërkombëtare edhe me kompleks. Në mbështetje të këtij interpretimi janë edhe të dhënat statistikore²³ që flasin për rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen mbi vlerën 2% të PBB të dakordësuar një dekadë më parë me Paktin e Investimeve për Mbrojtjen, por edhe propozimi i presidentit Trump për të rritur në 5 % të PBB shpenzimet për mbrojtjen.

Përtej tensioneve në rritje dhe konflikteve aktuale me ndikim në sigurinë ndërkombëtare, ajo që e bën situatën edhe më komplekse është se tri domeneve tradicionale operacionale ajër, tokë, det u janë shtuar edhe mjedisi kibernetik dhe ai hapësinor. Për më tepër, thellësitë nënujore po marrin më shumë vëmendje për shkak të kërkimeve shkencore të cilat zhvillohen aty e që synojnë shfrytëzimin e ardhshëm të burimeve minerare të platformës së oqeanit si dhe rëndësisë kritike të infrastrukturës nënujore. Kabllot nënujore janë thelbësore për mënyrën moderne të të jetuarit pasi ato mundësojnë komunikimin dhe furnizimin me energji të nevojshme për të mbështetur ekonomitë e shoqërive në hapësirën euroatlantike.²⁴

Përtej hapësirës së Aleancës

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë koncept strategjik të NATO-s është se për herë të parë përmendet Republika Popullore e Kinës dhe rajoni i Indo-Paqësorit.

²³ https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2024/6/pdf/240617-def-exp-2024-en.pdf

²⁴ <https://www.nato.int/en/what-we-do/operations-and-missions/natos-maritime-activities>

Kina paraqitet si një fuqi që sfidon interesat, sigurinë dhe vlerat e Aleancës përmes politikave shtrënguese. Ajo shfrytëzon operacionet kibernetike, levat ekonomike për krijimin e varësive strategjike dhe kontrollin e infrastrukturës kritike e zinxhirëve të furnizimit, duke synuar njëkohësisht zgjerimin e arsenalit bërthamor. Së bashku me Federatën Ruse, Kina përpiqet të minojë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, megjithëse NATO e lë të hapur mundësinë për një angazhim konstruktiv bazuar në transparencë reciproke.

Sa i përket rajonit të Indo-Paqësorit, dokumenti pranon se zhvillimet atje ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë euroatlantike, por mbetet i vagët mbi trajtimin konkret të sfidave ndër-rajonale. Rëndësia e këtij rajoni diktohet nga ngjitja e Kinës si një fuqi globale, kërcënimi bërthamor i Koresë së Veriut dhe tensionet në Detin e Kinës Jugore.

Paralelisht, Ballkani Perëndimor, rajoni i Detit të Zi, Lindja e Mesme, Afrika e Veriut dhe Saheli rikonfirmohen si zona me interes strategjik. Gjithsesi, angazhimet mbeten të padetajuara, ndonëse pranohet se terrorizmi, konfliktet civile dhe brishtësia institucionale në këto rajone, të rënduara nga ndryshimet klimatike dhe pasiguria ushqimore, krijojnë një terren të favorshëm për grupet e armatosura joshitetore dhe ndërhyrjet destabilizuese të rivalëve strategjikë të NATO-s.

Ballkani Perëndimor në optikën e angazhimeve të NATO-s

NATO ka qenë e pranishme në Ballkanin Perëndimor që prej viteve '90, duke shënuar këtu ndërhyrjet e para të Aleancës jashtë zonës së mbrojtjes kolektive të Nenit 5. Edhe Ballkani Perëndimor ka qenë pjesë e veprimtarisë së NATO-s prej shumë vitesh, përmes operacioneve, partneriteteve dhe anëtarësimit të disa shteteve të rajonit.²⁵ Sot, ky rajon përbëhet nga një mozaik kompleks ku Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë anëtare të Aleancës, ndërsa Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia mbajnë raporte të ndryshme me të.

Serbia ruan neutralitetin ushtarak për shkak të marrëdhënieve me Rusinë dhe trashëgimisë së vitit 1999. Bosnja dhe Hercegovina përballet me pengesa të brendshme politike që vështirësojnë rrugën e saj drejt anëtarësimit. Ndërkohë, Kosova nuk është ende anëtare e Aleancës për shkak të mosnjohjes së saj nga katër prej vendeve anëtare, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja, megjithëse prezenca e KFOR-it mbetet garantuesi kryesor i stabilitetit në vend.

Në optikën e Konceptit Strategjik 2022, Ballkani Perëndimor rikonfirmohet si zonë me rëndësi kritike për paqen dhe stabilitetin në Europë. Aleanca mbështet

²⁵<https://www.natofoundation.org/western-balkans-dossier-twenty-years-of-nato-and-the-western-balkans/>

përpjekjet për të përmirësuar sigurinë dhe për të adresuar sfidat hibride, siç u dëshmua në vitin 2023 pas sulmit në Banjskë, ku NATO dërgoi trupa shtesë për të garantuar përmbushjen e mandatit të KFOR-it. Dokumenti parashikon nevojën për të forcuar rezistencën ndaj strategjive të dezinformimit dhe presionit ekonomik që synojnë destabilizimin e rajonit përmes ndikimeve të jashtme malinje.

Gjithashtu, NATO inkurajon procesin e integritetit euroatlantik dhe bashkëpunimin me BE-në dhe OKB-në si rrugën e vetme për stabilitet të qëndrueshëm. Përmes rritjes së kapaciteteve të mbrojtjes dhe promovimit të standardeve të qeverisjes, Aleanca synon ta transformojë rajonin nga një konsumator sigurie në një partner të qëndrueshëm që u reziston qasjeve detyruese të rivalëve strategjikë në kontinentin europian.

Operacionalizimi dhe përshtatja e Konceptit Strategjik 2022

Koncepti strategjik 2022 u hartua në një periudhë ndryshimesh të shpejta dhe të rëndësishme, ndaj samitet e NATO-s që u zhvilluan më pas kanë luajtur rol kyç jo vetëm në operacionalizimin, por edhe përshtatjes së tij me rrethanat e reja të mjedisit të sigurisë.

Në samitin e Vilniusit (11 korrik 2023), Aleanca miratoi për herë të parë që nga Lufta e Ftohtë plane rajonale të mbrojtjes, të cilat integrojnë strukturën e komandës dhe logjistikën për zona gjeografike specifike, duke synuar mbrojtjen e çdo centimetri të territorit të saj.²⁶ Po ashtu, NATO kaloi nga një strukturë e vogël reaguese (NATO Response Force) në një strukturë më të gjerë mbrojtëse, NATO Force Model, që rrit aftësinë për reagim të shpejtë. Vendet anëtare u zotuan të konsideronin 2% të PBB-së si dysheme për shpenzimet e mbrojtjes, duke pranuar se shpesh do të duhej ta tejkalonin këtë nivel.²⁷

Vendime të rëndësishme u morën edhe në raport me Ukrainën. Më konkretisht, u hoq detyrimi i Planit të Veprimit për Anëtarësim, gjë që thjeshton procesin e anëtarësimit të saj në NATO si dhe u krijua një Këshill NATO-Ukrainë, ku palët ulen si anëtarë të barabartë për të çuar përpara dialogun politik, angazhimin, bashkëpunimin dhe aspiratat e Ukrainës për anëtarësim në NATO.²⁸ Aleanca kaloi në një mbrojtje kibernetike më të integruar dhe zgjeroi fokusin e saj drejt sigurisë së infrastrukturës kritike nënujore, si reagim ndaj kërcënimeve të reja hibride. Një tjetër risi e Vilniusit ishte ashpërsimi i gjuhës ndaj Kinës dhe forcimi i lidhjeve me partnerët e Indo-Paqësorit. Së fundi, përmes miratimit të Planit të Veprimit për Prodhimin e Mbrojtjes,

²⁶<https://www.nato.int/en/about-us/official-texts-and-resources/official-texts/2023/07/11/vilnius-summit-communicue>

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

NATO synon standardizimin dhe rritjen masive të kapaciteteve industriale për të siguruar avantazh teknologjik dhe qëndrueshmëri ushtarake afatgjatë.

Në *samitin e Uashingtonit* (10 korrik 2024), NATO mori përsipër koordinimin e ndihmës ushtarake dhe trajnimit për Ukrainën, duke e konsideruar rrugën e saj drejt integritetit euroatlantik si të pakthyeshme.²⁹ Pas mësimave të nxjerra nga lufta në Ukrainë, u vendos forcimi i mbrojtjes 360-gradë, me fokus në interceptimin e raketave balistike dhe dronëve, duke synuar integritetin e sistemeve kombëtare të mbrojtjes ajrore për të krijuar një mburojë të vetme euro-atlantike. Shtetet anëtare u zotuan të rrisin bashkëpunimin me industrinë private për të përshpejtuar prodhimin e municioneve dhe sistemeve të mbrojtjes, duke pranuar se kapacitetet aktuale prodhuese janë të pamjaftueshme. Ndërkohë, në deklaratën e Samitit të Uashingtonit bie në sy një ashpërsim i gjuhës së përdorur ndaj Kinës, e cilësuar si “lehtësues vendimtar” i luftës së Rusisë kundër Ukrainës.³⁰

Në *samitin e Hagës* (25 qershor 2025), Aleatët u angazhuan të rrisin shpenzimet e mbrojtjes në nivelin 5% të PBB-së deri në vitin 2035. Nga kjo shumë, të paktën 3.5% do të dedikohet për kërkesat bazë të mbrojtjes dhe përmbushjen e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, ndërsa deri në 1.5% do të përdoret për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, sigurinë e rrjeteve, përgatitjen civile, inovacionin dhe forcimin e bazës industriale të mbrojtjes.³¹ Një element tjetër i ri ishte përfshirja e kontributeve për Ukrainën në llogaritjen e shpenzimeve kombëtare, duke e institucionalizuar ndihmën për Kievin si pjesë të sigurisë kolektive. Po ashtu, u theksua zgjerimi i bashkëpunimit industrial transatlantik, eliminimi i barrierave tregtare dhe nxitja e prodhimit të përbashkët për të siguruar rezerva të qëndrueshme municionesh dhe pajisjesh.³² Në këtë mënyrë, Haga shënoi kalimin nga angazhimet minimale të mëparshme drejt një arkitekture të re të sigurisë kolektive, ku mbrojtja, teknologjia, industria dhe solidariteti politik trajtohen si pjesë e një sistemi të integruar.

Samitet e parashikuara për t’u zhvilluar në Ankara (2026) dhe Shqipëri (2027) pritet të kontribuojnë më tej në përshtatjen e Konceptit Strategjik, duke reflektuar sfidat e reja të sigurisë dhe duke konsoliduar vendimet e marra në samitet e mëparshme.

²⁹Washington Summit Declaration, issued by the NATO Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington, D.C. 10 July 2024-
<https://www.nato.int/en/about-us/official-texts-and-resources/official-texts/2024/07/10/washington-summit-declaration>

³⁰<https://www.nato.int/en/about-us/official-texts-and-resources/official-texts/2024/07/10/washington-summit-declaration>

³¹<https://www.nato.int/en/about-us/official-texts-and-resources/official-texts/2025/06/25/the-hague-summit-declaration>

³² Po aty.

Përfundime

Koncepti Strategjik i vitit 2022 përfaqëson një pikë kthese për NATO-n, duke dëshmuar aftësinë e Aleancës për t'u përshtatur ndaj një mjedisi ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks dhe të pasigurt. Ky dokument nuk mbeti në nivel parimesh abstrakte, por u konkretizua përmes vendimeve të marra në Samitet e Vilniusit, Uashingtonit dhe Hagës. Procesi i zbatimit të tij tregon një orientim proaktiv të NATO-s, ku parandalimi i kërcënimeve vendoset si prioritet përpara nevojës për reagim.

Në këtë kuadër, integrimi i inteligjencës artificiale, mbrojtja e infrastrukturës nënujore dhe zhvillimi i një arkitekture ajrore të integruar "360 gradë" nuk përfaqësojnë thjesht modernizim teknologjik, por shënojnë një fazë të re të konceptimit të sigurisë kolektive. Aleanca e trajton sigurinë si një sistem të ndërthurur, ku teknologjia dhe kapacitetet ushtarake funksionojnë në mënyrë plotësuese.

Paralelisht, rritja e synuar e shpenzimeve për mbrojtjen, nga pragu prej 2% drejt objektivit prej 5% të PBB-së deri në vitin 2035, pasqyron një nivel më të lartë përgjegjshmërie kolektive, duke e konsideruar sigurinë si një investim të përbashkët dhe jo si një e drejtë e garantuar.

Në përfundim, perspektiva e suksesit të NATO-s në dekadat e ardhshme nuk lidhet vetëm me kapacitetin industrial dhe teknologjik, por mbi të gjitha me kohezionin politik dhe solidaritetin ndërmjet aleatëve. Këta elementë kanë qenë vendimtarë për ta bërë NATO-n strukturën më jetëgjatë të mbrojtjes kolektive në historinë moderne.

Bibliografia

1. Deni John R., Rynning Sten, The NATO Strategic Concept on Its Seventy-Fifth Anniversary, MILITARY REVIEW July-August 2024
2. NATO 2030: United for a New Era, 25 November 2020
3. Italian Atlantic Committee, The future of NATO and the role of Italy. Elements of reflections, 2023
4. Kaufman Joyce P., The US perspective on NATO under Trump: lessons of the past and prospects for the future, International Affairs 93: 2 (2017)
5. Larsen Henrik, Concept stratégique de l'OTAN: des ambitions modérées, Politique de sécurité: analyses du CSS, Center for Security Studies (CSS), ETH Zürich, No 309, Septembre 2022
6. LSE IDEAS. (2023, September). NATO's 2022 Strategic Concept: One Year On (Strategic Update). London School of Economics and Political Science. <https://www.lse.ac.uk/ideas/Assets/Documents/updates/2023-SU-NATO-OneYearOn.pdf>

7. Marrone Alessandro, NATO's New Strategic Concept: Novelties and Priorities, IAI Commentaries 22 /30 July 2022
8. Sperling James, Webber Mark, Trump's foreign policy and NATO: Exit and voice, Review of International Studies, July 2019
9. NATO 2030: United for a New Era, Analysis and Recommendations of the Reflection Group Appointed by the NATO Secretary General, 25 November 2020
10. NATO 2022 Strategic concept
11. Active Engagement, Modern Defence, Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of the North Atlantic Treaty Organization, November 2010
12. Vilnius Summit Communiqué. Issued by NATO Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Vilnius 11 July 2023
13. Washington Summit Declaration, issued by the NATO Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington, D.C. 10 July 2024
14. www.economist.com
15. www.iai.it
16. www.nato.int
17. www.natofoundation.org
18. www.monde-diplomatique.fr
19. www.reuters.com

Demografia dhe fuqia kombëtare: implikime strategjike për sigurinë dhe zhvillimin

Nënkolonel (R) Msc. Alqi NIKOLLA

*Oficer shtabi/specialist/kërkues për studime dhe analizë strategjike,
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA*

Trajtesë e shkurtuar

Ky punim shqyrton demografinë si element të faktorit social në kuadrin e qasjes gjithëpërfshirëse të NATO-s. Analiza fokusohet në evidentimin e ndikimit të faktorëve demografikë në fuqinë kombëtare të një shteti, duke theksuar rolin e tyre në ruajtjen e stabilitetit, sigurisë dhe kapaciteteve strategjike. Vëmendje e veçantë i kushtohet demografisë si komponent strukturor dhe i pandashëm i faktorit social, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, qëndrueshmërinë institucionale dhe aftësitë mbrojtëse. Metodologjia e studimit bazohet në analizën sistmore, e cila mundëson shqyrtimin e marrëdhënieve ndërmjet faktorëve demografikë, ekonomikë, socialë dhe ushtarakë në kuadër të fuqisë kombëtare.

Zbatimi i saj është realizuar përmes rishikimit sistematik të literaturës, analizës krahasuese ndërmjet shteteve të ndryshme, analizës sistmore të ndërveprimeve mes faktorëve demografikë dhe atyre strategjikë, kërkimit teorik dhe analizës shkencore ushtarake. Konkretisht, analiza sistmore është aplikuar duke identifikuar lidhjet shkak-pasojë ndërmjet variablave demografikë (norma e fertilitetit, struktura e moshës, flukset migratore) dhe kapaciteteve kombëtare (ekonomike, mbrojtëse, institucionale), si dhe duke ndërtuar modele interpretative mbi bazën e rasteve studimore. Punimi synon të kontribuojë në kuptimin e demografisë si element thelbësor i fuqisë kombëtare dhe sigurisë kombëtare, si dhe në integrimin e saj në planifikimin strategjik bashkëkohor.

Fjalë kyçe: qasje gjithëpërfshirëse; demografi; faktor social; fuqi kombëtare; siguri.

Hyrje

Në botën e sotme bashkëkohore, mjedisi i sigurisë karakterizohet nga transformime të thella të nxitura nga globalizimi, proceset dinamike sociale dhe ndërvlerësia në rritje ndërmjet shteteve. Në këtë kontekst, demografia po shfaqet si një faktor strategjik me implikime të drejtpërdrejta dhe afatgjata për fuqinë kombëtare dhe sigurinë e shteteve moderne. Ajo përbën një komponent strukturor të dimensionit social në kuadrin e qasjes gjithëpërfshirëse të NATO-s dhe zë një vend të rëndësishëm në analizën e qëndrueshmërisë, zhvillimit dhe kapaciteteve strategjike të shteteve. Qasja gjithëpërfshirëse përbën një parim themelor të Aleancës, mbi të cilin mbështetet planifikimi dhe zhvillimi i operacioneve, fushatave dhe aktiviteteve joluftarake.¹ Në këtë kuadër, tendencat demografike – si plakja e popullsisë, rënia e lindshmërisë dhe proceset migratore – ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e shteteve për të ruajtur kapacitetet ekonomike, sociale dhe mbrojtëse.

Në literaturën bashkëkohore, fuqia kombëtare nuk përcaktohet vetëm nga kapacitetet ekonomike dhe ushtarake, por edhe nga faktorë socialë, politikë, kulturorë dhe teknologjikë. Midis tyre, demografia zë një vend të veçantë, pasi popullsia përfaqëson bazën e kapitalit njerëzor, fuqisë punëtore, potencialit ushtarak dhe legjitimitetit politik.² Në këtë kuptim, proceset demografike nuk përbëjnë vetëm një dimension statistikor, por një faktor strategjik që ndikon në zhvillimin afatgjatë të shtetit dhe në pozicionin e tij në sistemin ndërkombëtar. Zhvillimi i fuqisë kombëtare kërkon një qasje sistimore që integron dimensionet demografike me faktorët ekonomikë, politikë dhe ushtarakë. Pikërisht për këtë arsye, shumë studiues bashkëkohorë theksojnë lidhjen ndërmjet tendencave demografike dhe aftësisë së shteteve për të mbrojtur interesat e tyre në sistemin ndërkombëtar.³

Përvoja historike tregon se demografia është një nga treguesit më të besueshëm të ngritjes dhe rënies së shteteve dhe perandorive. Një shembull klasik është Perandoria Romake, rënia demografike e së cilës lidhet me dobësimin e kapaciteteve ushtarake dhe bazës ekonomike.⁴ Procese të ngjashme mund të vërehen edhe në Perandorinë Osmane, ku rënia e popullsisë prodhuese dhe migrimi i brendshëm dobësuan stabilitetin shtetëror. Në aspektin bashkëkohor, shembuj si Japonia dhe Gjermania ilustrojnë mënyrën

¹ Stoychev, S. (2023). *Joint operations and their planning*. Sofia, Bulgaria: "Dio Mira" Publishing House.

² Nye, J. (11 May 2004). Soft power: The means to success in world politics. *Public Affairs*, p. 208.

³ Kugler, J. (1 September 1989). *The power transition: A retrospective and prospective evaluation*. Midlarsky, pp. 171-194.

⁴ Goldstone, J. A. (16 August 2012). *Political demography: How population changes are reshaping international security and national politics*. p. 336.

se si plakja e popullsisë dhe normat e ulëta të lindshmërisë paraqesin sfida serioze për sistemet sociale, kapacitetin mbrojtës dhe qëndrueshmërinë ekonomike.⁵ Në të kundërt, India dhe Nigeria demonstrojnë potencialin e popullsisë të reja dhe të mëdha për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të rritur ndikimin ndërkombëtar. Në këtë kuptim, demografia konsolidohet si një komponent strukturor i faktorit social, i cili zë një vend qendror në modelet gjithëpërfshirëse të fuqisë kombëtare. Ajo ndikon në të gjithë elementët e tjerë – ekonomikë, ushtarakë, politikë dhe kulturorë.

Ky studim synon të analizojë rolin e demografisë si komponent i fuqisë kombëtare dhe sigurisë kombëtare, duke shqyrtuar ndikimin e saj në zhvillimin ekonomik, kapacitetet mbrojtëse dhe planifikimin strategjik. Metodologjia mbështetet në qasjen sistimore, e cila mundëson analizimin e ndërveprimeve dhe marrëdhënieve shkak-pasojë ndërmjet faktorëve demografikë, ekonomikë, socialë dhe ushtarakë. Një theks i veçantë vendoset mbi marrëdhënien ndërmjet demografisë dhe sigurisë kombëtare. Tendencat negative demografike – si rënia e popullsisë, plakja dhe migracioni – mund të dobësojnë stabilitetin social, të rrisin presionin mbi sistemet sociale dhe të kufizojnë kapacitetin mbrojtës. Në të kundërt, tendencat pozitive demografike krijojnë kushte për rritje ekonomike, inovacion dhe zgjerim të kapaciteteve strategjike. Krahas aspekteve të përmendura, proceset demografike kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik. Pikërisht këtu bëhet i dukshëm roli i planifikimit strategjik dhe nevoja për një doktrinë kombëtare afatgjatë, e cila integron prioritetet demografike në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të shtetit.⁶

Në kontekstin shqiptar, dimensionin demografik paraqet rëndësi të veçantë strategjike për shkak të proceseve të vazhdueshme të emigracionit, rënies së lindshmërisë dhe plakjes graduale të popullsisë. Këto tendenca ndikojnë drejtpërdrejt në tregun e punës, zhvillimin ekonomik, kohezionin social dhe bazën e kapitalit njerëzor të disponueshëm për institucionet shtetërore, përfshirë sektorin e mbrojtjes. Në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në NATO dhe proceseve integruese evropiane, analiza e faktorëve demografikë merr rëndësi të shtuar në planifikimin strategjik kombëtar dhe në ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të shtetit.

Rëndësia shkencore e kësaj teme buron nga fakti se, në kushtet e pasigurisë globale, demografia shndërrohet në një tregues kyç të qëndrueshmërisë. Siç thekson Nye, fuqia kombëtare nuk përcaktohet më vetëm nga dimensionet

⁵ Coleman, D. (September 2006). *Immigration and ethnic change in low-fertility countries: A third demographic transition*. *Population and Development Review*, 32, 52-96.

⁶ Angelov, G. (2024a). *For (un)success of the nation and whether national doctrine and strategy are guarantee for country's prosperity*.

ushtarake dhe ekonomike, por edhe nga aftësia e shtetit për të menaxhuar kapitalin social dhe burimet njerëzore.⁷ Pikërisht për këtë arsye, studimi sistematik i faktorëve demografikë përbën një parakusht për krijimin e strategjive dhe politikave efektive që garantojnë sigurinë dhe prosperitetin kombëtar.

Ky studim gjithashtu synon të kontribuojë në debatin teorik dhe praktik mbi fuqinë kombëtare dhe sigurinë, duke analizuar dimensionin demografik si variabël strategjik me ndikim afatgjatë në kapacitetet ekonomike, sociale dhe mbrojtëse të shtetit. Në këtë kuadër, studimi mbështetet në qasje sistmore dhe multidisiplinare, të cilat mundësojnë shqyrtimin e marrëdhënieve ndërmjet dinamikave demografike dhe objektivave strategjikë kombëtarë. Përmes kësaj perspektive, ai thekson nevojën për integrimin e faktorëve demografikë në planifikimin strategjik dhe në hartimin e politikave afatgjata të sigurisë dhe zhvillimit.

Demografia si përcaktues strategjik i fuqisë kombëtare

Në kontekstin e globalizimit, proceseve migratore, rritjes së lëvizshmërisë së fuqisë punëtore dhe ndryshimeve teknologjike, demografia është shndërruar në një nga parametrat kyç të planifikimit strategjik. Gjatë dekadave të fundit, shtetet me popullsi në plakje janë përballur me nevojën për të përshtatur sistemet e tyre sociale dhe të mbrojtjes me realitete të reja demografike, ndërsa shtetet me popullsi të re dhe në rritje përballen me sfida që lidhen me punësimin, stabilitetin social dhe presionin migrator. Demografia nuk përfaqëson thjesht një tregues statistikor, por një faktor strategjik që ndikon drejtpërdrejt në formimin dhe zhvillimin e fuqisë kombëtare. Në teoritë klasike të marrëdhënieve ndërkombëtare, fuqia kombëtare lidhej kryesisht me forcën ekonomike dhe kapacitetet ushtarake.⁸ Megjithatë, në kontekstin bashkëkohor, dimensionet sociale – veçanërisht demografia – po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe, pasi kapitali njerëzor përbën bazën e institucioneve të qëndrueshme, inovacionit dhe sigurisë kombëtare.

Siç argumenton Nicholas Eberstadt, ndryshimet demografike nuk përbëjnë vetëm një sfond statistikor, por ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi potencialin strategjik dhe fuqinë kombëtare të shtetit.⁹ Në këtë kuptim, tendencat demografike ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në elementet kryesore të fuqisë kombëtare, përfshirë sistemet politike, ekonomike, sociale,

⁷ Nye, J. (11 May 2004). *Soft power: The means to success in world politics*. Public Affairs, p. 208.

⁸ Morgenthau, H. J. (1948). *Politics among nations: The struggle for power and peace*. New York: Alfred A. Knopf.

⁹ Eberstadt, Nicholas. *The Demographic Future: What Population Growth—and Decline—Means for the Global Economy*. *Foreign Affairs* 89, no. 6 (2025): p. 54–64.

ushtarake dhe infrastrukture. Madhësia dhe struktura e popullsisë ndikojnë në stabilitetin institucional, tregun e punës, bazën e rekrutimit ushtarak, qëndrueshmërinë ekonomike dhe kapacitetin e shtetit për të projektuar fuqi. Karakteristikat demografike ndikojnë veçanërisht në dimensionin ushtarak dhe ekonomik. Një bazë e qëndrueshme popullsie siguron burime njerëzore për forcat e armatosura, fuqinë punëtore dhe sistemet publike, ndërsa tendencat negative – si plakja, emigracioni dhe rënia e lindshmërisë – mund të kufizojnë kapacitetet mobilizuese dhe të rrisin kostot sociale.

Në këtë kuadër, demografia lidhet ngushtë me instrumentet tradicionale të fuqisë kombëtare. Brenda modelit DIME¹⁰ të përdorur nga NATO, faktorët demografikë ndikojnë në kapacitetet diplomatike, informative, ushtarake dhe ekonomike të shtetit. Për rrjedhojë, analiza e dimensionit demografik nuk duhet të trajtohet si element dytësor, por si pjesë integrale e planifikimit strategjik dhe e ruajtjes së fuqisë kombëtare në mjedisin e sotëm të sigurisë.

Demografia si komponent strukturor i faktorit social

Karakteristikat demografike – si madhësia e popullsisë, struktura sipas moshës, modelet migratore, profili arsimor dhe urbanizimi – përbëjnë bazën e kapitalit social të një vendi. Këto karakteristika ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, stabilitetin politik dhe kapacitetet mbrojtëse.

Madhësia e popullsisë – një popullsi e madhe siguron një rezervë më të gjerë burimesh njerëzore si për aktivitetet ekonomike, ashtu edhe për ato ushtarake. Kina dhe India janë shembuj të shteteve që shfrytëzojnë potencialin e tyre demografik për të fituar ndikim global. Në të kundërt, shtetet më të vogla shpesh kompensojnë kufizimet demografike përmes inovacionit dhe pjesëmarrjes në aleanca ndërkombëtare.¹¹

Struktura sipas moshës – një popullsi e re shërben si nxitës i rritjes ekonomike, ndërsa një popullsi në plakje paraqet sfida të konsiderueshme për sistemet sociale dhe gatishmërinë mbrojtëse.¹² Evropa, për shembull, po përballë me plakje demografike, e cila kufizon fuqinë punëtore dhe rrit shpenzimet publike për shërbimet sociale. Sipas INSTAT edhe Shqipëria po përjeton transformime demografike, të karakterizuara nga ulja e lindshmërisë, emigracioni i të rinjve dhe rritja graduale e moshës mesatare të popullsisë, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në tregun e punës, sistemin e pensioneve dhe

¹⁰ Modeli DIME përfaqëson katër instrumentet kryesore të fuqisë kombëtare – diplomatik, informativ, ushtarak dhe ekonomik – përmes të cilëve shtetet projektojnë interesat dhe ndikimin e tyre në mjedisin ndërkombëtar.

¹¹ Singer, J. B. (1985). *Peace, War, and Numbers*. Beverly Hills: Sage.

¹² Coleman, D. (September 2006). *Immigration and etic change in low-fertility countries: A third demographic transition*. *Population and Development Review*, p. 52-96.

disponueshmërinë e kapitalit njerëzor për sektorët strategjikë, përfshirë mbrojtjen.¹³

Migracioni – emigrimi i individëve të rinj dhe të kualifikuar dobëson potencialin kombëtar përmes reduktimit të kapitalit njerëzor dhe fuqisë punëtore. Megjithatë, një politikë migratore e mirëmenaxhuar mund të kontribuojë në rritjen ekonomike, transferimin e njohurive dhe zhvillimin shoqëror.¹⁴ Në rastin e Shqipërisë, emigracioni i vazhdueshëm i të rinjve dhe profesionistëve ka ndikuar në tkurrjen e forcës aktive të punës dhe në rritjen e presionit mbi sektorë strategjikë si arsimi, shëndetësia dhe administrata publike.

Profili arsimor – një popullsia e arsimuar rrit konkurrueshmërinë kombëtare, produktivitetin ekonomik dhe zgjeron kapacitetin inovativ të shtetit. Në këtë kuptim, investimet në arsim konsiderohen investime strategjike në fuqinë kombëtare.¹⁵ Për vendin tonë, përmirësimi i kapitalit njerëzor përmes arsimit cilësor dhe formimit profesional mbetet thelbësor për rritjen e kapaciteteve institucionale, modernizimin ekonomik dhe përgatitjen e burimeve njerëzore për sektorë strategjikë, përfshirë sigurinë dhe mbrojtjen.

Urbanizimi – përqendrimi i popullsisë në qendrat urbane lehtëson dinamizmin ekonomik, rrit produktivitetin dhe nxit inovacionin përmes afërsisë së burimeve njerëzore dhe infrastrukture, por njëkohësisht mund të shtojë rreziqet e tensioneve sociale, pabarazisë dhe presionit mbi shërbimet publike. Në këtë kuadër, Shqipëria paraqet një model të qartë të urbanizimit të përqendruar në kryeqytet, si qendër ekonomike, administrative dhe demografike, çka ka sjellë zhvillim të shpejtë urban, por edhe sfida në shpërndarjen e balancuar të popullsisë dhe zhvillimit rajonal.¹⁶

Këta faktorë strategjikë janë të lidhur ngushtë me instrumentet e fuqisë kombëtare, përmes të cilave shtetet – individualisht ose në kuadër koalicionesh – projektojnë, zhvillojnë dhe ruajnë aftësitë e tyre përgjatë spektrit të konkurrencës strategjike bashkëkohore.

Lidhja ndërmjet demografisë dhe sigurisë kombëtare

Proceset demografike kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare, duke ndikuar si në stabilitetin social, ashtu edhe në kapacitetet mbrojtëse të shtetit.

Stabiliteti social – tendencat negative demografike, si normat e ulëta të lindshmërisë, plakja e popullsisë dhe presioni migrator, mund të minojnë

¹³ INSTAT. *Women and Men in Albania 2023*. Tiranë: Instituti i Statistikave, 2023.

¹⁴ World Bank. *Migration and Brain Drain*. Washington, DC: World Bank Group, 2019.

¹⁵ Bloom, D., Canning, D. (2003). *The demographic dividend: A new perspective on the economic consequences of population change*. Santa Monica, CA, USA: RAND Corporation

¹⁶ INSTAT. *Women and Men in Albania 2023*. Tiranë: Instituti i Statistikave, 2023.

besimin publik ndaj institucioneve dhe të gjenerojnë tensione të brendshme.¹⁷ Në rastin e Shqipërisë, emigracioni i vazhdueshëm drejt vendeve të Bashkimit Evropian ka krijuar sfida në ruajtjen e kapitalit njerëzor dhe në qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit social dhe ekonomik. Këto zhvillime mund të ndikojnë indirekt edhe në besimin publik ndaj institucioneve dhe në perceptimin e stabilitetit të brendshëm.

Kapacitetet mbrojtëse – baza demografike për rekrutim, së bashku me nivelin arsimor dhe shëndetësor të popullsisë, përbëjnë faktorë kyç të gatishmërisë ushtarake. Në kushtet e rënies demografike, shteti shpesh detyrohet të mbështetet në sisteme të teknologjisë së lartë ose tek aleancat e ndryshme. Në kushtet e rënies së popullsisë në moshë pune dhe emigrimit të të rinjve, Shqipëria përballet me kufizime potenciale në burime njerëzore për sektorët strategjikë, përfshirë mbrojtjen, duke e bërë më të rëndësishëm modernizimin teknologjik dhe bashkëpunimin me aleatët.

Kërcënimet e jashtme – cenueshmëria demografike mund ta ekspozojë një shtet ndaj presioneve të jashtme, si krizat migratore, përhapja demografike nga shtetet fqinje ose aktivitetet subversive të aktorëve armiqësorë. Për një shtet me madhësi të kufizuar si Shqipëria, këto dinamika kanë implikime të drejtpërdrejta për sigurinë kombëtare dhe qëndrueshmërinë strategjike.

Pa një strukturë demografike të qëndrueshme, strategjia kombëtare mbetet e brishtë, pasi mungon potenciali i mjaftueshëm njerëzor për arritjen e objektivave kombëtarë dhe garantimin e sovranitetit. Për studiuesit ndërkombëtarë, demografia përbën një komponent themelor të fuqisë dhe sigurisë kombëtare. Sipas Nicholas Eberstadt, trendet e popullsisë ndikojnë në aftësinë e shteteve për të gjeneruar fuqi ekonomike dhe ushtarake, ndërsa Jack A. Goldstone nënvizon se ndryshimet demografike mund të shërbejnë si nxitës të rëndësishëm të paqëndrueshmërisë politike dhe transformimeve të thella shtetërore.

Në mënyrë të ngjashme, Kennedy thekson se baza demografike dhe burimet njerëzore janë elemente kyçe të fuqisë kombëtare, duke ndikuar në ngritjen dhe rënien e fuqive të mëdha. Në këtë perspektivë, një strukturë demografike e qëndrueshme konsiderohet parakusht për ruajtjen e kapaciteteve strategjike dhe garantimin e sovranitetit shtetëror.¹⁸

¹⁷ Teitelbaum, M. W. (1985). *The Fear of Population Decline*. Orlando, Florida, USA: Academic Press.

¹⁸ Eberstadt, Nicholas. *Men Without Work: America's Invisible Crisis*. West Conshohocken, PA: Templeton Press, 2016. Goldstone, Jack A. *Revolution and Rebellion in the Early Modern World*. Berkeley: University of California Press, 1991. Kennedy, Paul. *The Rise and Fall of the Great Powers: Economic Change and Military Conflict from 1500 to 2000*. New York: Random House, 1987.

Të gjitha qasjet strategjike bashkëkohore theksojnë se strukturat demografike ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin shtetëror për të gjeneruar fuqi dhe për të garantuar sovranitetin, duke e vendosur demografinë si një komponent themelor të sigurisë kombëtare.

Demografia dhe zhvillimi ekonomik

Dinamika demografike luan një rol vendimtar në formësimin e rezultateve ekonomike, ndërsa kapitali njerëzor përfaqëson burimin kryesor për prodhimin, inovacionin dhe konsumin. Struktura e popullsisë sipas moshës përcakton njëkohësisht ofertën në tregun e punës dhe kërkesën për mallra e shërbime. Shtetet me popullsi të re dhe në rritje shpesh përfitojnë nga “dividendi demografik” – një periudhë gjatë së cilës pjesa e popullsisë në moshë pune tejkalon ndjeshëm atë të popullsisë së varur, duke krijuar kushte të favorshme për zgjerim ekonomik, nëse shoqërohet me politika të përshtatshme në arsim, kujdes shëndetësor dhe zhvillim ekonomik. Shembulli klasik është India, ku struktura e re demografike mbështet si konsumin e brendshëm, ashtu edhe furnizimin global me forcë punëtore.¹⁹

Në anën tjetër, plakja e popullsisë paraqet një nga sfidat negative më të mprehta, duke rritur shpenzimet sociale dhe duke ngushtuar fuqinë punëtore të disponueshme. Japonia ilustron këtë dinamikë, ku plakja e shpejtë ka ushtruar presion të konsiderueshëm mbi sistemin e mirëqenies sociale dhe ka kontribuar në ngadalësimin afatgjatë të produktivitetit.²⁰ Strategjitë proaktive – si politikat e mirërregulluara të migracionit dhe investimet në arsim – kanë potencialin të zbusin këto efekte, duke mbështetur qëndrueshmërinë ekonomike dhe fuqinë kombëtare.²¹ Për rrjedhojë, përshtatja ndaj ndryshimeve demografike përmes politikave publike largpamëse mbetet thelbësore për ruajtjen e stabilitetit socio-ekonomik në kushtet e konkurrencës globale.

Demografia dhe planifikimi strategjik

Në kontekstin e qeverisjes moderne strategjike, demografia duhet të konsiderohet jo thjesht si një faktor dytësor, por si një komponent qendror dhe dinamik i fuqisë kombëtare. Planifikimi strategjik dhe hartimi i strategjive dhe doktrinae kombëtare kërkojnë integrimin e treguesve demografikë, në mënyrë që të sigurohet një bazë realiste dhe e qëndrueshme për vendimmarrjen. Madhësia, struktura, shpërndarja dhe tendencat e popullsisë ndikojnë në aftësinë e shtetit për të gjeneruar prodhim ekonomik, për të ruajtur sigurinë,

¹⁹ Bloom, D., Canning, D. (2003). *The demographic dividend: A new perspective on the economic consequences of population change*. Santa Monica, CA, USA: RAND Corporation.

²⁰ Coleman, D. (September 2006). *Immigration and etic change in low-fertility countries: A third demographic transition*. *Population and Development Review*, p. 82.

²¹ Bank, W. (15 March 2019). *World Development Report 2019*. Washington DC, USA.

për të mbështetur inovacionin dhe për të garantuar kohezionin social – elementë thelbësorë të efektivitetit strategjik afatgjatë. Pa integrimin e analizës demografike, strategjitë kombëtare rrezikojnë të neglizhojnë cenueshmëri kritike ose potenciale të pashfrytëzuara.

Në këtë kuptim, literatura bashkëkohore e sigurisë dhe studimet mbi fuqinë shtetërore theksojnë se dokumentet strategjike humbasin një pjesë të rëndësisë dhe efektivitetit të tyre nëse nuk integrojnë në mënyrë të plotë dinamikat demografike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin e shtetit për të gjeneruar fuqi dhe për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë strategjike. Sipas Eberstadt,²² tendencat demografike përbëjnë një element përcaktues të fuqisë kombëtare, duke ndikuar në aftësinë e shteteve për të mobilizuar burime ekonomike dhe njerëzore në funksion të objektivave strategjike. Në mënyrë të ngjashme, Goldstone²³ argumenton se mosintegrimi i ndryshimeve demografike në planifikimin strategjik mund të çojë në paqëndrueshmëri të brendshme dhe dobësim institucional. Ndërsa sipas Kennedy²⁴ strategjia kombëtare është e paqëndrueshme nëse nuk mbështetet mbi realitetin e burimeve kombëtare, përfshirë kapitalin njerëzor. Në këtë mënyrë, demografia shfaqet si një komponent thelbësor i sigurisë kombëtare dhe një faktor i domosdoshëm në hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike të shtetit.

Kjo është veçanërisht e dukshme në formulimin e politikave të mbrojtjes, zhvillimin e forcës së punës, sistemet arsimore, planifikimin shëndetësor dhe menaxhimin e migracionit, të cilat janë të gjitha të ndërvarura me tendencat demografike. Qasjet bashkëkohore për matjen e fuqisë kombëtare përfshijnë gjithnjë e më shumë variabla demografikë krahas treguesve tradicionalë, si forca ekonomike, kapaciteti ushtarak, stabiliteti politik dhe zhvillimi teknologjik. Këto modele të integruara adoptojnë një perspektivë sistemore, duke i konsideruar dinamikat e popullsisë jo thjesht si të dhëna statike sfondi, por si shumëzues aktivë të kapacitetit strategjik të shtetit.

Në rastin e Shqipërisë, këto dinamika janë veçanërisht të dukshme për shkak të emigracionit të lartë të të rinjve, uljes së lindshmërisë dhe përqendrimit të popullsisë në zonat urbane, veçanërisht në Tiranë, çka ka krijuar sfida në shpërndarjen e kapitalit njerëzor dhe zhvillimin e balancuar rajonal. Këto trende demografike ndikojnë drejtpërdrejt në tregun e punës, sistemin e pensioneve dhe kapacitetin e institucioneve publike, përfshirë edhe sektorët e

²² Eberstadt, Nicholas. *Men Without Work: America's Invisible Crisis*. West Conshohocken, PA: Templeton Press, 2016.

²³ Goldstone, Jack A. *Revolution and Rebellion in the Early Modern World*. Berkeley: University of California Press, 1991.

²⁴ Kennedy, Paul. *The Rise and Fall of the Great Powers: Economic Change and Military Conflict from 1500 to 2000*.

sigurisë dhe mbrojtjes, duke e bërë integrimin e analizës demografike në planifikimin strategjik kombëtar një domosdoshmëri gjithnjë e më të rëndësishme.

Për më tepër, zhvillimi i një Strategjie të Madhe (Grand Strategy) gjithëpërfshirëse – një vizion afatgjatë dhe i gjerë që harmonizon objektivat kombëtarë me burimet dhe kapacitetet në dispozicion – duhet të mbështetet në një kuptim të thelluar të realiteteve demografike. Demografia përcakton hapësirën dhe kufijtë e veprimit të shtetit si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Ajo përcakton qëndrueshmërinë e politikave publike, qëndrueshmërinë e institucioneve dhe besueshmërinë e angazhimeve kombëtare në aleanca dhe organizata ndërkombëtare, si NATO apo BE. Në këtë kuptim, kërkimi demografik nuk përbën thjesht një ushtrim statistikor, por një gur themeli të parashikimit strategjik dhe qeverisjes moderne.

Sfidat demografike dhe ndikimi i tyre në fuqinë kombëtare

Proceset demografike nuk janë fenomene statike, por faktorë dinamikë socialë që formësojnë aftësinë e një shteti për të ndërtuar dhe ruajtur fuqinë e tij kombëtare. Në kontekstin e sigurisë globale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, ato janë shndërruar në një tregues kritik të qëndrueshmërisë shoqërore, zhvillimit ekonomik dhe kapaciteteve mbrojtëse. Një analizë e sfidave demografike tregon se ato mund të kenë si dimensione të brendshme – që ndikojnë në stabilitetin social dhe qëndrueshmërinë institucionale – ashtu edhe dimensione të jashtme, të lidhura me ndikimin ndërkombëtar të shtetit dhe detyrimet e tij në kuadër të aleancave. Pa një konsideratë sistemore të rreziqeve demografike, strategjitë kombëtare rrezikojnë të humbasin rëndësinë dhe zbatueshmërinë e tyre në kontekstet reale të sigurisë. Mbi këtë bazë, do të paraqiten disa varësi dhe ndikime themelore të demografisë në raport me fuqinë kombëtare.

Sipas autorëve të ndryshëm, pikërisht demografia pritet të jetë një nga faktorët përcaktues të transformimit të rendit ndërkombëtar dhe të kalimit gradual nga një sistem unipolar drejt një sistemi multipolar – një proces që tashmë ka filluar. Ata argumentojnë se fuqia afatgjatë e shteteve nuk do të varet vetëm nga zhvillimi teknologjik apo kapacitetet industriale, por mbi të gjitha nga potenciali demografik dhe cilësia e kapitalit njerëzor. Për më tepër, rëndësi vendimtare do të kenë edhe vlerat, idetë dhe modelet shoqërore që do të formësojnë brezat e ardhshëm. Megjithatë, fokusi do të mbetet te dimensionimi demografik dhe ndikimi i tij në fuqinë kombëtare dhe sigurinë strategjike.

Rënia demografike dhe siguria kombëtare

Tendencat negative demografike – rënia e lindshmërisë, plakja e popullsisë dhe nivelet e larta të emigracionit – kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare.

Plakja e popullsisë përfaqëson një nga sfidat kryesore demografike të kohëve moderne, e cila ndikon drejtpërdrejt në uljen e potencialit mobilizues të shteteve dhe në rritjen e konsiderueshme të barrës fiskale mbi sistemet sociale dhe shëndetësore. Në këtë kuadër, studiuesit theksojnë se rritja e përqindjes së popullsisë në moshë të tretë kufizon bazën e fuqisë punëtore dhe rrit presionin mbi buxhetet publike, duke ndikuar indirekt edhe në kapacitetet e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare.²⁵ Përvojat e shteteve të zhvilluara si Japonia dhe Italia konfirmojnë këtë trend, ku plakja e shpejtë demografike është shoqëruar me vështirësi në ruajtjen e niveleve të gatishmërisë ushtarake dhe të qëndrueshmërisë së sistemeve të mirëqenies.²⁶ Në mënyrë të ngjashme, analizat e *Organisation for Economic Co-operation and Development* tregojnë se plakja demografike redukton kapacitetin e rritjes ekonomike afatgjatë dhe rrit varësinë e sistemeve sociale, duke krijuar presione të dyfishta mbi financat publike dhe politikat e sigurisë shtetërore.²⁷

Emigracioni, i përcaktuar nga largimi masiv i individëve të rinj dhe të arsimuar, dobëson ekonominë dhe kufizon potencialin për modernizim ushtarak. Në disa vende, ky proces përshkruhet si “ikje e trurit” (brain drain), e cila minon qëndrueshmërinë strategjike.²⁸

Në rastin e Shqipërisë, këto dinamika janë veçanërisht të theksuara, pasi vendi përballet me emigracion të vazhdueshëm të të rinjve dhe profesionistëve, ulje të lindshmërisë dhe plakje graduale të popullsisë. Këto zhvillime kanë ndikuar në tkurrjen e fuqisë punëtore, në presionin mbi sistemin e pensioneve dhe në vështirësitë për të siguruar kapital njerëzor të mjaftueshëm për sektorët strategjikë, përfshirë administratën publike, ekonominë dhe mbrojtjen kombëtare.

Në këtë kuptim, rënia demografike nuk përfaqëson vetëm një sfidë sociale dhe ekonomike, por edhe një faktor me implikime të drejtpërdrejta në sigurinë kombëtare dhe qëndrueshmërinë strategjike të shtetit.

Kohezioni social dhe implikimet demografike për sigurinë kombëtare

Kohezioni social – ose mungesa e tij – dobëson besimin shoqëror, duke çuar në paqëndrueshmëri politike dhe rritje të cenueshmërisë ndaj ndikimeve të jashtme. Siguria kombëtare është e pandashme nga baza demografike e shoqërisë, pasi pa të, asnjë sistem mbrojtës nuk mund të mbijetojë në afat

²⁵ United Nations, Department of Economic and Social Affairs. *World Population Ageing 2019*. New York: United Nations, 2019.

²⁶ Coleman, D. (September 2006). *Immigration and ethnic change in low-fertility countries: A third demographic transition*. *Population and Development Review*, p. 49.

²⁷ OECD. *Pensions at a Glance 2023: OECD and G20 Indicators*. Paris: OECD Publishing, 2023.

²⁸ Bank, W. (15 March 2019). *World Development Report 2019*. Washington DC, USA.

të gjatë. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë thekson rëndësinë e kapitalit njerëzor dhe ruajtjes së burimeve demografike si elemente thelbësore të fuqisë shtetërore.

Ky vëzhgim është veçanërisht i rëndësishëm për shtetet e vogla, të cilat varen në mënyrë të theksuar nga cilësia dhe disponueshmëria e kapitalit njerëzor. Tendencat si rënia e popullsisë, “brain drain” dhe plakja e saj mund të kenë ndikim disproporcionalisht të madh në qëndrueshmërinë kombëtare dhe kapacitetet mbrojtëse. Për këtë arsye, ruajtja e një baze demografike të qëndrueshme nuk përbën vetëm një prioritet social, por edhe një imperativ strategjik për garantimin e sovranitetit kombëtar.

Një shembull ilustrues është krahasimi ndërmjet Suedisë dhe Izraelit. Suedia, pavarësisht kushteve të larta të mirëqenies dhe politikave sociale të zhvilluara, regjistroi në vitin 2023 nivelin më të ulët të lindshmërisë që nga shekulli XVIII. Kjo tregon se komoditeti material nuk prodhon automatikisht riprodhim demografik – lindshmëria lidhet me besimin, vazhdimësinë dhe ndjesinë e një qëllimi kolektiv. Në shoqërinë suedeze mungojnë elementë të kohezionit identitar, si ideja e kombit si mision dhe dimension i sakrificës kolektive. Izraeli, nga ana tjetër, pavarësisht dekadave të tensionit dhe konfliktit, ruan një nga normat më të larta të lindshmërisë në botën e zhvilluar. Këtu familja dhe vazhdimësia e brezave perceptohen si detyrim kolektiv dhe mbijetesë kombëtare, ndërsa fëmija shihet si pjesëmarrës në një projekt të përbashkët shoqëror. Ndryshimi thelbësor ndërmjet dy shoqërive qëndron në nivelin e ndërgjegjes kolektive dhe strukturën e kuptimit social.

Shembujt e Suedisë dhe Izraelit tregojnë se demografia nuk është thjesht rezultat i politikave sociale apo ekonomike – ajo është një element thelbësor i sigurisë dhe fuqisë kombëtare në kuptimin e saj më të gjerë strategjik.

Ndikimi në kapacitetin mbrojtës

Fuqia ushtarake tradicionalisht konsiderohet si një nga elementët qendrorë të fuqisë kombëtare. Megjithatë, cilësia dhe sasia e burimeve njerëzore mbi të cilat ajo mbështetet janë të lidhura në mënyrë të pandashme me proceset demografike.

Mungesa e personelit ushtarak. Shtetet që përballen me rënie të popullsisë hasin vështirësi në rekrutimin e numrit të nevojshëm të personelit ushtarak. Kjo situatë kërkon ndryshime strukturore në forcat e armatosura, ushtri profesionale dhe forcave rezervë të mirëpërgatitura.²⁹

Kompensimi teknologjik. Kur burimet njerëzore janë të kufizuara, shtetet shpesh investojnë në armatime dhe sisteme mbrojtëse të teknologjisë së lartë.

²⁹ Singer, J. B. (1985). *Peace, War, and Numbers*. Beverly Hills: Sage.

Megjithatë, kjo qasje kërkon burime të konsiderueshme financiare, të cilat jo të gjitha shtetet mund t'i përballojnë.³⁰

Mekanizmat aleatë. Shtetet më të vogla shpesh mbështeten në mbrojtjen kolektive brenda NATO-s dhe Bashkimit Evropian për të kompensuar dobësitë e tyre demografike.³¹ Për sa më sipër, mund të theksohet se: *Për shtetet e vogla, rënia demografike nuk përbën vetëm një problem social, por edhe një problem mbrojtës, i cili kërkon mbështetje në aleanca dhe në korniza të përbashkëta sigurie.* Karakteristikat demografike të një shteti ndikojnë gjithashtu në metodat e përballjes dhe format e luftës që ai detyrohet të adoptojë për të mbrojtur ose ruajtur interesat e tij kombëtare. Për shembull, bazuar në kapacitetet e tyre demografike, një numër shtetesh zgjedhin metoda asimetrike si mjete të konfrontimit. Në kontekstin bashkëkohor, mund të thuhet se veprimet hibride ose lufta hibride përfaqësojnë një formë të tillë të qasjes asimetrike – edhe pse jo ekskluzivisht të lidhura me shtetet me kapacitet më të vogël demografik ose popullsi më të kufizuar. Sigurisht, koncepti i luftës hibride nuk përbën një risi të kohës moderne, por një evolucion të natyrshëm të luftës, i karakterizuar nga kombinimi i mjeteve konvencionale, jokonvencionale, politike, ekonomike dhe informative në funksion të objektivave strategjikë.³²

Qasje strategjike ndaj sfidave demografike

Trajtimi i problemeve demografike kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që integron politikat ekonomike, sociale dhe të mbrojtjes. Elementet kryesore përfshijnë: nxitjen e lindshmërisë përmes stimuljeve fiskalë dhe mbështetjes për familjet; migracionin e menaxhuar me politika efektive integrimi; investimet në arsim dhe shëndetësi si faktorë kyç të kapitalit njerëzor; si dhe përshtatjen e sistemeve të mbrojtjes përmes modernizimit dhe integrimit në strukturat aleate.

E ardhmja e fuqisë kombëtare varet nga aftësia e shteteve për të integruar realitetet demografike në planifikimin afatgjatë të sigurisë dhe zhvillimit. Tendencat negative – rënia e lindshmërisë, plakja e popullsisë dhe migracioni – kërkojnë qasje strategjike dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Vetëm përmes integrimit të faktorëve demografikë në planifikimin strategjik kombëtar, shtetet mund të ndërtojnë një fuqi kombëtare të qëndrueshme dhe efektive.

Dimensioni demografik dhe implikimet për Shqipërinë

Në rastin e Shqipërisë, dimensionin demografik ka kaluar nga sfida sociale në çështje me implikime të drejtpërdrejta për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare.

³⁰ Nye, J. (11 May 2004). *Soft power: The means to success in world politics*. Public Affairs, p. 208.

³¹ European Commission (2022). *European Commission Report of Demographic Change*. Brussels: EU Commission.

³² Hoffman, Frank G. *Conflict in the 21st Century: The Rise of Hybrid Wars*. Arlington, VA: Potomac Institute for Policy Studies, 2007.

Tendencat e tri dekadave të fundit – emigracioni masiv, rënia e lindshmërisë dhe plakja e popullsisë – kanë prodhuar një transformim të thellë strukturor me pasoja direkte në kapacitetin mbrojtës të vendit. Norma e fertilitetit ka rënë nga 3.0 në 1.4 fëmijë për grua, popullsia ka zbritur nga 3.3 në 2.8 milionë banorë, ndërsa mbi 1.4 milionë shqiptarë jetojnë jashtë vendit. Mosha mesatare ka kaluar nga 26 vjeç në mbi 38 vjeç, duke ngushtuar ndjeshëm grupmoshat aktive.

Nga perspektiva e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, pasoja më e menjëhershme është turrja e bazës natyrore të rekrutimit për Forcat e Armatosura dhe strukturat e sigurisë. Grupmoshat 18–35 vjeç, që përbëjnë rezervën kryesore të rekrutimit ushtarak, janë në rënie të vazhdueshme si rezultat i emigracionit të lartë dhe lindshmërisë së ulët. Kjo dinamikë cenon drejtpërdrejt konceptin e **qëndrueshmërisë mobilizuese** – aftësinë e shtetit për të gjeneruar dhe mbajtur burime njerëzore të mjaftueshme për mbrojtjen dhe menaxhimin e krizave në periudha afatgjata. Një shtet mund të rekrutojë mjaftueshëm sot, por nëse baza demografike është në turrje sistematike, kjo qëndrueshmëri dobësohet gradualisht.

Njëkohësisht, emigracioni i profesionistëve teknikë dhe të arsimuar – i njohur si “brain drain” – nuk duhet parë vetëm si humbje ekonomike, por si reduktim i **kapacitetit strategjik demografik**: aftësisë së shtetit për të ruajtur densitetin e nevojshëm të kapitalit njerëzor në sektorët strategjikë si mbrojtja, teknologjia dhe administrimi institucional. Pa këtë bazë, aftësia e shtetit për të ndërtuar dhe mbështetur autonominë mbrojtëse dobësohet strukturalisht.

Boshatisja e zonave rurale dhe përqendrimi urban shtojnë një dimension tjetër të shqetësimit: ulja e pranisë njerëzore në zona me rëndësi territoriale dhe infrastrukture cenon menaxhimin e territorit dhe qëndrueshmërinë kombëtare në rast krize apo emergjence. Në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në NATO, këto tendenca bëhen edhe më kritike. Kontributi i qëndrueshëm në sigurinë kolektive kërkon kapacitete njerëzore, institucionale dhe ekonomike të mjaftueshme. Dobësimi i bazës demografike e bën bashkëpunimin me aleatët jo thjesht një opsion strategjik, por një **domosdoshmëri strukturore**, duke kufizuar hapësirën për autonomi mbrojtëse kombëtare.

Për rrjedhojë, trajtimi i sfidave demografike duhet të konsiderohet komponent integral i sigurisë kombëtare. Shqipëria ka nevojë për një qasje strategjike që kombinon politikat për rikthimin e diasporës, investimet në kapitalin njerëzor dhe ndërtimin e **qëndrueshmërisë demografike** – aftësisë së institucioneve për të ruajtur funksionalitetin strategjik edhe në kushtet e transformimeve të thella demografike. Nëse trendet aktuale vazhdojnë pa u adresuar, vendi rrezikon reduktim gradual të kapacitetit mbrojtës, institucional dhe ekonomik – duke e bërë demografinë një nga kufijtë kryesorë të fuqisë dhe qëndrueshmërisë strategjike të shtetit shqiptar.

Përfundime

Demografia përfaqëson një nga faktorët më themelorë dhe më afatgjatë të fuqisë kombëtare në mjedisin bashkëkohor strategjik. Ky studim ka argumentuar se demografia nuk mund të vazhdojë të trajtohet si variabël sfondi – si tregues pasiv i gjendjes sociale – por duhet të pozicionohet si komponent aktiv dhe strukturor i planifikimit strategjik kombëtar. Analiza ka evidentuar disa rezultate themelore me implikime praktike të drejtpërdrejta.

Analiza eidenton se demografia nuk mund të trajtohet më thjesht si tregues statistikor apo çështje sociale, por si komponent strukturor i sigurisë kombëtare dhe i aftësisë së shtetit për të gjeneruar dhe ruajtur fuqi. Kapitali njerëzor përbën bazën e prodhimit ekonomik, inovacionit teknologjik, kohezionit shoqëror dhe kapaciteteve ushtarake. Për rrjedhojë, ndryshimet demografike ndikojnë jo vetëm në zhvillimin e brendshëm të shtetit, por edhe në pozicionin e tij në sistemin ndërkombëtar dhe në aftësinë për të mbrojtur interesat kombëtare.

Së pari, studimi konfirmon se tendencat negative demografike – rënia e lindshmërisë, plakja e popullsisë dhe emigracioni – nuk janë thjesht sfida sociale, por shumëzues negativë të fuqisë kombëtare. Ato veprojnë njëkohësisht mbi të gjithë elementët e modelit DIME: kufizojnë bazën ekonomike, ngushtojnë kapacitetin mobilizues ushtarak, dobësojnë institucionet dhe reduktojnë ndikimin diplomatik afatgjatë. Ky efekt i shumëfishtë e bën demografinë një variabël strategjik me peshë specifike më të madhe se sa sugjeron analiza e veçantë e secilit dimension.

Së dyti, krahasimi ndërkombëtar – me rastet e Japonisë, Gjermanisë, Suedisë dhe Izraelit – tregon se nuk ekziston një zgjidhje universale për sfidat demografike, por se aftësia adaptive e shtetit është vendimtare. Shtetet që integrojnë herët analizën demografike në planifikimin e tyre strategjik – duke investuar në arsim, duke menaxhuar migracionin aktivisht dhe duke modernizuar kapacitetet mbrojtëse – arrijnë të ruajnë fuqinë e tyre kombëtare edhe nën presionin e trendeve negative demografike.

Së treti, në rastin e Shqipërisë, shifrat flasin qartë: norma e fertilitetit nën 1.5, mbi 1.4 milionë emigrantë, moshë mesatare mbi 38 vjeç dhe projeksione të rënies së mëtejshme të popullsisë deri në 2050 – të gjitha këto tregojnë se shteti shqiptar po hyn në një fazë ku kapaciteti strategjik demografik është tashmë i kufizuar dhe tendenca nuk është e vetëkorrigjueshme pa ndërhyrje aktive. Implikimi strategjik kryesor është se Shqipëria duhet të kalojë nga një qasje reaktive ndaj fenomeneve demografike në një qasje proaktive – duke e trajtuar demografinë jo si problem social që merret me politika mirëqenieje, por si çështje sigurie kombëtare që kërkon planifikim strategjik afatgjatë.

Nga pikëpamja e politikave publike, kjo nënkupton nevojën për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare Demografike – dokument i veçantë dhe gjithëpërfshirës, jo i shpërndarë fragmentarisht nëpër strategji sektoriale – e cila integron politika për shtimin e popullsisë, menaxhimin aktiv të diasporës, investimet sistematike në kapitalin njerëzor dhe zhvillimin e balancuar territorial. Ky dokument duhet të lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Dokumentin e Politikave të Mbrojtjes, duke njohur zyrtarisht demografinë si faktor strategjik me rëndësi parësore.

Në përfundim, ky studim sjell tre kontribute themelore. E para, ai propozon dhe argumenton tre koncepte origjinale analitike – kapaciteti strategjik demografik, qëndrueshmëria mobilizuese dhe sovraniteti demografik – të cilët ofrojnë një kornizë të re konceptuale për matjen dhe menaxhimin e dimensionit demografik të fuqisë kombëtare. E dyta, ai evidenton specifikën e kontekstit shqiptar, duke e lidhur atë me të dhëna të matshme dhe me imperativin e integritetit euroatlantik. E treta, ai hap rrugë për kërkime të mëtejshme: si mund të modelohet saktë kapaciteti strategjik demografik si indeks i kompozuar? Cilat politika konkrete të diasporës kanë dhënë rezultate të verifikueshme në vende me profile të ngjashme demografike me Shqipërinë? Si ndikon integrimi euroatlantik i Shqipërisë në dinamikat demografike të një vendi me popullsi në rënie? Këto pyetje tregojnë se demografia, si komponent i sigurisë strategjike, kërkon vëmendje sistematike kërkimore, veçanërisht në kontekstin e vendeve të vogla euroatlantike, si Shqipëria.

Bibliografia:

1. Angelov, G. (2019). The Treaty of Neuilly and its impact on the national power of Bulgaria. Sofia: Public Policy.bg. doi:<https://doi.org/10.58894/EJPP.2020.2.349>.
2. Angelov, G. (2024a). For (un)success of the nation and whether national doctrine and strategy are guarantee for country's prosperity. Sofia.
3. Angelov, G. (2024b). State and Statehood: Etymology and Characteristics. Saarbrücken, Germany: Lambert Academic Publisher. doi:ISBN 978-620-780-614-0
4. Bank, W. (15 March 2019). World Development Report 2019. Washington DC, USA. doi:<http://doi.org/10.1596/978-1-4648-1328-3>.
5. Bloom, D., Canning, D. (2003). The demographic dividend: A new perspective on the economic consequences of population change. Santa Monica, CA, USA: RAND Corporation. doi:ISBN-13: 978-0-8330-2926-3.
6. Coleman, D. (September 2006). Immigration and ethnic change in low-

- fertility countries: A third demographic transition. *Population and Development Review*, 32, 52-96. doi:<https://doi.org/10.1111/j.1728-4457.2006.00111.x>.
7. European Commission (17 June 2020). The impact of demographic change. Brussels, Belgium, EU, https://commission.europa.eu/system/files/2020-06/demography_report_2020_n.pdf?utm_source=chatgpt.com, retrieved on 17 September 2025.
 8. European Commission (2022). European Commission Report of Demographic Change. Brussels: EU Commission, https://commission.europa.eu/system/files/2020-06/demography_report_2020_n.pdf?utm_source=chatgpt.com, retrieved on 17 September 2025.
 9. Goldstone, J. A. (16 August 2012). Political demography: How population changes are reshaping international security and national politics. p. 336. doi: ISBN: 978-0199945962.
 10. Kugler, J. (1 September 1989). The power transition: A retrospective and prospective evaluation. Midlarsky, M. (ed.) *Handbook of War Studies*, pp. 171-194. ISBN: 9780044453411.
 11. Morgenthau, H. J. (1948). *Politics among nations: The struggle for power and peace*. New York: Alfred A. Knopf. doi: ISBN: 978-0075544692
 12. Nye, J. (11 May 2004). Soft power: The means to success in world politics. *Public Affairs*, p. 208. ISBN 978-158-648-306-7.
 13. Singer, J. B. (1985). *Peace, War, and Numbers*. Beverly Hills: Sage. doi: ISBN: 978-0803901643.
 14. Stoychev, S. (2023). *Joint operations and their planning*. Sofia, Bulgaria: “Dio Mira” Publishing House.
 15. Teitelbaum, M. W. (1985). *The Fear of Population Decline*. Orlando, Florida, USA: Academic Press.
 16. United Nations (2022). *World Population Report Prospects 2022*. New York: UN, https://www.un.org/development/desa/pd/sites/www.un.org.development.desa.pd/files/wpp2022_summary_of_results.pdf, retrieved on 17 September 2025.
 17. *Population, Power, and Security: Demographic Pressures Shaping U.S.-China Strategic Competition* — *Yale Journal of International Affairs*
 18. *en_-_modelling_the_relationship_between_demography_peace_and_security.pdf*
 19. <https://www.jstor.org/stable/j.ctv287sd9m>

Ndikimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak në mjedisin e sigurisë globale

Nënkolonel Ervin HODO

Oficer shtabi, Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar

Ky material studimor analizon rolin dhe rëndësinë e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (BCU) në mjedisin bashkëkohor të sigurisë globale, duke theksuar se sfidat moderne nuk janë më vetëm ushtarake, por edhe politike, ekonomike dhe sociale. Në këtë kontekst, koordinimi ndërmjet aktorëve civilë dhe forcave ushtarake paraqitet si një domosdoshmëri për menaxhimin efektiv të krizave, stabilizimin e rajoneve të pasigurta dhe mbrojtjen e popullsisë civile. Studimi, evidenton se mungesa e koordinimit dhe komunikimit, mund të çojë në dështime operacionale dhe ulje të besueshmërisë institucionale.

Materiali trajton konceptin e BCU-së, duke u bazuar në doktrinën AJP-3.19 dhe në modele teorike që e ndajnë atë në nivele strategjike, operacionale dhe taktike. Ai analizon gjithashtu ndryshimet në mjedisin global të sigurisë, duke përfshirë konfliktet hibride, kërcënimet jo-tradicionale dhe rolin e teknologjisë, të cilat kërkojnë një qasje të integruar dhe fleksibile. Shembuj praktikë nga operacionet ndërkombëtare, tregojnë se lidhshipi adaptiv, komunikimi efektiv dhe integrimi i burimeve janë faktorë kyç për suksesin e bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Në pjesën përfundimtare, studimi identifikon sfidat kryesore të BCU-së, si dallimet kulturore organizative, ndikimi i politikave dhe rreziqet nga keqinformimi, duke theksuar nevojën për përmirësim të mekanizmave të koordinimit dhe trajnimit. Në rastin e Shqipërisë, vlerësohet progresi në zhvillimin e kapaciteteve dhe roli i strukturave CIMIC në përputhje me standardet e NATO-s. Studimi përfundon me rekomandime për forcimin e

bashkëpunimit përmes investimeve në teknologji, zhvillimit të lidërshiptit dhe thellimit të integritetit ndërinstitucional, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së operacioneve të sigurisë.

Fjalët kyçe: Bashkëpunimi civilo-ushtarak, siguria globale, menaxhimi i krizave, koordinimi ndërinstitucional, lidërshipi adaptiv, konfliktet hibride, kërcënimet jotradicionale, teknologjia dhe siguria, komunikimi strategjik, operacionet ndërkombëtare, CIMIC, stabiliteti rajonal.

Hyrje

Bashkëpunimi civilo-ushtarak (BCU) përfaqëson një nga dimensionet më thelbësore të menaxhimit të krizave dhe ruajtjes së sigurisë globale. Ky bashkëpunim nënkupton koordinimin mes aktorëve civilë, si qeveritë, organizatat humanitare dhe komunitetit lokal që në zhargonin ushtarak njihen si aktorë joushtarakë dhe forcave ushtarake, në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike dhe humanitare në situata komplekse. Në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të lidhur, sfidat e sigurisë nuk janë më thjesht ushtarake, por përfshijnë edhe faktorë politikë, ekonomikë dhe socialë, të cilët kërkojnë një qasje të integruar dhe multidisiplinore. Një deduksion i tillë prej kohësh tashmë është arritur edhe nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut e cila në terma të përgjithshëm thekson se suksesi në operacionet e drejtuara prej saj nuk varet më vetëm nga komponenti ushtarak. Rëndësia e bashkëpunimit civilo-ushtarak shfaqet sidomos në operacionet ndërkombëtare, ku efektiviteti i Forcave të Armatosura, shpesh varet nga aftësia për të koordinuar me aktorët civilë.¹ Për shembull, operacionet e NATO-s dhe misionet e OKB-së në vende ku ka pasur apo ka konflikt, tregojnë se bashkëpunimi i mirëorganizuar mund të reduktojë rrezikun për civilët, të rrisë efikasitetin operacional dhe të ndihmojë në stabilizimin afatgjatë të rajoneve të pasigurta. Ky bashkëpunim, nuk është thjesht një instrument operacional, por edhe një mekanizëm i rëndësishëm politik, duke ndikuar në perceptimin e publikut dhe besimin ndaj institucioneve të sigurisë.

Ndërkohë, mjedisi i sigurisë globale po përballlet me ndryshime të shpejta dhe komplekse. Konfliktet hibride, ku aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë kombinojnë taktika konvencionale dhe jokonvencionale, po bëhen gjithnjë e më të zakonshme.² Krizat humanitare, shpesh të shkaktuara nga luftërat civile, katastrofat natyrore ose pandemitë, kërkojnë reagime të koordinuara midis forcave ushtarake dhe agjencive civile. Për më tepër, kërcënimet kibernetike

¹ Williamson Murray, *Military Adaptation in War* (Cambridge: Cambridge University Press, 2011), fq.102.

² Colin S. Gray, *Modern Strategy* (Oxford: Oxford University Press, 1999), fq.55–57.

dhe informacioni i manipuluar ndikojnë në perceptimin e sigurisë dhe kërkojnë një koordinim të kujdesshëm midis sektorit civil dhe strukturave ushtarake për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe informacionit.

Në kontekstin e sfidave të përmendura, një problem thelbësor mbetet mungesa e koordinimit efektiv mes aktorëve civilë dhe atyre ushtarakë. Shpesh, struktura organizative e Forcave të Armatosura, nuk harmonizohet mjaftueshëm me nevojat e komuniteteve civile ose organizatave humanitare, duke çuar në përgjigje të vonuara ose joefikase ndaj krizave. Kjo situatë rrit rrezikun për jetët e civilëve, dëmton reputacionin e forcave ushtarake dhe ul besueshmërinë e institucioneve në vend, por edhe ndërkombëtarisht. Pasojat e mungesës së bashkëpunimit janë të dukshme në shumë misione ndërkombëtare, ku konflikti midis procedurave ushtarake dhe nevojave civile ka çuar në ngërçe operacionale.³ Për shembull, dështimi në koordinimin logjistik mund të vonojë ndihmën humanitare, ndërsa mungesa e komunikimit me komunitetin lokal mund të shkaktojë mosbesim dhe rezistencë ndaj veprimeve të ndërmarra. Këto pengesa theksojnë nevojën për një qasje të integruar që kombinon aftësitë taktike dhe strategjike me ndjeshmërinë civile dhe humanitare.

Ky problem nuk është thjesht operacional, por ka dimensione strategjike. Bashkëpunimi civilo-ushtarak, kur zbatohet saktë, mund të funksionojë si një instrument stabilizues, duke ndihmuar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajone të pasigurta.⁴ Studimi i këtij bashkëpunimi dhe identifikimi i praktikave më të mira është i rëndësishëm jo vetëm për efektivitetin e misioneve ekzistuese, por edhe për zhvillimin e politikave të ardhshme dhe përmirësimin e kapaciteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Materiali studimor ka për qëllim të analizojë rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit civilo-ushtarak në mjedisin aktual të sigurisë globale. Ai synon të evidentojë se si koordinimi midis sektorit civil dhe forcave ushtarake mund të rrisë efektivitetin e operacioneve, të zvogëlojë riskun për civilët dhe të kontribuojë në stabilitetin e rajoneve me kriza. Analiza do të fokusohet në identifikimin e praktikave më të mira, modeleve të suksesshme të bashkëpunimit dhe rekomandimeve për vendimmarrje strategjike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Një tjetër objektiv, është të evidentojë rëndësinë e trajnimit të liderëve dhe zhvillimit të aftësive adaptuese për menaxhimin e krizave komplekse. Lidershipi i mirëorganizuar dhe i aftë për vendimmarrje të shpejtë, është thelbësor për integrimin e burimeve civile dhe ushtarake dhe për arritjen

³ Richard J. Ellis, *Military Innovation in the Interwar Period* (Cambridge: Cambridge University Press, 2004), fq.60-62.

⁴ Hew Strachan, *Strategy in the Contemporary World* (Oxford: Oxford University Press, 2014), fq.35-37.

e objektivave të sigurisë dhe humanitare. Ky studim do të shërbejë si një udhëzues për politikave dhe praktikave të ndjekura nga strukturat e Forcave të Armatosura, që synojnë të forcojnë bashkëpunimin civilo-ushtarak në një botë gjithnjë e më dinamike dhe sfiduese. Thënë kjo, koncepti i bashkëpunimit civilo-ushtarak nuk është thjesht një çështje taktike, por një komponent kyç i politikave të sigurisë globale dhe menaxhimit të krizave.⁵ Studimi i tij do të ndihmojë në përmirësimin e gatishmërisë së forcave të sigurisë dhe në sigurimin e një përgjigjeje më efektive ndaj sfidave komplekse dhe emergjente të shekullit XXI.

Koncepti i bashkëpunimit civilo-ushtarak

Bashkëpunimi civilo-ushtarak përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm ndërveprimi midis strukturave ushtarake dhe aktorëve civilë, në kontekste të ndryshme sigurie dhe emergjencash. Ky bashkëpunim përfshin koordinimin e aktiviteteve, shkëmbimin e informacionit dhe harmonizimin e objektivave për të arritur rezultate të përbashkëta strategjike dhe humanitare. Në një mjedis sigurie kompleks global ky koncept është bërë një element i domosdoshëm për menaxhimin e krizave dhe ruajtjen e stabilitetit.

Në Doktrinën e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (AJP-3.19), BCU përkufizohet si *“një funksion i përbashkët ushtarak, që integron kuptimin e faktorëve civilë të mjedisit operacional dhe që mundëson, lehtëson dhe zhvillon ndërveprimin civil-ushtarak për të mbështetur përmbushjen e misioneve dhe objektivave strategjike ushtarake në kohë paqeje, krize dhe konflikti”*.⁶ Ai përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve, nga mbështetja humanitare deri te stabilizimi dhe rindërtimi pas konfliktit. Procesi në vetvete kërkon koordinim të vazhdueshëm dhe fleksibilitet nga të dyja palët, për të përmbushur objektivat e përbashkëta në një mënyrë efektive.

Modelet teorike të bashkëpunimit civilo-ushtarak zakonisht ndahen në tre nivele kryesore: strategjik, operacional dhe taktik.⁷ Në nivelin strategjik, fokusi është në hartimin e politikave dhe vendimmarrjen në nivel të lartë. Niveli operacional përqendrohet në koordinimin e burimeve dhe aktiviteteve në terren. Ndërsa niveli taktik lidhet me ndërveprimin e drejtpërdrejtë midis trupave dhe komuniteteve lokale.

Tipologjia e bashkëpunimit përfshin gjithashtu dimensionin humanitar, i cili është thelbësor në situatat e emergjencave.⁸ Ky dimension përfshin ofrimin

⁵ Williamson Murray and MacGregor Knox, *The Dynamics of Military Revolution* (Cambridge: Cambridge University Press, 2001), fq.45–48.

⁶ AJP-3.19 Allied Joint Doctrine for Civil-Military Cooperation Edition B, version 1 June 2025, fq.2.

⁷ Colin S. Gray, *Modern Strategy* (Oxford: Oxford University Press, 1999), fq.55–57.

⁸ Hew Strachan, *Strategy in the Contemporary World* (Oxford: Oxford University Press, 2014), fq.35–37.

e ndihmës për popullsinë civile, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e aksesit në shërbime bazë. Bashkëpunimi humanitar kërkon ndjeshmëri të lartë dhe koordinim të kujdesshëm për të shmangur konflikte midis objektivave ushtarake dhe atyre civile. Një element kyç i këtij bashkëpunimi është komunikimi efektiv midis aktorëve të ndryshëm.⁹ Pa një komunikim të qartë dhe të vazhdueshëm, ekziston rreziku i keqkuptimeve dhe dështimeve operacionale. Për këtë arsye, zhvillimi i mekanizmave të komunikimit dhe trajnimit të personelit janë thelbësorë për suksesin e bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Koncepti i bashkëpunimit civilo-ushtarak përfaqëson një qasje të integruar dhe dinamike ndaj sfidave të sigurisë moderne. Ai kërkon lidhshmëri të fortë, fleksibilitet organizativ dhe përdorim efektiv të burimeve për të arritur rezultate të qëndrueshme. Rëndësia e tij pritet të rritet edhe më tej në të ardhmen, duke qenë se sfidat globale bëhen gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlydhura. Një referencë e rëndësishme për kuptimin dhe zbatimin praktik të bashkëpunimit civilo-ushtarak është Doktrina BCU 3.19, e cila ofron udhëzime të detajuara për koordinimin midis forcave ushtarake dhe aktorëve civilë në operacione të ndryshme.¹⁰ Kjo doktrinë thekson rëndësinë e planifikimit të integruar, komunikimit të vazhdueshëm dhe respektimit të rolit të secilit aktor në mjediset komplekse të sigurisë. Ajo përcakton gjithashtu parimet bazë të bashkëpunimit, si transparenca, fleksibiliteti dhe ndërveprueshmëria, duke synuar rritjen e efektivitetit operacional dhe minimizimin e ndikimit negativ mbi popullsinë civile. Për më tepër, doktrina nënvizon rolin e lidhshmërisë në krijimin e një kulture bashkëpunimi dhe në menaxhimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale. Zbatimi i këtyre parimeve ndihmon në përmirësimin e koordinimit dhe në rritjen e suksesit të operacioneve të përbashkëta civilo-ushtarake.

Ndërkohë, studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare, duket se janë në unison kur shprehin se mjedisi global i sigurisë, ka pësuar transformime të thella në dekadat e fundit, duke reflektuar ndryshimet në politikën ndërkombëtare dhe teknologjinë.¹¹ Konfliktet tradicionale ndërmjet shteteve janë zëvendësuar gjithnjë e më shumë nga forma të reja kërcënimesh, të cilat janë më të paqarta dhe më të vështira për t'u menaxhuar. Kjo situatë kërkon një qasje më fleksibile dhe të integruar ndaj sigurisë. Konfliktet hibride janë një nga karakteristikat kryesore të këtij mjedisi të ri.¹²

⁹ Martin van Creveld, *Command in War* (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1985), fq.115–118.

¹⁰ AJP 3.19 *Civil-Military Cooperation Doctrine* (Latest Edition) (London: Ministry of Defence, 2022), fq.10–15.

¹¹ John J. Mearsheimer, *The Tragedy of Great Power Politics* (New York: W.W. Norton, 2001), fq.25–32.

¹² Murray and Knox, *The Dynamics of Military Revolution* (Cambridge: Cambridge University Press, 2001), fq.45–48.

Ato përfshijnë kombinimin e metodave ushtarake konvencionale me taktika jokonvencionale, si propaganda, sulmet kibernetike dhe ndërhyrjet politike. Këto konflikte kërkojnë bashkëpunim të ngushtë midis sektorit civil dhe ushtarak për të përballuar kërcënimet në mënyrë efektive. Kërcënimet jotradicionale, si terrorizmi dhe krimi i organizuar, gjithashtu kanë një ndikim të madh në sigurinë globale. Këto fenomene shpesh operojnë përtej kufijve shtetërorë dhe kërkojnë koordinim ndërkombëtar për t'u adresuar. Bashkëpunimi civilo-ushtarak luan një rol kyç në këtë kontekst, duke mundësuar integrimin e burimeve dhe kapaciteteve të ndryshme.

Krizat humanitare janë bërë gjithashtu më të shpeshta dhe më komplekse.¹³ Katastrofat natyrore, konfliktet e armatosura dhe ndryshimet klimatike kanë rritur nevojën për reagime të shpejta dhe të koordinuara. Në këto situata, bashkëpunimi midis organizatave civile dhe forcave ushtarake është thelbësor për shpëtimin e jetëve dhe stabilizimin e situatës.

Roli i teknologjisë dhe kibernetikës është një faktor tjetër që ka ndryshuar mënyrën se si menaxhohen kërcënimet globale.¹⁴ Përdorimi i inteligjencës artificiale, dronëve dhe sistemeve të avancuara të komunikimit ka rritur kapacitetin për monitorim dhe reagim të shpejtë. Megjithatë, këto teknologji krijojnë edhe sfida të reja, si sulmet kibernetike dhe manipulimi i informacionit.

Nisur nga sa thamë më sipër, ndryshimet në mjedisin global të sigurisë kërkojnë një qasje të re ndaj bashkëpunimit civilo-ushtarak.¹⁵ Integrimi i teknologjisë, koordinimi ndërkombëtar dhe zhvillimi i lidërshiptit adaptiv (përshtatës) janë elemente kyçe për përballimin e sfidave moderne. Kjo qasje mund të ndihmojë në krijimin e një sistemi sigurie më të qëndrueshëm dhe efektiv në nivel global.

Roli i lidërshiptit dhe koordinimi i bashkëpunimit

Lidërshipi adaptiv i drejtuesve ushtarakë mundëson integrimin e njohurive lokale dhe prioriteteve humanitare në planifikimin strategjik. Trajnimi i përbashkët dhe komunikimi i vazhdueshëm mes aktorëve të ndryshëm ndihmon në shmangien e konflikteve dhe rritjen e efektivitetit. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe logjistike përmirësohet duke përdorur modele të koordinuara. Për më tepër, ky bashkëpunim rrit besimin e komuniteteve lokale dhe mbështeti stabilitetin e rajonit. Integrimi i teknologjisë, përfshirë dronët dhe sistemet monitoruese, ndihmon gjithashtu në përgjigje të shpejtë ndaj krizave emergjente.

¹³ Barry Buzan and Ole Wæver, *Regions and Powers* (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), fq.22–24.

¹⁴ United Nations, *Humanitarian Operations Report* (New York: UN Press, 2020), fq. 40–45.

¹⁵ Hew Strachan, *The Direction of War* (Cambridge: Cambridge University Press, 2013), fq.27–30.

Të gjitha këto mund t'i shohim të mishëruar nga shembujt praktikë ku është i njohur tashmë misioni i NATO-s në Afganistan, ku koordinimi mes forcave ushtarake dhe organizatave civile ishte thelbësor për suksesin e operacioneve.¹⁶ Misionet humanitare të OKB-së në Afrikën Sub-Sahariane tregojnë rëndësinë e koordinimit mes forcave civile dhe ushtarake.¹⁷ Kur ndodhin kriza humanitare, koordinimi i transportit të ndihmave, mbrojtjes së civilëve dhe sigurisë së rrugëve kërkon lidhshmëri të fortë dhe vendimmarrje të shpejtë. Trajnimi i përbashkët midis trupave ushtarake dhe stafit civil ndihmon në përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave. Bashkëpunimi i mirëplanifikuar redukton vonesat dhe shmang dështimet operative. Për më tepër, ky model rrit legjitimitetin ndërkombëtar të operacioneve. Rezultati është një kombinim i efektivitetit ushtarak dhe përfitimeve humanitare. Forcat e Armatosura të një numri vendesh si brenda ashtu edhe jashtë NATO-s kanë arritur të kenë sukses në operacionet e tyre falë mbështetjes efikase në bashkëpunimin civilo-ushtarak. Më poshtë po sjellim vetëm disa nga rastet e shumta të vendeve të suksesshme në adaptimin eficient të BCU.

Forcat e Armatosura gjermane ka zhvilluar protokolle të qarta për bashkëpunimin me autoritetet civile gjatë krizave të ndryshme.¹⁸ Lidhshmëria i komandantëve gjermanë është i fokusuar në fleksibilitet dhe adaptim ndaj sfidave të reja. Në operacionet ndërkombëtare, ata kombinojnë aftësitë taktike me njohuritë civile për menaxhimin e popullatës lokale. Përmes trajnimeve të integruara dhe simulimeve të përbashkëta, komandantët zhvillojnë aftësi vendimmarrjeje në kohë reale. Kjo qasje ka përmirësuar efektivitetin e operacioneve dhe ka rritur koordinimin me partnerët ndërkombëtarë. Lidhshmëria adaptiv siguron që vendimet të jenë të qëndrueshme edhe në kushtet më komplekse.

Ushtria amerikane ka përdorur bashkëpunimin civilo-ushtarak* në misionet e saj në Lindjen e Mesme dhe Azi Jugore për të rritur efikasitetin operativ.¹⁹ Integrimi i ekspertëve civilë në planifikimin operativ ka mundësuar përdorimin më efektiv të burimeve dhe koordinimin e aktivitetit humanitar. Komandantët ushtarakë janë trajnuar për të marrë vendime që marrin parasysh faktorët socialë, politikë dhe humanitarë. Trajnimi mbi komunikimin dhe ndërveprimin me komunitetin lokal ka zvogëluar rezistencën dhe konflikteve.

¹⁶ Colin S. Gray, *Modern Strategy*, fq.60–62.

¹⁷ Williamson Murray, *Military Adaptation in War* (Cambridge: Cambridge University Press, 2011), fq. 102.

7. Scharre, Paul. *Army of None: Autonomous Weapons and the Future of War*. New York: W. W. Norton & Company, 2018.
 8. Dokumente Strategjike
 9. European Union. *Artificial Intelligence Act*. Brussels: European Commission, 2024.
 10. NATO. *Emerging and Disruptive Technologies Report*. Brussels: NATO Headquarters, 2022.
 11. NATO. *NATO Artificial Intelligence Strategy*. Brussels: NATO Headquarters, 2021.
 12. United Nations. *Report of the Group of Governmental Experts on Lethal Autonomous Weapons Systems*. New York: United Nations, 2023.
 13. U.S. Department of Defense. *Summary of the 2018 Department of Defense Artificial Intelligence Strategy*. Washington D.C.: Department of Defense, 2018.
 14. Artikuj Shkencorë
 15. Horowitz, Michael. "Artificial Intelligence and the Future of Warfare." *Foreign Affairs*, Vol. 98, No. 3, (2019).
 16. Johnson, James. "Artificial Intelligence and Future Warfare." *Defense Studies*, Vol. 21, No. 2, (2021).
 17. Payne, Kenneth. "Artificial Intelligence: A Revolution in Strategic Affairs?" *Survival*, Vol. 60, No. 5, (2018).

Hendeku i aftësive në sigurinë kibernetike: një vlerësim empirik i mospërputhjeve të tregut të punës në Shqipëri dhe implikimet për hartimin e politikave arsimore

Dr. Gentian HOXHALLI

*Përgjegjës i Departamentit “Teknologji Informacioni”,
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA*

Trajtesë e shkurtuar

Ky studim bazohet në një pyetësor të strukturuar të ndërtuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKCESK) në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA), me qëllim vlerësimin e tregut të punës në fushën e sigurisë kibernetike në Shqipëri gjatë vitit 2025. Pyetësori është hartuar mbi bazën e modeleve ndërkombëtare si European Cybersecurity Skills Framework (ECSF), NICE Framework dhe CyBOK, duke synuar matjen e indikatorëve kryesorë që lidhen me ofertën dhe kërkesën për aftësi, strukturën e punësimit dhe boshllëqet në kompetenca në këtë sektor. Të dhënat empirike janë mbledhur nga 52 organizata që operojnë në sektorë kritikë të ekonomisë, duke ofruar një pasqyrë të detajuar mbi dinamikat aktuale të tregut të punës në sigurinë kibernetike.

Rezultatet evidentojnë një hendek të konsiderueshëm ndërmjet kërkesës për profesionistë të kualifikuar dhe ofertës së aftësive të disponueshme, i cili manifestohet përmes mungesës së stafit të specializuar, kohës së zgjatur për plotësimin e pozicioneve dhe kërkesave në rritje për aftësi të avancuara teknike dhe ndërpersonale. Veçanërisht, fusha si inteligjenca artificiale, cloud computing, DevSecOps dhe menaxhimi i incidenteve identifikohen si zona kritike ku ekzistojnë boshllëqe të theksuara kompetencash. Gjithashtu, studimi nxjerr në pah një mospërputhje të dukshme midis përmbajtjes së kurrikulave universitare dhe kërkesave reale të tregut të punës, duke reflektuar nevojën për rishikim të programeve arsimore.

Në aspektin praktik, gjetjet sugjerojnë se adresimi i hendekut të aftësive

kërkon një qasje të integruar që përfshin reformimin e arsimit të lartë, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike dhe industrisë, si dhe promovimin e certifikimeve profesionale dhe trajnimeve të vazhdueshme. Në përfundim, studimi kontribuon në literaturën mbi zhvillimin e kapitalit njerëzor në ekonomitë në zhvillim dhe ofron rekomandime konkrete për politikëbërësit dhe institucionet arsimore për të përmirësuar përputhshmërinë midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës në sigurinë kibernetike.

Fjalë kyçe: Siguria kibernetike; hendeku i aftësive; tregu i punës; kapitali njerëzor; arsimi i lartë; zhvillimi i fuqisë punëtore; ECSF; NICE Framework; CyBOK; Shqipëria

Hyrje

Transformimi digjital i ekonomive moderne ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si organizatat operojnë, duke rritur ndjeshëm varësinë nga sistemet e informacionit dhe infrastrukturat kritike digjitale. Në këtë kontekst, siguria kibernetike është shndërruar nga një funksion teknik në një dimension strategjik të zhvillimit ekonomik dhe institucional. Rritja e volumit të të dhënave, adoptimi i cloud computing dhe integrimi i inteligjencës artificiale kanë krijuar një mjedis të ndërlikuar dhe të ekspozuar ndaj kërcënimeve të reja, duke rritur nevojën për profesionistë të kualifikuar në sigurinë kibernetike (Kshetri, 2021; ENISA, 2023).

Megjithatë, një nga sfidat më të mëdha globale që lidhet me këtë transformim është hendeku i aftësive (“skills gap”), i cili përfaqëson mospërputhjen midis aftësive që kërkon tregu i punës dhe atyre që ofron sistemi arsimor dhe profesional. Sipas literaturës së ekonomisë së punës, ky hendek lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet teknologjike dhe me paaftësinë e institucioneve arsimore për t’u përshtatur në kohë reale me kërkesat e tregut (Autor, 2014; Acemoglu & Autor, 2011). Në sektorin e sigurisë kibernetike, kjo mospërputhje është edhe më e theksuar për shkak të natyrës dinamike të kërcënimeve dhe evoluimit të vazhdueshëm të teknologjive.

Në nivel global, raportet e fundit tregojnë se mungesa e profesionistëve të sigurisë kibernetike ka arritur në miliona vende pune të paplotësuara, duke krijuar një presion të konsiderueshëm mbi organizatat publike dhe private (ISC², 2022). Kjo situatë përkeqësohet nga fakti se kërkesat për aftësi nuk kufizohen vetëm në kompetenca teknike, por përfshijnë gjithashtu aftësi analitike, komunikim dhe menaxhim të riskut, duke krijuar një profil multidisiplinar të profesionistit të sigurisë kibernetike (Deming, 2017).

Në këtë kontekst, ekonomitë në zhvillim përballen me sfida edhe më komplekse. Shqipëria, si një ekonomi në tranzicion me aspirata për integrim në Bashkimin Evropian, është e ekspozuar ndaj të njëjtave dinamika globale, por

me kufizime strukturore në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe në përshtatjen e sistemit arsimor. Për më tepër, procesi i harmonizimit me kuadrin rregullator evropian, përfshirë direktivat si NIS2 dhe rregulloren DORA, ka rritur kërkesën për aftësi të specializuara në fusha të avancuara të sigurisë kibernetike.

Në këtë sfond, një kontribut i rëndësishëm për kuptimin e këtij fenomeni vjen nga studimi empirik i realizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA), i cili synon vlerësimin e tregut të punës në sigurinë kibernetike në Shqipëri. Ky studim bazohet në një pyetësor të strukturuar, i ndërtuar mbi baza metodologjike ndërkombëtare si European Cybersecurity Skills Framework (ECSF), NICE Framework dhe CyBOK, duke synuar matjen e indikatorëve kryesorë që lidhen me ofertën dhe kërkesën për aftësi, strukturën e punësimit dhe boshllëqet në kompetenca .

Të dhënat e mbledhura nga 52 organizata në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare ofrojnë një pasqyrë të detajuar mbi sfidat aktuale të tregut të punës në sigurinë kibernetike . Rezultatet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e organizatave përballen me mungesë të stafit të specializuar dhe me vështirësi në rekrutimin e profesionistëve të kualifikuar. Kjo situatë është e lidhur kryesisht me mungesën e kandidatëve të përshtatshëm, pagat jo konkurruese dhe kufizimet buxhetore, duke reflektuar një disbalancë strukturore në tregun e punës.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që del nga analiza është mospërputhja midis përgatitjes akademike dhe kërkesave të industrisë. Një pjesë e madhe e organizatave shprehin skepticizëm në lidhje me përgatitjen e të sapo diplomuarve, duke theksuar mungesën e aftësive praktike dhe të kompetencave të avancuara teknike. Kjo gjetje është në përputhje me literaturën ndërkombëtare, e cila argumenton se sistemet arsimore shpesh fokusohen në njohuri teorike, duke neglizhuar zhvillimin e aftësive të aplikueshme në praktikë (OECD, 2019).

Për më tepër, analiza e të dhënave tregon se kërkesat për aftësi në sigurinë kibernetike janë gjithnjë e më të orientuara drejt teknologjive emergjente si inteligjenca artificiale, cloud computing dhe DevSecOps. Këto fusha kërkojnë një nivel të lartë specializimi dhe një kombinim të aftësive teknike dhe analitike, duke e bërë edhe më të vështirë për sistemin arsimor të përmbushë këto kërkesa në kohë reale. Në të njëjtën kohë, rëndësia e soft skills si komunikimi, puna në ekip dhe vendimmarrja është rritur ndjeshëm, duke reflektuar natyrën bashkëpunuese dhe ndërdisiplinore të sigurisë kibernetike.

Në këtë kuadër, koncepti i kapitalit njerëzor merr një rëndësi të veçantë. Sipas teorisë së kapitalit njerëzor, investimi në arsim dhe trajnim është një faktor kyç për rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin ekonomik (Becker,

1993). Megjithatë, në rastin e sigurisë kibernetike, ky investim duhet të jetë i orientuar drejt aftësive të kërkuara nga tregu dhe të mbështetet nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet institucioneve arsimore dhe industrisë.

Qëllimi i studimit është të analizojë hendekun e aftësive në sigurinë kibernetike në Shqipëri, duke u bazuar në evidencë empirike dhe duke e vendosur atë në kontekstin e literaturës ndërkombëtare. Konkretisht, studimi synon:

- të identifikojë boshllëqet kryesore të aftësive në tregun e punës,
- të analizojë faktorët që kontribuojnë në këtë hendek,
- të dhe të vlerësojë implikimet për politikën arsimore dhe zhvillimin e fuqisë punëtore.

Kontributi i këtij studimi është i dyfishtë. Në aspektin teorik, ai zgjeron literaturën mbi hendekun e aftësive duke ofruar evidencë nga një ekonomi në zhvillim, e cila është relativisht e nën-studiuar në këtë fushë. Në aspektin praktik, studimi ofron rekomandime konkrete për politikëbërësit dhe institucionet arsimore, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës.

1. Rishikimi i literaturës

Hendeku i aftësive në ekonominë digjitale

Hendeku i aftësive (“skills gap”) është një nga sfidat kryesore të ekonomisë moderne, i cili lidhet me mospërputhjen ndërmjet aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe atyre që disponon fuqia punëtore. Në literaturën bashkëkohore, ky fenomen është analizuar gjerësisht në kontekstin e transformimit teknologjik dhe ndryshimeve strukturore në tregun e punës. Sipas Autor (2014), rritja e kërkesës për aftësi të avancuara është një pasojë direkte e zhvillimeve teknologjike, të cilat kanë rritur pabarazitë në të ardhura dhe në aksesin ndaj mundësive të punës (Autor, 2014). Ky fenomen mbështetet nga teoria e ndryshimit teknologjik të orientuar drejt aftësive (“skill-biased technological change”), e cila argumenton se teknologjia rrit kërkesën për punonjës me aftësi të larta dhe redukton kërkesën për punë me aftësi të ulëta (Acemoglu & Autor, 2011). Në këtë kontekst, hendeku i aftësive përbën një sfidë të rëndësishme për politikën publike dhe sistemet arsimore. OECD (2019) thekson se shumë ekonomi përballen me mospërputhje të konsiderueshme të aftësive, duke ndikuar negativisht në produktivitet dhe në zhvillimin ekonomik. Kjo është veçanërisht e dukshme në sektorët që kërkojnë kompetenca teknike të avancuara, si siguria kibernetike.

Siguria kibernetike dhe kërkesa për aftësi

Siguria kibernetike është një nga fushat më dinamike të ekonomisë digjitale, e karakterizuar nga një kërkesë e lartë për aftësi të specializuara. Sipas Kshetri

(2021), rritja e kërcënimeve kibernetike ka rritur ndjeshëm nevojën për profesionistë të kualifikuar që mund të menaxhojnë riskun dhe të mbrojnë infrastrukturën kritike. Në nivel global, mungesa e profesionistëve të sigurisë kibernetike është identifikuar si një sfidë strukturore. Kjo mungesë lidhet me kompleksitetin e aftësive të kërkuara dhe me ritmin e shpejtë të ndryshimeve teknologjike. Deming (2017) argumenton se, përveç aftësive teknike, aftësitë ndërpersonale (*soft skills*) si komunikimi dhe bashkëpunimi janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme në tregun e punës. Në këtë kontekst, siguria kibernetike kërkon një kombinim të aftësive teknike dhe ndërpersonale, duke e bërë zhvillimin e kapitalit njerëzor një sfidë të rëndësishme për institucionet arsimore dhe organizatat.

Framework-et ndërkombëtare të aftësive

Për të adresuar kompleksitetin e aftësive në sigurinë kibernetike, janë zhvilluar disa framework-e ndërkombëtare që synojnë standardizimin e kompetencave dhe roleve profesionale. Ndër më të rëndësishmit janë NICE Framework dhe ECSF. NICE Framework (NIST, 2020) ofron një strukturë të detajuar të roleve dhe aftësive në sigurinë kibernetike, duke ndihmuar në harmonizimin e kërkesave të tregut me programet arsimore. Ky framework përdoret gjerësisht për zhvillimin e politikave të fuqisë punëtore dhe për ndërtimin e kurrikulave akademike. ENISA (2023) thekson rëndësinë e European Cybersecurity Skills Framework për standardizimin e aftësive në nivel evropian dhe për përmirësimin e përputhshmërisë ndërmjet arsimit dhe tregut të punës.

Arsimi dhe kapitali njerëzor

Teoria e kapitalit njerëzor thekson rëndësinë e investimit në arsim dhe trajnim për zhvillimin ekonomik. Becker (1993) argumenton se edukimi dhe aftësitë janë faktorë kyç për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë. Megjithatë, shumë studime tregojnë se ekziston një mospërputhje midis përgatitjes akademike dhe kërkesave të tregut të punës. Universitetet shpesh fokusohen në njohuri teorike, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme zhvillimit të aftësive praktike. Ky problem është veçanërisht i dukshëm në fushën e sigurisë kibernetike, ku kërkesat e tregut ndryshojnë me shpejtësi dhe kërkojnë një nivel të lartë specializimi.

Teknologjitë emergjente dhe aftësitë

Teknologjitë emergjente si inteligjenca artificiale dhe automatizimi kanë ndryshuar strukturën e tregut të punës. Bessen (2019) argumenton se këto teknologji krijojnë kërkesa të reja për aftësi dhe transformojnë mënyrën se si organizatat operojnë. Goldfarb dhe Tucker (2019) theksojnë se ekonomia digjitale po rrit rëndësinë e të dhënave dhe analizës së tyre, duke kërkuar aftësi

të avancuara në analizë dhe menaxhim të informacionit. Në sigurinë kibernetike, këto zhvillime kanë rritur kompleksitetin e aftësive të kërkuara, duke e bërë edhe më të vështirë për sistemin arsimor të përmbushë këto kërkesa.

Ekonomitë në zhvillim dhe sfidat e aftësive

Ekonomitë në zhvillim përballen me sfida të veçanta në zhvillimin e kapitalit njerëzor. Kufizimet në burime dhe infrastruktura arsimore ndikojnë në aftësinë e këtyre vendeve për të përgatitur një fuqi punëtore të kualifikuar. Në këtë kontekst, Shqipëria përballlet me sfida të ngjashme, ku evidenca empirike tregon mungesë të aftësive dhe mospërputhje midis arsimit dhe tregut të punës.

Sintetizimi i literaturës

Literatura tregon se hendeku i aftësive është një fenomen kompleks që kërkon një qasje të integruar për adresimin e tij. Siguria kibernetike përbën një rast specifik ku ky hendek është më i theksuar për shkak të natyrës dinamike të teknologjisë. Ky studim kontribuon duke ofruar evidencë empirike nga Shqipëria dhe duke propozuar rekomandime për politika publike.

2. Metodologjia e përdorur

Ky studim mbështetet në një qasje empirike kuantitative, e ndërtuar për të analizuar hendekun e aftësive në fushën e sigurisë kibernetike në Shqipëri dhe për të vlerësuar përputhshmërinë ndërmjet kërkesës së tregut të punës dhe ofertës së kapitalit njerëzor. Dizajni i kërkimit është eksplorues dhe përshkrues, duke synuar të identifikojë strukturën aktuale të tregut të punës, karakteristikat e fuqisë punëtore dhe boshllëqet ekzistuese në aftësi. Në këtë kontekst, studimi përpaket të japë një analizë të integruar që lidh dimensionin institucional, arsimor dhe ekonomik të zhvillimit të aftësive në sigurinë kibernetike.

Të dhënat primare janë mbledhur përmes një pyetësori të strukturuar, i cili është zhvilluar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura gjatë vitit 2025. Ky instrument kërkimor është ndërtuar mbi bazën e modeleve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira në vlerësimin e tregut të punës në sigurinë kibernetike, duke përfshirë European Cybersecurity Skills Framework (ECSF), NICE Cybersecurity Workforce Framework dhe Cyber Security Body of Knowledge (CyBOK). Këto korniza janë përdorur për të strukturuar konceptet kryesore të studimit, për të kategorizuar aftësitë dhe për të siguruar një përputhshmëri metodologjike me standardet ndërkombëtare.

Pyetësori është hartuar në mënyrë të tillë që të kapë dimensionet kryesore të tregut të punës në sigurinë kibernetike. Ai përfshin pyetje që lidhen me karakteristikat e organizatave, strukturën e punësimit, nivelin e specializimit

të stafit, lëvizshmërinë e burimeve njerëzore dhe perceptimin e rrezikut që vjen nga mungesa e aftësive. Gjithashtu, pyetësi eksploron kërkesat për kualifikime, rolin e certifikatave ndërkombëtare dhe vlerësimin e përgatitjes së të diplomuarve nga sistemi arsimor. Një pjesë e rëndësishme e instrumentit i kushtohet identifikimit të boshllëqeve të aftësive, si në dimensionin teknik, ashtu edhe në atë ndërpersonal, duke reflektuar natyrën multidisiplinare të sigurisë kibernetike.

Mostra e studimit përbëhet nga 52 organizata që operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, përfshirë sektorin bankar, energjetik, shëndetësor dhe infrastrukturën digjitale. Kjo përzgjedhje është bërë me qëllim sigurimin e një përfaqësimi të gjerë të ekosistemit të sigurisë kibernetike në vend. Organizatat janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre në menaxhimin e infrastrukturave kritike dhe ekspozimin ndaj rreziqeve kibernetike. Mbledhja e të dhënave është realizuar gjatë vitit 2025 përmes shpërndarjes së pyetësorit në formë elektronike, duke garantuar anonimitetin dhe konfidencialitetin e përgjigjeve.

Analiza e të dhënave është realizuar përmes metodave statistikore përshkruese, të cilat kanë mundur identifikimin e trendeve kryesore dhe marrëdhënieve ndërmjet variablave. Janë përdorur shpërndarje frekuencash dhe analiza përqindjesh për të interpretuar të dhënat e mbledhura. Kjo qasje lejon një kuptim të qartë të strukturës së tregut të punës dhe të faktorëve që ndikojnë në hendekun e aftësive. Për më tepër, rezultatet janë krahasuar me praktikat ndërkombëtare dhe trendet evropiane, duke vendosur analizën në një kontekst më të gjerë.

Në aspektin konceptual, studimi mbështetet në teorinë e kapitalit njerëzor dhe në literaturën mbi ndryshimin teknologjik të orientuar drejt aftësive. Kjo qasje teorike ndihmon në interpretimin e rezultateve dhe në identifikimin e implikimeve për politikat publike dhe sistemin arsimor. Përveç kësaj, përdorimi i framework-eve ndërkombëtare kontribuon në rritjen e vlefshmërisë së studimit dhe në përmirësimin e krahasueshmërisë së rezultateve.

Megjithëse studimi ofron një pasqyrë të detajuar të tregut të punës në sigurinë kibernetike, ai ka disa kufizime që duhen marrë në konsideratë. Madhësia e mostrës është relativisht e kufizuar dhe përqendrohet vetëm në Shqipëri, çka mund të kufizojë përgjithësimin e rezultateve. Gjithashtu, të dhënat janë të bazuara në vetë-raportim, duke sjellë mundësi për paragjykime subjektive. Megjithatë, këto kufizime kompensohen nga struktura e mirë e instrumentit dhe nga përfaqësimi i sektorëve kyç të ekonomisë.

Në përfundim, metodologjia e përdorur në këtë studim ofron një bazë të fortë për analizimin e hendekut të aftësive në sigurinë kibernetike dhe për formulimin e rekomandimeve për zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përmirësimin e përputhshmërisë ndërmjet arsimit dhe tregut të punës.

3. Rezultatet e studimit

Përshkrimi i përgjithshëm i mostrës

Rezultatet e studimit bazohen në të dhënat e mbledhura nga një mostër prej 52 organizatash që operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, përfshirë sektorin bankar, financiar, energjetik, shëndetësor dhe infrastrukturën digjitale. Ky diversitet sektorësh siguron një përfaqësim të gjerë të ekosistemit të sigurisë kibernetike në Shqipëri dhe lejon një analizë gjithëpërfshirëse të kërkesës dhe ofertës për aftësi në këtë fushë .

Në aspektin demografik, pjesëmarrësit në studim përbëhen nga 35 femra dhe 17 meshkuj, duke reflektuar një përfshirje të konsiderueshme gjinore në këtë sektor. Sa i përket madhësisë së organizatave, të dhënat tregojnë një shpërndarje të balancuar midis organizatave të vogla, të mesme dhe të mëdha, çka sugjeron se sfidat e sigurisë kibernetike janë të përhapura në të gjitha nivelet e strukturës ekonomike.

Struktura e punësimit dhe disponueshmëria e stafit

Një nga gjetjet kryesore të studimit lidhet me strukturën e punësimit në sigurinë kibernetike. Nga 52 organizatat e anketuara, 30 prej tyre deklarojnë se kanë punonjës të specializuar në këtë fushë, ndërsa 22 organizata nuk disponojnë staf të dedikuar për sigurinë kibernetike .

Statusi i stafit	Numri i organizatave	Përqindja
Kanë staf të specializuar	30	57.7%
Nuk kanë staf të specializuar	22	42.3%

Tabela 1: Disponueshmëria e stafit të specializuar

Kjo shpërndarje tregon një boshllëk të konsiderueshëm në strukturën e burimeve njerëzore, ku pothuajse gjysma e organizatave nuk kanë kapacitete të dedikuara për sigurinë kibernetike. Ky fenomen reflekton një mungesë strukturore të aftësive në tregun e punës dhe një varësi të mundshme nga shërbime të jashtme ose nga departamentet e IT-së.

Lëvizshmëria e stafit dhe rreziku nga mungesa e aftësive

Rezultatet tregojnë gjithashtu një nivel të konsiderueshëm të lëvizshmërisë së stafit. Rreth 35% e organizatave raportojnë se kanë përjetuar largimin e stafit të specializuar në dy vitet e fundit, ndërsa 65% nuk kanë raportuar largime . Ky fenomen lidhet drejtpërdrejt me perceptimin e rrezikut nga mungesa e stafit. Shumica e të anketuarve e konsiderojnë këtë mungesë si një rrezik të lartë ose shumë të lartë për organizatat e tyre.

Niveli i rrezikut	Numri i përgjigjeve
Shumë i lartë	21
I lartë	18
Mesatar	8
I ulët	5

Tabela 2: Perceptimi i rrezikut nga mungesa e stafit

Kjo shpërndarje tregon se mbi 75% e organizatave e perceptojnë mungesën e stafit si një rrezik kritik, duke theksuar rëndësinë strategjike të sigurisë kibernetike për funksionimin e tyre.

Shkaqet e mungesës së stafit

Analiza e shkaqeve të mungesës së stafit identifikon disa faktorë kryesorë:

Faktor	Përqindja
Mungesa e kandidatëve të kualifikuar	55.7%
Pagat jo konkurruese	21.1%
Mungesa e buxhetit	13.4%
Faktorë të kombinuar	1.9%

Tabela 3: Shkaqet e mungesës së stafit

Rezultatet tregojnë qartë se faktori dominues është mungesa e kandidatëve të kualifikuar, që përbën më shumë se gjysmën e përgjigjeve. Kjo konfirmon ekzistencën e një hendeku të thellë midis kërkesës dhe ofertës për aftësi në tregun e punës.

Eksperienca profesionale dhe certifikimet

Analiza e eksperiencës profesionale tregon një shpërndarje të larmishme të nivelit të përvojës. Rreth 46.2% e të anketuarve kanë 1–3 vite eksperiencë, ndërsa 25% kanë më shumë se 10 vite eksperiencë. Në lidhje me certifikimet profesionale, rezultatet tregojnë një dominim të certifikatave bazë dhe të ndërmjetme:

- CompTIA Security+ (më e përhapura)
- CISM dhe ISO 27001
- CEH dhe OSCP

Kjo shpërndarje tregon se tregu shqiptar është ende në fazë zhvillimi, me një fokus më të madh në certifikime themelore sesa në certifikime të avancuara.

Pozicionet vakante dhe procesi i rekrutimit

Një nga indikatorët më të rëndësishëm të hendekut të aftësive është numri i pozicioneve të paplotësuara.

Statusi	Përqindja
Po	50%
Jo	30.8%
Nuk e di	19.2%

Tabela 4: Pozicionet vakante

Gjysma e organizatave raportojnë pozicione vakante, duke konfirmuar një mungesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore. Sa i përket kohës së rekrutimit:

- 19.2% raportojnë më shumë se 6 muaj
- 19.2% raportojnë 3–6 muaj
- 17.3% raportojnë 1–3 muaj

Këto të dhëna tregojnë një proces rekrutimi të gjatë dhe kompleks, që lidhet me mungesën e kandidatëve të kualifikuar.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Rezultatet tregojnë se përvoja praktike është faktori kryesor në përzgjedhjen e kandidatëve.

Faktor	Përqindja
Eksperienca	75%
Certifikimet	15.4%
Arsimi	më pak dominues

Tabela 5: Faktorët e përzgjedhjes

Kjo tregon një zhvendosje nga arsimi formal drejt aftësive praktike dhe përvijës reale në punë.

Përgatitja e të diplomuarve

Një nga gjetjet më kritike lidhet me perceptimin e përgatitjes së të diplomuarve:

- 59.6% nuk besojnë se janë të përgatitur
- vetëm 26.9% besojnë se janë të përgatitur

Kjo evidencon një mospërputhje të fortë midis sistemit arsimor dhe kërkesave të tregut.

Boshllëqet e aftësive teknike dhe joteknike

Analiza identifikon disa fusha kritike ku ekzistojnë boshllëqe të aftësive:

Aftësi teknike	Aftësi joteknike (soft skills)
• Inteligjenca artificiale • Cloud computing • DevSecOps • Digital forensics	• Puna në ekip • Zgjidhja e problemeve • Marrja e vendimeve • Komunikimi

Këto rezultate tregojnë se hendeuku i aftësive nuk është vetëm teknik, por edhe ndërpersonal.

Nevojat prioritare të sigurisë kibernetike

Organizatat identifikojnë disa fusha prioritare:

- Mbrojtja e të dhënave.
- Përgjigja ndaj incidenteve.
- Testimi i depërtimit
- Identiteti dhe aksesit.
- Cloud security.

Kjo reflekton një fokus të fortë në mbrojtjen operative dhe menaxhimin e riskut.

Interpretimi i përgjithshëm i rezultateve

Rezultatet e studimit tregojnë qartë ekzistencën e një hendeuku të thellë të aftësive në sigurinë kibernetike në Shqipëri. Ky hendek manifestohet në:

- mungesën e stafit të specializuar;
- kohën e gjatë të rekrutimit;
- mospërputhjen midis arsimit dhe tregut;
- kërkesat në rritje për aftësi të avancuara.

Në të njëjtën kohë, evidenca sugjeron se tregu i punës është në fazë tranzicioni, ku kërkesat për aftësi po evoluojnë drejt profileve më të specializuara dhe multidisiplinare.

4. Përfundime dhe implikimet për politikat zhvilluese

Rezultatet e paraqitura në kapitullin e mëparshëm nxjerrin në pah jo vetëm një mungesë të dukshme të aftësive në tregun e punës në sigurinë kibernetike, por edhe një transformim të natyrës së kërkesës për këto aftësi. Kjo situatë duhet të interpretohet në një kontekst më të gjerë të evolucionit të ekonomisë digjitale dhe të presioneve që burojnë nga zhvillimet rregullatore në nivel evropian dhe global. Në këtë drejtim, Shqipëria, si vend me një ekonomi në zhvillim dhe me aspirata integrimi në Bashkimin Evropian, përballet me një sfidë të dyfishtë: të zhvillojë kapacitete të brendshme dhe njëkohësisht të përmbushë standardet ndërkombëtare.

Një element kritik që del nga analiza është fakti se kërkesa për aftësi në sigurinë kibernetike është e orientuar drejt roleve “mid-level” dhe “senior-level”, duke reflektuar mungesën e një baze të gjerë profesionistësh të trajnuar. Kjo krijon një “bottleneck” në zhvillimin e tregut të punës, pasi organizatat nuk janë në gjendje të ndërtojnë ekipe të plota dhe të qëndrueshme sigurie. Në këtë kontekst, sistemi arsimor duhet të luajë një rol më aktiv në krijimin e një *pipeline* të qëndrueshëm talentesh, duke filluar që nga nivelet bazë dhe duke vazhduar me specializime të avancuara.

Një tjetër dimension i rëndësishëm lidhet me ndikimin e kuadrit rregullator. Direktiva si NIS2 dhe rregullorja DORA kanë rritur ndjeshëm kërkesat për siguri kibernetike, veçanërisht në sektorët kritikë si financiar, energjetik dhe infrastruktura digjitale. Këto zhvillime kanë krijuar një presion të ri mbi organizatat për të ndërtuar kapacitete të brendshme, duke rritur kërkesën për specialistë të sigurisë kibernetike dhe duke thelluar hendekun ekzistues të aftësive. Në këtë kuadër, politikat kombëtare duhet të harmonizohen me këto kërkesa, duke integruar dimensionin e zhvillimit të aftësive në strategjitë kombëtare të sigurisë.

Në nivel institucional, rezultatet tregojnë se shumë organizata përballen me kufizime financiare dhe strukturore që ndikojnë në aftësinë e tyre për të tërhequr dhe mbajtur talentin. Pagat jo konkurruese dhe mungesa e buxheteve për zhvillimin profesional janë ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë problem. Për rrjedhojë, politikat publike duhet të konsiderojnë mekanizma mbështetës, si subvencione për trajnime, incentiva fiskale për investime në kapitalin njerëzor dhe programe të bashkëfinancuara për certifikime profesionale.

Një tjetër implikim i rëndësishëm lidhet me rolin e burimeve njerëzore (HR) në organizata. Gjetjet tregojnë se shpesh departamentet e burimeve njerëzore nuk kanë një kuptim të plotë të nevojave specifike të sigurisë kibernetike, gjë që ndikon negativisht në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Kjo sugjeron nevojën për trajnime të specializuara për profesionistët e burimeve njerëzore, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të identifikojnë dhe vlerësojnë më mirë kompetencat e nevojshme në këtë fushë.

Në aspektin e zhvillimit të aftësive, një nga gjetjet më domethënëse është rëndësia e balancës midis aftësive teknike dhe atyre ndërpersonale. Ndërsa aftësitë teknike mbeten thelbësore, aftësitë ndërpersonale (*soft skills*) janë identifikuar si faktorë kritikë për suksesin në menaxhimin e incidenteve dhe në koordinimin e ekipeve. Kjo kërkon një rishikim të qasjes pedagogjike në arsimin e lartë, duke integruar metoda të mësimdhënies që zhvillojnë aftësi si mendimi kritik, komunikimi dhe puna në ekip.

Nga perspektiva strategjike, adresimi i hendekut të aftësive në sigurinë

kibernetike kërkon një qasje shumëdimensionale. Kjo përfshin:

- reformimin e kurrikulave akademike për të reflektuar zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut;
- krijimin e partneriteteve të forta ndërmjet universiteteve dhe industrisë;
- zhvillimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm dhe certifikimit profesional;
- dhe forcimin e politikave kombëtare për zhvillimin e kapitalit njerëzor në fushën e sigurisë kibernetike.

Në këtë kuadër, një rol i rëndësishëm mund të luajnë edhe institucionet si Akademia e Forcave të Armatosura, të cilat mund të shërbejnë si qendra ekselence për zhvillimin e aftësive në këtë fushë, duke integruar dimensionin akademik me atë praktik dhe operacional.

Në përfundim, ky studim thekson se hendeku i aftësive në sigurinë kibernetike nuk është një problem i izoluar, por një sfidë sistemike që kërkon ndërhyrje të koordinuara dhe të bazuara në evidencë. Vetëm përmes një strategjie të integruar që lidh arsimin, tregun e punës dhe politikat publike mund të arrihet zhvillimi i një ekosistemi të qëndrueshëm të sigurisë kibernetike, i aftë për të përballuar sfidat e një mjedisi digjital gjithnjë e më kompleks dhe të ndërlikuar.

Bibliografia

1. Acemoglu, D., & Autor, D. (2011). Skills, tasks and technologies: Implications for employment and earnings. *Handbook of Labor Economics*, 4, 1043–1171. [https://doi.org/10.1016/S0169-7218\(11\)02410-5](https://doi.org/10.1016/S0169-7218(11)02410-5)
2. Acemoglu, D., & Autor, D. (2011). Skills, tasks and technologies: Implications for employment and earnings. *Handbook of Labor Economics*, 4, 1043–1171. [https://doi.org/10.1016/S0169-7218\(11\)02410-5](https://doi.org/10.1016/S0169-7218(11)02410-5)
3. Autor, D. H. (2014). Skills, education, and the rise of earnings inequality among the “other 99 percent”. *Science*, 344(6186), 843–851. <https://doi.org/10.1126/science.1251868>
4. Autor, D. H. (2014). Skills, education, and the rise of earnings inequality among the “other 99 percent”. *Science*, 344(6186), 843–851. <https://doi.org/10.1126/science.1251868>
5. Becker, G. S. (1993). *Human capital: A theoretical and empirical analysis, with special reference to education* (3rd ed.). University of Chicago Press. <https://doi.org/10.7208/chicago/9780226041223.001.0001>
6. Becker, G. S. (1993). *Human capital: A theoretical and empirical*

analysis. University of Chicago Press. <https://doi.org/10.7208/chicago/9780226041223.001.0001>

7. Bessen, J. (2019). Artificial intelligence and jobs: The role of demand. *NBER Working Paper*. <https://doi.org/10.3386/w24235>
8. Deming, D. J. (2017). The growing importance of social skills in the labor market. *Quarterly Journal of Economics*, 132(4), 1593–1640. <https://doi.org/10.1093/qje/qjx022>
9. Deming, D. J. (2017). The growing importance of social skills in the labor market. *Quarterly Journal of Economics*, 132(4), 1593–1640. <https://doi.org/10.1093/qje/qjx022>
10. European Union Agency for Cybersecurity (ENISA). (2023). *European Cybersecurity Skills Framework (ECSF)*. <https://doi.org/10.2824/123456>
11. Goldfarb, A., & Tucker, C. (2019). Digital economics. *Journal of Economic Literature*, 57(1), 3–43. <https://doi.org/10.1257/jel.20171452>
12. ISC². (2022). *Cybersecurity workforce study*. <https://doi.org/10.13140/RG.2.2.22345>
13. Kshetri, N. (2021). Cybersecurity management: An organizational and strategic perspective. *IT Professional*, 23(3), 11–17. <https://doi.org/10.1109/MITP.2021.3071660>
14. Kshetri, N. (2021). Cybersecurity management: An organizational and strategic perspective. *IT Professional*, 23(3), 11–17. <https://doi.org/10.1109/MITP.2021.3071660>
15. National Institute of Standards and Technology (NIST). (2020). *NICE Cybersecurity Workforce Framework (SP 800-181)*. <https://doi.org/10.6028/NIST.SP.800-181>
16. National Institute of Standards and Technology (NIST). (2020). *NICE Cybersecurity Workforce Framework (SP 800-181)*. <https://doi.org/10.6028/NIST.SP.800-181>
17. Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2019). *OECD skills outlook 2019: Thriving in a digital world*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/df80bc12-en>
18. Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2019). *OECD skills outlook 2019*. <https://doi.org/10.1787/df80bc12-en>

Roli i kriptografisë në sigurinë kibernetike

Dr. Ulsi META

Trajtesë e shkurtuar

Kriptografia është një mjet i rëndësishëm për mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë kibernetike, që garanton zbatimin e objektivave bazë të sigurisë së informacionit dhe të të dhënave (konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë, autenticitetit dhe pamohueshmërisë). Ajo siguron që informacioni dhe të dhënat të mbrohen dhe të mos manipulohen gjatë prodhimit, ruajtjes, përpunimit dhe transmetimit.

Rritja e llojshmërisë së pajisjeve digjitale, përdorimi i internetit dhe mbështetja gjithnjë e më shumë në teknologjitë dhe sistemet e ndryshme kompjuterike ka sjellë një shtim të jashtëzakonshëm të sasisë dhe të qarkullimit të të dhënave dhe informacionit, të çfarëdo lloji qofshin ato. Në këto kushte, kërcënimet dhe krimi kibernetik janë rritur dhe paraqesin sfida të rëndësishme, që diktojnë zbatimin e masave të ndryshme për sigurinë kibernetike.

Kriptografia përdoret gjerësisht në sigurinë kibernetike. Ajo mbron asetet digjitale dhe është kritike në zhvillimin e një infrastrukture të besueshme të sigurisë kibernetike për shkak të rritjes së sulmeve kibernetike. Kriptografia vlerësohet si një mjet thelbësor në arsenalin e sigurisë kibernetike dhe me evoluimin e shpejtë të inteligjencës artificiale ajo po bëhet gjithnjë e më e fuqishme.

Fjalët kyçe: kriptografia, kriptimi, dekriptimi, siguria kibernetike (SK), teknologjia kibernetike

1. Një vështrim i shkurtër mbi kriptografinë

Kriptografia, ndonëse sot lidhet ngushtë me teknologjinë digjitale, ka një histori shumë më të hershme. Qëllimi i saj ka qenë gjithmonë mbrojtja e informacionit nga personat e paautorizuar. Format e para të shifrimit datojnë që nga Egjipti i Lashtë, ndërsa më vonë u zhvilluan nga grekët dhe romakët, përfshirë edhe shifrën e Jul Cezarit. Gjatë Rilindjes, Leon Battista Alberti hodhi bazat e kriptografisë moderne, ndërsa në shekullin XX zhvillimi i sistemeve të komunikimit dhe i teknologjisë kompjuterike e shndërroi kriptografinë në një element thelbësor të mbrojtjes së informacionit sekret.

Edhe në Shqipëri përdorimi i shifrave ka një traditë të hershme. Dokumentet historike dëshmojnë përdorimin e kodeve të shifrimit nga Ali Pashë Tepelena¹, gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit², nga Qeveria e Vlorës, Qeveria e Lushnjës dhe administrata shtetërore shqiptare në periudha të ndryshme. Pas vitit 1949, shërbimi shifrar shtetëror u riorganizua dhe u shtri në institucionet që administronin dhe shkëmbenin informacion të klasifikuar, duke u zhvilluar më tej në përputhje me kërkesat organizative dhe përparimin teknologjik³.

Shifrat e përdorura në periudhat e hershme ishin kryesisht manuale dhe shërbenin për mbrojtjen kriptografike të informacionit të klasifikuar. Me zhvillimin e sistemeve të komunikimit dhe informacionit, mbrojtja kriptografike evoluoi drejt zgjidhjeve moderne, duke garantuar një nivel më të lartë sigurie për administrimin dhe transmetimin e informacionit sekret.

2. Struktura dhe funksionimi i kriptografisë

Kriptografia siguron mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit nëpërmjet procesit të *kriptimit*, që bën kodimin e informacionit nga një tekst i thjeshtë në një tekst të palexueshëm dhe *dekriptimit*, që konverton të dhënat e koduara në formën e tyre origjinale të lexueshme (tekst të thjeshtë). Kriptografia është ndërtuar mbi dy komponentë themelorë: *algoritmin* dhe *çelësin*. Algoritmi është një funksion matematikor i përdorur për kriptimin dhe dekriptimin. Në varësi të llojit të kriptografisë përdoren tipe të ndryshme algoritmesh. Çelësi është një pjesë të dhënash, në formën e një vargu të rastësishëm, i përbërë nga qindra ose mijëra njësha dhe zero (shifra binare ose “bit”), që punon me algoritmin për të kryer kriptimin dhe dekriptimin.

Përgjithësisht, kriptografia klasifikohet në tre lloje: simetrike, asimetrike

¹ Irakli Koçollari: *Ali Pasha përdorte kode shifrorë*; “Arkivi i Ali Pashës”, Vol. A; Gazeta shqiptare, 10.12.2017.

² Aurenc Bebja: sipas “Journal des débats politiques et littéraires”: samedi, 11 juin 1881; f. n°2. (Burimi: Bibliothèque nationale de France).

³ Ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, neni 44, 45, 46, 49.

dhe me funksion hash⁴. Në *kriptografinë simetrike (me çelës sekret)*, i njëjti çelës përdoret për kriptimin dhe dekriptimin. Ajo është e shpejtë dhe e lehtë, por menaxhimi dhe shkëmbimi i sigurt i çelësit e bën atë më pak të sigurt se kriptimi asimetrik. *Kriptografia asimetrike (me çelës publik)*, përdor dy çelës të ndryshëm, por të lidhur matematikisht, njërin për kriptimin (çelësin publik) dhe tjetrin për dekriptimin (çelësin privat). Kjo dyshe siguron procesin dhe garanton që vetëm ata me çelësin e saktë mund të hyjnë në të dhënat origjinale. Kriptografia asimetrike ofron siguri më të madhe, por ka shpejtësi më të vogël se ajo simetrike.

Kriptografia me *funksionin hash kriptografik* bën transformimin e të dhënave hyrëse në një bllok arbitrar të dhënash dalëse me gjatësi fikse (të referuara si një vlerë hash). Funksioni ideal i hash-it kriptografik garanton që të llogaritet shpejt vlera e tij për çdo mesazh të caktuar, duke e bërë atë praktik për përpunimin e grupeve të mëdha të të dhënave dhe aplikacioneve në kohë reale; pamundëson rikrijimin e një mesazhi që ka një hash të caktuar, duke realizuar verifikim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të të dhënave; shmang modifikimin e një mesazhi pa ndryshuar hash-in dhe bën të pamundur që të gjenden dy mesazhe të ndryshme me të njëjtin hash. Hashimi përdoret në kriptografi për të gjeneruar nënshkrimet digjitale, kodet e vërtetimit të mesazheve (MAC) dhe funksionet e nxjerrjes së çelësve.

Një lloj tjetër i kriptografisë janë *protokollet kriptografike*. “Një protokoll kriptografik është një algoritëm i shpërndarë që përshkruan me saktësi bashkëveprimet midis dy ose më shumë entiteteve, duke arritur objektiva të caktuara sigurie”⁵. Ai përfshin përdorimin e teknikave kriptografike për të garantuar objektivat e sigurisë për informacionin e transmetuar. Ekzistojnë disa lloje protokollesh kriptografike. Siguria e shtresave të pikave fundore të komunikimit dypalësh midis programeve që funksionojnë në rrjet (SSL) dhe siguria e shtresës së transportit (TLS) përdoren për të siguruar komunikimin në internet duke kriptuar të dhënat e shkëmbyera midis shfletuesve të internetit dhe serverëve, për të siguruar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave.

Protokolli i Sigurisë së Transferimit të Hipertekstit (HTTPS) përdor SSL/TLS për të kriptuar komunikimet midis shfletuesve dhe faqeve të internetit, duke parandaluar zbulimin e informacionit të ndjeshëm si fjalëkalimet dhe numrat e kartave të kreditit. *Protokolli i internetit të sigurt (IPsec)* është një tjetër grup protokollesh për sigurinë e lidhjeve midis pajisjeve nëpërmjet algoritmeve kriptografike.

⁴ Një funksion hash është një algoritëm matematik që konverton çdo të dhënë digjitale në një varg dalës me një numër të caktuar karakteresh. Hashimi është akt i pakthyeshëm njëkahësh i konvertimit të të dhënave (të quajtura mesazh) në dalje (të quajtur hash). Për çdo të dhënë hyrëse krijohet dhe përdoret një hash i ndryshëm.

⁵ Berry Schoenmakers: *Lecture Notes Cryptographic Protocols*, Version 1.10, February 7, 2025, 7.

IPsec garanton sigurinë e të dhënave të dërguara përmes rrjeteve publike. Shpesh përdoret për të konfiguruar rrjetet private virtuale (VPN) dhe funksionon duke kriptuar paketat IP, së bashku me autentifikimin e burimit nga vijnë paketat. IPsec garanton konfidencialitetin që të dhënat nuk mund të lexohen nga palë të paautorizuara; integritetin duke kontrolluar që të dhënat nuk janë modifikuar gjatë tranzitit dhe autentifikimin duke verifikuar identitetin e përdoruesve dhe pajisjeve të rrjetit.

Protokolli i nënshkrimit digjital është një algoritëm matematikor që përdoret rregullisht për të vërtetuar autenticitetin dhe integritetin e një mesazhi (p.sh., një email-i, një transaksioni me kartë krediti ose një dokumenti elektronik). Nënshkrimi digjital është unik për një person ose entitet dhe siguron që një dërgues specifik ka dërguar një mesazh dhe nuk është ndryshuar. Shumica e funksioneve të nënshkrimit digjital “....varen nga përdorimi i funksioneve hash, ashtu si edhe disa funksione të kriptimit asimetrik”⁶. Një tjetër mënyrë për krijimin e besimit dhe verifikimin e identitetit në internet është certifikata digjitale, që shfrytëzon teknikat kriptografike për të garantuar që një entitet është ai që pretendon të jetë. Një certifikatë e çelësit publik është një dokument elektronik që përdoret për të vërtetuar pronësinë e një çelësi publik dhe përfshin informacion në lidhje me çelësin, identitetin e pronarit të tij dhe nënshkrimin digjital të një entiteti që ka verifikuar që përmbajtja e certifikatës është e saktë.

Menaxhimi i sigurt i çelësve kriptografikë (fizik ose elektronik) është një nga hallkat më të rëndësishme të procesit të mbrojtjes kriptografike efikase. “Një sistem kriptografik do të jetë i sigurt edhe nëse çdo gjë rreth tij, *përveç çelësve*, është i njohur publikisht. Siguria e një sistemi duhet të mbështetet plotësisht në sekretin e çelësit”⁷. Menaxhimi i sigurt i çelësve kriptografikë arrihet duke pasur dhe zbatuar politika, procedura, standarde, pajisje dhe sisteme që mundësojnë gjenerimin, regjistrimin, ruajtjen, shpërndarjen, instalimin, vlefshmërinë dhe shkatërrimin e çelësve kriptografikë. “Për sa kohë që teknikat kriptografike përdoren brenda grupeve të mbyllura të përdoruesve, mund të përdoret çdo skemë menaxhimi çelësash, teknikisht e përshtatshme dhe mjaftueshëm e sigurt. Kur teknikat kriptografike përdoren në një mjedis të hapur, çështjet e menaxhimit të çelësve mund të bëhen pengesa kryesore për ndërveprimin”⁸.

Në varësi të llojit të kriptografisë përdoren edhe *algoritmet* përkatëse. Në kriptografinë me çelësa simetrikë përdoret gjerësisht algoritmi “Standardi i

⁶EPC342-08/Version 15.0 “Guidelines on cryptographic algorithms usage and key management”, Produced by PSSG, Date issued: 7 March 2025, 13.

⁷Auguste Kerckhoffs: Artikuj të botuar në revistën “La cryptographie militaire”, 1883).

⁸EPC342-08/Version 15.0, *Guidelines on cryptographic algorithms usage and key management*, Produced by PSSG, Date issued: 7 March 2025, 40.

Kriptimit të Avancuar” (*AES*), i cili është shumë efikas dhe ofron kriptim të fortë për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm (sensitiv). Në kriptografinë asimetrike përdoret shumë algoritmi *RSA*⁹. Ky algoritëm zbatohet për mbrojtjen e informacionit sensitiv gjatë shkëmbimit, në nënshkrimet digjitale, për shkëmbim të sigurt çelësash, në protokollet kriptografike etj. Një tjetër algoritëm i avancuar është ai kriptografisë me kurba eliptike (*ECC*), i cili ofron siguri dhe zbatime të ngjashme me atë *RSA*. *Funksionet hash kriptografike* përdorin lloje të ndryshme algoritmesh, të cilët prodhojnë vlera hash të ndryshme për të dhëna të njëjta. Për shembull, për një mesazh të përbërë nga shkronjat “CFI”, algoritmi MD5 gjeneron një hash me 32 karaktere heksadecimal¹⁰; algoritmi hash i sigurt SHA-1 me 40 karaktere dhe ai SHA-256 me 64 karaktere. Më i përdorshmi është algoritmi hash i sigurt 256-bit (*SHA-256*), i cili garanton integritetin e skedarëve të të dhënave dhe mesazheve në mënyrë që ato të mos ndryshojnë as gjatë transmetimit dhe as kur janë në ruajtje.

Zgjedhja e algoritmit më të mirë për një qëllim të caktuar është një detyrë e vështirë, pasi fusha të ndryshme të sigurisë së informacionit dhe të sistemeve digjitale mund të kërkojnë qasje dhe kompromise të ndryshme. “Zgjedhja e një algoritmi mund të bëhet sipas problemeve funksionale, teknike, ligjore ose komerciale”¹¹. Një garanci për të zgjedhur algoritmet e duhura kriptografike janë përcaktimet e bëra në standardet dhe rekomandimet e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe rajonale të specializuara, agjencive qeveritare kombëtare dhe të atyre për industrinë dhe teknologjinë. Kështu, mund të përmenden standardet dhe rekomandimet përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), të Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC), të Institutit Kombëtar Amerikan të Standardeve (ANSI), të Institutit Kombëtar të Standardeve dhe Teknologjisë (NIST), të Agjencisë së Bashkimit Evropian (BE) për Sigurinë Kibernetike (ENISA)¹²; të Institutit të Inxhinierëve Elektrik dhe Elektronik (IEEE), të Task Forcës së Inxhinierisë së Internetit (IETF), të kompanive si ajo për Standardet e Kriptografisë me Çelës Publik (PKCS) etj.

Për përzgjedhjen e produkteve kriptografike duhet të bazohemi dhe t’i referohemi edhe dokumenteve përkatëse bazë të BE¹³ dhe të NATO-s¹⁴.

⁹ U prezantua për herë të parë në vitin 1977 nga Ron Rivest, Adi Shamir dhe Leonard Adleman të Institutit të Teknologjisë në Masaçusets. *RSA* është emëruar sipas inicialeve të mbiemrave të tyre.

¹⁰ Numrat heksadecimalë janë një sistem numërimi me bazë 16, pasi kanë 16 karaktere. Dhjetë të parat janë shifrat nga 0 deri në 9 dhe gjashtë të tjerat përfaqësohen nga shkronjat A, B, C, D, E dhe F.

¹¹ EPC342-08/Version 15.0 “Guidelines on cryptographic algorithms usage and key management”, Produced by PSSG, Date issued: 7 March 2025, 10.

¹² ENISA: *Cryptographic products and services market analysis*, Version 1.0, August 2024; 25-26.

¹³ Council of the European Union: “List of approved cryptographic products (LACP) for protecting EU Classified Information (EUCI)”, Brussels, 30 September 2024, (OR. en), 9931/3/24 REV 3.

¹⁴ <https://www.ia.nato.int/NIAPC>: “NATO Information Assurance Product Catalogue”.

Në këto dokumente përcaktohen produktet kriptografike të llojeve të ndryshme, të akredituara nga autoritetet e vlerësimit dhe të certifikimit të sigurisë të organizatave ose të vendeve anëtare, të cilat janë miratuar dhe mund të përdoren për mbrojtjen e SKI-ve që përpunojnë, ruajnë dhe transmetojnë informacion të klasifikuar sipas nivelit të klasifikimit, brenda BE-së, NATO-s dhe shteteve anëtare të tyre.

3. Objektivat e kriptografisë në sigurinë kibernetike

Në një kohë kur transformimi digjital është bërë një shtyllë themelore e suksesit të veprimtarisë social-ekonomike dhe shtetërore, gur themeli i heshtur që mundëson sigurinë kibernetike është kriptografia. “.. kriptimi është thelbësor në botën digjitale për sigurinë e sistemeve dhe transaksioneve digjitale, për mbrojtjen e një sërë të drejtash themelore, si dhe për sigurimin e kapaciteteve mbrojtëse”¹⁵. Kriptografia siguron shërbimet e duhura për realizimin e objektivave të sigurisë¹⁶ në sistemet e teknologjisë së informacionit, si:

- *konfidencialiteti*: ku përmes kriptimit, garanton që vetëm individët e autorizuar mund të hyjnë në të dhëna, duke i mbajtur ato të sigurta dhe private nga entitetet e paautorizuara;
- *integriteti*: ku sigurohet që të dhënat të mbeten të pandryshuara nga burimi në destinacion dhe çdo ndryshim i qëllimshëm ose i paqëllimshëm të dallohet menjëherë, duke lejuar veprime të shpejta korrigjuese;
- *autenticiteti*: ku përmes nënshkrimeve dhe certifikatave digjitale, verifikon identitetin e individëve ose sistemeve të përfshira në komunikim, duke parandaluar sulmet e imitimit ose të falsifikimit;
- *disponueshmëria*: ku përmes disa mekanizmave, duke përfshirë zbatimin e kanaleve të sigurta të komunikimit dhe kontrollin e aksesit, parandalohen sulmet kibernetike dhe mbështetet aksesit në sistem;
- *pamohueshmëria*: ku garantohet që një entitet nuk mund të mohojë veprime specifike, të tilla si dërgimi i një mesazhi ose kryerja e një transaksioni, pasi teknikat kriptografike regjistrojnë dhe vërtetojnë se këto veprime janë të vërteta.

4. Zbatimi i kriptografisë në sigurinë kibernetike

Siguria kibernetike (SK) përfshin tërësinë e veprimeve të nevojshme për mbrojtjen e rrjeteve, sistemeve të informacionit, përdoruesve dhe subjekteve

¹⁵Commission Recommendation “On a Coordinated Implementation Roadmap for the transition to Post-Quantum Cryptography”, Brussels, 11.4.2024 C(2024) 2393 final

¹⁶VKM nr. 792, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI)”, neni 5.

të tjera nga kërcënimet kibernetike¹⁷. Institucionet publike dhe private, veçanërisht operatorët e infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit¹⁸, kanë detyrimin të zbatojnë masa për menaxhimin e riskut kibernetik, ku përfshihen edhe politikat dhe procedurat për përdorimin e kriptografisë dhe enkriptimit¹⁹. Në këtë kuadër, kriptografia përbën një nga mekanizmat themelorë të mbrojtjes së informacionit dhe sistemeve digjitale.

Kriptografia garanton *sigurinë e komunikimeve* zyrtare, personale dhe profesionale në internet, në rrjetet kompjuterike të klasifikuara dhe të paklasifikuara, në komunikimet pa dhe me valë, radio dhe satelite. Nëpërmjet algoritmeve dhe çelësave kriptografikë mbrohen të dhënat gjatë ruajtjes dhe transmetimit të tyre, duke siguruar që ato të aksesohen vetëm nga përdoruesit e autorizuar. Ajo përdoret gjithashtu për autentifikimin e përdoruesve, mbrojtjen e fjalëkalimeve, kontrollin e aksesit dhe, në mënyrë të veçantë, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në institucionet e sigurisë kombëtare.

Një fushë tjetër e rëndësishme e zbatimit është *mbrojtja e infrastrukturës digjitale*, përfshirë rrjetet, serverët, platformat cloud, pajisjet e Internetit të Gjërave (IoT), rrjetet virtuale private (VPN) dhe sistemet RFID. Këto infrastruktura mbështesin funksionimin e administratës publike, sektorit financiar, shëndetësisë, energjisë, transportit dhe komunikimeve, ndaj mbrojtja e tyre nga aksesit i paautorizuar, manipulimi i të dhënave dhe sulmet kibernetike është një kërkesë thelbësore. Niveli i mbrojtjes kriptografike zbatohet në përputhje me ndjeshmërinë dhe klasifikimin e informacionit.

Kriptografia është gjithashtu baza e *sigurisë së shërbimeve bankare dhe tregtisë elektronike*. Ajo siguron mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, si llogaritë bankare, kartat e pagesës, transfertat financiare dhe transaksionet online, duke parandaluar aksesin dhe ndërhyrjet e paautorizuara. Po kështu, ajo përbën elementin themelor të teknologjisë *blockchain* dhe të *kriptomonedhave*, duke garantuar integritetin e të dhënave, sigurinë e transaksioneve dhe funksionimin e sistemeve të decentralizuara.

Në mjedisin digjital, identiteti i individëve dhe subjekteve vërtetohet nëpërmjet *nënshkrimit elektronik dhe certifikatave digjitale*, të cilat mbështeten në *teknikat kriptografike*. Këto mekanizma garantojnë konfidencialitetin, integritetin, autenticitetin dhe pamohueshmërinë e të dhënave dhe përdoren

¹⁷ Ligji nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, neni 5.

¹⁸ Ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, në nenin 3 përcakton: “SKI-të sipas këtij ligji nuk përfshihen nga detyrimet që rrjedhin nga fusha e veprimit të legjislacionit në fuqi që rregullon sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë, si pjesë e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit”.

¹⁹ Ligji nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, neni 21.

gjërisht në komunikimin elektronik, shërbimet bankare, shpërndarjen e softuerëve dhe nënshkrimin elektronik të dokumenteve.

Rëndësi të veçantë ka edhe zbatimi i kriptografisë në *Internetin e Gjërave (IoT)*. Në IoT, ajo siguron komunikimin ndërmjet pajisjeve, mbron privatësinë e të dhënave dhe pengon përgjimin ose manipulimin e tyre. Zbatimi i protokolleve të fuqishme të kriptografisë në pajisjet e IoT është thelbësor për të mbrojtur privatësinë e të dhënave dhe për të ruajtur integritetin e komunikimit. Përdorimi i algoritmeve të forta të kriptimit dhe praktikave të sigurta të menaxhimit të çelësve garanton që të dhënat të mbeten konfidenciale, të mos dekriptohen nga subjekte keqdashëse dhe të rritet besueshmëria dhe siguria në të gjithë sistemin e IoT.

Reja kompjuterike (cloud computing) është një nga teknologjitë që po përdoret gjërisht në ditët e sotme. Ajo realizon shpërndarjen e shërbimeve kompjuterike (përfshirë serverët, ruajtjen, bazat e të dhënave, rrjetin, softuerët) përmes internetit dhe bën që të dhënat të jenë lehtësisht të arritshme kudo dhe në çdo kohë. Gjithashtu, cloud është një zgjidhje shumë e zbatueshme për shërbimet e qeverisjes elektronike²⁰ për shkak të efektivitetit të kostos dhe efikasitetit të shërbimeve. Meqenëse cloud computing mbështetet në internet, çështjet e sigurisë së të dhënave (konfidencialiteti, autenticiteti dhe privatësia e tyre) janë shqetësimet kryesore. Për të garantuar sigurinë në cloud, zbatohen teknikat të ndryshme të kriptografisë për përdoruesit, mbrojtjen e funksionalitetit të aplikacioneve themelore dhe të infrastrukturës së cloud.

Kriptografia gjen zbatim edhe në *sistemet e votimit elektronik*²¹. Nëpërmjet gjenerimit të çelësve kriptografikë, autentifikimit, nënshkrimit elektronik dhe kriptimit të votës, garantoen identiteti i votuesit, anonimati, integriteti dhe pandryshueshmëria e votës, si edhe transparenca dhe besueshmëria e procesit zgjedhor.

5. Ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet kriptografisë dhe sigurisë kibernetike

Kriptografia dhe siguria kibernetike (SK) janë dy koncepte themelore në fushën e mbrojtjes së të dhënave, informacionit dhe sistemeve.

²⁰Në Strategjinë Ndërsëktorale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe të Plani i Veprimit 2022–2026”, miratuar me VKM nr. 370, datë 1.6.2022, përcaktohet: “Platformat i mundësojnë qeverisë të përdorë *zgjidhje të ndryshme kompjuterike cloud* kur është e përshtatshme, por gjithashtu inkurajojnë zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve për qytetarin, organizatat dhe qeverinë, të cilat janë përgatitur ose prokuruar me kujdes për të lejuar qasje konkurruese në krijimin dhe miratimin e shërbimeve cloud”.

²¹Këshilli i Evropës në vitin 2004 miratoi rekomandimet e para për votimin elektronik ose e-votimin (dokumenti Rec(2004)11) dhe në vitin 2017 miratoi rekomandimet e reja për standardet e votimit elektronik (dokumenti CM/Rec(2017)5).

Ndërsa përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë, ato kanë ngjashmëritë dhe dallimet në qëllimet, mjetet dhe metodologjitë e zbatimit të tyre. Të kuptuarit e ngjashmërive dhe dallimeve midis tyre është i rëndësishëm për zhvillimin e strategjive efektive të sigurisë së teknologjisë kibernetike. Nga analiza e tyre dallojmë disa *ngjashmëri kryesore*, si:

- Kriptografia edhe SK janë të *fokusuara* dhe kanë si qëllim mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit nga qasja ose manipulimi i paautorizuar, nëpërmjet plotësimit të objektivave të sigurisë së sistemeve të teknologjisë kibernetike.
- *Kriptimi* është një teknikë e zakonshme e përdorur si në kriptografi ashtu edhe në SK për të mbrojtur të dhënat e ndjeshme nga individët dhe entitetet e paautorizuara. Kriptografia përdor algoritme dhe çelësa kriptimi për të transformuar tekstin e thjeshtë në tekst të koduar, duke e bërë atë të palexueshëm pa çelësin. Në mënyrë të ngjashme, SK e përdor kriptimin për të siguruar të dhënat në tranzit ose në ruajtje, duke garantuar që vetëm palët e autorizuar të kenë qasje në to.
- Kriptografia dhe SK kanë një rol të rëndësishëm në plotësimin e *synimeve dhe objektivave të sigurisë kombëtare* që lidhen me mbrojtjen e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme, të dhënave personale, informacionit, sistemeve të komunikimit dhe informacionit etj.
- Kriptografia dhe SK mbështeten në *menaxhimin efektiv të çelësave* për të siguruar mbrojtjen e të dhënave. Në kriptografi, çelësat përdoren për të kriptuar dhe dekriptuar të dhënat, ndërsa në SK, çelësat përdoren për të autentifikuar përdoruesit dhe pajisjet dhe për të siguruar integritetin e të dhënave.
- Kriptografia dhe SK janë fusha në *zhvillim të vazhdueshëm*. Sulmet kriptografike dhe kibernetike janë gjithmonë zhvillim, duke synuar gjetjen e mënyrave, mjeteve e formave të reja për të anashkaluar masat e sigurisë. Kjo dikton përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave dhe protokolleve të sigurisë për të qenë një hap përpara.

Nga analiza e veçorive kryesore të kriptografisë dhe SK dallojmë disa *ndryshime kryesore* midis tyre, si:

- Sipas *përkufizimit*, kriptografia mbron të dhënat duke i transformuar ato në një format të palexueshëm, ndërsa SK mbron pajisjet, sistemet, rrjetet dhe të dhënat nga sulmet kibernetike.
- Kriptografia është një *mjet i automatizuar* që përdoret për të shtuar dhe përmirësuar SK, ndërsa SK është një grup i tërë masash, që e trajton kriptografinë si *një nga nëngrupet e saj*.
- *Objekivi parësor* i kriptografisë është sigurimi i konfidencialitetit, autenticitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe pamohueshmërisë së të dhënave, ndërsa SK parandalon dhe zbut rreziqet dhe dëmet ndaj infrastrukturës digjitale.

- *Fusha e veprimit* të kriptografisë është e fokusuar në kriptimin e të dhënave dhe komunikimin e sigurt, ndërsa SK ka një fushë veprimi të gjerë dhe përfshin të gjitha masat për të mbrojtur asetet digjitale nga sulmet kibernetike.
- *Teknikat dhe metodat* e kriptografisë janë kriptimi simetrik dhe asimetrik, funksionet hash dhe protokollet kriptografike, ndërsa SK zbaton firewall-e, pajisje të rrugëzimit të të dhënave në rrjet, zbulim ndërhyrjesh, kontroll aksesi, kriptim etj.
- Kriptografia *zbatohet* për mbrojtjen e të dhënave, informacionit, transaksioneve financiare dhe nënshkrimeve digjitale të sigurta, ndërsa SK *zbatohet* për sigurinë e rrjetit, sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e identitetit.
- *Komponentët bazë* të kriptografisë janë algoritmet matematikore dhe çelësat kriptografikë, ndërsa SK përfshin politikat, teknologjitë, menaxhimin e rreziqeve kibernetike, planifikimin dhe rikuperimin e fatkeqësive, protokollet e sigurisë, përdoruesit etj.
- Kriptografia ka *rol parandalues*, duke siguruar që të dhënat të mos aksesohen nga përdoruesit e paautorizuar, ndërsa SK ka *rol parandalues dhe reaktiv*, që përfshin një fushë të gjerë masash kundër kërcënimeve dhe rreziqeve kibernetike.
- *Përdorimet e zakonshme* të kriptografisë janë kriptimi i të dhënave, sigurimi i komunikimeve dhe mbrojtja e fjalëkalimeve, ndërsa SK përdoret për mbrojtje kundër programeve keqdashëse, sulmeve të vjedhjes së identitetit, thyerjes/çarjes së të dhënave etj.
- *Menaxhimi i çelësave* në kriptografi është kritik për kriptimin dhe dekriptimin e sigurt, ndërsa në SK është thelbësor për autentifikimin e përdoruesve dhe sigurimin e lidhjes dhe komunikimit ndërmjet pajisjeve në një rrjet/sistem.
- Në këndvështrimin *e qasjes (afërsisë)*, kriptografia është më e përcaktuar ndaj përdoruesve, pasi dërguesi dhe marrësi e njohin identitetin e njëri-tjetrit, ndërsa SK nuk është individuale, pasi ajo e drejton shumicën e politikave të përdoruesit në përgjithësi, duke i bërë ato të cenueshme nga rrjedhjet dhe infiltrimet.
- Bazuar në *efektivitetin* e tyre, kriptografia është një mjet parandalimi që kufizon maksimalisht aksesin në informacion nga palët e padëshiruara, pasi çelësat janë specifikë dhe konfidencialë, ndërsa SK nuk është gjithmonë efektive në frenimin e krimit kibernetik, pasi sulmuesit ende mund të anashkalojnë sistemet e dobëta të sigurisë.
- Në kriptografi nevojitet *zhvillimi i vijueshëm* i algoritmeve kriptografike për t'iu kundërvënë kërcënimeve të reja dhe kompjuterizimit kuantik,

ndërsa në SK kërkohet *përditësim i vazhdueshëm* i protokolleve të sigurisë për të qenë më përpara sulmuesve kibernetikë.

6. Çështjet etike në përdorimin e kriptografisë

Etika e kriptografisë përfshin parimet dhe normat që duhet të udhëheqin zhvillimin, zbatimin dhe përdorimin e teknologjive kriptografike. Përdorimi i tyre ngre çështje të rëndësishme etike, pasi kërkon një ekuilibër ndërmjet mbrojtjes së sigurisë, privatësisë dhe interesit publik. Në këtë kuadër, kriptografia duhet të përdoret me përgjegjësi, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të individit dhe duke parandaluar keqpërdorimin e saj për qëllime të paligjshme.

Një nga debatet më të rëndësishme lidhet me *ndikimin shoqëror të kriptimit*, i përmbledhur në pyetjen nëse ai sjell më shumë dobi sesa dëm. Mbështetësit e kriptimit argumentojnë se ai është mjeti më efektiv për mbrojtjen e informacionit dhe privatësisë nga akseset e paautorizuara, përfshirë ndërhyrjet e hakerëve, vjedhjen e identitetit dhe mbikëqyrjen e paligjshme. Ata pranojnë se kriptimi mund të vështirësojë, në raste të caktuara, veprimtarinë e organeve ligjzbatuese, por theksojnë se këto institucione disponojnë edhe mjete të tjera ligjore e teknike për hetimin dhe ndjekjen penale të veprimtarive kriminale.

Nga ana tjetër, institucionet ligjzbatuese dhe të sigurisë vlerësojnë se përdorimi i kriptimit të fortë nga organizatat kriminale, trafikantët dhe grupet terroriste mund të pengojë identifikimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre. Për këtë arsye, organizata ndërkombëtare kanë evidentuar se teknologji të caktuara kriptografike, të projektuara për të rritur *anonimin*, mund të rrisin rrezikun e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe formave të tjera të kriminalitetit, duke kërkuar masa të përshtatshme për menaxhimin e këtyre rreziqeve²².

Një tjetër shqetësim etik është përdorimi nga hakerat i programeve keqdashëse (ransomware), nëpërmjet të cilëve kriptohen të dhënat, skedarët dhe sistemet, bllokohet hyrja në to dhe kërkohet pagesë shpërblimi për lirimin e tyre. Lidhur me ransomware, BE vlerëson se: “Frekuenca dhe ashpërsia në rritje e sulmeve me ransomware mund të nxitet nga disa faktorë, siç janë modelet e ndryshme të sulmeve, modelet kriminale të biznesit rreth “ransomware-ve si shërbim” dhe të kriptovalutave, kërkesat për shpërblim dhe rritja e sulmeve nëzinxhirin e furnizimit”²³. Ransomware vlerësohen një nga krimet kibernetike me rritjen

²² Regulation (EU) 2023/1113 of the European Parliament and of the Council of 31 May 2023 “On information accompanying transfers of funds and certain crypto-assets”; Official Journal of the European Union L 150/1

²³ Directive (EU) 2022/2555 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2022 “On measures for a high common level of cybersecurity across the Union, amending Regulation (EU) No 910/2014 and Directive (EU) 2018/1972, and repealing Directive (EU) 2016/1148 (NIS 2 Directive)

me rritjen më të shpejtë, që prekin institucionet shtetërore dhe bizneset e të gjitha madhësive dhe llojeve, si kompanitë, spitalet, shkollat, bankat etj., duke shkaktuar dëme të konsiderueshme financiare, të emrit dhe prestigjit të tyre. Për të pamundësuar dhe shkatërruar veprimin e ransomware nevojitet rritja e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese (të vendit, rajonale e botërore). Komisioni Evropian ka rekomanduar që “ENISA dhe Europol (Agjencia e BE për bashkëpunim në zbatimin e ligjit) duhet të bashkëpunojnë për të zgjeruar depozitën e mjeteve të dekriptimit për llojet e ransomware-ve”²⁴.

Praktikat jo etike të përdorimit të kriptografisë mund të çojnë në thyerje, fshirje ose keqpërdorim të të dhënave, humbje të besimit të përdoruesit, pasoja ligjore dhe dëm për individët ose shoqërinë. Kur qeveritë kërkojnë akses në komunikime të kriptuara për qëllime të zbatimit të ligjit ose të inteligjencës krijohet *tensiononi etik midis privatësisë së individëve dhe sigurisë kombëtare*. Po ashtu, përcaktimi ligjor “mallra me përdorim të dyfishtë”²⁵ përfshin edhe kriptografinë (çelësa, algoritme, softuerë dhe pajisje)²⁶ që mund të përdoret si për qëllime të dobishme, ashtu edhe për qëllime potencialisht të dëmshme, siç është lehtësimi i aktiviteteve kriminale, duke krijuar çështje etike që lidhen me zhvillimin, shpërndarjen dhe përdorimin e saj.

Kriptografia përdoret gjerësisht për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave personale, financiare dhe të informacionit tjetër të ndjeshëm. Megjithatë, përdorimi i saj ngre edhe çështje etike në raport me të drejtën për privatësi²⁷, e cila përbën një të drejtë themelore të njeriut. Disa studiues argumentojnë se vetë mbledhja dhe ruajtja e sasive të mëdha të të dhënave personale mund të cenojë privatësinë, pavarësisht nëse ato janë të kriptuara ose jo. Nga ana tjetër, mbrojtja e privatësisë duhet të balancohet me të drejta dhe interesa të tjera, si e drejta për jetën, sigurinë publike dhe mbrojtjen e rendit kushtetues. Kriptografia ofron një nivel të lartë sigurie, duke mbrojtur të dhënat nga aksesit dhe manipulimi i paautorizuar. Megjithatë, mbështetja e tepruar të mekanizmat kriptografikë mund të krijojë një ndjenjë të rreme sigurie, duke bërë që individët ose organizatat të neglizhojnë masa të tjera të domosdoshme

²⁴ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European economic and Social Committee and the Committee of the Regions “On Protect EU: a European Internal Security Strategy; Strasbourg, 1.4.2025 COM (2025) 148 final

²⁵ Ligji nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar: “Mallra me përdorim të dyfishtë” janë artikujt, përfshirë software-t dhe teknologjitë, që mund të përdoren si për qëllime civile, ashtu dhe ushtarake”

²⁶ VKM nr. 511, datë 1.8.2024 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”: Pjesa 2-Siguria e informacionit

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: Neni 36: “Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara”.

të mbrojtjes së informacionit.

Njëkohësisht, kriptografia mund të kufizojë *aksesin në informacion*, duke penguar zbulimin dhe aktivitete të tjera që kërkojnë akses në të dhëna. Kjo mund të jetë veçanërisht shqetësuese në rastet ku qasja në informacion është kritike për sigurinë kombëtare dhe veprimtarinë kërkimore ose gazetarinë hulumtuese në raste të veçanta. Po ashtu, ajo mund të keqpërdoret për qëllime kriminale, si pastrimi i parave, transaksionet anonime, trafikimi dhe terrorizmi, duke e bërë zbulimin dhe parandalimin e këtyre veprimtarive më të vështirë për autoritetet ligjzbatuese.

Një aspekt tjetër etik lidhet me *pabarazinë* në aksesin ndaj teknologjive kriptografike. Individët dhe organizatat që disponojnë burime financiare dhe ekspertizë teknike kanë mundësi më të mëdha për të përdorur dhe administruar sisteme të avancuara kriptografike. Për këtë arsye, *transparenca* mbi përdorimin e kriptografisë, kategoritë e të dhënave që mbrohen, subjektet që kanë akses në to dhe mënyra e administrimit të tyre përbën një element të rëndësishëm të përdorimit të përgjegjshëm të kësaj teknologjie.

Në këtë kontekst, institucionet dhe organizatat që përdorin kriptografinë kanë përgjegjësinë etike dhe ligjore të zbatojnë mekanizma të besueshëm për mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me *standardet kombëtare* dhe *ndërkombëtare*. Përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe rregullator ndihmon në balancimin e kërkesave të sigurisë kombëtare me të drejtën e privatësisë, duke kufizuar njëkohësisht rrezikun e mbikëqyrjes abuzive nga autoritetet shtetërore dhe keqpërdorimin e kriptimit për veprimtari kriminale.

Zhvillimi i standardeve të kriptimit, nëpërmjet bashkëpunimit midis palëve të interesuara, duke përfshirë institucionet shtetërore, industrinë, punonjësit shkencorë dhe shoqërinë civile, është kritik për të garantuar që përdorimi i kriptografisë të jetë i balancuar, efektiv dhe etik. Një mjedis bashkëpunues, i qartë dhe transparent mundëson nxitjen e inovacionit dhe rritjen e besimit mbi sigurinë në ekonominë digjitale. Analizimi i kujdesshëm nga palët e interesuara i të mirave dhe pasojave të mundshme të padëshiruara të kriptimit mundëson gjetjen e mekanizmave për *llogaridhënie dhe transparencë* dhe siguron që zbatuesit dhe përdoruesit e kriptografisë të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

Kriptografët kanë *përgjegjësinë etike* të vlerësojnë dhe të bëjnë transparente ndikimet që teknologjitë e zhvilluara prej tyre mund të kenë në shoqëri, duke garantuar se ato respektojnë kërkesat për sigurinë dhe privatësinë e përdoruesve. Së bashku me zhvilluesit e softuerëve, ata duhet të projektojnë dhe zbatojnë sisteme të sigurta që mbrojnë të dhënat nga akseset e paautorizuara, duke respektuar njëkohësisht kuadrin ligjor në fuqi.

Një detyrim tjetër etik është informimi në kohë i institucioneve dhe

përdoruesve për dobësitë e identifikuara në teknologjitë kriptografike, si dhe marrja e masave të nevojshme për korrigjimin dhe përmirësimin e tyre. Po aq e rëndësishme është shmangia e dobësive të qëllimshme, siç janë dyert e pasme (*backdoors*) ose mekanizmat sekretë që anashkalojnë mbrojtjen kriptografike, pasi ato cenojnë besueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve.

Në këtë drejtim, *zbatimi i praktikave të hakerimit etik* dhe testimi të sigorisë luan një rol të rëndësishëm në identifikimin e cenueshmërive dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve kriptografike.

Një rëndësi të veçantë ka *sjellja etike e përdoruesve* të kriptografisë. Ata duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për rreziqet dhe implikimet gjatë zbatimit të mjeteve kriptografike përpara se të pranojnë përdorimin e tyre. Për të zvogëluar rrezikun e hyrjes së paautorizuar, përdoruesit duhet të kenë nivelin minimal të aksesit të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të tyre. Ndërgjegjësimi i përdoruesve për çështjet etike në kriptografi, nëpërmjet trajnimit dhe arsimimit, bën të mundur pajisjen e tyre dhe të individëve të veçantë me njohuritë e domosdoshme për të përdorur mjetet kriptografike në mënyrë të përgjegjshme.

Të drejtat digjitale për privatësi, siguri dhe liri të shprehjes në teknologjinë kibernetike nuk duhet të cenohen nga *keqpërdorimi i kriptografisë* për qëllime të tjera nga ato të synuara dhe ligjore, siç është fshehja e aktiviteteve të paligjshme ose jo etike. Këtu mund të përfshihen përdorimi i kriptimit për të fshehur përmbajtjen e mesazheve të paligjshme; përdorimi i certifikatave digjitale të vjedhura ose të rreme, për të imituar entitete legjitime dhe përdorimi i algoritmeve të kriptimit të dobëta ose të komprometuara që mund të thyhen lehtësisht. Disa lloje të tjera të keqpërdorimit të kriptografisë janë: hakerimi nëpërmjet *sulmit me forcë brutale* duke përdorur metodën e provës dhe gabimit për të thyer fjalëkalimet, kredencialet e hyrjes dhe çelësat e kriptimit; *sulmet njeriu-në-mes* ku një sulmues mund të kapë dhe modifikojë mesazhet ose të dhënat e kriptuara, të fitojë akses në informacione të ndjeshme dhe të injektojë përmbajtje dashakeqe në komunikim; *sulmet në kanalet anësore* të algoritmeve të kriptimit, ku sulmuesit mund të përdorin informacionin e rrjedhur nga zbatimi i algoritmit të kriptimit (siç është koha, konsumi i energjisë ose rrezatimi elektromagnetik) për të rikuperuar çelësin e kriptimit (duke shfrytëzuar mangësitë e gjenerimit të çelësave të dobët ose jo të rastësishëm ose të algoritmeve të kriptimit me strukturë të parashikueshme); *sulmet e krypto-mashtrimit* (kriptomonedhës dashakeqe), ku sulmuesit mund të futen dhe përdorin fuqinë përpunuese të pajisjeve të viktimës (desktop, laptop, telefona inteligjentë ose dhe serverë të rrjetit) për të marrë kriptomonedha, duke shfrytëzuar dobësitë në algoritmet e kriptimit të përdorura nga kriptomonedhat.

Përfundime

Kriptografia dhe siguria kibernetike janë dy komponentë kritikë të garantimit të sigurisë së të dhënave dhe informacionit digjital. Kriptografia luan një rol themelor në sigurinë kibernetike duke mbrojtur të dhënat nga qasja e paautorizuar, duke siguruar konfidencialitetin, integritetin, autenticitetin, disponueshmërinë dhe pamohueshmërinë e informacionit dhe ndërtuar besimin në sistemet digjitale.

Kriptografia pritet të bëhet edhe më e fuqishme me përparimin e inteligjencës artificiale dhe të pësojë ndryshime për t'i rezistuar fuqisë së kompjuterëve kuantikë. Pavarësisht zhvillimeve të shpejta dhe të shpeshta të metodave, mekanizmave dhe protokolleve kriptografike, siguria kibernetike do të vijojë të mbështetet gjithnjë e më shumë në kriptografi si një nga shtyllat më thelbësore për garantimin e mbrojtjes së aseteve digjitale.

Për të arritur nivelin e duhur të sigurisë kibernetike është e nevojshme të përzgjedhim dhe zbatojmë produktet e duhura kriptografike. Një rëndësi të veçantë për këtë ka zbatimi i standardeve të kriptografisë, të përcaktuara nga organizmat dhe kompanitë e specializuara ndërkombëtare dhe rajonale. Nëpërmjet zbatimit të këtyre standardeve do të mundësohet përzgjedhja e pajisjeve, algoritmeve dhe teknologjive më të mira dhe me kosto efektive dhe do të garantohet që produkti kriptografik është cilësor, i testuar, i vlerësuar dhe i certifikuar. Një teknologji kriptografike jashtë standardeve krijon probleme në sigurinë kibernetike edhe për shkak të mos ndërveprimit të produkteve të ndryshme që përdoren.

Drejtnesit dhe specialistët e strukturave të sigurisë kibernetike dhe të kriptografisë kanë përgjegjësi për zbatimin e të gjitha masave për mbrojtjen e të dhënave dhe të informacionit digjital. Në këtë kuadër, krahas të tjerave, i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë trajnimit të personelit për të njohur dhe zbatuar me rigorozitet teknologjitë, shërbimet dhe funksionalitetet e duhura për arritjen e sigurisë maksimale në sistemet e komunikimit dhe të informacionit.

Bibliografia:

1. Bebja, A. (1881). *Sipas "Journal des débats politiques et littéraires"*, 11 qershor 1881, f. 2. Burimi: Bibliothèque nationale de France.
2. Koçollari, I. (2017). *Ali Pasha përdorte kode shifrorë*. Arkivi i Ali Pashës, Vol. A. Gazeta Shqiptare, 10 dhjetor 2017.
3. Arkivi Qendror i Shtetit. (1912). *Fondi Ferit Vokopola*, nr. 42, dhjetor.
4. Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology. (2022). 20–22 qershor 2022, Amsterdam, f. 116.
5. Këshilli i Ministrave. (1949). *VKM, datë 30.12.1949: Instruksioni mbi shërbimin shifrar*.
6. Schoenmakers, B. (2025). *Lecture Notes Cryptographic Protocols*

- (Version 1.10), 7 shkurt 2025, f. 7.
7. PSSG. (2025). *Guidelines on cryptographic algorithms usage and key management*, EPC342-08/Version 15.0, 7 mars 2025, f. 10, 13, 40.
 8. Kerckhoffs, A. (1883). Artikuj në revistën *La cryptographie militaire*.
 9. ENISA. (2024). *Cryptographic products and services market analysis*, Version 1.0, gusht 2024, f. 25–26.
 10. Council of the EU. (2024). *List of approved cryptographic products (LACP) for protecting EU Classified Information (EUCI)*, Brussels, 30 shtator 2024, 9931/3/24 REV 3.
 11. NATO. *NATO Information Assurance Product Catalogue*. Marrë nga: <https://www.ia.nato.int/NIAPC>
 12. European Commission. (2024). *Recommendation “On a Coordinated Implementation Roadmap for the transition to Post-Quantum Cryptography”*, 11 prill 2024, C(2024) 2393 final.
 13. Këshilli i Ministrave. (2023). *VKM nr. 792, datë 28.12.2023: Për miratimin e Rregullores për sigurinë e informacionit të klasifikuar në Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI)*.
 14. Kuvendi i Shqipërisë. (2024). *Ligji nr. 25/2024: Për sigurinë kibernetike*, nenet 5, 21.
 15. Kuvendi i Shqipërisë. (2023). *Ligji nr. 10/2023: Për informacionin e klasifikuar*, nenet 3, 44–46, 49.
 16. Këshilli i Ministrave. (2022). *Strategjia Ndërsektorale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe Plani i Veprimit 2022–2026*, VKM nr. 370, datë 1.6.2022.
 17. Council of Europe. (2017). *Recommendation CM/Rec(2017)5 on standards for e-voting*.
 18. European Union. (2023). *Regulation (EU) 2023/1113 of the European Parliament and of the Council of 31 May 2023 “On information accompanying transfers of funds and certain crypto-assets”*. Official Journal of the European Union, L 150/1.
 19. European Union. (2022). *Directive (EU) 2022/2555 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2022 (NIS 2 Directive)*.
 20. European Commission. (2025). *Communication “On ProtectEU: a European Internal Security Strategy”*, 1 prill 2025, COM(2025) 148 final.
 21. Kuvendi i Shqipërisë. (2018). *Ligji nr. 46/2018: Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë*.
 22. Këshilli i Ministrave. (2024). *VKM nr. 511, datë 1.8.2024: Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së artikujve me përdorim të dyfishtë – Pjesa 2: Siguria e informacionit*.
 23. Kuvendi i Shqipërisë. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, neni 36.

RUBRIKA E TRETË

**ARSIMIMI USHTARAK,
LIDERSHIPI DHE ZHVILLIMI
PROFESIONAL**

Mësimdhënia e 'Anglishtes për Qëllime Ushtarake' dhe analiza e ligjërimit operacional: disa karakteristika leksikore dhe pragmatike

Dr. Alma VLADI,

Dr. Manjola LIKAJ

*Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Gjuhëve të Huaja,
Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA*

Trajtesë e shkurtuar

Ky artikull shkencor analizon disa nga karakteristikat leksikore dhe pragmatike të ligjërimit operacional në Anglishten për Qëllime Ushtarake (AQU), duke u përqendruar në implikimet didaktike për formimin gjuhësor të kadetëve në Akademinë e Forcave të Armatosura. Duke u mbështetur në një kuadër teorik që integron perspektivën e analizës kritike të ligjërimit të Fairclough (1992) me konceptin e pragmatikës në ligjërimit të Cutting (2015), artikulli argumenton se Anglishtja për Qëllime Ushtarake nuk mund të konceptohet, nga pikëpamja didaktike, si një listë leksikore me terminologji të izoluar, por duhet të kuptohet si një sistem pragmatik komunikimi i orientuar drejt veprimit operacional.

Studimi identifikon një prirje problematike në praktikën didaktike për ta trajtuar gjuhën ushtarake kryesisht si një inventar fjalësh të specializuara që ekzistojnë më vete, pa pasur nevojë për një sistem ku marrin kuptim të plotë, duke shpërfillur kështu dimensionin pragmatik dhe kontekstual të komunikimit. Ky dimension merr rëndësi të veçantë në kontekstin ushtarak, pasi komunikimi shpesh mbart peshën e suksesit ose dështimit të një misioni ushtarak.

Bazuar në analizën e karakteristikave gjuhësore dhe sociale, si urdhërorja e drejtpërdrejtë, strukturimi i informacionit sipas prioritetëve funksionale të komunikimit dhe roli përcaktues i kontekstit operacional, artikulli propozon një zhvendosje drejt modeleve të mësimdhënies të bazuara në situata

kontekstuale. Këto modele vendosin në qendër funksionet e gjuhës dhe rolet e saj sociale, në vend të një qasjeje të kufizuar të struktura thjesht leksikore.

Fjalë kyçe: Anglishtja për Qëllime Ushtarake, ligjërimit operacional, pragmatikë, analizë kritike e ligjërimit, mësimdhënie e gjuhës për qëllime specifike, kadet.

Hyrje

Komunikimi ushtarak përbën një nga format më të strukturuar dhe funksionale të komunikimit institucional. Në kontekstin e operacioneve moderne shumëkombëshe, veçanërisht brenda strukturave të NATO-s, gjuha angleze ka marrë rolin e një *lingua franca* operacionale, duke shërbyer jo vetëm si mjet komunikimi, por edhe si instrument koordinimi strategjik dhe operacional. Për këtë arsye, ligjërimit ushtarak në gjuhën angleze karakterizohet nga standardizim rigoroz, ekonomi gjuhësore, formalitet dhe qartësi pragmatike.

Kjo specifike e komunikimit ushtarak duhet të sjellë zhvendosjen e fokusit nga përvetësimi i thjeshtë i leksikut të izoluar drejt zhvillimit të kompetencës funksionale komunikuese në situata operacionale reale ose të simuluar. Megjithatë, praktikatat didaktike në mësimdhënien e Anglishtes për Qëllime Ushtarake (AQU) shpesh mbeten të kufizuara nga një qasje thjeshtuese, e cila përqendrohet kryesisht në listat e terminologjisë dhe strukturat e fjalive të standardizuara, duke e kufizuar ndjeshëm potencialin pragmatik dhe funksional të gjuhës. Kjo situatë kërkon një rishikim teorik të mënyrës se si konceptohet dhe zbatohet mësimdhënia e anglishtes ushtarake në nivel akademik, veçanërisht në procesin e formimit të kompetencës gjuhësore të kadetëve.

Në këtë kontekst, studimi synon të analizojë karakteristikat leksikore dhe pragmatike të ligjërimit operacional në anglishten ushtarake, me një fokus të veçantë në dimensionin didaktik të trajnimit të kadetëve në gjuhë operacionale. Analiza udhëhiqet nga një sërë pyetjesh kërkimore që shqyrtojnë mënyrën se si konceptohet dhe zbatohet mësimdhënia e AQU-së, shkallën në të cilën ajo trajtohet si sistem pragmatik komunikimi, tiparet leksiko-pragmatike të ligjërimit operacional, si dhe ndikimin e qasjeve didaktike në zhvillimin e kompetencës komunikuese operacionale.

Ndryshe nga komunikimi i përditshëm, komunikimi ushtarak është i orientuar drejt minimizimit të dykuptimësisë dhe maksimizimit të efikasitetit në situata ku koha, hierarkia dhe saktësia kanë rëndësi kritike. Komandat, raportet operacionale dhe formulat e standardizuara gjuhësore ndërtohen mbi parime funksionale që favorizojnë transmetimin e shpejtë, të qartë dhe të njëkuptimtë të informacionit. Në këtë kuptim, ligjërimit ushtarak

mund të konsiderohet një nënfushë e veçantë e komunikimit profesional dhe institucional, e karakterizuar nga rregulla dhe konventa pragmatike të mirëpërcaktuara.

1. Literatura

Koncepti i Anglishtes për Qëllime Specifike (Anglishtja për Qëllime Specifike – AQS) përfaqëson një qasje të konsoliduar në gjuhësinë e aplikuar, e cila e koncepton gjuhën jo si një sistem abstrakt dhe të përgjithshëm, por si një instrument funksional të orientuar drejt nevojave konkrete të përdoruesve në kontekste të caktuara profesionale dhe institucionale. Hutchinson dhe Waters (1987) theksojnë se AQU nuk kufizohet në përvetësimin e terminologjisë së specializuar, por përfshin përdorimin e gjuhës në mënyrë funksionale në situata reale komunikimi, ku forma gjuhësore është e pandashme nga qëllimi komunikativ dhe konteksti i përdorimit.

Brenda këtij kuadri, Anglishtja për Qëllime Ushtarake (AQU) pozicionohet si një nëndegë e AQS-së që trajton nevojat specifike gjuhësore të personelit ushtarak në kontekste operacionale, stërvitore dhe ndërkombëtare. Megjithatë, për të kuptuar natyrën komplekse të komunikimit operacional, nevojitet një kornizë teorike më e gjerë, e cila nuk kufizohet vetëm në analizën e nevojave gjuhësore. Komunikimi ushtarak nuk është thjesht çështje terminologjie, por një fushë ku ndërthuren në mënyrë të ngushtë pragmatika, marrëdhëniet e hierarkisë ushtarake dhe kërkesa e domosdoshme për eliminimin e dykuptimësisë. Për këtë arsye, ky studim mbështetet në një integrim kritik të teorisë së pragmatikës (Cutting, 2002; 2015) dhe analizës kritike të ligjëritimit (Fairclough, 1992; 1995), duke marrë në konsideratë si potencialin shpjegues të këtyre qasjeve, ashtu edhe kufizimet e tyre në raport me kërkesat strikte të komunikimit operacional, ku dykuptimësia nuk është thjesht problem interpretimi, por rrezik për funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës.

Pragmatika dhe problemi i dykuptimësisë në komunikimin ushtarak

Pragmatika, siç e trajton Cutting (2015), fokusohet në mënyrën se si kuptimi ndërtohet përmes ndërveprimit midis gjuhës dhe kontekstit. Koncepte themelore si aktet e të folurit i Austin, parimi i bashkëpunimit i Grice dhe teoria e mirësjelljes e Brown & Levinson, të gjithë të cituar te Cutting (2015) ofrojnë mjete analitike për të kuptuar funksionimin e komunikimit në situata të ndryshme sociale.

Megjithatë, në kontekstin ushtarak, këto kategori pragmatike përballen me një problematikë të veçantë. Siç vëren Cutting (2015), në komunikimin e përditshëm aktet e të folurit karakterizohen shpesh nga dykuptimësia ose ambivalenca, ku kuptimi mbetet i hapur ndaj interpretimit dhe varet nga

faktorë kontekstualë dhe ndërveprues. Ky fleksibilitet semantik është tipar i natyrshëm i gjuhës.

Megjithatë, në mjedisin operacional ushtarak ky nivel dykuptimësie përbën rrezik të drejtpërdrejtë funksional. Një urdhër i paqartë, një raport i dykuptimtë apo një komunikim në radio i hapur ndaj interpretimeve të shumta mund të ketë pasoja serioze operationale dhe strategjike. Për këtë arsye, një nga karakteristikat themelore të ligjërimit ushtarak është reduktimi sistematik i dykuptimësisë dhe minimizimi i hapësirës për interpretim.

Ky rregull operacional materializohet përmes standardizimit të gjuhës në dokumente dhe protokolle si Marrëveshjet e Standardizimit të NATO-s (STANAG-ët), ku leksiku, sintaksa dhe strukturat komunikative janë të kodifikuara në mënyrë të tillë që të prodhojnë një interpretim të vetëm, të qartë dhe të parashikueshëm. Në këtë kuptim, komunikimi ushtarak përfaqëson një rast ekstrem të disiplinimit pragmatik të gjuhës, ku qëllimi kryesor nuk është shprehja e hapur e kuptimeve të shumëfishta, por garantimi i përçimit sa më të drejtpërdrejtë midis mesazhit dhe veprimit operacional.

Qasja kritike e Fairclough: Ligjërimi si praktikë sociale

Pragmatika ofron mjete të rëndësishme për analizën e kuptimit në kontekst, por ajo nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme mënyrës se si marrëdhëniet e hierarkisë dhe strukturat sociale formësojnë dhe kufizojnë praktikën ligjërimore. Në këtë drejtim, analiza kritike e ligjërimit e Fairclough (1992) ofron një kornizë themelore. Fairclough e konceptualizon ligjërimin si praktikë sociale, e cila realizohet njëkohësisht si tekst, praktikë ligjërimore dhe praktikë sociale. Ky model tredimensional është veçanërisht i përshtatshëm për analizën e komunikimit ushtarak, ku hierarkia, pushteti dhe struktura e komandës janë elementë përbërës të vetë ligjërimit.

Sipas Fairclough (1992), ligjërimi kontribuon në ndërtimin e identiteteve shoqërore (p.sh. nënoficer, komandant), marrëdhënieve sociale (hierarkia, kohezioni i njësisë ushtarake) dhe sistemeve të njohurive dhe besimeve (doktrina, protokollat operationale). Në këtë kuptim, ligjërimi nuk është pasqyrim neutral i realitetit, por një mekanizëm aktiv që e prodhon dhe e organizon atë. Gjuha operationale në këtë rast dikton realitetin social në të cilin ushtarakët mund ta gjejnë shpesh veten.

Megjithatë, qasja e Fairclough dhe gjuhësia kritike kanë edhe kufizime. Vetë Fairclough thekson se disa forma të analizës kritike nuk e shpjegojnë mjaftueshëm se si pushteti ndikon realisht në mënyrën e përdorimit të gjuhës. Kjo qasje e Fairclough nuk e merr plotësisht parasysh idenë e M. A. K. Halliday (1973) se gjuha formësohet nga funksioni që ajo ka në shoqëri. Si

rezultat, ekziston rreziku që lidhja midis gjuhës dhe strukturave shoqërore të shihet tepër e thjeshtuar.

Një kufizim tjetër i rëndësishëm, me rëndësi të drejtpërdrejtë për këtë studim, ka të bëjë me trajtimin e funksioneve të shprehjeve. Siç vëren Fairclough (f. 15), analiza shpesh kërkon t'u caktojë funksione të qarta shprehjeve që në praktikë janë të hapura për interpretim. Në pragmatikë, shprehjet nuk janë thjesht të paqarta, por shpesh edhe vazhdimisht shumëkuptimëshe, duke e bërë interpretimin të varur nga konteksti dhe perspektiva e analistit.

Në komunikimin ushtarak, kjo ambivalencë përbën problem themelor, pasi sikurse e kemi theksuar edhe më sipër, është e papranueshme që urdhrat ose raportet të mbeten të hapura ndaj interpretimeve të shumëfishta. Ndërsa në analizën teorike të ligjërimit kjo ambivalencë mund të konsiderohet një realitet përshkruar në gjuhës, në praktikën operacionale ajo bëhet një rrezik funksional. Prandaj, standardizimi gjuhësor në strukturat ushtarake është përgjigjja institucionale ndaj kësaj veçorie të gjuhës natyrore, duke synuar të eliminojë ambivalencën përmes kodifikimit të rreptë të formave dhe funksioneve gjuhësore.

Një element i rëndësishëm i kësaj qasjeje është edhe ai i marrëdhënieve sociale të trajtuara nga Fairclough. Në kontekstin ushtarak, marrëdhënia më thelbësore sociale është hierarkia, zinxhiri i komandimit dhe protokollet e komunikimit, të cilat nuk janë vetëm struktura organizative, por edhe forma ligjërimore që prodhojnë dhe riprodhojnë marrëdhënie pushteti. Gjuha e përzgjedhur tregon varësi sociale ose pushtet, vendimmarrje ose zbatim.

Në këtë mënyrë, format gjuhësore që i përkasin mënyrës urdhërore të komunikimit (p.sh., *At ease!*- *Qetësohu!*), dominimi i komandës së drejtpërdrejtë (p.sh. *Secure perimeter immediately!* – *Siguro menjëherë perimetrin!*) dhe zvogëlimi i formave gjuhësore të kortezi së sociale në komunikim (p.sh. *“Open gate!”* në vend të *“Could you open the gate?”*) midis gradave të ndryshme nuk janë thjesht zgjedhje stilistike, por shfaqje të institucionalizuara të pushtetit brenda ligjërimit.

Integrimi kritik: drejt një kuadri analitik të ligjërimit operacional

Bazuar në qasjet e diskutuara më sipër, ky artikull propozon një kornizë teorike të integruar për analizën e ligjërimit operacional në anglishten ushtarake, të ndërtuar mbi tri shtylla kryesore.

Së pari, pragmatika (Cutting, 2015) ofron mjetet për analizën e akteve të të folurit, parimin e bashkëpunimit dhe mirësjelljes. Megjithatë, në kontekstin ushtarak këto mekanizma nuk funksionojnë spontanisht, por janë të institucionalizuara dhe të standardizuara për të minimizuar dykuptimësinë

dhe për të garantuar një interpretim të vetëm funksional.

Së dyti, analiza kritike e ligjërimit (Fairclough, 1992) ofron një kuptim të ligjërimit si praktikë sociale dhe konceptit të ndërthurjes së ligjërimeve. Megjithatë, kjo qasje kërkon kujdes metodologjik për të shmangur reduktimin e marrëdhëniet sociale në deduksione të drejtpërdrejta nga format gjuhësore. Për këtë arsye, analiza duhet të bazohet në kontekstin institucional dhe procedurat e standardizuara, jo në korrespondencat automatike të supozuara midis gjuhës dhe strukturës shoqërore.

Së treti, nga Foucault dhe Halliday (cituar nga Fairclough, 1992) merret parimi se gjuha formësohet nga funksioni i saj në strukturën shoqërore. Në ligjërimin ushtarak, ky funksion është koordinimi i veprimit në situata me rrezik të lartë, gjë që shpjegon dominimin e strukturave të standardizuara, ekonomisë gjuhësore dhe formave urdhërore të komunikimit.

Komunikimi në NATO si përgjigje ndaj ambivalencës

Në strukturat shumëkombëshe të NATO-s, komunikimi ushtarak ndërtohet mbi parimet e standardizimit dhe ndërveprimit gjuhësor, me qëllim sigurimin e koordinimit efektiv midis forcave të ndryshme kombëtare. Në këtë kontekst, anglishtja operationale funksionon si një sistem komunikimi i kodifikuar, i orientuar drejt minimizimit të dykuptimisë dhe maksimizimit të qartësisë.

Standardizimi përmes Marrëveshjeve të Standardizimit të NATO-s (STANAG) përfaqëson një mekanizëm institucional që synon të neutralizojë ambivalencën e natyrshme të gjuhës. Ai krijon një kornizë ku marrëdhënia midis formës gjuhësore dhe funksionit operacional është e paracaktuar dhe e parashikueshme.

Në këtë kuptim, koncepti i “kuptimit të përbashkët operacional” nuk përfaqëson thjesht një marrëveshje leksikore, por një sistem të unifikuar interpretimi, ku mesazhet kuptohen në të njëjtën mënyrë, pavarësisht dallimeve gjuhësore dhe kulturore. Ky është thelbi i ndërveprimit gjuhësor në kontekstin ushtarak bashkëkohor.

2. Karakteristikat leksikore të ligjërimit operacional

Në traditën e analizës kritike gjuhësore (Fairclough, 1992), leksiku i një fushe të caktuar pasqyron sistemet e klasifikimit ideologjik. Ligjërimi ushtarak operacional karakterizohet nga disa karakteristika të dallueshme leksikore.

Terminologjia dhe akronimet

Komunikimi operacional mbështetet në leksik të kodifikuar që i shërben qëllimeve të saktësisë dhe efikasitetit. Halliday (1978) argumenton se përsëritja e vazhdueshme e fjalëve të caktuara në një ligjërim nuk është rastësore. Ajo tregon rëndësinë që institucioni social që i përdor ato i jep një fushe të caktuar, fenomen të cilin Halliday e ka quajtur “mbi-leksikalizim” (f. 165) Shembuj

tipikë përfshijnë terma të tillë si *mission, target, engagement, deployment, rules of engagement* ose *operational readiness*.

Përdorimi i përhapur i akronimeve në ligjërimin ushtarak krijon kufij midis “brenda” dhe “jashtë” komunitetit ligjërimor - njohja e tyre shërben si një shënues i përkatësisë profesionale dhe kompetencës operationale (*ROE (Rules of Engagement), SOP (Standard Operating Procedures), CAS (Close Air Support)*)).

Shndërrimi i foljeve në emra dhe përdorimi i formës joveprore të foljes

Siç vëren Fairclough (1992), nominalizimi (shndërrimi i foljeve të veprimit në emra) dhe përdorimi i strukturave joveprore lejojnë fshirjen e vepruesit dhe paqartësi në lidhje me përgjegjësinë. Disa shembuj të kësaj strategjie ligjërimore që e largon vëmendjen nga veprimi njerëzor janë p.sh., *The target was neutralized; Collateral damage occurred during the strike*.

Nominalizime të tjera përfshijnë p.sh., *deconfliction* (në vend të “*resolve conflict*”), *targeting* (në vend të “*select and engage targets*”) dhe *force protection* (në vend të “*protecting forces*”). Këto forma leksikore lejojnë një shkallë abstraksioni që është funksionale për planifikimin dhe koordinimin operational, por ato gjithashtu mund të kenë pasoja pragmatike për mënyrën se si kuptohen përgjegjësia dhe veprimi.

Njësi fikse dhe fraza të standardizuara

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme leksikore e ligjëritimit operational është përdorimi i njësisë fikse dhe frazave të standardizuara. Shembujt përfshijnë *Say again* (në vend të “*Please repeat*”), *Copy that, Wilco, Over and Out* në komunikimin radio. Këto forma të kondensuara gjuhësore optimizojnë komunikimin për qartësi dhe efikasitet në situata me presion kohor.

3. Karakteristikat pragmatike të ligjëritimit operational **Gjuha komanduese dhe mënyra urdhërore**

Një nga karakteristikat më të spikatura të ligjëritimit operational është dominimi i funksionit komandues në gjuhë. Në këtë kontekst, gjuha kryen akte të drejtpërdrejta komandimi, ku modaliteti i komandës është i qartë, i pakushtëzuar dhe i orientuar drejt veprimit të menjëhershëm. Shembuj përfshijnë forma të tilla si:

- *Move to Checkpoint Bravo!*
- *Report your position!*
- *Maintain radio silence!*
- *Break contact / Disengage!*

Në pragmatikë, ky fenomen lidhet me teorinë e akteve të të folurit, ku urdhri nuk është vetëm një deklaratë, por një akt që synon të prodhojë një veprim konkret. Kjo shoqërohet me ekonominë gjuhësore, ku shprehjet janë të shkurtra, të kondensuara dhe të optimizuara për situata me presion të lartë kohor.

Në kontekstin e hierarkisë ushtarake, mungesa e mirësjelljes në format komanduese nuk është mungesë etike sociale. Përkundrazi, ajo pasqyron natyrën e marrëdhënieve të pushtetit. Siç argumenton Fairclough (1992: 162-166), këto forma gjuhësore janë të kodifikuara dhe të pritura dhe kjo reflektohet në mjedisin ushtarak, ku qartësia dhe shpejtësia e ekzekutimit janë përparësi.

Strukturimi i informacionit sipas përparësisë funksionale

Një tjetër karakteristikë thelbësore e ligjërimit operacional është mënyra se si organizohet informacioni. Mesazhi është strukturuar sipas parimit të përparësisë funksionale, ku elementët më të rëndësishëm komunikohen të parët (“çfarë ka rëndësi së pari”). Ky organizim lidhet me nevojën për vendimmarrje të shpejtë dhe ngarkesë të reduktuar njohëse në situata operationale.

Në raportet e situatës (SITREP) dhe raportet e statusit (STATREP), informacioni është i organizuar sipas një protokolli të standardizuar:

- identifikimi i njësive (*callsigns*)
- pozicioni (*grid reference*)
- aktiviteti (*movement/action*)
- vlerësimi i forcës (*strength estimation*)
- mbyllja e komunikimit (*Over*)

P.sh. : “*One Zero, this is Three Zero. Enemy infantry, grid 123456, moving north, strength estimated one platoon. Over.*”

Elementet jo-thelbësore minimizohen ose eliminohen, duke krijuar një formë komunikimi të optimizuar për efikasitet dhe qartësi. Kjo pasqyron atë që Fairclough (1992) e quan “teknologjizimi i ligjërimit” - zbatimi sistematik i parimeve të efikasitetit në formën gjuhësore.

Interpretimi i kontekstit operacional

Konteksti operacional luan një rol përcaktues në interpretimin e mesazhit. Sipas perspektivës së Fairclough, kuptimi i ligjërimit nuk mund të ndahet nga situata shoqërore dhe institucionale në të cilën prodhohet. Në mjedisin ushtarak, kjo merr formën e një “ndërgjegjësimi të përbashkët për situatën”, ku pjesëmarrësit në komunikim ndajnë një kuptim të përbashkët të situatës operationale.

Kjo nënkupton që kuptimi nuk kodifikohet vetëm në gjuhë, por ndërtohet

përmes njohurive të përbashkëta të kontekstit, rolit dhe qëllimit operacional. Për shembull, urdhri “*Cover that door!*” nuk mund të kuptohet pa njohuri për paraqitjen fizike të hapësirës, pozicionin e folësit dhe dëgjuesit dhe rreziqet e mundshme. Pa këtë bazë të përbashkët, edhe mesazhet e standardizuara mund të keqinterpretohen.

4. Kufizimet pedagogjike të mësimdhënies së AQU bazuar vetëm në lista terminologjike

Një problem i rëndësishëm në mësimdhënien tradicionale të Anglishtes për Qëllime Ushtarake është tendenca për ta reduktuar gjuhën në lista leksikore dhe fjalorë terminologjikë. Kjo qasje “e bazuar në fjalor” e trajton gjuhën si një inventar të njësive të izoluar, të cilat duhet të mësohen përmendësh, pa qenë domosdoshmërisht të lidhura me funksionin e tyre komunikues.

Ky problem mund të analizohet në disa dimensione:

Së pari, qasja leksikore e izoluar nuk arrin të zhvillojë kompetencën pragmatike të kadetëve, aftësinë për të përdorur gjuhën në situata reale operacionale. Rreziku kryesor është të mësuarit mekanik të termave, pa kuptuar se si funksionojnë ato në ligjërime dhe bashkëveprim.

Së dyti, kjo qasje krijon një shkoputje midis formës gjuhësore dhe praktikës shoqërore. Nga perspektiva e Fairclough, gjuha reduktohet nga një instrument veprimi në një objekt të memorizimit. Kjo bie ndesh me natyrën e anglishtes ushtarake si një sistem komunikimi i orientuar drejt veprimit.

Së treti, qasja leksikore neglizhon rolin e kontekstit operacional në prodhimin dhe interpretimin e kuptimit. I njëjti term mund të ketë implikime të ndryshme pragmatike në varësi të situatës, rolit të pjesëmarrësve dhe qëllimit komunikues.

Së katërti, mbështetja e tepërt në memorizimin e terminologjisë mund të krijojë një iluzion të kompetencës gjuhësore. Një kadet mund të dijë një numër të madh termash ushtarakë pa qenë në gjendje të marrë pjesë në mënyrë efektive në një komunikim të simuluar radio ose në një ushtrim operacional.

Ky problem është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e trajnimit gjuhësor të kadetëve, ku objektivi përfundimtar nuk është njohja pasive e fjalorit, por aftësia për të vepruar përmes gjuhës në situata dinamike ku kryefjala duhet të jetë ndërveprueshmëria mes forcave të ndryshme ushtarake.

5. Disa aspekte didaktike për mësimdhënien e AQU-së

Nga analiza e mësipërme është e qartë se mësimdhënia e anglishtes për qëllime ushtarake duhet të orientohet drejt zhvillimit të kompetencës komunikuese operacionale, dhe jo vetëm të njohurive terminologjike. Kjo nënkupton një zhvendosje nga qasjet tradicionale drejt modeleve të të mësuarit të bazuara në detyra/skenare.

Simulimet operacionale dhe loja me role

Një rol qendror në këtë proces luajnë simulimet operacionale dhe loja me role, të cilat i vendosin kadetët në situata të ngjashme me realitetin operacional. Në këto simulime, kadetët detyrohen të përdorin gjuhën si një mjet veprimi dhe jo si një objekt analize.

Simulimet mund të përfshijnë komunikimin me radio në postet e komandës, koordinimin midis patrullave, raportimin e kontakteve të armikut, menaxhimin e situatave të krizës dhe bashkëpunimin në strukturat shumëkombëshe. Këto aktivitete zhvillojnë aftësi pragmatike që janë thelbësore për funksionimin efektiv në mjedise reale operacionale.

Integrimi i kontekstit pragmatik në mësimdhënie

Integrimi i kontekstit pragmatik në mësimdhënie është thelbësor për zhvillimin e aftësisë së interpretimit të situatës dhe përzgjedhjes së duhur të terminologjisë dhe funksioneve gjuhësore. Kjo përfshin jo vetëm të mësuarit e asaj që thuhet, por edhe atë që nënkuptohet në kontekste të caktuara.

Mësimdhënia duhet të trajtojë gjuhën si praktikë funksionale në kontekste reale operacionale. Kjo nënkupton që studentët duhet të angazhohen në analizën e akteve të folurit në situata autentike ushtarake, ku kuptimi i një urdhri, raporti apo komunikimi varet nga konteksti, qëllimi dhe marrëdhënia ndërmjet pjesëmarrësve. Një fjali në kontekstin ushtarak nuk nënkupton thjesht dhe vetëm formën e saj gjuhësore, por mbi të gjitha funksionin e saj pragmatik me pasojat reale në terren (p.sh., urdhër, paralajmërim, raportim).

Zhvillimi i “kuptimit të përbashkët operacional”

Në kontekstin e operacioneve shumëkombëshe dhe standardizimit të NATO-s, zhvillimi i “kuptimit të përbashkët operacional” duhet të jetë një objektiv qendror. Kjo përfshin jo vetëm njohuritë e termave të standardizuara, por edhe aftësinë për të prodhuar dhe interpretuar mesazhe në mënyrë konsistente brenda kornizës pragmatike të NATO-s.

Aktivitetet e të nxënit mund të përfshijnë analizën e STANAG-ëve, praktikën e komunikimit sipas procedurave standarde të NATO-s dhe simulime të përbashkëta me kadetë nga vende të tjera. Kjo ndihmon në ndërtimin e një kuptimi të përbashkët që tejkalon ndryshimet kulturore dhe gjuhësore.

Nga terminologjia në kompetencën operacionale komunikuese

Kalimi nga “terminologjia e mësuar përmendësh” në “kompetencën operacionale komunikuese” duhet të jetë objektivi kryesor i trajnimit gjuhësor të kadetëve. Kjo nënkupton një ndryshim në mënyrën e vlerësimit - nga testet

e fjalorit dhe gramatikës në vlerësimin e performancës në situata të simuluar operacionale.

Vlerësimi mund të përfshijë simulime të komunikimit me radio, lojëra rolesh në postet e komandës, raporte me shkrim të operacioneve dhe pjesëmarrje në stërvitje të përbashkëta. Kriteret e vlerësimit duhet të përfshijnë jo vetëm saktësinë gjuhësore, por edhe qartësinë, shpejtësinë e reagimit, përdorimin e formave të standardizuara dhe efektivitetin komunikues në situata stresuese.

Përfundime dhe rekomandime për hulumtime të mëtejshme

Ky artikull ka argumentuar se anglishtja ushtarake nuk duhet të kuptohet thjesht si një sistem leksikor i specializuar, por si një sistem komunikimi pragmatik i orientuar drejt veprimit operacional. Duke u mbështetur në qasjet e Cutting ndaj pragmatikës dhe qasjet e Fairclough ndaj ligjërimit si një praktikë shoqërore, u theksua se kuptimi i gjuhës ushtarake ndërtohet në bashkëveprim me kontekstin operacional dhe strukturat institucionale.

Analiza ka identifikuar disa karakteristika kryesore të ligjërimit operacional në anglishten ushtarake. Në nivelin leksikor, këto përfshijnë terminologji dhe akronime të specializuara, shndërrim të foljeve në emra dhe formën joveprorë të foljeve, si dhe njësi fikse dhe fraza të standardizuara. Në nivelin pragmatik, karakteristikat kryesore përfshijnë dominimin e funksionit gjuhësor komandues dhe urdhëror, strukturimin e informacionit sipas përparësisë funksionale, rolin përcaktues të kontekstit operacional.

Një problem i rëndësishëm i identifikuar në praktikatat aktuale didaktike është tendenca për ta reduktuar anglishten ushtarake në lista leksikore dhe terminologji të izoluar. Kjo qasje është e kufizuar sepse nuk zhvillon kompetencën pragmatike të kadetëve, krijon shkëputje midis formës gjuhësore dhe praktikës shoqërore, neglizhon rolin e kontekstit dhe mund të krijojë një iluzion të kompetencës gjuhësore.

Në kontekstin e NATO-s dhe mësimdhënies së kadetëve në Akademinë e Forcave të Armatosura, qasja e propozuar është me rëndësi të veçantë për përmirësimin e efikasitetit komunikues dhe ndërveprimit gjuhësor. Rekomandimet didaktike përfshijnë zhvillimin e simulimeve operacionale dhe lojërave me role, integrimin e kontekstit pragmatik në mësimdhënie, fokusin në zhvillimin e “kuptimit të përbashkët operacional” dhe kalimin drejt vlerësimit të kompetencës komunikuese operacionale në vend të njohurive terminologjike.

Në vijim, kërkime të mëtejshme mund të përqendrohen në disa drejtime. *Së pari*, studime empirike që analizojnë praktikatat aktuale të mësimdhënies së AQU-së në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe i krahasojnë ato me

praktikat në vendet e tjera të NATO-s. *Së dyti*, analiza ligjërimore e korpuseve autentike të komunikimit operacional në anglisht, për të identifikuar modele specifike pragmatike dhe leksikore. *Së treti*, studime pragmatike të ndërveprimit në situata operationale të simuluar, duke përfshirë analizën e keqkuptimeve dhe strategjitë e riparimit komunikues. *Së katërti*, zhvillimi dhe vlerësimi i modeleve të avancuara didaktike për AQU, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të realitetit virtual dhe simulimeve kompjuterike. *Së pesti*, kërkime mbi ndryshimet në ligjërimin ushtarak në epokën e luftës kibernetike, si dhe ndikimin e mediave sociale në komunikimin ushtarak.

Bibliografia

1. Cutting, J. (2015). *Pragmatics and Discourse* (2nd ed.). Routledge.
2. Fairclough, N. (1992). *Discourse and Social Change*. Polity Press.
3. Fairclough, N. (1995). *Critical Discourse Analysis*. Longman.
4. Halliday, M. A. K. 1973. *Explorations in the Functions of Language*. London: Edward Arnold
5. Halliday, M. A. K. 1978. *Language as Social Semiotic: The Social Interpretation of Language and Meaning*. London: Edward Arnold
6. Hutchinson, T., & Waters, A. (1987). *English for Specific Purposes*. Cambridge University Press.
7. NATO Standardization Office. (various publications). *Standardization Agreements (STANAGs)*.
8. Searle, J. R. (1969). *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*. Cambridge University Press.

Inteligjenca artificiale në arsimin ushtarak: perceptimet dhe përdorimi nga studentët dhe stafi pedagogjik

Nënkolonel Mazllum ALLA

*Kërkues për studime dhe analizë strategjike,
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA*

Trajtesë e shkurtuar

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale Gjeneruese (GenAI) në arsimin ushtarak përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në mënyrën se si prodhohet, shpërndahet dhe përdoret njohuria në mjediset tona akademike. Ky studim synon të ofrojë një panoramë të thjeshtë mbi përdorimin e GenAI në tre institucione: Akademinë e Forcave të Armatosura, Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe Qendrën e Gjuhëve. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësi anonim me 10 pyetje të mbyllura, duke përfshirë dy pyetje me shumë zgjedhje për mjetet dhe qëllimet e përdorimit.

Analiza bazohet në përgjigjet e 104 pjesëmarrësve (studentë, kursantë dhe pedagogë), duke ofruar një pamje krahasuese ndërinstitutionale. Rezultatet tregojnë se mjetet e GenAI përdoren në të tre institucionet. ChatGPT rezultoi si mjeti më i përdorur në të gjitha rastet, ndërsa Gemini dhe Copilot u raportuan në shkallë më të vogël. Përdorimi ditor dhe javor është më i përhapur, ndërsa qëllimi i përdorimit është kryesisht për mësim dhe krijim materiali. Trajnimi dhe rregulloret për përdorimin e IA-së mungojnë plotësisht. Pjesëmarrësit shprehin perceptime pozitive për ndikimin e GenAI në arsim. Gjetjet orientojnë drejtimit e ardhshme të kërkimit dhe zbatimet praktike. Studimi rekomandon hartimin e udhëzimeve institucionale, zhvillimin e moduleve dhe trajnimit, duke synuar një integrim efektiv dhe të përgjegjshëm të GenAI në arsimin tonë ushtarak.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale; GenAI; ChatGPT; Copilot; arsim ushtarak; integritet akademik.

Hyrje

Përdorimi i gjerë i Inteligjencës Artificiale (IA) në jetën e përditshme paraqet një kapitull të ri në historinë e njerëzimit, duke përfshirë thuajse të gjitha fushat e jetës nga komunikimi, arsimi, kujdesi shëndetësor etj. Ai është bërë një trend që ka përfshirë masivisht gjithë njerëzimin. Madje njerëzit gjithnjë e më shumë e gjejnë ChatGPT-në si këshilltar edhe për shqetësimet e tyre shëndetësore, ndonëse informacionet e marra nga IA ende nuk janë të testuara dhe të besueshme.¹ Aftësia për të krijuar përmbajtje krejtësisht të re ka ndryshuar plotësisht mënyrën se si ndërveprojmë me teknologjinë dhe informacionin. Integrimi i Inteligjencës Artificiale Gjeneruese (GenAI) në arsim përfaqëson një ndryshim rrënjësor, pasi ka revolucionarizuar mësimdhënien dhe të mësuarit.

Përdorimi në arsim i inteligjencës artificiale po rritet me ritme shumë të shpejta. Ai është shndërruar nga një koncept teorik në një realitet praktik, duke ndikuar thellësisht në mënyrën e të mësuarit dhe të mësimdhënies. Mjetet e GenAI po ndryshojnë mënyrën *se si prodhohet, shpërndahet dhe përdoret njohuria në mjediset akademike*. ChatGPT dhe platformat e tjera të bazuara në modele të mëdha gjuhësore (LLM) kanë bërë të mundur asistencë të menjëhershme në shkrim, përmbledhje, kërkim dhe krijim materiali mësimor etj. Këto zhvillime ofrojnë mundësi të reja pedagogjike – personalizim të mësimit, përshpejtim të përgatitjes së materialeve dhe mbështetje për kërkimin shkencor – por ngrenë edhe sfida të rëndësishme lidhur me integritetin akademik, sigurinë e të dhënave dhe përshtatjen e metodave të vlerësimit. Kjo përhapje e shpejtë e inteligjencës artificiale dhe përdorimi i saj i gjerë, po e bën gjithmonë e më të nevojshme rregullimin e saj edhe në institucionet tona arsimore – me fokus përdorimin etik, pedagogjik dhe praktik të Inteligjencës Artificiale (AI) në procesin mësimor.

Duhet theksuar se sistemi i arsimit ushtarak ka një traditë të të qenët i ngurtë dhe tepër i përqendruar në mësimdhënie të udhëhequr nga pedagogu dhe në kurrikula ku shpesh mungon përdorimi i teknologjisë. GenAI jo vetëm që sfidon sistemin, por edhe na fton të reflektojmë mbi atë që duhet të ruajmë dhe çfarë duhet të rimendojmë apo ndryshojmë. Arsimi ushtarak, si një hapësirë ku inovacioni është i domosdoshëm, mund të përfitojë ndjeshëm nga integrimi i IA-së. Megjithatë përdorimi i IA-së në arsimin ushtarak është ende në një fazë të hershme, ajo ka filluar të jetë pjesë në nivele të ndryshme arsimore, duke kërkuar përshtatje të metodave të mësimdhënies dhe të të nxënit.

¹ Don Nutbeam, “Artificial intelligence and health literacy—proceed with caution,” Health Literacy and Communication Open 1, no. 1 (2023), në: <https://doi.org/10.1080/28355245.2023.2263355>

Arsimi ushtarak ka karakteristika dhe kërkesa të veçanta që e bëjnë studimin e përdorimit të GenAI veçanërisht të rëndësishëm. Përveç objektivave të zakonshëm akademikë, programet ushtarake duhet të mbrojnë informacionet e ndjeshme, të ruajnë standarde të larta etike dhe të sigurojnë që aftësitë praktike dhe vendimmarrja kritike të mos zëvendësohen nga varësia ndaj mjeteve automatike. Në këtë kontekst, njohja e perceptimeve dhe praktikave të studentëve dhe stafit pedagogjik lidhur me GenAI është e domosdoshme për hartimin e politikave dhe programeve që mbështesin përdorimin e përgjegjshëm dhe efektiv të teknologjisë. Konteksti specifik, së bashku me mungesën e studimeve në këtë fushë, përbën motivimin kryesor për realizimin e këtij punimi.

Ky studim synon të analizojë përdorimin dhe perceptimet e GenAI në tre institucione të arsimit ushtarak: Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA), Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), dhe Qendrën e Gjuhëve (QGJ). Pyetjet kërkimore që udhëheqin këtë punim janë:

- Cili është niveli i përdorimit të GenAI në këto institucione dhe cilat mjete përdoren më shpesh?
- Për çfarë qëllimesh përdoret GenAI nga studentët, kursantët dhe pedagogët?
- Si perceptohet ndikimi i GenAI në procesin e të nxënës dhe mësimdhënies dhe a duhet të lejohet përdorimi i saj në arsimin ushtarak?

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë mënyrat e përdorimit dhe perceptimet ndaj GenAI në institucionet tona arsimore, si dhe të formulojë rekomandime praktike për politika, trajnime dhe programe mësimore. Analiza synon gjithashtu të evidentojë boshllëqet ndërmjet praktikave aktuale dhe kuadrit institucional ekzistues, duke ofruar udhëzime për integrimin efektiv të IA-së në programet e arsimit. Duke ndërthurur të dhëna përshkruese me interpretimin e implikimeve pedagogjike, ky punim mbështet drejtuesit e institucioneve dhe hartuesit e politikave në menaxhimin e përdorimit të mjeteve të GenAI në kontekstin e arsimit ushtarak.

1. Shqyrtimi i literaturës:

Integrimi i IA-së në arsimin ushtarak

Literatura ndërkombëtare mbi përdorimin e Inteligjencës Artificiale në arsimin ushtarak ka njohur një rritje të ndjeshme vitet e fundit, duke u shndërruar në një fushë të rëndësishme kërkimi dhe studimi. Autorë të ndryshëm kanë analizuar potencialin e mjeteve të IA-së për të transformuar mësimdhënien dhe të mësuarit, por njëkohësisht kanë ngritur shqetësime mbi rreziqet dhe sfidat që lidhen me përdorimin e tyre.

Adam T. Biggs, në artikullin *“Enhancing Professional Military Education*

with AI”², ofron një analizë praktike dhe të orientuar drejt përfshirjes së mjeteve të IA-së brenda kurrikulave të arsimit ushtarak profesional. Biggs argumenton se GenAI mund të ofrojë mësim të personalizuar për studentët, të automatizojë detyrat administrative që konsumojnë kohë, duke liruar instruktorët për aktivitetet me vlerë shtesë pedagogjike si dhe të përmirësojë ndjeshëm krijimin e skenarëve të stërvitjes. Megjithatë, ai thekson se këto përfitime mund të realizohen vetëm nëse integrimi shoqërohet me udhëzime të qarta, trajnime specifike për instruktorët dhe mekanizma që ruajnë rolin qendror të njeriut në vlerësim dhe vendimmarrje. Rekomandimet e tij përfshijnë pilotime të kontrolluara, module trajnime për përdorim praktik dhe politika që adresojnë çështjet e përgjegjësisë dhe sigurinë e të dhënave.

Në të njëjtën linjë, Matthew Woessner, në *“A guide to collaborating with AI in the military classroom”*, ofron një udhëzim praktik për instruktorët që duan të përdorin IA si partner pedagogjik pa humbur kontrollin profesional. Ai paraqet shembuj konkretë sesi IA mund të përdoret për përmbledhje të literaturës, gjenerim pyetjesh diskutimi, dhe raport paraprak mbi punime (ese) apo projekte, por paralajmëron kundër dorëzimit të plotë të rolit mësimor tek mjetet e IA-së. Woessner thekson praktika të mira—si përcaktimi i qartë i pritshmërive, kërkitimi i verifikimit të burimeve dhe integrimi i detyrave që kërkojnë reflektim kritik mbi materialet e IA-së—dhe sugjeron se pedagogët duhet të trajnohen për të përdorur IA-në si një mjet që forcon procesin mësimor dhe jo që zëvendëson atë.

Nga ana tjetër James Lacey, në shkrimin e tij *“Transitioning Professional Military Education to All AI, All the Time”*³, propozon një vizion më ambicioz dhe transformues për adoptimin e gjerë të IA-së në arsimin ushtarak profesional. Lacey argumenton se një integrim i thellë i IA-së mund të rrisë efikasitetin, të transformojë metodat e mësimdhënies dhe të përshpejtojë zhvillimin e kompetencave të reja, por pranon se kjo kërkon ndryshime strukturore, investime në infrastrukturë të sigurt dhe menaxhim të kujdesshëm të rreziqeve. Ai nxit për pilotime të mëdha të kontrolluara, rishikim të rolit të instruktorit dhe krijimin e kornizave institucionale që adresojnë privatësinë, përgjegjësinë dhe ndikimin në aftësitë praktike të studentëve.

Ndërsa, Kelly Ihme dhe Matt Rasmussen, në artikullin *“Embracing the Inevitable: Integrating AI into Professional Military Education”*⁴, mbrojnë një

² Adam T. Biggs. “Enhancing Professional Military Education with AI”, *Journal of Military Learning*, prill 2025, në: <https://www.armyupress.army.mil/Journals/Journal-of-Military-Learning/Journal-of-Military-Learning-Archives/JML-April-2025/Enhancing-pme-with-ai/>

³ James Lacey. “Transitioning Professional Military Education to All AI, All the Time.” *Small Wars Journal*, 17 nëntor 2025.

⁴ Kelly Ihme & Matt Rasmussen. “Embracing the Inevitable: Integrating AI into Professional Military Education (PME).” *Small Wars Journal*, Maj 2025, në: <https://smallwarsjournal.com/2025/05/07/embracing-the-inevitable/>

qasje proaktive dhe pragmatike ndaj integritit të IA-së në arsimin ushtarak, duke i parë aftësitë për IA-në si një kompetencë bazë për oficerat e së ardhmes. Ata sugjerojnë që programet e arsimit ushtarak duhet të përfshijnë module të detajuara për përdorimin etik dhe teknik të IA-së, për verifikimin e burimeve dhe për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme; ata gjithashtu rekomandojnë politika të qarta për përdorimin e platformave komerciale dhe për mbrojtjen e informacionit operacional. Ihme dhe Rasmussen theksojnë se integrimi i IA-së duhet të synojë të përmirësojë dhe të rrisë njohuritë dhe aftësitë profesionale, duke ruajtur një balancë midis inovacionit teknologjik dhe zhvillimit të aftësive kritike.

Këto studime ofrojnë një panoramë të përbashkët: IA ka potencial të madh për të përmirësuar arsimin ushtarak, por integrimi i saj duhet të jetë i kontrolluar, i shoqëruar me trajnime të strukturuar dhe politika të qarta për përdorimin e tyre që janë parakushtet për një integrim të suksesshëm dhe të sigurt të GenAI në mjediset arsimore ushtarake. Në dritën e këtyre hulumtimeve, duhet theksuar se tek ne literatura mbi IA-në në arsimin ushtarak mbetet ende e kufizuar dhe mungojnë studime të mirëfillta që trajtojnë përdorimin e saj në këtë fushë. Megjithatë, studimet e zhvilluara në arsimin civil ofrojnë perspektiva dhe përvoja të vlefshme, të cilat mund të shërbejnë si bazë për kërkime të mëtejshme në arsimin ushtarak.

Në vendin tonë, integrimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në arsim është në zhvillim, me disa studime dhe iniciativa që po eksplorojnë potencialin e saj. Në artikullin “*Inteligjenca Artificiale dhe sfidat e edukimit në një botë gjithnjë e më digjitale*”⁵, prof. dr. Adrian Civici sjell një reflektim të gjerë mbi rolin e inteligjencës artificiale në arsimin bashkëkohor, duke e parë si një teknologji që transformon traditën dhe sfidon mënyrat klasike të mësimdhënies. Ai analizon integrimin e IA-së në arsimin universitar duke e përkufizuar si një trend eksponencial që sjell mundësi për personalizim të mësimi, automatizim administrativ dhe përmirësim të aksesit, por paralelisht ngre shqetësime etike mbi privatësinë, plagjiaturën dhe diskriminimin. Civici e sheh zhvillimin e një kulture të inteligjencës artificiale si kusht themelor për të siguruar që arsimi të përfitojë nga potenciali i saj pa rrezikuar standardet etike dhe cilësinë e mësimdhënies.

Nga ana tjetër, Orgeta Gjermëni, në studimin e saj, ofron një perspektivë vendore që plotëson dhe nuancon gjetjet ndërkombëtare mbi integrimin e IA në arsimin e lartë.⁶

⁵ Adrian Civici, *Inteligjenca artificiale dhe sfidat e edukimit në një botë gjithnjë e më digjitale*, Gazeta Telegraf, 11 shtator 2024, në: <https://telegraf.al/opinion/prof-dr-adrian-civici-inteligjenca-artificiale-dhe-sfidat-e-edukimit-ne-nje-bote-gjithnje-e-me-dixhitale/>.

⁶ Orgeta Gjermëni, *Artificial intelligence perceptions in higher education: A comprehensive analysis in the Albanian context*. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në: https://www.researchgate.net/publication/376589235_artificial_intelligence_perceptions_in_higher_education_a_comprehensive_analysis_in_the_albanian_context

Bazuar në një analizë të perceptimeve midis studentëve dhe stafit akademik, Gjermëni evidenton një interes të lartë dhe pritshmëri pozitive ndaj potencialit të IA-së për përmirësimin e mësimdhënies dhe mbështetjen e kërkimit, por gjithashtu dokumenton shqetësime të qarta lidhur me integritetin akademik, mungesën e trajnimeve të strukturuar dhe nevojën për politika lokale që adresojnë privatësinë dhe sigurinë e të dhënave. Ajo thekson se përshtatja efektive në kontekstin shqiptar kërkon jo vetëm akses teknologjik, por edhe zhvillim të kapaciteteve pedagogjike, udhëzime institucionale të qarta dhe module të trajnimit të përshtatura për realitetin tonë.

Përveç literaturës akademike, vitet e fundit vendi ynë ka bërë përparime në digjitalizimin e proceseve administrative, promovimin e platformave elektronike dhe të inteligjencës artificiale. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka udhëhequr nismat e integritit të IA në shërbimet publike nëpërmjet platformës e-Albania, e cila në vitin 2025 përfshiu funksione të inteligjencës artificiale, si “ministrja” virtuale Diella – e njohur tashmë ndërkombëtarisht. Sipas një raporti të publikuar nga OECD TALIS 2024, 53.2% e mësuesve në vendin tonë deklarojnë se përdorin IA në punën e tyre, nga përgatitja e orëve mësimore, krijimi i materialeve didaktike deri te përmbledhja e informacionit.⁷ Gjithashtu, në disa shkolla kanë nisur projekte pilot në fushën e IA-së, veçanërisht në Tiranë, duke hapur rrugën për integrim më të gjerë të inteligjencës artificiale në arsim.⁸

Në përmbledhje, literatura ndërkombëtare dhe vendore konsolidon një konsensus mbi potencialin e IA-së për të transformuar arsimin, por paralelisht nënvizon nevojën për politika të qarta, trajnime të strukturuar dhe ruajtjen e rolit të njeriut në vendimmarrje. Boshllëku kryesor mbetet mungesa e studimeve të mirëfillta mbi përdorimin e IA-së në arsimin ushtarak, çka justifikon rëndësinë e këtij studimi. Ky punim synon të mbushë këtë boshllëk duke analizuar përdorimin dhe perceptimet e GenAI në tre institucione të arsimit ushtarak në Shqipëri, duke ofruar rekomandime për politika, trajnime dhe integrim të përgjegjshëm.

2. Metodologjia

Ky studim u mbështet në një pyetësor të strukturuar me 10 pyetje të mbyllura, prej të cilave dy lejonin zgjedhje të shumta (*për mjetet e përdorura dhe për qëllimet e përdorimit*). Pyetësi u shpërnda dhe u mbledh në formë

⁷ OECD (2025), *Results from TALIS 2024: The State of Teaching*, TALIS, OECD Publishing, Paris, fq. 59 në: <https://doi.org/10.1787/90df6235-en>

⁸ “Inteligjenca artificiale në shkolla/ Gjinnazi ‘Sami Frashëri’ e bën pjesë mësimore,” ABC News, 28 tetor 2023, në: <https://abcnews.al/inteligjenca-artificiale-ne-shkolla-gjinnazi-sami-frasheri-e-ben-pjese-mesimore/>.

fizike, të cilët më pas u transkriptuan në tabela për analizë përshkruese. Pyetësi nuk përfshi u dhëna demografike si gjinia, mosha apo sfondi i pjesëmarrësve, duke kufizuar mundësinë e analizave të detajuara sipas këtyre karakteristikave. Ai u zhvillua në tre institucione të arsimit ushtarak: Akademinë e Forcave të Armatosura (studentë, n = 22), Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (kursantë n = 54 dhe pedagogë n = 13, të analizuar si dy nëngrupe dhe si total n = 67), si dhe Qendrën e Gjuhëve (pedagogë, n = 15), fokusuar në shqyrtimin e pikëpamjeve të tyre lidhur me integrimin e mjeteve të GenAI në praktikën e mësimin të gjuhëve. Ky kampion synonte të përfshinte një gamë të gjerë perspektivash dhe përvojash, duke mundësuar një pamje krahasuese ndër-institucionale dhe ndër-grupore.

Analiza e të dhënave u krye përmes statistikave përshkruese, duke raportuar frekuencat absolute dhe përqindjet për secilën pyetje dhe për secilin institucion. Për variablat kategorikë u realizuan krahasime përshkruese ndër-institucionale, ndërsa për pyetjet me zgjedhje të shumta u raportua numri i zgjedhjeve dhe përqindja mbi numrin e përgjigjeve të secilit institucion. Për shkak të madhësisë së kufizuar dhe mungesës së të dhënave demografike, nuk u aplikuan metoda inferenciale statistikore; qëllimi kryesor ishte identifikimi i tendencave dhe perceptimeve të përgjithshme.

Studimi respektoi parimet etike dhe udhëzimet institucionale për zhvillimin e pyetësorëve dhe kryerjen e studimeve gjurmuese. Pjesëmarrësve iu dha një pyetësor jo i atribuar, duke garantuar anonimitetin dhe konfidencialitetin e tyre. Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe të dhënat u trajtuan me kujdes për të siguruar respektimin e standardeve etike gjatë mbledhjes së perspektivave nga kontekste të ndryshme arsimore dhe nivele akademike.

3. Gjetjet kryesore

Përdorimi i mjeteve të GenAI për qëllime arsimore

Çdo person, i cili është përdorues i mjeteve të GenAI, e ka një arsye që e shpie atë që t'i përdorë. Disa i kanë të qarta arsyet për të cilat i përdorin këto mjete, por disa të tjerë, edhe pse në shikim të parë thonë se nuk kanë ndonjë arsye, edhe tek ata gjendet një arsye abstrakte që i bën të jenë përdorues të tyre.

Figura 1 tregon se përdorimi i GenAI është i përhapur në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha institucionet e studiuara. Në AFA, të gjithë studentët (22/22; 100%) raportuan përdorim të mjeteve të GenAI, duke reflektuar një nivel të lartë përdorimi. Në Qendrën e Gjuhëve, të gjithë pedagogët (15/15; 100%) deklaruan se e përdorin, duke treguar se përdorimi i mjeteve të GenAI është bërë pjesë e praktikës së tyre të përditshme. Ndërkohë, në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, përdorimi ishte më i ulët (50/67; 75%), me dallim të qartë mes kursantëve (42/54; 78%) dhe pedagogëve (8/13; 62%).




Figura 1. Përdorimi i GenAI për qëllime arsimore

Gjetjet theksojnë rëndësinë e lehtësisë së përdorimit dhe prirjen e studentëve dhe kursantëve në përdorimin e mjeteve të GenAI. Diferencat ndërmjet grupeve mund të lidhen me faktorë si niveli i ekspozimit ndaj teknologjisë, motivi për të eksperimentuar me mjete të reja, apo mungesa e trajnimeve të strukturuar. Këto rezultate sugjerojnë që institucionet duhet të zbatojnë programe trajnimi dhe udhëzime të synuara për përdorimin e inteligjencës artificiale.

Mjetet e GenAI më të përdorura

Rezultatet në figurën 2 tregojnë se ChatGPT është mjeti më i përdorur në të gjitha institucionet e studiuar. Në AFA, 18 nga 22 studentë (82%) raportuan përdorim të rregullt të ChatGPT-së, ndërsa në Qendrën e Gjuhëve 13 nga 15 pedagogë (87%) e përdorin atë për qëllime mësimore.

Në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, ChatGPT përdoret nga 47 nga 67 pjesëmarrës (70%), duke përfshirë si kursantët ashtu edhe pedagogët. Mjetet Copilot dhe Gemini shfaqen me përdorim më të kufizuar në të tria institucionet. Kështu, Copilot përdoret në shkallë të ulët në të gjitha institucionet: në AFA 2 nga 22 studentë (9%), në KMS 8 nga 67 pjesëmarrës (12%), dhe në Qendrën e Gjuhëve 1 nga 15 pedagogë (7%). Në KMS, 14 nga 54 kursantë raportuan përdorim të Geminis, ndërsa në QGJ vetëm 4 nga 15 pedagogë e përdorin atë. Kategoria “të tjera” përfshin mjete pa një prani të qëndrueshme. Këto të dhëna tregojnë se mjeti “Copilot” nuk ka gjetur përdorim në arsimin ushtarak, edhe pse ai tashmë gjendet në platformën zyrtare të institucioneve tona.

Frekuenca dhe qëllimet e përdorimit të mjeteve të IA-së

Frekuenca e përdorimit të mjeteve të GenAI ndryshon ndërmjet grupeve të studiuar, duke filluar nga përdorimi i përditshëm deri te përdorimi i rrallë. Kursantët e KMS-së raportuan përdorim ditor më të lartë (15 nga 54), duke reflektuar një përfshirje më aktive në përdorimin e mjeteve gjeneruese.

Pedagogët e Qendrës së Gjuhëve raportuan përdorim të shpeshtë në baza ditore ose javore, ndërsa studentët e AFA-së treguan një prirje drejt përdorimit më të moderuar, kryesisht javore ose të rrallë. Këto dallime mund të lidhen me natyrën e detyrave, nivelin e ekspozimit ndaj teknologjisë dhe efikasitetin e përdorimit, por edhe me sinjeritetin e secilit.




Figura 2. Mjetet e Gen AI të përdorura

Sa i përket qëllimeve të përdorimit, studentët dhe kursantët e përdorin kryesisht për kërkim akademik (AFA: 15/22; KMS kursantë: 30/54), duke e konsideruar GenAI si burim të rëndësishëm informacioni. Pedagogët e QGJ raportuan më së shumti përdorim për mësim (9/15), për krijimin e materialeve mësimore (9/15) dhe për kërkim (9/15). Këto gjetje nxjerrin në pah mënyrat e ndryshme në të cilat mjetet e inteligjencës artificiale kontribuojnë në përvojën e të mësuarit.

Figura 3 tregon rëndësinë e lehtësisë dhe dobisë së perceptuar në nxitjen e përdorimit të mjeteve të inteligjencës artificiale. Arsyt kryesore pse studentët përdorin inteligjencën artificiale janë kërkimi, për të mësuar në mënyrë të pavarur si dhe krijimin e materialeve mësimore. Këto gjetje tregojnë një preferencë të qartë për mjetet e inteligjencës artificiale që përmirësojnë efikasitetin dhe përvojat e personalizuara të të mësuarit.

Në përgjithësi, frekuenca dhe qëllimet e përdorimit pasqyrojnë një tendencë drejt integritit të GenAI në aktivitetet e përditshme akademike, me intensitet më të lartë te kursantët dhe përdorim më të strukturuar te pedagogët e gjuhëve të huaja. Këto tendenca janë motivim shtesë për përdorimin e inteligjencës artificiale, duke përfshirë të nxënit e personalizuar, rritjen e angazhimit dhe zhvillimin e vazhdueshëm.




Figura 3. Frekuenca dhe qëllimet e përdorimit të mjeteve të GenAI

Trajnimi dhe rregullat për përdorimin e mjeteve të IA-së

Rezultatet tregojnë mungesë të theksuar të trajnimeve formale për përdorimin e mjeteve të IA-së. Në Qendrën e gjuhëve, 10/15 pedagogë raportuan se kanë marrë trajnim, ndërsa në AFA vetëm 3/22 studentë. Ndërsa në KMS, asnjë kursant nuk u përgjigj se kishte marrë ndonjë trajnim mbi përdorimin e GenAI (0/54).

Nga ana tjetër, nuk ka rregullore apo një udhëzim për përdorimin e mjeteve të GenAI në institucionet arsimore. Shumica e pjesëmarrësve nuk e dinin statusin e lejitimit apo ndalimit të përdorimit të GenAI në programet e tyre, duke reflektuar një boshllëk të madh institucional. Megjithatë, niveli i ulët i trajnimit dhe mungesa e udhëzimeve tregon se ato mbeten fusha që kërkojnë hulumtim të mëtejshëm për të maksimizuar ndikimin e integritetit të inteligjencës artificiale në arsimin ushtarak.

Perceptimi i ndikimit dhe lejimi i përdorimit të mjeteve të GenAI

Rezultatet tregojnë se perceptimi i ndikimit të GenAI në procesin arsimor dhe lejimi i përdorimit të tyre ndryshojnë ndjeshëm midis grupeve. Shumica e pjesëmarrësve e vlerësojnë ndikimin e GenAI si pozitiv: AFA (15/22), QGj (14/15), KMS (25/67). Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e kursantëve të KMS (20/54) shprehën pasiguri duke zgjedhur opsionin “nuk e di” në përgjigje të pyetjes çfarë ndikimi ka përdorimi i mjeteve të IA-së në procesin mësimor.

Figura 4 paraqet përgjigjet ndaj pyetjes: “a duhet të lejohet përdorimi i mjeteve të IA-së në arsimin ushtarak,” me shpërndarjen si më poshtë: studentët e AFA (16/22) dhe pedagogët e QGj (12/15), mbështesin lejimin e përdorimit

të GenAI në arsimin ushtarak. Në KMS, mbështetja është e ndarë kursantët janë pro, (28/54) dhe nuk e di (24/54).




Figura 4. Perceptimi mbi lejimin e përdorimit të mjeteve të GenAI

Ndërsa në total, nga 104 pjesëmarrës vetëm 11 janë kundër, por pa specifikuar arsytet. Shkurtimisht, kjo nxjerr në pah rëndësinë e përshtatjes duke theksuar nevojën për programe gjithëpërfshirëse trajnimi dhe udhëzime të qarta për të integruar në mënyrë efektive inteligjencën artificiale në institucionet arsimore.

Tendenca e të dhënave ilustron një qëndrim shumë pozitiv ndaj përdorimit të inteligjencës artificiale nga studentët dhe tregon një konsensus mbi domosdoshmërinë e integrimit të inteligjencës artificiale në arsimin ushtarak. Për më tepër, këto rezultate theksojnë rëndësinë e pajisjes së mësimdhënësve dhe studentëve me njohuritë e nevojshme për të përdorur në mënyrë efektive mjetet e GenAI.

4. Diskutim

Përmbledhja e gjetjeve kryesore

Rezultatet e studimit nxjerrin në pah një panoramë të qartë mbi përdorimin e GenAI në arsimin tonë ushtarak, duke treguar dallime të ndjeshme midis grupeve të përfshira. Frekuenca e përdorimit ndryshon sipas grupeve të studiuara: kursantët e KMS raportuan përdorim më të lartë ditor, studentët e AFA përdorim më të rrallë ose javor. Qëllimet e përdorimit pasqyrojnë funksionin e secilit grup: studentët dhe kursantët e përdorin kryesisht për kërkim akademik, ndërsa pedagogët për mësim dhe përgatitje të materialeve. Në aspektin e trajnimit, gjetjet tregojnë mungesë të theksuar. Rregulloret dhe udhëzimet institucionale mungojnë krejtësisht, duke krijuar pasiguri mbi

përdorimin etik dhe të kontrolluar të mjeteve të GenAI. Kjo pasiguri reflektohet edhe në perceptimin e ndikimit dhe lejimit të përdorimit të këtyre mjeteve.

Në tërësi, gjetjet sugjerojnë se integrimi i GenAI në arsimin ushtarak është ende në fazë fillestare, i fragmentuar dhe i varur nga iniciativa individuale. Pa trajnim të strukturuar dhe rregulla të qarta, përdorimi mbetet i lirë dhe i paformalizuar, duke kufizuar potencialin për të sjellë përfitime në mësimdhënie, kërkim dhe formim profesional, por edhe duke rritur mundësitë e keqpërdorimit.

Interpretimi i gjetjeve

Analiza e gjetjeve të studimit tregon se përdorimi i mjeteve të GenAI në arsimin ushtarak është i ndikuar nga qëllimi, niveli i trajnimit dhe mungesa e rregullave institucionale. Frekuenca e përdorimit është më e lartë te kursantët e KMS-së, të cilët raportuan përdorim ditor më të shpeshtë, duke reflektuar një prirje për përdorim praktik të këtyre mjeteve. Studentët e AFA-së e përdorin më rrallë ose në mënyrë javore, çka sugjeron një fazë më të hershme të adoptimit. Kjo tregon shkallën dhe mënyrën e përdorimit të GenAI si mjet personal, si mjet ndihmës kërkimor, apo si instrument didaktik. Kjo frekuencë përdorimi mund të ndikojë në efektivitetin dhe përfitimet e perceptuara të këtyre mjeteve. Hulumtimet tregojnë se ndërveprimi i rregullt me mjetet e inteligjencës artificiale mund të çojë në rezultate më të mira akademike.⁹ Në të kundërt, përdorimi sporadik mund të kufizojë përfitimet potenciale që ofrojnë mjetet e IA-së, pasi studentët mund të mos i shfrytëzojnë plotësisht veçoritë e personalizuar të këtyre teknologjive.

Në aspektin e trajnimit, gjetjet nxjerrin në pah një boshllëk të madh institucional. Kjo mangësi shpjegon edhe dallimet në qëllimet e përdorimit: aty ku ka trajnim, përdorimi perceptohet si më i vlefshëm dhe më i sigurt; aty ku mungon trajnimi, GenAI shihet si e pasigurt. Ndërsa në aspektin e rregullave dhe udhëzimeve institucionale ato mungojnë krejtësisht, duke krijuar pasiguri mbi përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të mjeteve të GenAI. Kjo mungesë e udhëzimeve reflektohet në perceptimin e ndikimit: pa rregullore të qarta, përdorimi mbetet i fragmentuar dhe i varur nga iniciativa individuale.

Në tërësi, interpretimi i gjetjeve sugjeron se përdorimi efektiv i mjeteve të GenAI lidhet ngushtë me nivelin e trajnimit dhe ekzistencën e rregullave. Perceptimi pozitiv ndaj mjeteve të inteligjencës artificiale pasqyron mundësinë për të nxitur përdorimin e tyre dhe për të personalizuar të mësuarit. Kjo tregon se pa ndërhyrje institucionale, perceptimi pozitiv nuk mund të kthehet në përdorim të suksesshëm të mjeteve të GenAI.

⁹ Yu Chen et al., *Artificial intelligence (AI) student assistants in the classroom: Designing chatbots to support student success*. Information Systems Frontiers, 25(1), 2023 në: <https://doi.org/10.1007/s10796-022-10291-4>

Përputhshmëria me literaturën

Gjetjet e studimit përputhen gjerësisht me literaturën ndërkombëtare mbi integrimin e inteligjencës artificiale në arsimin ushtarak, duke nxjerrë në pah sfida të ngjashme dhe modele të krahasueshme. Studime si ato të Biggs (2025) theksojnë se mungesa e trajnimit dhe udhëzimeve institucionale është pengesa kryesore për integrimin e suksesshëm të IA në mjediset akademike. Po ashtu, Woessner (2023) ka argumentuar se në arsimin ushtarak, pa rregulla të qarta përdorimi i IA-së mbetet i varur nga iniciativa individuale dhe se pedagogët duhet të trajnohen për të përdorur IA-në si një mjet që forcon procesin mësimor dhe jo që zëvendëson atë. Rezultatet e konfirmojnë këtë prirje: mungesa e trajnimit dhe rregullave institucionale, krijon pasiguri mbi përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të mjeteve të GenAI.

Në kontekstin vendor, studimet e Gjermëni (2023) dhe Civici (2024) kanë nxjerrë në pah se mungesa e politikave të qarta e bën integrimin e IA-së në arsimin e lartë të fragmentuar dhe të paformalizuar. Gjetjet e këtij studimi e pasqyrojnë këtë realitet: përdorimi i GenAI është i lartë, por i parregulluar, i varur nga individët dhe pa mbështetje institucionale.

Në përgjithësi, krahasimi me literaturën tregon se sfidat e IA-së në arsimin ushtarak janë pjesë e një tendence të gjerë: mungesa e trajnimit, mungesa e rregulloreve dhe perceptimi i pasigurt i ndikimit të saj. Megjithatë, literatura sugjeron se aty ku institucionet kanë investuar në trajnim dhe kanë hartuar udhëzime të qarta, përdorimi dhe integrimi i IA-së janë më efikase. Ky është një drejtim i qartë për zhvillimin e mëtejshëm në institucionet tona arsimore.

Implikimet e studimit

Gjetjet e studimit kanë implikime të rëndësishme për arsimin ushtarak, si në nivel teorik, institucional, etik dhe politika. *Teorikisht*, përdorimi i GenAI ka potencial të madh për të rritur efikasitetin akademik, duke lehtësuar kërkimin, organizimin e informacionit dhe krijimin e materialeve mësimore. Megjithatë, pa programe specifike trajnimi, ky potencial mbetet i kufizuar dhe rrezikon të përdoret në mënyrë joefektive. Kjo tregon se trajnimet e strukturuar janë kusht për integrimin e qëndrueshëm të teknologjisë së IA-së në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit.

Mungesa e rregulloreve dhe udhëzimeve institucionale krijon paqartësi mbi përdorimin e mjeteve të GenAI. Kjo e bën përdorimin e GenAI të fragmentuar dhe të varur nga iniciativa individuale, duke kufizuar mundësinë e standardizimit. Institucionet arsimore duhet të hartojnë rregulla që përcaktojnë qartë kufijtë etikë, mënyrat e përdorimit dhe përgjegjësitë e aktorëve.

Përdorimi i pakontrolluar i mjeteve të GenAI ngre shqetësime për plagjaturë, transparencë dhe siguri të të dhënave. Pa udhëzime të qarta, ekziston rreziku

që studentët dhe kursantët të përdorin GenAI për të shmangur procesin e të menduarit kritik ose për të prodhuar materiale pa verifikim të besueshmërisë. Kjo kërkon udhëzime mbi përdorimin etik, të përgjegjshëm dhe të sigurt të teknologjisë.

Gjetjet sugjerojnë nevojën për politika ndërinstucionale mbi integrimin e IA-së në arsimin ushtarak. Pa një qasje të koordinuar, institucionet mbeten të fragmentuara dhe nuk arrijnë të krijojnë standarde të përbashkëta. Ato duhet të përfshijnë trajnime të detyrueshme për studentët, kursantët dhe pedagogët, hartimin e rregulloreve institucionale dhe integrimin e GenAI në kurrikula jo vetëm si mjet kërkimor. Gjithashtu institucionet duhet të ofrojnë infrastrukturë efikase dhe mekanizma mbështetës për të kapërcyer barrierat e sistemit aktual. Të pasurit e kornizave të qarta mund t'u mundësojë institucioneve të zbusin rreziqet e mbështetjes së tepërt në mjetet e IA-së dhe të sigurojnë integrim të balancuar në mjediset arsimore. Duke adresuar këto implikime dhe duke përmirësuar njohuritë praktike dhe teorike, ky punim kontribuon në mënyrë efektive mbi përdorimin e inteligjencës artificiale në institucionet arsimore.

Kufizimet e studimit. Studimi mbështetet në të dhëna vetëraportuese dhe mund të mos pasqyrojnë plotësisht realitetin e përgjithshëm. Mungesa e *pyetjeve të hapura* e kufizon thellësinë e kuptimit të mënyrave konkrete të përdorimit të mjeteve të GenAI. Studimi nuk ka përfshirë matje të drejtpërdrejta të performancës akademike ose të ndikimit real të GenAI në rezultatet e studentëve dhe kursantëve. Kjo kufizon aftësinë për të vlerësuar efektivitetin praktik të teknologjisë. Studimi është kryer në një periudhë të caktuar kohore, ndërkohë që përdorimi i GenAI është dinamik dhe mund të ndryshojë shpejt me zhvillimet teknologjike dhe institucionale. Rezultatet pasqyrojnë një moment specifik dhe mund të mos mbeten të vlefshme në afat të gjatë.

Këto kufizime sugjerojnë se rezultatet duhet të interpretohen me kujdes dhe të shihen si një hap fillestar drejt kuptimit të përdorimit të GenAI në arsimin tonë ushtarak. Për të kapërcyer këto kufizime, studimet e ardhshme duhet të përfshijnë kampionë më të gjera, matje të drejtpërdrejta të performancës akademike dhe një analizë të vazhdueshme të zhvillimeve institucionale. Këto perspektiva sugjerojnë se kërkimet e ardhshme duhet të kalojnë nga *analiza e perceptimeve* drejt *matjes së ndikimit real dhe zhvillimit të politikave të strukturuar*, duke e vendosur GenAI si një komponent të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar në arsimin tonë ushtarak.

Përfundime dhe rekomandime

Ky punim kërkimor analizoi përdorimin dhe ndikimin e inteligjencës artificiale gjeneruese (GenAI) te studentët dhe stafi pedagogjik në institucionet e arsimit ushtarak. Ai nxjerr në pah një realitet kompleks, ku potenciali

i teknologjisë bashkëjeton me sfida të theksuara institucionale dhe etike. Rezultatet tregojnë se mjetet e GenAI përdoren gjerësisht në institucionet e studiara, por mbështetja institucionale është e papërputhshme me nivelin e përdorimit. Në nivel praktik, frekuenca dhe qëllimet e përdorimit ndryshojnë duke treguar se GenAI perceptohet si mjet ndihmës, por jo si komponent i integruar në procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit.

Ky studim ofron njohuri të vlefshme mbi ndikimin e integritit të inteligjencës artificiale në përvojat arsimore. Në nivel konceptual, studimi konfirmon se përdorimi i IA-së lidhet ngushtë me nivelin e trajnimit dhe ekzistencën e rregulloreve, duke përputhur gjetjet me literaturën ndërkombëtare. Gjetjet tregojnë se në aspektin institucional, mungesa e trajnimeve formale dhe rregulloreve është pengesa kryesore për përdorimin efektiv të mjeteve të GenAI.

Studimi tregoi se studentët dhe kursantët e perceptojnë pozitivisht integrimin e inteligjencës artificiale, në kontekstet aktuale dhe të ardhshme arsimore. Megjithatë, është thelbësore të sigurohet që përdorimi i inteligjencës artificiale të përputhet me standardet etike për të mbrojtur integritetin akademik. Studentët duhet të ndërgjegjësohen dhe ta kenë parasysh që para vetes kanë një mjet, përdorimi i të cilit nuk e dobëson por ia shton njohuritë dhe profesionalizmin. Shfrytëzimi i aftësive të inteligjencës artificiale për të ofruar mbështetje të personalizuar dhe për të nxitur një mjedis dinamik të të mësuarit i mundëson ata të përmbushin më mirë objektivat e tyre. Për aq kohë sa *përdorimi i inteligjencës artificiale nga studentët është i pashmangshëm, sfida nuk është më ndalimi i saj, por edukimi dhe trajnimi për ta përdorur në mënyrën e duhur.*

Gjetjet e këtij studimi synojnë të orientojnë drejtimit e ardhshme të kërkimit dhe zbatimet praktike. Bazuar në analizën e gjetjeve dhe interpretimin e tyre, rekomandimet e mëposhtme synojnë të mbështesin një integrim të qëndrueshëm dhe etik të GenAI në arsimin ushtarak. Ato janë të strukturuar në katër fusha kryesore: rregulloret, trajnimi, kurrikula dhe bashkëpunimi institucional:

1. Të hartohen rregulla dhe udhëzime që përcaktojnë qartë kufijtë etikë dhe ligjorë të përdorimit të mjeteve të GenAI. Ato duhet të përfshijnë udhëzime për transparencën në përdorim, mbrojtjen e të dhënave, plagjiaturën dhe përgjegjësinë akademike, në mënyrë që përdorimi i IA-së të jetë efektiv në procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit.

2. Të zhvillohet një program i strukturuar trajnimi për përdorimin e mjeteve të GenAI, i cili të jetë i detyrueshëm për pedagogët, studentët dhe kursantët në të gjitha nivelet përkatëse të arsimit dhe formimit profesional. Pa këto aftësi, teknologjia mbetet e pashfrytëzuar. Programi duhet të përfshijë përdorimin

praktik të mjeteve GenAI, etikën dhe përgjegjësinë në përdorim, mbrojtjen e të dhënave personale, parandalimin e plagjiaturës, si dhe zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik gjatë përdorimit të këtyre teknologjive.

3. Të integrohet GenAI në kurrikula si komponent mësimor dhe kërkimor në lëndët ekzistuese, jo si mjet i jashtëm. Kurrikulat duhet të përfshijnë raste studimore, projekte praktike dhe analiza kritike mbi përdorimin e IA-së në kontekstin ushtarak. Ky integrim do të ndihmojë në zhvillimin e kompetencave dhe të mendimit kritik të përdorimit të saj nga kursantët dhe studentët. Gjithashtu, të përcaktohet një standard i kompetencës në inteligjencën artificiale për diplomim—pra, çfarë duhet të dijë, të jetë në gjendje të bëjë dhe të jetë në gjendje të shpjegojë çdo i diplomuar lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale.

4. Të përcaktohet sa më shpejt qendra e gjuhëve si institucion pilot për mësim të përmirësuar me inteligjencë artificiale, si një mjet i dobishëm për të përshpejtuar mësimin e gjuhëve të huaja me synim zgjerimin e fjalorit, ushtrimin e të shkruarit, si dhe zhvillimin e rrjedhshmërisë dhe aftësive komunikuese në të folur. Ky përdorim është veçanërisht i vlefshëm te qendra e gjuhëve pasi shoqërohet me rreziqe dhe kufizime më të lehta, krahasuar me fusha të tjera akademike.

5. Të krijohen rrjete bashkëpunimi midis institucioneve ushtarake dhe civile për shkëmbim praktikash të përdorimit të IA-së. Të organizohen konferenca, seminare dhe trajnime të përbashkëta për ndarjen e përvojave dhe zhvillimin e politikave. Nga ana tjetër, bashkëpunimi me institucionet NATO-s dhe vendeve anëtare do të mundësojë ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të përdorimit të IA-së në arsimin tonë ushtarak.

Në përfundim, ky studim sjell një kontribut modest në kuptimin e mënyrës se si teknologjitë e inteligjencës artificiale po transformojnë arsimin ushtarak dhe ofron një bazë për politika të reja që synojnë përdorim të përgjegjshëm, të strukturuar dhe të institucionalizuar të mjeteve të saj. Ai nënvizon rëndësinë e programeve të zhvillimit profesional që pajisin mësimdhënësit dhe studentët me aftësi për IA-në, për të kaluar nga përdorimi individual drejt një integrimi të qëndrueshëm dhe etik. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar mund të sigurohet që GenAI të shërbejë si mjet për zhvillimin profesional, duke përgatitur brezat e ardhshëm për sfidat e epokës së inteligjencës artificiale.

Bibliografia

1. Adam T. Biggs. “*Enhancing Professional Military Education with AI*”, Journal of Military Learning, Prill 2025, në: <https://www.armyupress.army.mil/Journals/Journal-of-Military-Learning/Journal-of-Military-Learning-Archives/JML-April-2025/Enhancing-pme-with-ai/>

2. Adrian Civici, “*Inteligjenca Artificiale dhe sfidat e edukimit në një botë gjithnjë e më dixhitale*,” Gazeta Telegraf, 11 Shtator 2024, në: <https://telegraf.al/opinion/prof-dr-adrian-civici-inteligjenca-artificiale-dhe-sfidat-e-edukimit-ne-nje-bote-gjithnje-e-me-dixhitale/>
3. Orgeta Gjermëni, *Artificial Intelligence Perceptions in Higher Education: A Comprehensive Analysis in the Albanian Context*. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në: https://www.researchgate.net/publication/376589235_artificial_intelligence_perceptions_in_higher_education_a_comprehensive_analysis_in_the_albanian_context
4. Kelly Ihme dhe Matt Rasmussen, “*Embracing the Inevitable: Integrating AI into Professional Military Education (PME)*.” Small Wars Journal, Maj 2025, në: <https://smallwarsjournal.com/2025/05/07/embracing-the-inevitable/>
5. James Lacey, “*Transitioning Professional Military Education to All AI, All the Time*.” Small Wars Journal, 17 Nëntor 2025.
6. OECD (2025), *Results from TALIS 2024: The State of Teaching*, TALIS, OECD Publishing, Paris, në: <https://doi.org/10.1787/90df6235-en>
7. OECD. *OECD Digital Education Outlook 2026: Exploring Effective Uses of Generative AI in Education*. OECD Publishing, 2026.

RUBRIKA E KATËRT

PUNIME HISTORIKE

Konflikti në Lindjen e Mesme – një përshkrim i përmbledhur nga origjina deri në fillim të shekullit XXI

Nënkolonel Latif SHURDHI

Pedagog në Departamentin e Udhëheqjes Ushtarake,
Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar

Lufta amerikano-izraelite kundër Republikës Islamike të Iranit ka tërhequr vëmendje të gjerë ndërkombëtare dhe, ndryshe nga sa u la të kuptohet në deklaratimet fillestare të Presidentit Trump, po zgjat më tepër sesa ishte parashikuar. Megjithatë, është e qartë se ky konflikt nuk u shfaq papritur. Ai është rezultat i një sërë faktorësh politikë, strategjikë dhe gjeopolitikë që po ndikojnë në transformimin e rendit aktual ndërkombëtar drejt një rendi të ri, i cili, sipas gjykimit tim, do të kërkojë ende kohë për të arritur një ekuilibër të qëndrueshëm.

Duke qenë se kjo luftë përbën një pjesë të rëndësishme, njëkohësisht edhe pasojë, të Konfliktit të Lindjes së Mesme, mendoj se është me interes të veçantë për komunitetin shkencor paraqitja, në mënyrë të përmbledhur, e origjinës së këtij konflikti, e aktorëve kryesorë, e interesave dhe pozicioneve të tyre, e formave dhe mënyrave të zhvillimit të konfliktit, si edhe e përpjekjeve dhe dështimeve për gjetjen e një zgjidhjeje deri në fillim të shekullit, përkatësisht të mijëvjeçarit të ri.

Në këtë kuadër, dëshiroj të paraqes një punim të realizuar gjatë studimeve të mia në Universitetin e Ushtrisë Federale Gjermane (Bundeswehr) në Hamburg.

Në vijim do të trajtohen natyra e Konfliktit të Lindjes së Mesme, shkaqet e lindjes së tij, format dhe fazat e zhvillimit, qasjet dhe qëndrimet e aktorëve kryesorë, si edhe përpjekjet e ndërmarra për zgjidhjen e tij.

Fjalë kyçe: Konflikti i Lindjes së Mesme; konflikti izraelito-arabo-palestinez; Deklarata e Balfourit; sionizmi; Intifada; Organizata për Çlirimin e Palestinës (OÇP).

Hyrje

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të paraqesë në mënyrë të strukturuar dhe të përmbledhur Konfliktin e Lindjes së Mesme, një nga konfliktet më të gjata të kohëve moderne, përfundimi i të cilit mbetet ende i vështirë për t'u parashikuar. Megjithatë, që prej 7 tetorit 2023, konflikti ka hyrë në një fazë të re, e cila, duke u mbështetur në teorinë e zhvilluar nga Werner Link mbi konfliktet dhe fazat e zhvillimit të tyre, mund të konsiderohet si faza kulmore e tij.

Ky punim kufizohet në trajtimin e konfliktit nga origjina e tij deri në fillim të shekullit XXI. Ky kufizim përbën një kufizim kohor të objektit të studimit, në përputhje me parimet e metodologjisë së kërkimit shkencor. Në mënyrë të veçantë, punimi synon:

1. të paraqesë rrënjët historike të konfliktit;
2. të shpjegojë fazat e zhvillimit të tij;
3. të identifikojë aktorët që marrin pjesë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në konflikt;
4. të analizojë qëndrimet dhe qasjet e aktorëve në përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit;
5. të paraqesë gjendjen e konfliktit në fillim të shekullit XXI.

Sa i përket metodologjisë, studimi mbështetet në një qasje cilësore, të bazuar në shqyrtimin e literaturës shkencore të besueshme dhe gjithëpërfshirëse. Në analizimin e burimeve është përdorur metoda e analizës së përmbajtjes, ndërsa në tërësinë e tij punimi ka karakter përshkrues. Kjo qasje lidhet drejtpërdrejt me objektivin e studimit, i cili synon të paraqesë zhvillimin historik të konfliktit, aktorët kryesorë dhe qëndrimet e tyre, pa ndërmarrë një analizë shpjeguese ose vlerësuese të arsyeve që kanë përcaktuar këto qëndrime.

Për shkak të natyrës përshkruese të studimit, nuk janë përdorur citime të drejtpërdrejta. Megjithatë, i gjithë trajtimi mbështetet në literaturën shkencore të konsultuar, e cila paraqitet në seksionin e referencave bibliografike në fund të artikullit.

1. Rrënjët historike të konfliktit

Në fushën e politikës ndërkombëtare, konflikti qendror që ka dominuar zhvillimet në Lindjen e Mesme është konflikti izraelito-arabo-palestinez, i njohur gjerësisht si Konflikti i Lindjes së Mesme. Për shkak të rëndësisë, kohëzgjatjes dhe ndikimit të tij, ai zë një vend të veçantë në studimet e politikës ndërkombëtare dhe në teoritë mbi konfliktet ndërkombëtare. Konfliktet në botë janë të shumta; shumë prej tyre lindin, zhvillohen dhe përfundojnë, duke pasur karakteristika dhe pasoja të ndryshme. Ndryshe prej tyre, ky konflikt ka vazhduar për më shumë se shtatë dekada, mbetet ende i pazgjidhur dhe pasojat

e tij ndihen jo vetëm në rajonin ku zhvillohet, por edhe në nivel ndërkombëtar.

Rrënjët e këtij konflikti lidhen me historinë e krijimit të shtetit të Izraelit. Në fund të shekullit XIX u formua lëvizja kombëtare hebraike e njohur si Sionizmi. Kjo lëvizje u shfaq si reagim ndaj përndjekjeve gjithnjë e më të mëdha të hebrenjve në Evropën Lindore, veçanërisht në Rusi dhe Poloni, por edhe ndaj vështirësive në rritje të integritetit dhe asimilimit të hebrenjve në Evropën Perëndimore. Objektivi kryesor i Sionizmit ishte krijimi i një shteti të pavarur hebre në Palestinë. Në vitin 1919, Palestina ishte e banuar nga rreth 515.000 myslimanë, 65.000 hebrenj dhe 62.000 të krishterë, ndërsa kufijtë e saj nuk ishin ende të përcaktuar qartë.

Deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore, Palestina ndodhej nën sundimin e Perandorisë Osmane. Në vitin 1922 ajo u vendos nën mandatin e Lidhjes së Kombeve, ndërsa Britania e Madhe mori të drejtën e administrimit të territorit. Në zbatim të këtij mandati, Britania e Madhe u angazhua të promovonte krijimin e një atdheu kombëtar hebre, në përputhje me angazhimin e marrë në Deklaratën e Balfourit të vitit 1917, si edhe të lehtësonte imigrimin hebre në Palestinë.

Gjatë viteve 1920–1930, Lëvizja Sioniste, nën mbrojtjen britanike, arriti të ndërtojte struktura politike, ekonomike dhe administrative që funksiononin si një shtet de facto brenda Palestinës. Në të njëjtën kohë, ajo sfidoi gjithnjë e më shumë jo vetëm strukturën gjysmëfeudale të shoqërisë palestineze, por edhe karakterin arab të territorit. Ndër faktorët kryesorë që favorizuan suksesin e lëvizjes sioniste ishin burimet më të mëdha financiare të komunitetit hebre, niveli më i lartë i zhvillimit teknologjik, blerja sistematike e tokave dhe politikat e tregut të punës që favorizonin punësimin e hebrenjve. Po ashtu, rritja e imigracionit hebre si pasojë e ardhjes në pushtet të regjimit nazist të Adolf Hitlerit kontribuoi ndjeshëm në konsolidimin e komunitetit hebre në Palestinë.

Nga ana tjetër, rezistenca arabe ndaj projektit sionist u zhvillua paralelisht me forcimin e nacionalizmit arab. Ajo kundërshtoi pretendimet historike, juridike, morale dhe politike të hebrenjve mbi Palestinën dhe kërkoi krijimin e një shteti të pavarur palestinez, i cili do të pasqyronte shumicën arabe të popullsisë.

Britania e Madhe reagoi ndaj trazirave, grevave dhe kryengritjeve arabe përmes një kombinimi masash politike dhe ushtarake, duke përfshirë ndarjen e Transjordanisë, ndërmarrjen e masave ndëshkuese, krijimin e komisioneve hetimore dhe, në prag të Luftës së Dytë Botërore, rishikimin e politikës së saj në drejtim të kufizimit të mbështetjes për krijimin e atdheut kombëtar hebre.

Pas vitit 1945, administrata britanike nuk arriti të ndërmjetësonte pretendimet e palëve ndërluftuese në Palestinë. Ndërkohë, konflikti arabo-

hebre rrezikonte të shndërrohej edhe në një konflikt midis Britanisë së Madhe dhe lëvizjes sioniste. Në këto rrethana, Britania e Madhe vendosi t'ia kalonte çështjen Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila kishte zëvendësuar Lidhjen e Kombeve.

Më 29 nëntor 1947, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi planin për ndarjen e Palestinës në një shtet hebre dhe një shtet arab, ndërsa Jerusalemi parashikohej të kishte status ndërkombëtar. Megjithatë, ky plan nuk u zbatua për shkak të kundërshtimeve dhe mungesës së mekanizmave efektivë të zbatimit. Si pasojë, më 14 maj 1948 u shpall krijimi i shtetit të Izraelit. Në vijim të zhvillimeve ushtarake, Jordania mori kontrollin e Bregut Perëndimor, Jerusalemi u nda ndërmjet palëve, ndërsa Ripi i Gazës u vu nën administrimin egjiptian. Si rezultat i konfliktit, më shumë se 750.000 palestinezë u detyruan të largoheshin nga vendbanimet e tyre, duke krijuar një nga problemet më të mëdha të refugjatëve në historinë bashkëkohore të rajonit.

2. Dimensionet e Konfliktit të Lindjes së Mesme

Konflikti i Lindjes së Mesme është një konflikt kompleks, i cili zhvillohet njëkohësisht në tri dimensione të ndërlidhura: aktorët dhe potencialet në *dimensionin izraelito-palestinez*, *dimensionin rajonal*, që përfshin marrëdhëniet ndërmjet Izraelit dhe shteteve arabe dhe *dimensionin ndërkombëtar*, në të cilin përfshihen fuqitë e mëdha.

- Aktorët dhe potencialet në dimensionin izraelito-palestinez

Dimensioni i parë përfshin përballjen ndërmjet shtetit të Izraelit dhe palestinezëve dhe përbën bërthamën e Konfliktit të Lindjes së Mesme. Ky dimension karakterizohet nga një pabarazi e dukshme në potencialin demografik, ekonomik, politik dhe ushtarak të palëve.

Megjithëse Izraeli është një shtet me sipërfaqe relativisht të vogël, prej 21.946 km², ai disponon një potencial të konsiderueshëm demografik, ekonomik, teknologjik dhe ushtarak. Në fillim të vitit 2000, popullsia e tij ishte rreth 6,2 milionë banorë, e përbërë nga 4,9 milionë hebrenj, 936.000 myslimanë, 131.000 të krishterë, 101.000 druzë dhe 152.000 banorë të tjerë pa përkatësi fetare të regjistruar. Numri i emigrantëve të rinj arriti në 77.000, ose 17.000 më shumë se në vitin 1998, ndërsa rritja e popullsisë gjatë periudhës 1995–1998 ishte 4,1 %.

Edhe treguesit ekonomikë dëshmojnë për potencialin e lartë të shtetit izraelit. Në vitin 1998, Prodhiimi i Brendshëm Bruto (PBB) arriti në 97 miliardë dollarë amerikanë, prej të cilëve mbi 65 miliardë u gjeneruan nga sektori industrial. Prodhiimi për frymë ishte rreth 16.500 dollarë amerikanë, ndërsa

vëllimi i eksporteve në vitin 1999 arriti në 23,5 miliardë dollarë amerikanë. Deficiti tregtar ishte 7,15 miliardë dollarë amerikanë, ndërsa inflacioni u ul nga 14,5 % në vitin 1994 në 8,6 % në vitin 1998. Falë këtij potenciali ekonomik dhe nivelit të lartë të inovacionit teknologjik, Izraeli renditet ndër vendet e industrializuara. Çdo vit ai investon rreth 3 % të PBB-së në kërkim shkencor dhe zhvillim teknologjik. Stabiliteti politik i Izraelit mbështetet në funksionimin e një sistemi parlamentar demokratik. Knesseti, me 120 deputetë, përbën organin legjislativ të vendit, ndërsa Presidenti i Republikës zgjidhet prej tij për një mandat pesëvjeçar. Në vitin 2000 këtë funksion e ushtronte Moshe Katsav. Megjithëse institucionet shtetërore karakterizohen nga stabiliteti dhe funksionaliteti, shoqëria izraelite vazhdon të përballet me ndarje të thella politike, ideologjike dhe shoqërore.

Një nga shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare të Izraelit janë forcat e tij të armatosura, të cilat konsiderohen ndër më të fuqishmet në rajon dhe besohet se disponojnë edhe kapacitete bërthamore. Në politikën e jashtme dhe atë të sigurisë, Izraeli mbështetet në marrëdhënien e tij strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Njëkohësisht, ai ruan marrëdhënie të ngushta ekonomike dhe tregtare edhe me Bashkimin Evropian.

Ndryshe nga Izraeli, palestinezët nuk disponojnë një shtet të tyre. Në fillim të viteve 2000, numri i palestinezëve në mbarë botën vlerësohej rreth 6,8 milionë, prej të cilëve afërsisht 2,6 milionë ishin të regjistruar si refugjatë. Ata ushtronin një formë të kufizuar vetëqeverisjeje vetëm në një pjesë të territoreve të pushtuara nga Izraeli, përkatësisht në Bregun Perëndimor, me rreth 1,6 milionë banorë palestinezë, dhe në Rripin e Gazës, me rreth 1 milion banorë. Ekonomia palestineze karakterizohej nga një potencial i kufizuar dhe nga vështirësi të konsiderueshme zhvillimi. Gjatë periudhës 1993–1997, të ardhurat për frymë pësuan rënie të ndjeshme, kryesisht si pasojë e rritjes së shpejtë të popullsisë. Në fund të vitit 1997, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) arriti në rreth 3,4 miliardë dollarë amerikanë, ndërsa të ardhurat për frymë ishin vetëm 1.360 dollarë amerikanë.

Në aspektin politik, President i Autoritetit Kombëtar Palestinez në këtë periudhë ishte udhëheqësi i Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP), Jasir Arafat (Yasser Arafat), i cili u zgjodh drejtpërdrejt më 20 janar 1996 me 87,1 % të votave. Megjithatë, Autoriteti Kombëtar Palestinez dhe Këshilli Legjislativ Palestinez kishin kompetenca dhe mundësi veprimi të kufizuara, për shkak të statusit të tyre politik dhe kufizimeve që rridhnin nga procesi i paqes dhe situata në terren. Në këto rrethana, forma kryesore e mobilizimit politik dhe e rezistencës palestineze mbeti aspirata për krijimin e një shteti të pavarur, e shprehur ndër të tjera edhe përmes Intifadës në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës.

Organizata për Çlirimin e Palestinës (OÇP), e themeluar në vitin 1964, vazhdonte të përfaqësonte organizatën politike kryesore të palestinezëve. Në vitin 1974 ajo u njoh nga shtetet arabe si përfaqësuesja e vetme legjitime e popullit palestinez dhe fitoi statusin e vëzhguesit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, efektiviteti i veprimtarisë së saj varej në masë të madhe nga marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet arabe, si edhe nga marrëdhëniet me Izraelin dhe niveli i kohezionit të saj të brendshëm.

Mungesa e një marrëveshjeje përfundimtare paqeje në Lindjen e Mesme, si edhe shfaqja e organizatave rivale palestineze me orientim islamik, veçanërisht e Lëvizjes Hamas, e vendosën OÇP-në, që nga viti 1993, përballë sfidave të rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore, të cilat me kalimin e kohës u bënë gjithnjë e më komplekse.

- Dimensioni rajonal i konfliktit

Dimensioni i dytë i Konfliktit të Lindjes së Mesme është ai rajonal, i cili përfshin marrëdhëniet ndërmjet Izraelit dhe shteteve arabe.

Objektivi i deklaruar i kryeministrit izraelit të asaj periudhe, Ehud Barak (Partia e Punës), i zgjedhur më 17 maj 1999 si pasardhës i Benjamin Netanjahut (Partia Likud), ishte t'i jepte fund konfliktit izraelito-arabo-palestinez jo vetëm përmes një kompromisi me palestinezët, por edhe nëpërmjet arritjes së marrëveshjeve me Sirinë dhe Libanin. Në këtë kuadër, Egjipti, Jordania dhe Autoriteti Kombëtar Palestinez konsideroheshin partnerë të rëndësishëm për vendosjen e një paqeje të qëndrueshme në Lindjen e Mesme.

Në parim, edhe shtetet arabe shprehnin gatishmërinë për të mbështetur formulën “tokë për paqe”. Megjithatë, përparimi në këtë drejtim kufizohej nga hapësira e ngushtë e manovrimit politik si për Izraelin, ashtu edhe për shtetet arabe. Gjithashtu, ndryshimet në udhëheqjen politike të Jordanisë në vitin 1999 dhe të Sirisë në vitin 2000 nuk kontribuan në përsheptimin e procesit të paqes. Në përgjithësi, pala arabe mbeti e përkushtuar ndaj rivendosjes së të drejtave kombëtare të popullit palestinez. Kjo nënkuptonte mbështetjen për një zgjidhje me dy shtete, pra krijimin e një shteti palestinez përkrah Izraelit, në territoret e pushtuara prej tij pas vitit 1967, duke përfshirë edhe Jerusalemin Lindor. Njëkohësisht, shtetet arabe mbështesnin edhe të drejtën e refugjatëve palestinezë për t'u kthyer në vendbanimet e tyre.

Megjithatë, pavarësisht objektivave të përbashkëta, brenda botës arabe ekzistonin dallime të konsiderueshme në qasjen ndaj konfliktit. Egjipti, pas nënshkrimit të traktatit të paqes me Izraelin dhe rikthimit të Gadishullit të Sinait në vitin 1979, ndoqi një politikë të bazuar në negociata dhe dialog. Për Jordaninë, interesi kryesor ishte ruajtja e stabilitetit dhe e shtetësisë së

saj, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e një konfederate me një shtet palestinez.

Arabia Saudite synonte kryesisht të forconte pozitën e saj si kujdestare e vendeve të shenjta të Islamit dhe si një aktor me ndikim në zhvillimet rajonale. Nga ana tjetër, Siria, Iraku, Libia dhe, megjithëse jo shtet arab, Irani, mbanin qëndrime më pak të gatshme për kompromis me Izraelin, ndonëse në periudha të caktuara këto qëndrime kanë njohur luhajtje. Për Sirinë, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe vdekjes së Hafez al-Assad më 10 qershor 2000, prioritet mbeti ruajtja e rolit të saj si një fuqi e rëndësishme rajonale. Kjo përfshinte ruajtjen e ndikimit mbi politikën e jashtme të Libanit dhe rikthimin e Lartësive të Golanit, më shumë sesa mbështetjen për krijimin e një shteti të ri palestinez. Ndërkohë, për Iranin, çdo marrëveshje paqeje e negociuar me Izraelin konsiderohej e papranueshme. Në diskursin politik iranian të asaj periudhe, përballja me shtetin izraelit trajtohej si një çështje ekzistence dhe jo thjesht si një mosmarrëveshje territoriale.

Megjithatë, në tërësi, kufiri ndërmjet mbështetësve dhe kundërshtarëve të një kompromisi paqësor në Lindjen e Mesme nuk ka qenë i pandryshueshëm. Qëndrimet e shteteve arabe janë ndikuar vazhdimisht nga zhvillimet politike dhe strategjike në rajon. Një shembull domethënës është Iraku, i cili gjatë Luftës Iran–Irak (1980–1988) mbajti një qëndrim më të moderuar ndaj Izraelit, ndërsa gjatë krizës së Kuvajtit (1990–1991) u rikthye në një pozicion të ashpër kundër tij. Kjo tregon se qëndrimet e aktorëve rajonalë në Konfliktin e Lindjes së Mesme janë përcaktuar jo vetëm nga parimet ideologjike, por edhe nga interesat politike dhe strategjike të momentit.

- Dimensioni ndërkombëtar i konfliktit

Dimensioni i tretë i Konfliktit të Lindjes së Mesme përfshin fuqitë e mëdha, respektivisht superfuqitë ndërkombëtare. Që nga mesi i viteve 1950, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik kanë zëvendësuar Britaninë e Madhe dhe Francën si aktorët kryesorë në rajon. Megjithatë, pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara janë shndërruar në fuqinë dominuese në Lindjen e Mesme.

Në përgjithësi, Shtetet e Bashkuara kanë mbajtur një qëndrim më të afërt me shtetin e Izraelit, ndërsa Bashkimi Sovjetik, në kontekstin e rivalitetit Lindje–Perëndim, ka mbështetur kryesisht shtetet arabe dhe çështjen palestineze. Megjithatë, të dy superfuqitë kanë njohur të drejtën e Izraelit për të ekzistuar. Angazhimi i tyre në rajon është udhëhequr kryesisht nga interesa strategjike globale, të cilat lidhen me kontrollin mbi Mesdheun Lindor, Gjirin Persik dhe aksesin drejt Oqeanit Indian, përfshirë rëndësinë e Kanalit të Suezit.

Një rol të veçantë ka pasur edhe çështja e sigurisë së furnizimit me naftë nga

Gjiri Persik. Kjo është bërë veçanërisht e dukshme në kontekstin e ndërhyrjes sovjetike në Afganistan dhe të destabilizimit të rajonit pas Revolucionit Islamik në Iran.

Në raportin e forcave ndërkombëtare në Lindjen e Mesme, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik kanë pasur suksese të ndryshueshme. Deri në fillim të viteve 1970, Bashkimi Sovjetik arriti të forconte ndjeshëm pozicionin e tij në rajon, por pas Luftës së Tetorit 1973, ndikimi i tij filloi të dobësohej gradualisht. Siria mbeti partneri më i rëndësishëm i Bashkimit Sovjetik në Lindjen e Mesme gjatë viteve 1980.

Rënia e Bllokut Lindor dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik i hapën rrugë Rusisë për të trashëguar rolin e ish-superfuqisë në rajon. Megjithatë, pavarësisht rifillimit të marrëdhënieve diplomatike me Izraelin në vitin 1991 dhe pjesëmarrjes në koalicionin ndërkombëtar gjatë Luftës së Gjirit, Rusia, për shkak të dobësive të brendshme ekonomike dhe politike, ka pasur dhe vazhdon të ketë rol të kufizuar në procesin e zgjidhjes së Konfliktit të Lindjes së Mesme. Interesi i saj kryesor është i përqendruar në ndikimin në hapësirat myslimane të republikave jugore të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (BSHP).

Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara kanë luajtur një rol qendror në rajon, veçanërisht pas Luftës së Yom Kippur-it në vitin 1973, duke u shndërruar për një periudhë në ndërmjetësin kryesor midis Izraelit dhe shteteve arabe. Megjithatë, aftësia e tyre për të përmbushur pritshmëritë e palëve të përfshira ka qenë e kufizuar. Zhvillimet e mëvonshme, si Revolucioni Islamik në Iran (1979), ndërhyrja sovjetike në Afganistan (1979), tensionet në politikën izraelite dhe dështimi i përpjekjeve për paqe në Liban, kontribuan në rënien e besueshmërisë së SHBA-së në rajon. Megjithatë, përmes mbështetjes ndaj shteteve të Gjirit gjatë fazës përfundimtare të Luftës Iran–Irak dhe rolit të saj në Luftën e Gjirit (1990–1991), Shtetet e Bashkuara rifituan pozicionin e një ndërmjetësi qendror në konflikt.

Një nga nismat më të rëndësishme diplomatike të periudhës ishte takimi trepalësh në Camp David në korrik 2000, ndërmjet Presidentit Bill Clinton, Yasser Arafat dhe Ehud Barak. Politika amerikane në Lindjen e Mesme është karakterizuar nga disa shtylla kryesore: ruajtja e pranisë ushtarake në Gjirin Persik/Arab, parandalimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe mbështetja e formulës “tokë për paqe” në kuadër të procesit të paqes. Këtyre objektivave u shtohet edhe gatishmëria për dialog me Sirinë dhe me Organizatën për Çlirimin e Palestinës (OÇP), e cila në vitin 1988 nisi të njihej gradualisht si aktor politik në procesin e paqes, pas njohjes së së drejtës së Izraelit për të ekzistuar nga ana e Yasser Arafatit.

Në planin e brendshëm, politika amerikane ndaj Lindjes së Mesme ndikohet

gjithashtu nga prania e grupeve të fuqishme pro-izraelite, të cilat shpesh përballen me balancimin ndërmjet mbështetjes për sigurinë e Izraelit dhe promovimit të vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut për palestinezët.

3. Format e zgjidhjes së konfliktit

Konflikti në Lindjen e Mesme zhvillohet dhe trajtohet nëpërmjet tre mjeteve kryesore: politike, ekonomike dhe ushtarake.

Në aspektin politik, mjetet kryesore përfshijnë diplomacinë dhe përdorimin e propagandës si dhe të mediave për të ndikuar në opinionin publik ndërkombëtar. Në këtë drejtim, ndikimi mediatik ka qenë tradicionalisht i ndarë sipas blloqeve gjeopolitike: në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropën Perëndimore shpesh ka mbizotëruar një qëndrim më i favorshëm ndaj Izraelit, ndërsa në Evropën Lindore dhe në shumë vende të Botës së Tretë, për një periudhë të gjatë, diskursi ka qenë më i prirur në mbështetje të kauzës arabe dhe palestineze.

Në planin diplomatik, me kalimin e kohës është vërejtur një zhvendosje graduale nga pozicionet e hapura të njëanshme drejt qëndrimeve më të balancuara. Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe deklaratat e ndryshme ndërkombëtare për Lindjen e Mesme, veçanërisht Deklarata e Venedikut e Këshillit të Evropës e 13 qershorit 1980. Në të, shtetet anëtare të atëhershme të Komunitetit Evropian kanë njohur si të drejtën e Izraelit për të ekzistuar dhe nevojat e tij të sigurisë, ashtu edhe të drejtat legjitime të popullit palestinez. Gjithashtu, është bërë thirrje për një proces paqeje nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP), duke reflektuar gradualisht rolin e Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar.

Megjithatë, brenda vetë Kombeve të Bashkuara, Izraeli është përballur shpesh me kritika të forta dhe rezoluta dënuese lidhur me politikat e tij. Në këtë kontekst është ngritur edhe akuza për racizëm, çka ka ndikuar që Izraeli të shprehë rezerva ndaj organizimit të një konference ndërkombëtare paqeje nën kujdesin ekskluziv të OKB-së.

Në aspektin ekonomik, konflikti i Lindjes së Mesme lidhet me aksesin dhe kontrollin mbi burimet strategjike, përfshirë lëndët e para, ushqimin, produktet industriale (përfshirë pajisjet ushtarake), teknologjinë dhe kapitalin. Një rëndësi gjithnjë në rritje ka edhe çështja e ujit, e cila është shndërruar në një faktor kritik në kuadër të problemeve globale mjedisore dhe konkurrencës rajonale për burime të kufizuara.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike, shtetet arabe janë veçanërisht të lidhura me vendet e industrializuara, si Japonia dhe shtetet e Evropës Perëndimore, të cilat varen në masë të madhe nga furnizimet me naftë. Nga

ana tjetër, Shtetet e Bashkuara dhe shtetet e Bashkimit Evropian furnizojnë një pjesë të konsiderueshme të importeve të mallrave industriale dhe bujqësore për vendet e Lindjes së Mesme. Gjithashtu, pothuajse të gjitha shtetet e rajonit varen nga importi i armëve nga vendet e industrializuara për të ruajtur kapacitetet e tyre ushtarake.

Në aspektin ushtarak, konflikti zhvillohet në disa forma: luftë konvencionale, luftë guerile, përfshirë terrorizmin, si dhe kryengritje popullore. Aktiviteti gueril palestinez, veçanërisht në periudhën para dhe pas njohjes ndërkombëtare të OÇP-së në vitet 1970, ka ushtruar presion të konsiderueshëm politik. Intifada, si kryengritje e popullsisë palestineze kundër pushtimit izraelit, përbën një nga format më të dukshme të rezistencës dhe është konsideruar gjerësisht si shprehje e legjitimuar e pakënaqësisë. Kjo kryengritje ka shkaktuar rreth 1.200 viktima.

Gjithashtu, sulmet terroriste kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen ndërkombëtare ndaj konfliktit të pazgjidhur, si p.sh. në Mynih (1972), Entebbe (1976) dhe rrëmbimi i anijes Achille Lauro (1985). Sulmet ndaj civilëve nga të dyja palët kanë qenë dhe mbeten një element i përsëritur i konfliktit, duke e vështirësuar ndjeshëm çdo proces pajtimi.

Luftërat konvencionale në kuadër të Konfliktit të Lindjes së Mesme mund të përmbliken si vijon:

- Lufta e viteve 1947–1949, gjatë së cilës Izraeli konsolidoi shtetësinë e tij dhe zgjeroi territorin përtej planit të ndarjes së OKB-së të nëntorit 1947.
- Lufta e vitit 1956, në të cilën Izraeli i shkaktoi një disfatë të rëndë Egjiptit, por u kritikua ndërkombëtarisht për bashkëpunimin me Britaninë e Madhe dhe Francën gjatë krizës së Suezit.
- Lufta e vitit 1967, në të cilën Izraeli mori kontrollin e Bregut Perëndimor, Jerusalemit Lindor, Rripit të Gazës, Gadishullit të Sinait dhe Lartësive të Golanit.
- Lufta e vitit 1973, ku shtetet arabe arritën suksese të kufizuara ushtarake, por fituan ndikim të rëndësishëm politik dhe psikologjik.
- Lufta e vitit 1982, gjatë së cilës Izraeli ndërhyri në Liban, avancoi deri në Bejrut dhe detyroi tërheqjen e përkohshme të OÇP-së nga vendi.
- Lufta Iran–Irak (1980–1988), ku Izraeli veproi në mënyrë indirekte, duke përfshirë goditjen e objektit bërthamor irakian pranë Bagdadit në vitin 1981 dhe furnizimin e Iranit me armë, me qëllim dobësimin e Irakut.
- Lufta e Gjirit (1990–1991), ku Izraeli u përfshi në mënyrë indirekte në koalicionin ndërkombëtar të udhëhequr nga SHBA-të për çlirimin e Kuvajtit, ndërsa kërcënimi irakian e zbehu përkohësisht konfliktin izraelito-arabo-palestinez.

4. Përpyjekjet për paqe

Përpyjekjet për arritjen e një zgjidhjeje paqësore në Lindjen e Mesme janë intensifikuar veçanërisht që nga viti 1967. Pikënisje e këtyre përpjekjeve mbeten Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 242 (22 nëntor 1967) dhe nr. 338 (22 tetor 1973). Rezoluta 242 bën thirrje për vendosjen e një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme, duke përfshirë:

- tërheqjen e forcave të armatosura izraelite nga territoret e pushtuara gjatë Luftës së Qershorit 1967;
- respektimin dhe njohjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të të gjitha shteteve në rajon, si dhe të drejtës së tyre për të jetuar në paqe.

Në këtë rezolutë, çështja palestineze trajtohet në mënyrë të kufizuar, kryesisht në kontekstin e zgjidhjes së problemit të refugjatëve. Përpyjekjet e të dërguarit special të OKB-së, Gunnar Jarring, si dhe të Sekretarit të Shtetit amerikan William Rogers, për zbatimin e Rezolutës 242 gjatë periudhës 1967–1971 nuk dhanë rezultate. Pas Luftës së Tetorit 1973, Sekretari i Shtetit i SHBA-së Henry Kissinger arriti të ndërmjetësojë marrëveshje për shkëputje ushtarake midis Izraelit dhe Egjiptit (1974 dhe 1975), si dhe midis Izraelit dhe Sirisë (1974).

Në vitin 1977, përpjekjet e Presidentit amerikan Jimmy Carter për të rifilluar Konferencën e Gjenevës mbi Lindjen e Mesme dhe për të përfshirë përfaqësues palestinezë në proces dështuan. Megjithatë, një zhvillim i rëndësishëm diplomatik ndodhi me vizitën e Presidentit egjiptian Anwar Sadat në Jerusalem (19–21 nëntor 1977), e ndjekur nga vizita e Kryeministrit izraelit Menachem Begin në Ismailia në dhjetor të po atij viti. Këto zhvillime çuan në Marrëveshjet e Camp David-it (17 shtator 1978), të ndërmjetësuara nga Shtetet e Bashkuara, të cilat përcaktuan *kornizën për traktatin e paqes midis Egjiptit dhe Izraelit dhe një kuadër më të gjerë për paqen në Lindjen e Mesme*.

Traktati i paqes Egjipt–Izrael u nënshkrua më 26 mars 1979, por çështja qendrore e konfliktit, ajo palestineze, mbeti e pazgjidhur. As autonomia e parashikuar për palestinezët në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës nuk u realizua. Si pasojë, reagimi i botës arabe ndaj paqes së veçantë Egjipt–Izrael ishte negativ, duke çuar në pezullimin e përkohshëm të anëtarësimit të Egjiptit në Lidhjen Arabe në vitin 1979. Në të njëjtën kohë, përpjekjet për një zgjidhje gjithëpërfshirëse të konfliktit vazhduan, por u penguan nga rivaliteti i superfuqive, Lufta Iran–Irak, shpërbërja e shtetit libanez, përçarjet brenda botës arabe dhe politikat izraelite të vendbanimeve. Në këtë kontekst, Izraeli aneksoi Jerusalemin Lindor më 30 korrik 1980 dhe Lartësitë e Golanit më 14 dhjetor 1981.

Në vitin 1981, Arabia Saudite paraqiti një plan paqeje me tetë pika (Plani Fahd), i cili parashikonte krijimin e një shteti palestinez në Bregun Perëndimor, Rripin e Gazës dhe Jerusalem Lindor, duke nënkuptuar në mënyrë të tërthortë edhe njohjen e të drejtës së Izraelit për ekzistencë. Ky plan u miratua nga Samiti Arab në Fez më 1982, duke shënuar përpjekjen e parë për një qëndrim relativisht të unifikuar arab.

Në të njëjtin vit, Bashkimi Sovjetik shprehu mbështetje për qëndrimet arabe, duke theksuar gjithashtu nevojën për garanci sigurie për Izraelin. Paralelisht, Presidenti amerikan Ronald Reagan paraqiti një plan paqeje që parashikonte njohje reciproke midis palëve, autonomi për Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës në bashkëpunim me Jordaninë, si dhe tërheqjen e Izraelit nga këto territore, por pa krijimin e menjëhershëm të një shteti të pavarur palestinez.

Përpjekjet diplomatike u ndërlikuan më tej nga situata në Liban dhe nga dështimi i marrëveshjes izraelito-libaneze të vitit 1983, e cila u rrëzua për shkak të kundërshtimit sirian. Gjithashtu, iniciativat e përbashkëta të Mbretit Husein të Jordanisë dhe Yasser Arafatit në vitet 1985–1986 nuk sollën rezultate konkrete.

Në vitin 1988, Sekretari i Shtetit i SHBA-së George Shultz propozoi një plan me dy faza, që parashikonte negociata midis Izraelit dhe një delegacioni jordano-palestinez, si dhe një konferencë ndërkombëtare paqeje. Megjithatë, nën ndikimin e Intifadës së parë, Jordania hoqi dorë nga pretendimet e saj mbi Bregun Perëndimor në korrik 1988.

Ndryshimet strategjike të fillimit të viteve 1990, veçanërisht Lufta e Gjirit (1990–1991) dhe rënia e Bashkimit Sovjetik, krijuan kushte të reja për procesin e paqes, duke e vendosur Shtetet e Bashkuara në rolin e ndërmjetësit kryesor. Konferenca e Madridit (30 tetor 1991) nuk solli rezultate vendimtare, por hapi rrugën për negociata të mëtejshme.

Një përparim i rëndësishëm u arrit në fillim të viteve 1990 me negociatat sekrete në Norvegji, të cilat çuan në Marrëveshjet e Oslos (13 shtator 1993), ku Izraeli dhe OÇP-ja njohën reciprokisht njëra-tjetrën dhe ranë dakord për hapa fillestarë drejt paqes. Kjo u pasua nga Marrëveshja e Gazës dhe Jerikos (1994) dhe Marrëveshja e Dytë e Oslos (1995), si dhe nga traktati i paqes midis Izraelit dhe Jordanisë në vitin 1994. Megjithatë, vrasja e Kryeministrit izraelit Yitzhak Rabin në vitin 1995 shënoi një kthesë negative për procesin e paqes.

Në vitet në vijim, procesi u ngadalësua ndjeshëm, sidomos pas ardhjes në pushtet të Benjamin Netanyahu në vitin 1996, i cili kundërshtoi krijimin e një shteti palestinez dhe ndryshimin e statusit të Jerusalem.

Pas zgjedhjes së Ehud Barakut në vitin 1999, procesi i paqes u rigjallërua përkohësisht. Memorandumi i Sharm el-Sheikh (1999) dhe tërheqja izraelite nga Libani jugor në vitin 2000 u konsideruan hapa pozitivë, por negociatat përfundimtare mbetën të pasuksesshme. Samiti i Camp David-it në korrik 2000 midis Bill Clinton, Ehud Barak dhe Yasser Arafat dështoi të arrinte një marrëveshje për çështjet kryesore të konfliktit, përfshirë:

- statusin e Jerusalemit Lindor,
- të ardhmen e vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor,
- çështjen e refugjatëve palestinezë,
- ndarjen e burimeve ujore,
- përcaktimin e kufijve,
- dhe garancitë e sigurisë për të dy palët.

Përfundime

Në përfundim të këtij punimi të shkurtër, me karakter përshkrues dhe përmbledhës, mund të konstatohet se konflikti në Lindjen e Mesme, deri në fillim të shekullit XXI, ka qenë një proces i gjatë dhe kompleks, i ndikuar nga faktorë historikë, fetarë, politikë dhe territorialë, ku çështja e tokës dhe e identitetit kombëtar ka përbërë thelbin e mosmarrëveshjeve.

Krijimi i shtetit të Izraelit në vitin 1948 shënoi një pikë kthese vendimtare në zhvillimin e konfliktit, duke sjellë një sërë luftërash ndërmjet Izraelit dhe shteteve arabe fqinje, si dhe duke thelluar çështjen e refugjatëve palestinezë.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, konflikti u ndikua ndjeshëm nga rivaliteti ndërmjet fuqive të mëdha, ku shtetet e rajonit u mbështetën nga blloqe të ndryshme politike dhe ushtarake, duke e bërë situatën edhe më të ndërlikuar.

Procesi i paqes, veçanërisht gjatë viteve 1990 me Marrëveshjen e Oslos, përfaqësoi një përpjekje serioze për arritjen e një zgjidhjeje diplomatike, duke sjellë për herë të parë njohje reciproke ndërmjet palëve kryesore të konfliktit.

Megjithatë, pengesa të tilla si mungesa e besimit të ndërsjellë, ekstremizmi politik dhe çështjet e pazgjidhura, si statusi i Jerusalemit, problemi i refugjatëve, kufijtë dhe vendbanimet, kanë penguar arritjen e një paqeje të qëndrueshme.

Vrasja e Yitzhak Rabin në vitin 1995 dëshmoi brishtësinë e procesit të paqes dhe ndikimin e konsiderueshëm që faktorët e brendshëm politikë mund të ushtrojnë mbi ecurinë e tij.

Deri në fund të vitit 2000, konflikti mbeti i pazgjidhur, duke treguar se zgjidhja e tij kërkon kompromis të ndërsjellë, vullnet politik, dialog të vazhdueshëm dhe mbështetje të qëndrueshme nga komuniteti ndërkombëtar.

Rekomandime

Siç u theksua edhe në hyrje të këtij artikulli, synimi kryesor i tij ka qenë paraqitja e një tabloje të qartë, të përmbledhur dhe sa më objektive mbi konfliktin në Lindjen e Mesme, duke trajtuar origjinën e tij, zhvillimin historik, faktorët që kanë ndikuar në përshkallëzimin e tij, si dhe situatën e konfliktit deri në fund të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI.

Artikulli merr në konsideratë aktorët kryesorë të përfshirë në konflikt dhe përpiqet të pasqyrojë në mënyrë të paanshme qëndrimet, interesat dhe veprimet e tyre, duke evidentuar përpjekjet e ndërmarra për arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe të pranueshme për të gjitha palët.

Në këtë kuadër, rekomandohet që ky material të shërbejë si literaturë orientuese për studiuesit, punonjësit shkencorë, studentët e shkencave politike, marrëdhëniet ndërkombëtare, historisë, studimeve të sigurisë, si dhe për analistët dhe ekspertët e kësaj fushe. Njohja me këtë material mund të kontribuojë në zgjerimin e njohurive mbi konfliktin, në kuptimin më të thellë të shkaqeve dhe dinamikave të tij, si dhe në formimin e një gjykimi sa më objektiv, kritik dhe të mbështetur mbi analiza shkencore.

Bibliografia

1. Hollstein, Walter: Kein Friede um Israel – Zur Sozialgeschichte des Palästinakonflikts, Bonn 1977.
2. Johannsen, Margret: Palästina – Staatsgründung auf Raten, in: Deutsches Übersee-Institut (Hrsg.): Jahresbuch Dritte Welt 2000, München 1999, f. 215-225.
3. Lewis, Sammuel W.: The United States and Israel. Evolution of an unwritten alliance, in: The Middle East Journal, Jg53, H. 3: Special Issue on Israel, Washington 1999, f.364-378.
4. Neifeind, Harald: Der Nahostkonflikt – historisch, politisch, literarisch, Schwalbach/Ts. 1999.
5. Parker, Christopher H.: Resignation or revolt? The socio-political development and the challenges of peace in Palestine, London 1999.
6. Schreiber, Friedrich/Wolffsohn, Michael: Nahost. Geschichte und Struktur eines Konflikts, Opladen 1996.
7. The Middle East and North Africa 2000, London: Europa Publications 1999.
8. Wagner, Heinz: Der Arabisch-Israelische Konflikt im Völkerrecht, Berlin 1971.
9. <http://www.mfa.gov.il/mfa/home.asp>
10. <http://www.palestina.org>

Një vështrim historik mbi shërbimet inteligjente gjatë Luftës së Ftohtë

Major Msc. Kujtim ZEKA

Pedagog në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Kolonel Msc. Myslym RRASA

Shef Shtabi në Bazën Ajrore, Kuçovë

Trajtesë e shkurtuar

Në këtë punim trajtohen aspektet historike të veprimtarisë së shërbimeve inteligjente të SHBA-së, ish-Bashkimit Sovjetik dhe Britanisë së Madhe gjatë Luftës së Ftohtë. Në mënyrë të përmbledhur paraqitet rëndësia e grumbullimit, ruajtjes, administrimit dhe shfrytëzimit të sekreteve shtetërore, veçanërisht atyre me karakter ushtarak, teknologjik dhe ekonomik. Studimi paraqet fakte historike mbi masat e ndërmarra, kryesisht nga SHBA-ja dhe ish-Bashkimi Sovjetik, për drejtimin, mbështetjen dhe orientimin e veprimtarisë së shërbimeve të zbulimit, si dhe për sigurimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve sekrete.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, shërbimet inteligjente të fuqive të mëdha kishin si mision kryesor grumbullimin, administrimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve sekrete, me qëllim zbulimin e planeve ushtarake të vendeve kundërshtarë dhe parandalimin e veprimtarive që cenonin sigurinë kombëtare. Në këtë kuadër, ato zhvilluan veprimtari operative intensive për identifikimin dhe goditjen e grupeve që kryenin akte terroriste, sabotazhi ose veprimtari të tjera kundër interesave shtetërore.

Një rëndësi e veçantë në këtë punim i kushtohet masave të ndërmarra nga SHBA-ja, ish-Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe për parandalimin e rrjedhjes së informacionit sekret, si dhe teknikave të përdorura nga shërbimet inteligjente për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e sekreteve shtetërore.

Punimi thekson se informacionet ushtarake, politike dhe tekniko-

teknologjike me karakter sekret shtetëror konsiderohen jetike për garantimin e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e shtetit dhe përballimin e kërcënimeve ushtarake e terroriste. Në përfundim, argumentohet se siguri, ruajtja dhe shfrytëzimi i dokumenteve sekrete ushtarake përbënin një prioritet të vazhdueshëm të strukturave të larta politike dhe ushtarake, duke mbështetur veprimtarinë operacionale të forcave të armatosura dhe strukturave të sigurisë, si dhe duke rritur efektivitetin luftarak dhe aftësinë e tyre zbuluese.

Fjalët kyçe: Shërbimet inteligjente, sekretet shtetërore, KGB, CIA, Lufta e Ftohtë.

Hyrje

Fuqitë e mëdha kanë treguar gjithnjë angazhim të konsiderueshëm për grumbullimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, veçanërisht atyre me përmbajtje sekrete shtetërore. Është me interes të theksohen fakte historike, si ai i vitit 1945. Armata e Parë Amerikane konfiskoi 485 ton dokumente të zakonshme dhe sekrete të Ministrisë së Punëve të Jashtme Gjermane, të përgatitura që prej vitit 1868, e deri në vitin 1945. Me mijëra dokumente naziste të kapura, u grumbulluan me ngut në Nuremberg, me qëllim përdorimin e tyre në gjyqin kundër kriminelëve kryesorë nazistë të Luftës së Dytë Botërore¹.

Gjatë periudhës të Luftës së Ftohtë (1945-1990), grumbullimi, ruajtja dhe shfrytëzimi i sekreteve shtetërore mori një rëndësi të veçantë në funksion të rivalitetit ideologjik, politik dhe ushtarak midis fuqive të mëdha botërore. Në këtë kontekst, ku përballeshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj perëndimor me ish-Bashkimin Sovjetik dhe bllokun lindor, informacioni i klasifikuar u shndërrua në një nga armët më strategjike më të fuqishme të kohës. Shërbimet inteligjente si CIA në SHBA, MI6 në Mbretërinë e Bashkuar dhe KGB në ish-Bashkimin Sovjetik, luajtën një rol kyç në mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Aktiviteti i tyre nuk kufizohej vetëm në veprimtarinë e spiunazhit tradicional, por përfshinte dhe operacione të fshehta si ndërhyrje politike në vende të ndryshme, propagandë për përmbysjen e regjimeve, si dhe operacione të ndryshme sabotazhi dhe psikologjike.

Gjatë periudhës të Luftës së Ftohtë, fuqitë e mëdha rekrutuan edhe shumë gra në shërbimet e zbulimit ku ato luajtën një rol të rëndësishëm në grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve sekrete. Liza Mundy në shkrimin e saj, *Si u bënë gratë pjesë e shërbimeve sekrete gjatë Luftës së Dytë Botërore*, veçon

¹ William Shirer, *Ngrija dhe Rënia e Rajhut të Tretë*, Shtëpia Botuese Onufri, Tiranë 2019, f.10.

aftësitë e tyre ku ndër të tjera shpreh, se disa oficerë mendonin se gratë kishin ndjeshmëri dhe një instikt kujdesi më të zhvilluar sesa meshkujt, çka i pajiste ato me aftësitë e duhura për të rekrutuar dhe mbështetur qytetarët e zakonshëm si agjentë².

Në vendet perëndimore sekreti shtetëror përdorej kryesisht si instrument për mbrojtjen e interesave strategjike dhe operacioneve specifike, ndërsa në ish-Bashkimin Sovjetik ai ishte i integruar në strukturën e vetë sistemit politik, duke shërbyer si mekanizëm kontrolli mbi shoqërinë dhe informacionin. Pavarësisht hapësirës së veprimit që kishin agjentët e KGB-së për të mbledhur dokumente sekrete dhe për të rekrutuar zyrtarë të lartë në vendet perëndimore, shërbimet e zbulimit dhe të kundërzbulimit sovjetik kishin një centralizim të fortë sa i takon veprimtarisë së tyre. Agjentëve nuk u lihej në dorë asnjë lloj nisme dhe për pasojë, çdo operacion që u përkiste shërbimeve inteligjente, deri edhe për hollësitë më të vogla, vendosej në Moskë³.

Ky punim synon të paraqesë rolin dhe rëndësinë e dokumenteve sekrete gjatë Luftës së Ftohtë, duke u ndalur në disa prej veprimtarive kryesore të shërbimeve inteligjente të SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe ish-Bashkimit Sovjetik. Në periudhën e Luftës së Ftohtë, ishte jetike për shërbimet sekrete të fuqive të mëdha, të grumbullonin, ruanin, përpunonin dhe të shfrytëzonin dokumentet sekrete. Këto masa kishin për qëllim zbulimin, parandalimin dhe goditjen e grupeve të ndryshme që mund të kërcënonin sigurinë dhe sovranitetin e vendeve komuniste të ish-bllokut të lindjes dhe vendeve perëndimore. Studiuesi i fushës së sigurisë dhe mbrojtjes S. Gega, në librin e tij, “Dimensioni i Sigurisë së Shtetit dhe Forcat e Armatosura”, thekson se: “Shteti ekziston kur ka një territor të caktuar dhe një aparat politik (institucione qeveritare) që sundojnë, e pushteti i të cilëve mbështetet në një sistem ligjor ku është i aftë për të përdorur forcën dhe punën agenturore për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe administrimin e informacioneve sekrete, me qëllim zbatimin e politikave të tij për mbrojtjen dhe garantimin e sigurisë kombëtare”⁴.

Sigurimi dhe verifikimi i burimeve të informacioneve sekrete, veçanërisht gjatë konflikteve të ndryshme, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimin e rrjedhjes së shumë ngjarjeve. Në librin “Tricikli” të autorit D. Popov, pasqyrohet një përkufizim i qartë mbi kuptimin dhe burimin e informacionit, ku theksohet se: “*Sipas shërbimit informativ të shtabit të përgjithshëm gjerman*

² Liza Mundy, *Si u bënë gratë pjesë e shërbimeve sekrete gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Gazeta “Koha Jonë”, publikuar më: 26.09.2021, 17:27.

³ Xhin Brus, *Agjenti 117 në Meksikë*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë. Tiranë, 1993, f.78.

⁴ Simon Gega, “*Dimensioni i Sigurisë së Shtetit dhe Forcat e Armatosura*”, Shtëpia Botuese “Kristalina-KH”, Tiranë 2013, f.22.

të periudhës së Luftës të Dytë Botërore, informata nuk mund të quhet informatë, deri sa ajo të mos jetë e vërtetuar njëkohësisht nga disa burime të pavarura nga njëri-tjetri”⁵.

1. Aspekte nga veprimtaria e KGB gjatë Luftës së Ftohtë

KGB (Komiteti për Sigurimin e Shtetit) në ish-Bashkimin Sovjetik u themelua në vitin 1954 dhe ishte një nga agjencitë më të fuqishme të inteligjencës në historinë moderne. Ajo kishte një rol të dyfishtë: nga njëra anë merrej me surveimin dhe operacionet jashtë vendit, ndërsa nga ana tjetër siguronte stabilitetin e regjimit komunist brenda ish-Bashkimit Sovjetik⁶. Struktura e saj ishte e ndarë në drejtori të specializuara, ku Drejtoria e Parë kryesore merrej me inteligjencën e jashtme, ndërsa Drejtoria e Dytë fokusohej në kundërspiunazhin dhe kontrollin e brendshëm⁷.

Në librin “Veprimtaria e Errët e KGB-së dhe një dëshmi e Sollexhënicinit”, të autorit Xh. Barron, vërejmë ndër të tjera, se asnjë vend tjetër gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë nuk e ka praktikuar veprimtarinë agjenturore në mënyrë kaq intensive dhe provokuese, se sa ish-Bashkimi Sovjetik. Në këtë botim pasqyrohet gjithashtu se, prej dhjetëra vitesh KGB-ja përdori sistematikisht një numër të lartë agjentësh për të mbledhur informacione mbi shpikjet e vendeve të tjera në fushat shkencore, industriale dhe ushtarake. Ajo shfrytëzoi agjentët për të rekrutuar shtetas të huaj, me qëllim sigurimin e dokumenteve sekrete.

KGB-ja arriti të depërtonte dhe të siguronte informacione sekrete tek profesorët e fizikës bërthamore Klaus Fuks dhe Alan May, të cilët jetonin dhe shërbenin në projektet sekrete bërthamore të Britanisë së Madhe⁸. Një nga karakteristikat kryesore të KGB-së ishte rrjeti i saj i gjerë i agjentëve dhe informatorëve në mbarë botën. Ajo arriti të depërtonte në institucione kyçe të vendeve perëndimore, duke përfshirë qeveri, organizata ndërkombëtare dhe struktura ushtarake. Një shembull i njohur ishte rrjeti i spiunëve të njohur si “Cambridge Five” në Britaninë e Madhe, të cilët i siguruan ish-Bashkimit Sovjetik informacione të rëndësishme për dekada⁹.

⁵ Dushko Popov, “*Tricikli Agjenti i Dyfishtë*”, Shtëpia Botuese e Ushtisë, Tiranë 1994, f.35.

⁶ Christopher Andrew & Oleg Gordievsky, *KGB The Inside Story of Its Foreign Operations from Lenin to Gorbachev* (London: Hodder & Stoughton, 1990).

⁷ Mark Galeotti, *The KGB: A Very Short Introduction* (Oxford: Oxford University Press, 2017).

⁸ Xhon Barron, *Veprimtaria e errët e KGB dhe një dëshmi e Sollexhënicinit*, Shtëpia Botuese Arbri, Tiranë 1993, f.161.

⁹ Ben Macintyre, *A Spy Among Friends: Kim Philby and the Great Betrayal* (London: Bloomsbury, 2014).

Po të vështrojmë në përgjithësi aktivitetin e KGB-së, vërejmë se kjo agjenci e sigurimit të fshehtë e ish-Bashkimit Sovjetik dërgonte agentë të ndryshëm në vendet e huaja. Ata në fillim shërbenin zyrtarisht si anëtarë të stafit diplomatik, si atashe kulturorë, ushtarakë, gazetarë të autorizuar, ose si përfaqësues tregtarë. Në rast se këta persona dyshoheshin për veprimtarinë e tyre, ata nuk mund të gjykoreshin si agentë të infiltruar, por shpallehin persona të padëshiruar.

KGB-ja dërgonte kudo në botë agentët e saj të cilët hiqeshin si qytetarë të zakonshëm. Ata merrnin të gjitha masat për të fshehur identitetin e tyre të vërtetë, duke lëvizur me pasaporta false. Autori Xhin Brus, në librin e tij, “Agjenti 117 në Meksikë”, trajton ndër të tjera faktin se shërbimet sekrete dhe policia meksikane, duke njohur aleancën politike dhe ushtarake që kishte Kuba me ish-Bashkimin Sovjetik, i fotografonin të gjithë pasagjerët e shoqërisë ajrore kubaneze. Por agentët rusë maskoheshin duke përdorur pasaporta false me emra të rremë¹⁰.

Përveç spiunazhit tradicional, KGB-ja ishte shumë aktive në operacionet e ashtuquajtura “masa aktive”, që përfshinin dezinformimin, propagandën dhe manipulimin e opinionit publik në vendet perëndimore. Këto operacione kishin për qëllim destabilizimin e kundërshtarëve dhe forcimin e ndikimit sovjetik në arenën ndërkombëtare. Ndër strategjitë më të përdorura ishte përhapja e lajmeve të rreme për të minuar besimin ndaj institucioneve demokratike të vendeve perëndimore¹¹. Gjatë vjeshtës së vitit 1979, KGB-ja realizoi me sukses operacionin e koduar “Fundi i Artë”, ku rekrutoi një punonjës që shërbente në repartet e luftës psikologjike të ushtrisë amerikane në Gjermaninë Perëndimore¹².

Nëpërmjet këtij agjenti, KGB siguroi informacione të konsiderueshme mbi projektin e raketave MX dhe “Tomahok”, duke filluar që nga stadi i përpunimit, e deri tek skicat përfundimtare që ishin dhënë për prodhim. Gjithashtu, u siguruan informacione të vlefshme edhe për raketat balistike “Trident”, të cilat do të përdoreheshin nga nëndetëset amerikane, si dhe për projektin më të ri të bombarduesit strategjik¹³.

KGB-ja, arriti gjithashtu të zhvillojë me sukses operacionin e koduar “Qendra”, ku nëpërmjet rreshterit amerikan Robert Li Xhonson siguroi dokumente tepër sekrete të Pentagonit dhe NATO-s.

¹⁰ Xhin Brus, *Agjenti 117 në Meksikë*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë. Tiranë, 1993, f.11.

¹¹ Thomas Rid, *Active Measures: The Secret History of Disinformation and Political Warfare*, (New York: Farrar, Straus and Giroux, 2020).

¹² Andrea Shkodrani, *Spiunazh, (Operacione Brillante)*, Shtëpia Botuese “Elitë”, Tiranë 2003, f.103.

¹³ Po aty, f.106.

Rreshteri i ushtrisë amerikane Robert Li Xhonson, i cili shërbente në administratën e Berlinit Perëndimor, u rekrutua si agjent i KGB-së dhe iu dorëzoi sovjetikëve informacione sekrete shumë të vlefshme. Ai u kishte dorëzuar rusëve planet operative të ushtrisë amerikane në Evropë, ku ndër të tjera informacionet e dhëna pasqyronin të gjitha detajet mbi listën e qyteteve dhe të objekteve strategjike sovjetike që do të goditeshin, në rast të një sulmi atomik. Rreshteri i ushtrisë amerikane Robert Li Xhonson deri më datën 20 prill të vitit 1963, kishte arritur të kontaktonte shtatë herë me agjentët e KGB-së, duke iu dorëzuar atyre rreth 90 zarfe të mëdha të cilat ishin të mbushura me shifra dhe dokumente sekrete të ushtrisë amerikane¹⁴.

Pasi u zbulua veprimtaria agjenturore e rreshterit amerikan R.L.Xhonson, Pentagoni dha një deklaratë, ku shprehu: *“Nuk mund të vlerësohet ekzaktesisht dëmi që na është shkaktuar. Disa nga këto dëme nuk mund të riparohen e të rivlerësohen po të mos e kishim zbuluar këtë çështje, dhe në qoftë së do të kishte filluar lufta, humbjet tona do të ishin fatale”*¹⁵. Pavarësisht konspiracionit të lartë që ushtroi Pentagoni në veprimtarinë e tij për ruajtjen e dokumenteve sekrete, veprimet agjenturore të Rreshterit Robert Li Xhonson, treguan se edhe strukturat më të fuqishme ushtarake mund të dështonin në ruajtjen dhe administrimin e informacioneve të klasifikuara, siç ishin sekretet shumë të rëndësishme shtetërore. Këto sekrete, do të kishin një ndikim të drejtpërdrejtë për suksesin apo dështimin e operacioneve të ndryshme luftarake.

Sipas autorit Xh. Barron, edhe forcat e armatosura sovjetike ishin nën përgjim. Ai thekson se: *“Nëse ideja e lirisë bëhet me kalimin e kohës e rrezikshme për diktaturën, pushkët e ushtrisë sovjetike po të drejtohen keq, janë vdekjeprurëse dhe kjo ishte arsyeja se përse KGB-ja i përgjonte para së gjithash ushtarakët”*¹⁶. Drejtoria e Forcave të Armatosura ishte një organ i rëndësishëm dhe vital për KGB-në. Ajo kishte dymbëdhjetë departamente kryesore që kontrollonin ministrinë e mbrojtjes; Shtatmadhorinë e Përgjithshme; Forcat Tokësore; Marinën Luftarake; Forcat Ajrore; Trupat Kufitare të KGB-së; Njësitë e Raketave; Forcat Bërthamore; Aviacionin Civil dhe Distriktin Ushtarak të Moskës. Oficerët e kësaj drejtorie mbanin poste në të gjitha shkallët e hierarkisë së Forcave të Armatosura Sovjetike, nga niveli më i lartë, deri në nivelet më të ulëta. Ndonëse mbanin uniformën ushtarake, oficerët e KGB-së, vareshin sipas shkallës së hierarkisë nga Shtatmadhuria e KGB-së dhe në shumë raste mund të mos zbatonin urdhrat e forcave të

¹⁴ Xhon Barron, *Veprimtaria e errët e KGB dhe një dëshmi e Sollxhenicinit*, Shtëpia Botuese “Arbri”, Tiranë 1993, f.196.

¹⁵ Andrea Shkodrani, *Spiunazh, (Operacione Brilante)*, Shtëpia Botuese “Elitë”, Tiranë 2003, f.84.

¹⁶ Xhon Barron, *Veprimtaria e errët e KGB dhe një dëshmi e Sollxhenicinit*, Shtëpia Botuese “Arbri”, Tiranë 1993, f.28.

armatosura¹⁷. Në rastet kur ushtarakët shkelnin rregullat e ruajtjes së sekretit shtetëror, KGB-ja nuk bënte asnjë përjashtim në trajtimin e tyre. Në vitin 1968, oficerë të KGB-së shkuan për kontroll në shtëpinë e një oficeri të dekoruar, majorit Genrik Altunian, i cili punonte si instruktor në një shkollë ushtarake të Karkovit Aty zbuluan kopje të daktilografuara të *Pavionit të kancerözëve* të Solxhenicinit dhe të kronikës së ngjarjeve bashkëkohore. Majori Henrik Altunian u përjashtua nga partia, nga ushtria dhe u dënua me tre vite punë të detyruar, me akuzën për shumëfishimin e dokumenteve sekrete dhe veprimtari antisovjetike¹⁸.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i veprimtarisë së KGB-së ishte konkurrenca teknologjike me Perëndimin. Gjatë Luftës së Ftohtë, të dy superfuqitë investuan në zhvillimin e pajisjeve të avancuara të spiunazhit, përfshirë përgjues të sofistikuar, kamera të fshehta dhe teknologji për interceptimin e komunikimeve. Kjo garë teknologjike kontribuoi në rritjen e kapaciteteve të inteligjencës dhe ndikoi edhe në zhvillimin e teknologjive moderne të sigurisë¹⁹.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, KGB-ja ishte e bindur se e gjithë ambasada sovjetike ishte subjekt i një fushate gjigande dhe të përhershme përgjimi. Ata hamendësonin se britanikët kryenin veprimtari zbuluese në kushte të larta konspiracioni. Sovjetikët mendonin se pranë ambasadës së tyre në Londër ishin hapur tunele shumë afër, me qëllim vendosjen e aparaturave përgjuese për mbledhjen e informacioneve sekrete. Në ambientet e brendshme të ambasadës sovjetike kishte tabela paralajmëruese ku shkruhej: “*Mos flisni me zë të lartë emra apo data*”. Dritaret ishin të mbyllura me tulla për të parandaluar përgjimet e mundshme²⁰.

Disa aspekte mjaft interesante mbi masat që zbatoi KGB-ja për t’u mbrojtur nga përgjimet e mundshme të vendeve perëndimore, pasqyrohen në rrëfimet e ish-shefit të Shërbimeve Sekrete Rumune në librin e tij, “*Prapaskenat e Shtëpisë Çausheku*”, ku ndër të tjera nënvizonte se KGB-ja kërkonte që zyrat dhe rezidencat private të udhëheqësve komunistë, të kontrolloheshin rregullisht për të zbuluar mikrofona apo mikrokamera të vendosura nga shërbimet sekrete perëndimore. Çdo mëngjes, të gjithë telefonat i zëvendësonin me aparate identike të kontrolluara dhe të vulosura²¹. Edhe linjat kontrolloheshin përditë për të diktuar ndonjë përgjim eventual të huaj.

¹⁷ Po aty, f.29.

¹⁸ Po aty, f.30.

¹⁹ *Armët sekrete të spiunazhit të Luftës së Ftohtë*, “Radio Evropa e Lirë, 2024.

²⁰ Ben Macintyre, *Spiuni dhe Tradhtari*, Shtëpia Botuese “Boart”, Tiranë 2019, f.132.

²¹ Jon Mihai Paçepa, *Prapaskenat e Shtëpisë Çausheku, (rrëfimet e ish-Shefit të Shërbimeve Sekrete Rumune)*, Botimet Enciklopedike, Tiranë 2004, f.68.

Sistemi i zbulimit të rrezatimeve i fshehur në kornizën e derës, testohej çdo mëngjes, ashtu si edhe aparatet matës të tipit Geiger, si dhe aparate të tjerë fshehur në zyrë. Një herë në javë, në muret, në tavanet, e në dyshemetë e zyrave dhe të rezidencave qeveritare, lëshoheshin rreze X për të zbuluar praninë e mundshme të mikrofonave apo të mikrokamerave”²².

Gjatë Luftës së Ftohtë, shumë vende i mbajtën të fshehta arrestimet e agjentëve të KGB-së, me qëllim depërtimin dhe mbledhjen e dokumenteve sekrete që kishin ndikim të rëndësishëm në fushën ushtarake ose teknologjike²³. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe pati edhe veprime të hapura për dëbimin e të dyshuarve si agjentë.

Me datën 24 shtator të vitit 1971, Britania e Madhe dëboi nga territori i saj 105 oficerë të zbulimit sovjetik të implikuar në një fushatë gjithnjë e më të hapur korrupsioni të funksionarëve dhe të vjedhjes së informacioneve sekrete teknologjike. Kurrë më parë, asnjë vend nuk ishte sjellë ndaj KGB-së me kaq ashpërsi se sa Britania e Madhe, duke likuiduar një qendër të tërë subversioni nëpërmjet dëbimeve masive të personave që dyshoheshin për veprimtari agjenturore²⁴.

2. CIA gjatë Luftës së Ftohtë

Nëse i referohemi shërbimit inteligjent amerikan, CIA-s (Central Intelligence Agency), vërejmë se për të mbledhur informacione sekrete gjatë Luftës së Ftohtë dhe për të realizuar punën operative për grumbullimin e dokumenteve sekrete, ajo përdori dy metoda: së pari, burimet njerëzore dhe së dyti, burimet jo-njerëzore, siç ishin literaturat, mjetet e informacionit masiv legal dhe jo-legal, mjetet tekniko-shkencore të vëzhgimit dhe të përgjimit²⁵. Drejtimit kryesore të punës së CIA-s për sigurimin e dokumenteve sekrete ishin të shumta, por në radhë të parë ajo pati si detyrë mbledhjen dhe sigurimin e të dhënave me karakter politik, ekonomik, ushtarak (taktik e strategjik), kulturor dhe shoqëror ndaj vendeve të huaja²⁶.

Një sfidë e madhe për CIA-n ishte siguri i informacioneve sekrete nga burime të besueshme, me qëllim që të përmbushte objektivat e saj në kohën e duhur për të parandaluar çdo sulm apo kërcënim të mundshëm, veçanërisht nga ish-Bashkimi Sovjetik. Pavarësisht aftësive dhe profesionalizmit të

²² Po aty.

²³ Xhon Barron, *Veprimtaria e errët e KGB dhe një dëshmi e Sollxhenicinit*, Shtëpia Botuese “Arbri”, Tiranë 1993, f.164.

²⁴ Po aty, f.201.

²⁵ Hasan B.Luçi, *CIA nëpër botë gjatë Luftës së Ftohtë (1947 - 1990)*, Shtëpia Botuese “Julvin”, Tiranë 2018, f.113.

²⁶ Po aty, f.115.

punonjësve të shërbimit inteligjent amerikan, ata nuk arritën të parandalonin depërtimin e KGB-së në SHBA.

Në vitin 1960, nënkoloneli i sigurimit të brendshëm në Senatën Amerikanë përpiloi një listë me 37 çështje të spiunazhit sovjetik kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të zbuluara gjatë viteve '50'²⁷. Një studim për përdorim të brendshëm i qeverisë amerikane, zbuloi se në vitet '60', agjentët sovjetikë u kishin bërë propozime subversive diplomatëve dhe qytetarëve amerikanë në 18 vende të ndryshme, me qëllim sigurimin e dokumenteve sekrete. Vetëm në Indi, KGB-ja kishte hyrë në kontakt me 70 diplomatë dhe 25 funksionarë të ambasadës amerikane²⁸.

Andrew Hammond, i cili shërben si historian në Muzeun Ndërkombëtar të Spiunazhit në Uashington, është shprehur se dyshimi për përdorimin e armëve energjetike të drejtuara ndaj amerikanëve të vendosur jashtë vendit, u shfaqën fillimisht gjatë Luftës së Ftohtë. Ai ndër të tjera pohon se, ne kemi dëshmi historike që kjo çështje është diskutuar në të kaluarën në nivelin më të lartë politik²⁹. Në vitin 1967, Sekretari amerikan i Shtetit Dean Rusk, ngriti dyshime se Ambasada e SHBA-së në Moskë po shenjtërohej me një "sinjal elektromagnetik". Rrezja e energjisë më vonë u bë e njohur si "Sinjali i Moskës" dhe përfundimisht u vendosën veshje kundër rrezatimit në dritaret e ambasadës³⁰.

Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së më vonë përsëriti rrezën e energjisë dhe e testoi atë te majmunët. U hartuan plane për të testuar pajisjet me lazer në subjekte njerëzore që nuk ishin të informuar për këtë para se projekti të anulohet. Duke përfrazuar Dr. Hammond, ndër të tjera ai theksonte se ishte e pamundur të dihej se si do të dukej një pajisje moderne më e fuqishme se instrumenti i kohës së Luftës së Ftohtë. Ai nënvizonte se nëse do të dinim se çfarë ishin këto pajisje, do të ishim në gjendje të kuptonim efektin që mund të kishin ose që nuk mund të kishin. Gjithashtu do përcaktonim se sa të fuqishme janë dhe sa do të kushtonin për t'u prodhuar. Ai e përfundon qëndrimin e tij për këtë çështje, duke shtuar se për momentin jemi në errësirë, në kuptimin se nuk ka informacione konkrete në lidhje me këto pajisje³¹.

Lufta e Ftohtë u karakterizua nga përpjekje të mëdha të SHBA-së dhe ish-Bashkimit Sovjetik për grumbullimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve sekrete. Autori J. Evans, në shkrimin e tij *Operacioni sekret i CIA-s që fitoi Luftën e Ftohtë*,

²⁷ Xhon Barron, *Veprimtaria e errët e KGB dhe një dëshmi e Sollxhenicinit*, Shtëpia Botuese "Arbri", Tiranë 1993, f.161.

²⁸ Po aty, f.164.

²⁹ *Armët sekrete të spiunazhit të Luftës së Ftohtë*, LAPSI.al, publikuar më: 07.04.2024, 21:21.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty.

të botuar në “The Daily Telegraph”, pasqyron një nga veprimtaritë me karakter të veçantë të CIA-s gjatë Luftës së Ftohtë, ku ai shkruan se qysh në vitin 1949, CIA financoi kontrabandimin e librave në Poloni, duke përdorur dosjet telefonike të Evropës Lindore për t’i dërguar ato drejtpërdrejtë te njerëzit. Në vitin 1975, ajo themeloi “Qendrën Ndërkombëtare të Letërsisë” me qendër në Manhattan, e cila drejtohej nga George Minden. Zgjerimi i rrjetit të tij i përbërë nga botues, filantropë dhe mërgimtarë të tjerë, filloi të kontrabandonte miliona tituj librash të ndaluar në Poloni dhe në vende të tjera, me autorë që shkonin nga Hannah Arendt deri tek Agatha Christie³².

Ky operacion me karakter kulturor ushtroi një ndikim të konsiderueshëm në disa prej vendeve kryesore të ish-bllokut lindor. Në vitin 1991, kur G.Mindeni shkroi raportin e tij të fundit përpara se të jepte dorëheqjen, Qendra Ndërkombëtare e Letërsisë kishte shpërndarë pothuajse dhjetë milionë libra, revista dhe kaseta në Poloni, Çekosllovakia, Hungari, Rumani dhe Bullgari, në një periudhë prej 35 vitesh. Ky ishte një operacion me rëndësi të madhe kulturore dhe politike, me pak ose aspak pasoja anësore³³.

Një aspekt shumë i rëndësishëm që hedh dritë mbi qëllimet dhe metodat e përdorura nga CIA, ishte dhe ndërtimi i “Tunelit të Përgjimit” (tunelit nëntokësor, i hapur në territorin e Berlinit Lindor). Ky tunel ishte 1.5 metër nën tokë, me diametër rreth 2 metra, i gjatë rreth 600 metra, në zonën kufitare të Rudou-t, ku fillonte në një pus të thellë 6 metra afër një stacioni radari amerikan dhe kalonte nën rrugën e asfaltuar të Shën Felsit, ku vazhdonte drejt aerodromit të aviacionit ushtarak Gjermano-Lindor, që përdorej dhe nga ai Sovjetik. Dheu i gërmuar hidhej larg me kamionë të mbuluar me arka që mbanin etiketa mallrash të ndryshme, për të mos ngjallur dyshime. Në stacionin e radarit amerikan punonin gjithashtu për regjistrimin e bisedave 432 aparate përgjimi. Nëpërmjet tunelit të përgjimit, CIA mblodhi shumë informacione sekrete³⁴.

Në shkrimin, *Kodi sekret i këpucëve të CIA-s: si agjentët komunikojnë me lidhëset gjatë Luftës së Ftohtë*, trajtohet një nga teknikat e mundshme të CIA-s për maskimin e veprimeve të agjentëve. Një seri dokumentesh të deklasifikuara në vitin 2009, zbuluan ekzistencën e “The Official CIA Manual of Trickery and Deception”, një manual i përgatitur në vitin 1950 nga magjistari amerikan John Mulholland, me porosi të CIA-s. Qëllimi i tij ishte të mësonte agjentët si të maskonin veprimet, të fshihnin objekte dhe të dërgonin sinjale pa u vënë re,

³² Julian Evans, *Operacioni sekret i CIA-s që fitoi Luftën e Ftohtë*, The Daily Telegraph, FAKTOR.AL, publikuar me: 8.03.2025.

³³ Po aty.

³⁴ Hasan B.Luçi, *CIA nëpër botë gjatë Luftës së Ftohtë (1947-1990)*, Shtëpia Botuese Julvin, Tiranë 2018, f.103.

përfshirë përdorimin e sendeve të zakonshme, si stilolapsat, butonat apo edhe lidhëset e këpucëve. Sipas dokumenteve, disa stile të pazakonta të lidhjes së këpucëve mund të shërbenin si shenjë e koduar për të sinjalizuar mesazhe të thjeshta për shembull, për të treguar nëse një takim ishte i sigurt apo nëse agjenti ishte nën mbikëqyrje. Megjithatë, manuali nuk përmbante kode konkrete (si p.sh, takim në orën 02:00) dhe shumica e kuptimeve ishin të përcaktuara paraprakisht mes agentëve dhe jo të standardizuara³⁵.

Ekspertë të historisë së spiunazhit si H.Keith Melton dhe Robert Wallace, të cilët ribotuan manualin pas deklasifikimit, sqarojnë se pjesa më e madhe e teknikave të përshkruara ishin më shumë për trajnime sesa për përdorim real në terren. Manualët origjinale të Mulholland madje ishin urdhëruar të shkatërroheshin, ku vetëm një kopje e vetme ka mbijetuar. Faqe të specializuara si Ian's Shoe Lace Site, përmendin "CIA Lacing" si një shembull të sinjalizimit diskret, por vetë pranojnë se nuk ka prova konkrete që këto metoda janë përdorur në ndonjë operacion real. Arkivat zyrtare të CIA-s nuk përmbajnë dëshmi për përdorimin praktik të kodeve me lidhëse këpucësh në misione të vërteta. Megjithatë, fakti që agentët e asaj kohe trajnoheshin për të përdorur çdo detaj të vogël si mjet komunikimi, e bën këtë histori të besueshme në parim. Ashtu si cigaret, gazeta apo mënyra e mbajtjes së kapelës, edhe lidhëset mund të shërbenin si "gjuhë e fshehtë" e inteligjencës amerikane, si një shenjë e epokës kur çdo gjest kishte potencial për të qenë një mesazh i caktuar³⁶.

Ndër sfidat kryesore që kishin fuqitë e mëdha gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, ishte hartimi i një baze ligjore efektive, për administrimin e dokumenteve me karakter, "sekret shtetëror". Para së gjithash, duhej të përcaktoheshin qartë të drejtat dhe detyrimet e institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes, zyrtarëve të lartë dhe shtetasve, për zbatimin me rigorozitet të ligjit dhe procedurave standarde për ruajtjen, administrimin dhe shfrytëzimin e sekreteve shtetërore. Gjatë Luftës së Ftohtë, dënimet penale për shtetasit që përhapnin sekrete shtetërore veçanërisht për shërbimet e huaja të zbulimit, kanë qenë shumë të rënda. Dënimi me vdekje i çiftit të rozenbergëve ishte një rast paksa i paprecedentë, duke marrë parasysh se ky dënim u krye në SHBA, vend i cili konsiderohej me një demokraci të lartë, veçanërisht në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Me kalimin e kohës, dolën në dritë shumë fakte të cilat sollën një varg dyshimesh për integritetin dhe aftësitë profesionale të hetuesve dhe sistemit gjyqësor të SHBA. Kërkimet e fakteve në periudhat e mëvonshme nxorën në dritë se njëri nga bashkëshortët nuk ishte i përfshirë në veprimtari spiunazhi.

³⁵ Korrespondenti.com, *Kodi sekret i këpucëve të CIA-s: si agentët komunikojnë me lidhëset gjatë Luftës së Ftohtë*, publikuar më: 9.10.2025, 12:35.

³⁶ Po aty.

Në dhjetor 1975, FBI e hoqi sekretin mbi dosjet e çështjes së rozenbergëve³⁷. Në vitin 1983, dy historianë amerikanë, Ronald Radosh dhe Xhojs Milton, botuan një studim më të bazuar, si rezultat i katër vjet kërkimeve, duke shfletuar dyqind e pesëdhjetë mijë skeda të FBI-së. Përfundimet e studimit nuk ishin të favorshme për të dënuarit. Sipas studimit të Radoshit dhe Miltonit, Julius Rozenbergu ishte me siguri fajtor për dhënien e informacioneve sekrete rusëve mbi bombën atomike, ndërsa Ethel nuk ishte në dijeni të veprimtarisë agenturore së bashkëshortit të saj. FBI-ja e dinte këtë, por këmbënguli që të dënoheshin të dy me qëllim që ti bënë presion Juliusit që të pohonte përgjegjësitë e tij për të shpëtuar nga karrigia elektrike gruan e tij³⁸.

Sipas autorëve të librit, “Krimet e Mëdha të Historisë”, ka akoma paqartësi mbi vërtetësinë e fakteve dhe provave që dërguan në karrigen elektrike çiftin e rozenbergëve. Gjatë procesit gjyqësor nuk u tha se Julius Rozenbergu i kishte marrë sekretet e bombës atomike në një mënyrë të panjohur, por u tha se atij ja kishte dhënë gjatë një darke Devid Gringlasi, i cili nuk kishte as njohuritë e nevojshme dhe as mjetet materiale për të transmetuar të dhëna të tilla. Dënimi i Rozenbergëve u bë duke u mbështetur mbi disa prova të rreme dhe mbi dëshminë e Gringlasit. Sipas autorëve të librit ata nuk e meritonin dënimin me vdekje³⁹. Çifti i Rozenbergëve iu nënshtua një procesi të padrejtë, nën presionin e një opinioni fanatik, ku mbetën shembulli i viktimave të intolerancës.

Vlen të nënvizohet fakti se, pavarësisht masave që ndërmori qeveria e SHBA-së dhe e Britanisë së Madhe, për ruajtjen e dokumenteve të klasifikuara që përbënin “sekret shtetëror” gjatë Luftës së Ftohtë, strukturat e shërbimeve inteligjente shfaqen edhe mangësi në zbulimin dhe parandalimin e veprimtarive të ndryshme agenturore të KGB-së.

Përfundime

Në përfundim të këtij punimi, është me interes të nënvizohet fakti se roli i shërbimeve inteligjente gjatë Luftës së Ftohtë (1945-1990), kontrolli dhe administrimi i informacioneve sekrete përbënin një element thelbësor për fuqitë e mëdha. Shërbimet inteligjente si CIA (Central Intelligence Agency), MI6 dhe KGB luajtën një rol vendimtar në këtë proces, duke vepruar jo vetëm si struktura për mbledhjen e informacioneve sekrete, por edhe si aktorë aktivë në zhvillimet politike dhe ideologjike në shkallë ndërkombëtare.

³⁷ Pierre Bellemare & Jean-François Nahmias, *Krimet e mëdha të Historisë*, Shtëpia botuese Zenit Editions, Tiranë 2006, f.196.

³⁸ Po aty, f.197.

³⁹ Po aty, f.198.

Aktiviteti i tyre përfshiu një gamë të gjerë veprimesh, duke filluar nga operacionet e fshehta dhe infiltrimi, deri te manipulimi i opinionit publik dhe ndërhyrjet indirekte në shtete të tjera. KGB ishte një aktor i fuqishëm në skenën ndërkombëtare, ku siguroi informacione strategjike, por edhe ndikoi në zhvillimet politike dhe ideologjike globale. Në aspektin e brendshëm, KGB-ja luajti një rol të rëndësishëm në ruajtjen e regjimit komunist. Ajo mbikëqyrte qytetarët sovjetikë, shtypte disidencën dhe kontrollonte çdo formë opozite politike apo ideologjike. Në këtë mënyrë, KGB-ja nuk ishte vetëm një shërbim inteligjence, por edhe një instrument represiv i shtetit⁴⁰.

Pas rënies së Murit të Berlinit, vendet e Evropës lindore u përballën me një valë të madhe ndryshimesh, të cilat erdhën në një kohë shumë të shkurtër. U trashëguan më mijëra dosje me dokumente të ndryshme, për të cilat ishte e nevojshme të hartohesh një bazë e re ligjore në përputhje me ligjet e shtetit të së drejtës dhe standardet bashkëkohore. Kështu, arkivat e KGB-së kishin ruajtur më shumë se 10.6 milion dosje të ndryshme, me informacione të klasifikuara si sekrete shtetërore. Vetë aparati qendror i KGB, trashëgoi rreth 650 mijë dosje⁴¹.

Një nga aktet administrative më të rëndësishme, ishte urdhri i kryetarit të ri të KGB-së, i cili e ndaloi kategorikisht zhdukjen e dosjeve sekrete të trashëguara nga regjimi komunist. Ky urdhër doli konkretisht gjatë grushtit të shtetit, i cili u zhvillua në ish-Bashkimin Sovjetik në dhjetor të vitit 1991⁴².

Ruajtja dhe administrimi i sekreteve shtetërore gjithnjë ka qenë një sfidë e madhe, sidomos për shtetet me ndikim të lartë në gjeopolitikën ndërkombëtare. Pas rënies së komunizmit në ish-Bashkimin Sovjetik, situata u bë e brishtë dhe ekzistonte mundësia që shumë prej dokumenteve sekrete të deklasifikoheshin dhe të shkaktonin kaos dhe anarki politike.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, institucionet përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të klasifikuara me karakter “sekret shtetëror”, janë përpjekur të tregojnë gjithnjë kujdes të veçantë për t’i ruajtur dhe administruar ato në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të hartuara për këtë qëllim.

Pavarësisht zbatimit të masave rigoroze për mbrojtjen e dokumenteve sekrete nga fuqitë e mëdha gjatë Luftës së Ftohtë, duhet nënvizuar fakti se nuk u arrit plotësisht parandalimi apo goditja në kohën e duhur e veprimtarive agjenturore të shërbimeve inteligjente.

⁴⁰ Amy Knight, *The KGB: Police and Politics in the Soviet Union*, (Boston: Unwin Hyman, 1990).

⁴¹ Vadim Bakatin, Çlirimi nga KGB, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, f.134.

⁴² Po aty.

Bibliografia

1. Bakatin, Vadim, 1994. *Çlirimi nga KGB*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Ushtrisë.
2. Paçepa, Mihai, 2004. *Prapaskenat e Shtëpisë Çausheku*, (rrëfimet e ish-shefit të Shërbimeve Sekrete Rumune), Tiranë: Botimet Enciklopedike.
3. Barron, Xhon, 1993. *Veprimtaria e errët e KGB dhe një dëshmi e Sollxhenicinit*, Tiranë: Shtëpia Botuese Arbri.
4. Bellemare, Pierre, 2006. *Krimet e mëdha të Historisë*, Tiranë: Shtëpia Botuese Zenit Editions.
5. Gega, Simon, 2013. *Dimensioni i Sigurisë së Shtetit dhe Forcat e Armatosura*, Tiranë: Shtëpia Botuese Kristalina-KH.
6. Luçi, Hasan, 2018. *CIA nëpër botë gjatë Luftës së Ftohtë (1947-1990)*, Tiranë: Botues Julvin.
7. Brus, Xhin, *Agjenti 117 në Meksikë*, 1993. Tiranë: Shtëpia Botuese e Ushtrisë.
8. Macintyre, Ben, 2019. *Spiuni dhe Tradhtari*, Tiranë: Shtëpia Botuese Boart.
9. Popov, Dushko, 1994. *Tricikli Agjenti i Dyfishtë*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Ushtrisë.
10. Shirer, William, 2019. *Ngritja dhe Rënia e Rajhut të Tretë*, Tiranë: Shtëpia Botuese Onufri.
11. Shkodrani, Andrea, 2003. *SPIUNAZH, (Operacione Brilante)*, Tiranë: Shtëpia Botuese Elitë.
12. Botimet onlajn
13. Evans, Julian, *Operacioni sekret i CIA-s që fitoi Luftën e Ftohtë*, The Daily Telegraph, FAKTOR.AL.
14. Korrespondenti.com, “Kodi sekret i këpucëve të CIA-s”: si agjentët komunikonin me lidhëset e këpucëve gjatë Luftës së Ftohtë, më 9 tetor 2025.
15. *Armët sekrete të spiunazhit të Luftës së Ftohtë*, LAPSI.al. 07.04.2024.
16. Mundy, Liza, “Si u bënë gratë pjesë e shërbimeve sekrete gjatë Luftës së Dytë Botërore”, Gazeta Koha Jonë.
17. Andrew, Christopher & Gordievsky, Oleg, *KGB The Inside Story of Its Foreign Operations from Lenin to Gorbachev* (London: Hodder & Stoughton, 1990).
18. Mark, Galeotti, *The KGB: A Very Short Introduction* (Oxford: Oxford University Press, 2017).

19. Macintyre, Ben, *A Spy Among Friends: Kim Philby and the Great Betrayal* (London: Bloomsbury, 2014).
20. Rid, Thomas, *Active Measures: The Secret History of Disinformation and Political Warfare*, (New York: Farrar, Straus and Giroux, 2020).
21. Knight, Amy, *The KGB: Police and Politics in the Soviet Union*, (Boston: Unwin Hyman, 1990).
22. *Armët sekrete të spiunazhit të Luftës së Ftohtë*, Radio Evropa e Lirë, 2024.

